

INTERVISTË ME ADNAN MEROVCIN

Prishtinë | Data: 28 nëntor dhe 3 dhjetor, 2018

Kohëzgjatja: 400 minuta

Të pranishëm:

1. Adnan Merovci (I intervistuari)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (intervistuesja)
4. Besarta Breznica (Kamera)
5. Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Okej, a mundesh... po kthehemi prej, në fillimet e jetës t'juj. Me na tregu diçka për fëmininë, për kujtimet e hershme t'fëminisë edhe për familjen e juaj. Ku jeni lind, çfarë familje ka qenë ajo? Qysh e mbani në mend fëmijërinë e juaj?

Adnan Merovci: Okej, domethanë, prej se kam ardhë në vetëdije, vetëdija kuptohet deri sa mbanë në mend njeriu si fëmi. Une kam lindë në një familje t'madhe le t'themi. Tash kjo fjalë e madhe i ka dy kuptime, edhe n'sasi mos t'thom tash edhe në kuptimin tradicional që thuhet, familje e madhe, familje me themel, me emën. Pa modesti, po këto te dyjat janë te une rast real. E para, domethanë, unë maj n'mend kur në familje, domethanë, kemi qenë 36 anëtarë, t'familjes. Une jom djali ma i vogël i babës edhe nanës time të tetë fmise, dhe jam edhe djali ma i vogël po edhe fëmiu ma i vogël, domethanë, sugari siç i thojnë. Dhe kam lind në vitin 1956, në ni shtëpi ku ka përfundu ndërtimi në vitin 1941, domethanë, n'prag të Luftës së Dytë Botnore shtëpia jonë osht' përfundu në Vushtrri.

Dhe kjo shtëpi ka qenë shtëpia ma e madhe n'qytetin e Vushtrrisë e ndërtume, që i bie se rrjedh edhe prej një familje, le t'themi tani, edhe mirë materialisht ose me ni pasuni solide, por duke qenë shtëpia ma e madhe edhe n'atë kohë e ndërtume me mjeshtër, flitet, domethanë pak a shumë ai... baza, themeli, prejardhja, ndërtimi fëminor e tjera, e tjera se ka shumë faktorë që ndikojnë. Dhe t'u marr parasysh ni numër të anëtarëve kaq t'madh, jep me kuptu që, domethanë vet une jom rrit në ni kolektivitet edhe me i thanë me ni celulë elementare t'shoqërisë që quhet familje, goxha t'madhe. Dhe atë që e mbaj në mend si ecuri në rrjedhën e familjes ka qenë hierarkia, domethanë prej... e mbaj në mend babgjyshin edhe gjyshen. Babgjyshi ka qenë bashkëpunëtor dhe bashkëkohanik i dijetarit t'madh e patriotit t'madh Hasan Prishtina n'atë kohë.

Dhe këto une po i them sepse kom rrëfime për të që m'i ka thanë babgjyshi, Mynin Merovci thirret dhe gjyshja Sherifja. Nga të cilët, domethanë deri vonë krejt kjo familje pak a shumë... përndryshe, stërgjyshi m'ka ardhë prej fshatit Merovc në Toplicë, në Serbinë e Jugut të sotit dhe ekziston edhe sot ky fshat. Në atë kohë mbaj në mend funksionimin e familjes, domethanë familja ka funksionu si ni shtet. Pse? E ka pasë t'parin e familjes, e ka pasë t'dytin e familjes edhe t'dytë gjithëherë ka qenë e zoja

e shpisë, përgjegjësisht gjyshja. Dy djem që i ka pasë babgjyshi jem, domethanë babën tim dhe axhën, dhe dy motra. Domethanë, katër fëmijë i kanë pasë n'jetë dhe t'gjallë.

Mund të dihet që fëmi ka pasë edhe ma shumë, po në ato kohna fëmitë edhe kanë pësuar shumë. Domethanë, nuk kanë mbijetuar sepse kanë qenë kohna me epidemi t'ndryshme edhe vështirë, si me thanë, kanë mbijetuar. Dhe nga ky brum kanë lind mandej krejt ky arsenal i ni familje goxha shumë t'madhe dhe në këtë aspekt une mbaj në mend funksionimin e familjes. Nuk po hy në gjana tjera ose hyj kohë pas kohe, por fjala vjen, çashtjen e ushqimit. Ka qenë problem me i ushqy qita njerëz, n'familje. Mbaj n'mend nanën time që ka qenë e angazhume me punë të bylmetit dhe të bukës, le t'themi, dhe kemi pasë në oborr t'shpisë furrë, furrë që, dhe kur them furrë, furrë e ndërtume me dru dhe aty është përgaditë ushqimi i tërë.

Kemi pasë tokë shumë, domethanë dhe punëtor shumë të marrun, siç i kemi qujt në atë kohë, argat ose punëtor fizik që kanë punu. Për me e dhanë ni detaj që e ilustron shumë për krejt këtë dhe fëmininë time, une mbaj n'mend si fëmijë dhe duke iu çu bukën argatëve, tani punëtorëve, nëpër tokë e ara ku kemi, ku ka punu babgjyshi e baba e mixha, kanë qenë deri në dyqind njerëz të angazhum për ni ditë. Të marrun dhe shpesh herë ka qenë edhe problem m'i gjetë. Kur ka qenë çashtja e herrjes së qepve, le t'themi, me herrë qepë nëpër lehë, thuhet domethanë ai veprimi ku hjekën...

Aurela Kadriu: Me i hjek barishtet.

Adnan Merovci: Barishtet, kanë qenë. Ka pasë rast, këto tash une po i them, jo se e kom ditë une atëherë me i numëru, kam qenë fmi kalama, por prej rrëfimeve t'matutjeshme ka pasë rast që kanë qenë deri në treqind gra t'angazhume për me e punue këtë punë. Pra, flitet për ni familje t'madhe dhe që është ni model i shtetit n'kuptim të funksionimit. Mëngjesi është ditë n'sa duhet me u ngritë anëtarët, puntë kanë qenë të ndara, ushqimi ka qenë n'kohnat kur s'ka qenë sezona e punës. Le t'themi, i ndamë, tavolinat për fëmi, tavolinat për grupmoshën e mesme dhe tavolinat e mëdha për ata kryesorët, le t'themi, sofra parë siç i kemi thanë ne.

Dhe une e mbaj në mend rendin e fëmive t'u pritë n'rend m'i la durty, me i fshi durty, me u ulë, me e hongër ushqimin në tavolinë. Në disa tavolina kështu, jo me karriga, por si banka shkollore të gjata. Dhe për shembull, ka qenë dëshira ma e madhe që ndonjëherë... se une e kam mburri energjinë elektrike, domethanë nuk i takoj gjeneratës kur s'ka pasë energji hiç. Me u ndal rryma edhe në ushqim që, atëherë si fëmi, domethanë me marr n'sofër çka t'dush edhe qysh t'dush. Ka pasë edhe këso që m'kujtohen sot.

Dhe ka qenë ni funksionim definitivisht i jashtë... i, i rregullt dhe kjo është ni ilustrim i prejardhjes time si familje, si fëmi dhe ni hierarki dhe ni rregull që ka ekzistuar. Domethanë, baba ka qenë ai që osht', si me thanë, paraardhës i yti por edhe një njeri, duhna ta them, i idealizim si fëmi që ai din çdo gjë, ai

çdo herë e ka mirë, atë duhet me ndëgju dhe ai është ni zot i vogël në tokë, derisa Zoti i madh na qenka n'qiell. Po të flas për fëmininë.

Çashtja e fëminisë te une shquhet n'familje edhe për ni aspekt se, ne e kemi pasë ni detaj t'vogël n'familje dhe këtë e dijnë edhe familjarët po edhe fqinjët aty që kanë qenë; që ne e kemi mbajt ni njeri me vite t'tëra i cili ka qenë me, me aftësi t'kufizume dhe babgjyshi e ka gjetë n'rugë dhe e ka marr dhe e kemi mbajtë me vite. Tani une këtë shumë nuk e mbaj n'mend, sepse ai ka ndrru jetë kur i kam pasë une tri vjet. Mu m'kujtohet vetëm andërr, si hije, por m'kujtohen reliktet, gjanat e mbetuna. Dhe ato kanë qenë dhoma e Bajramit, se Bajram e ka pasë emnin ai dhe n'përgjithësi domethanë ka qenë edhe ai ni institucion n'veti sepse ka qenë anëtar i barabartë i familjes, ka pasë dhomën e vet, ushqimin dhe kohën e ndejës. Sidomos dimrit kur s'ka pasë punë n'tokë, n'ara, ku kemi ndejtë, kanë ndejtë, tani vllaznit e mi, e motrat, e hallat ma t'vjetra, se une të thashë që kam pasë tri vjet kur ka ndrru jetë. Por, shquhet si familje edhe ky detaj që e flet pak a shumë atë fëmininë time, t'u marr parasysh që kur jom rrit kom pytë mandej çka u kanë puna e tij? Si? Qysh? Dhe kjo e ka pasë ndikimin e vet.

Dhe ni gja tjetër, ni moment, është n'lidhje me çashtjen e problemeve që mundet fëmiu me i bo, me fqinjët, me shoktë, pse jo edhe n'shkollë, domethanë që e mbaj në mend dhe domethanë që nuk m'harrohet, nuk e harroj as sot që për ndonjë ngatërresë eventuale... se si natyrë kam qenë i qetë, e i urtë edhe goxha i friksum prej familjes për me bo probleme jashtë. Çdo herë ka funksionu, si me thanë, parimi që fajtori t'lypet n'shtëpi mandej jashtë. Kjo i bjen që unë kom pasë probleme me bo probleme jashtë për shkak të dënimit që kam me pësu pa gjygj fare. Domethanë, prindi fillimisht e ka lyp fajin te unë pa gjygj, domethanë pa pyt fare une e kom pagu dhe pagesa nuk osht' e thanun me ndëshkim fizik, me rrahje, por ka mjaftu ni fjalë ose ni, dy-tri fjalë ose ni marrje n'pytje dhe atëherë ka qenë, domethanë, shumë e randë ajo. Dhe kjo ka qenë si preventivë edhe bile bile kjo m'ka përcjellë gjatë jetës që goxha shumë jam frigu me bo probleme, si me thanë, dhe kjo është fëminia ime.

Mandej fëminia m'lidhet edhe me ni rast të ni qingji që ma ka ble babgjyshi, se une kam qenë i lidhun shumë me babgjyshin. Dhe ai për ko incidencë, ai qingj emrin e ka pasë Reksi. Unë s'ia kom vnu, sigurisht vllaznit ma t... une kom qenë, domethanë po flas për periudhën parashkollore ose qatëherë veç n'vitin e parë, të dytë. Dhe merreni me mend, ai qingj dhe qingj tanë kohën une e kom konsideru... ka qenë ni periudhë para klasës t'parë dhe ai ka qenë i lidhun me mu. Domethanë, sikur që mund t'thuhet për ni qen, a ni macë që e zgjedh të zotin vet, ai m'ka zgjedh mu. U kanë çudi.

Dhe kjo ka ndiku që dikun ni vjet ai nuk osht' pre, se u marr ni qingj me u pre a kupton dhe meqenëse ai është lojalizu me mu shumë dhe kam pasë lidhje edhe emocionale edhe me të, atëherë babgjyshi e ka shty, si me thonë, përdorimin e tij për çka osht' marr. Dhe e mbaj në mend niherë në shkollë m'ka ardhë mrapa dhe une se kam pa fare deri në oborr t'shkollës. Kjo është pak nifarë prrallë por është prrallë e vërtetë, si me thanë, dhe këta e dijnë familja edhe e dijnë njerëzit.

Une kam pësue nifarë shoku t'vogël në kohën kur ai qingj, i ka ardhë fundi dhe çka t'bohet me të përpos që e kanë pre. E kanë pre pak si, si msheftas prej meje po une ndërkohë e kom kuptu dhe unë prej atëhershish mishin e qingjit nuk mundem me paramendu në sofër. Dhe kjo është ni kujtim që mu m'ka mbetë, Reksi. Dhe për kohëzgjatë, vëllau im tani djalë e tij t'madh e thirr Reksi, domethanë e ka ni *nickname* [nofkë] Reksi në dashurinë time që e kam pasë për ni qingj në fëmijë. Domethanë, pak a shumë është kjo.

Prëndryshe, po flasim gjithëherë për kohën e mas Luftës të Dytë Botnore, ku une i lindun n'vitin '56, domethanë atëherë kanë qenë dikund dymbëdhjet vjet, mbi ni dekadë. Fëmijë mas Luftës të Dytë Botnore kur dihet si ka qenë gjendja, le t'themi, edhe politike n'shkollë, edhe planprogrami... por gjithëherë e kom pasë atë, nifarë edukate n'aspektin edhe kombëtar prej babgjyshit. Se babgjyshi duke pasë kohë dhe duke qenë une ma i vogli, ai dashurinë ma së tepërmi e ka manifestu me mu në krejt familjen dhe e kam pasë ni relatë t'hatashme. Ai ka ndrru jetë njizetë vjet mandej, në vitin '76. Pra, une 20 vjet i kam pasë kur ai ka ndrru jetë dhe mjaftushëm kam marrë, si me thanë, rrëfime nga ai dhe mbaj n'mend shumë gjana.

Bile atë e kanë thirr në Vushtrri, patron i t'rive, se ka qenë njeri shumë i dashun nga brezat e ri. Ka qenë shumë bashkëkohorë, ka qenë ni, unë duhna me thonë ni plak, dy metra i gjatë edhe ni, ni, le t'themi edhe bukurosh, por pa ekzagjerim dhe i njoftun n'atë anë dhe pa.... Mos me lanë anash edhe babën, se babën babë, por unë duhna me thonë që e kom pasë nifarë emocioni të veçantë për babgjyshin. Dhe pak a shumë, kjo është fëmijë ime.

Dhe mandej n'shkollë kemi shkue... niherë m'kanë çu gjashtë vjet, nuk kom dashtë me shku n'fillim, kom hezitu, nuk e di pse, se ka qenë angazhimi n'familje shumë i madh. Mandej e kom ndërpre ni vit dhe kam shku kur i kam bo shtatë vjet, shkollën e parë. Mandej e kom ndrru se osht' ndrru ajo shkollë, dhe shkollën fillore e kom kry në "21 Nandori" është thirrë atëherë, dita e çlirimit kishe të Vushtrrisë e tjera, e tjera. Dhe kjo është pak a shumë ajo periudha kur une e mbaj në mend si ecuri, në ni familje shumë t'madhe ku ka funksionu n'përgjithësi hierarkia familjare, që definitivisht une sot n'moshën që jom, domethanë e shoh atë ndikimin shumë t'madh.

Bile edhe sot une jetoj me dy djemtë dhe në shtëpi i kemi pesë fmi, pesë nipa, ku rrijmë. Ka pavarësi secili, por prapë e kemi jetën e përbashkët. Dhe gjithëherë e them që edhe nipat edhe mbesat nuk kanë dam asgjë nga ni jetë fëmijë në, qysh i themi ne n'kallabllak, sepse thithet ni realitet tjetër, ni realitet që s'mund t'kompenzohet nga ni mënyrë tjetër jetese. Tash nuk du t'them që edhe kush jeton n'bashkësi të zvoglume që, që nuk osht' në rregull, por sido që të jetë nëse jipet rasti dhe nuk ka dame rreth kësaj, sepse msohet njeriu me kolektivitet. Nifarë hierarkie, nifarë respekti që ka funksionu edhe m'ka përcjellë tanë, tanë jetën.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë qajo jeta mrena n'shpi? Ju keni jetu edhe me fëmijë e axhës n'shpi, sa fëmijë i ka pasë axha?

Adnan Merovci: Axha... tani unë kur thash 36 anëtarë, kom mendu në anëtarë edhe të hallave, kallabllak kur jena... domethanë, në familje ka ndodhë vikendi kur i kem pasë 36, si me thanë, dhe këtë une të thashë nuk e kam ditë por masandej nga rrëfimet e kam kuptue këtë farë përbamjen. Po, kemi jetu me axhën, dhe ne shtëpinë duke e pasë t'madhe, secili e kem pasë dhomën tonë, domethanë, secili. Kanë qenë dhomat, domethanë për secilin vëlla, për secilën motër, hallat e mija, dhe për gjyshen dhe babgjyshin, plus ka pasë dhomat ndihmëse. Ka pasë, siç i themi ne, ashefi, ashef i kanë thanë atëherë ni pjesë ku përgaditet ushqimi edhe hahet ushqimi, si formë kuzhine. Por, shumë e madhe edhe ajo e ndame në tri pjesë, ni pjesë ma e naltë ku sofa e parë u kthy, e mesmja dhe fëmitë knej, ku kanë qenë dhe ka qenë ni pjesë ku ka qenë sikur lavamanat e sotshëm...

Aurela Kadriu: Po...

Adnan Merovci: Dhe janë kanë dy. Njani për tjerët ma t'moshumit dhe neve fëmive. Dhe ka qenë ni koekzistencë që ka funksionu sepse ka pasë sistem t'vlerave, domethanë, kryesorët, domethanë, babgjyshi me gjyshen dhe baba me mixhën kanë funksionu siç funksionohet me respekt reciprok dhe ne fëmitë mandej, fëmiu osht'... rrushi t'u e pa rrushin piqet thuhet edhe ndërtohet n'përgjithësi. Ka diçka gjenetike që trashëgohet edhe kuptohet. Por, t'u marr edhe nga ana e nanës, domethanë nana ka rrjedh prej ni familje t'beglerëve dhe ka qenë pak ni elitë urbane e nivelit ma t'qytetnum, mos t'thom nashta se baba. Dhe une sot kur muj me i analizu këto gjana edhe me i testu në vetëvete sepse njeriu evulon edhe shumë mirë n'moshën çfare jom e sheh çështjen edhe komponenten e trashëgimisë edhe atë t'përfitume si në vese, si në tabijate, në huje, në temperament e tjera, e tjera.

Pra, ka funksionu shumë mirë dhe ka pasë reciprocitet dhe ka pasë respekt të dy anshëm. Kuptohet ka pasë edhe anë personale ku, për shembull komunikimi me nanën time edhe me pse n'kallabllak dhe me ni dhomë ku fëmitë kanë qenë... sepse si t'vegjël në ni dhomë kemi ndejtë ku kanë ndejtë edhe prindtë sepse familja e madhe, ni dhomë për neve, po ka qenë edhe ni banjo që atëherë i kem thanë hamamxhik, i ndamë, secila dhomë. Osht' ditë që kjo osht' nana jote dhe me këtë e ke edhe lidhjen emotive, po edhe këtë sociale sepse ti me nanën fol diçka ndryshe n'krahësim me grunë e mixhës që si familje kanë funksionu...

Ti ke mujt me pasë ni simpati për ni çikë t'mixhës ma shumë se nashta për motrën se kur funksionon familja ashtu aty nuk ka ndarje, si me thanë, n'aspektin e afërsisë t'gjakut, po është çashtje thjesht e raportit social qysh njerëzit janë. Por gjithëhere mbaj n'mend e di që këta janë t'afërmit e mi, të partë e mi. Une edhe si gjeneratë, si ma i vogli prej krejtve... ne jemi edhe sot pesë vllazën edhe tri motra, domethanë, une pak jom ky i privilegjumi, pak... nashta jo i lazdrumi po kështu n'shiqim t'jashtëm pak ma i përkdhelni, sidomos p'i babgjyshit e kom pasë këtë privilegj. Po kurrë nuk jom kanë i lirë me bo çka t'du jashtë oborrit sepse e di që m'ka prit ndëshkimi.

Dhe nuk ka pasë gja ma e randë se me i pasë shku n'vesh babës ni fjalë që osht' bo ni problem, ka marr pjesë Adnani dhe tash une n'mramje... dhe ka ndodhë që shpesh here kam ra me fjet edhe jam bo kishe po flej, veç që t'mos ballafaqohna me babën sepse baba ose prindët e asaj... n'atë kohë kanë mujt çdo gja por nuk kanë bo gjana, le t'themi, brutale n'këtë rast. Nëse kom qenë fjet nuk o marr me mu, dhe kjo ka ndodhë dy-tri herë n'qata t'nxehtë dikur nana m'ka rrëfy që ka kalu ajo punë pak edhe ka ecë. Pra, tani prej kësaj distance kohore kur e mendoj, une megjithatë e konsideroj si, si ni vlerë të funksionimit të familjes.

Aurela Kadriu: Ku e keni pasë shpinë në Vushtrri?

Adnan Merovci: Shpija ka qenë, i themi ne, si te ambullanta e vjetër. Ambullanta e vjetër osht' ni ndërtesë e madhe, bile osht' e stilit austro-hungarez tash ka hy nën mbrojtje, osht' ni... nuk osht' n'qendër por është pak në nifare si, me thanë, pak periferi atëherë dhe ekziston edhe sot. Ajo shpi nuk osht' si pronë e jona ma, ne ndërkohë e kemi shitë, por ekziston dhe fjiu që e ka marr, ka bo edhe tri-katër shpia përreth këtë nuk e ka prishë dhe nuk e banon, nuk banonte, nuk e ka rrënu sepse dihet historia e kësaj shpie. Dhe ata me shenjë nderimi edhe për familjen tonë nuk mujn me bo ballë me rrënu edhe pse ajo funksionale osht' edhe sot.

Domethanë, fjala vjen, shtëpia ka pullaz t'mirë, ka ballkona t'mirë, ka, dy parë dritare i ka t'mira, që domethanë për dimrit osht' izolim, por për verës ni parë dritare i hjekshim. Kjo ma përngjanë sikur gomat e automjetit, verës ia qet tjera dimrit tjera. Edhe aty kanë qenë dritaret verës t'hjekne niparë dhe kanë qenë veç ni palë sepse është vera duhet ma freskët. Kur ka ardhë dimri, dritaret kanë ndejt ku kanë ndjetë, u ditë ku secila. Dhe kur flasim për dritare, po flasim për dritare që numri i tyre shkon ndoshta 70-80 krah t'dritareve, 80-90, se shumë dhoma, shumë dritare, shumë dalje. Dhe ajo shpi ekziston edhe sot në Vushtrri dhe është ni shtëpi që i ka t'gjitha tiparet e ni ndërtese familjare të asaj kohe.

Aurela Kadriu: Çka ka punu gjyshi që ka pasë kaq shumë pasuni?

Adnan Merovci: Gjyshi osht' marr me bujqësi, me tokë po ka qenë shumë punëtorë dhe n'atë kohë edhe Vushtrria dallohet me t'mirat që i sjell toka. Osht' toka shumë pjellore dhe dihen patatet, kompirat ma mirë me iu thanë popullorqe, të Vushtrrisë edhe laknat, domethanë, këto kanë qenë dy kultura dominuese dhe t'gjitha tjerat. Kem pasë tokë ku, për shembull, qysh kanë qenë 36 anëtarë niherë kanë qenë 36 trupa të kumbullave, ka pasë molla, dardha. Ka pasë do farë na iu thojshim bardakirika ose nëse këtë t'folne e dëgjon dikush prej gjeneratave e din çka janë, do farë frutash si n'formë pjeshkash, si... që as vet s'di me i dallu. Dhe ka qenë edhe bashçja domethanë.

Bashçja ka qenë e mbjellun me pemë, perime, boston dhe krejt këto. Ne kem pasë kontraktme, fjala vjen, n'kohën tash ma t'vonshme kur une n'shkollë fillore, n'shkollë, e mbaj n'mend ka pasë kontratë shtëpia dhe babgjyshi me menzën e studentëve të Prishtinës për furnizim me lakna dhe kompira,

domethanë, dhe ka funksionu. Në shtëpinë tonë kem pasë shtëpinë, ashefin, ahrijet për kafshë, dhoma e Bajramit, furra, çileri, hambari, dhoma e haletëve, dhoma e kompirave, bash po e thom origjinal, *sundurmja* edhe oborri edhe dy bunare. Domethanë, kjo jep me kuptu, që krejt në infrastrukturë e nevojshme ka qenë për kështu... dhe baba...

Aurela Kadriu: Çka është *sundurme* m'fal?

Adnan Merovci: *Sundurme* është si në *pojatë*¹, si në *pojatë*. Unë tash po i thom me qëllim këto...

Aurela Kadriu: Si verandë...

Adnan Merovci: Ajo është tash... jo verandë e sotit për me ndejtë. Osht' si *pojatë* ku lehet edhe ushqimi, edhe drutë, osht' pak a shumë e pa mbyllne, veç n'pullaz naltë; osht' e hapun, si me thanë, ku kryesisht lehet detelina ose tërfoja dhe kashta. Le të m'lejohet t'i përdori këto shprehje që i kem përdorë atëherë sepse pak a shumë janë për ilustrim edhe i tregoj saktë çka janë dhe krejt kjo ka qenë infrastrukturë e nevojshme për t'mirat, domethanë, pytja juj, çka ka punu babgjyshi që ka qenë kaq i pasun? Ajo pasuni nuk ka qenë pasuni unike, ka pasë edhe tjerë t'pasun por mënyra për me ardhë deri te... se pasuni osht' qujtun, me pasë tokë, me mjell... me punu tokën, atëherë, domethanë, edhe eventualisht naj zanatë.

Nuk ka pasë ndoni mënyrë tjetër ti me bo pasuni. Por, devotshmënia n'punë, toka e plleshme, puna. Për shembull, atë që e mbaj n'mend osht' që babgjyshi, siç i kanë thanë atëherë i ka rrëzu shtatë mexha. E ka pasë në tokë dikun, e ka punu, e ka ble edhe t'kojshisë, se tash edhe atëherë qashtja e globalizimit në ni mnyrë ka ec. Ai s'ka mujt me punu, ky ka mujt... u integru me to, nihere tokën me ia dhanë, e dikur e ka ble. E tjetrën, e tjetrën, shtatë mexha babgjyshi, domethanë, që e mbaj n'mend që në ni pjesë veç... edhe sot kur po flasim ni vëlla i jemi e trashëgon, fjala vjen, edhe te mixha tokë të asaj kohe dhe pasunia ka qenë ajo, me pasë tokë, me punu, me gjallnu dhe kjo osht' qujt si me thanë, pak a shumë pasuni.

Aurela Kadriu: E shkollën fillore qysh e mbani n'mend?

Adnan Merovci: Shkolla fillore ka qenë shkolla e "Bashkim Vllaznimit" atëhersh u konë në dogmë, t'themi edhe komuniste por ka pasë pedantëri. I mbaj në mend mësuesit e shkollës edhe shoktë... edhe sot jom shokë me ta. Ka pasë pedantëri, ka pasë seriozitet. E mbaj n'mend që në shkollë, për shembull e kom pasë ni rast kur... në këto vitet pak ma t'vonshme niherë kam shku me pantollë t'shkurtë n'shkollë dhe m'ka kthi kuriri. Më ka thanë, "Nuk bon me pantolla t'shkurtë", osht' ni detaj që flet edhe për kodin e etikës edhe pse, domethanë, edhe si fëmi ka qenë si periudhë, domethanë, jo e pantollave t'shkurtë.

¹ Serb.: *pojata* është një lloj shtëpize pjesë e shtëpitë fshatare, e cila shërben për llojloj qëllime: depo për alete, shpajz apo shtallë.

Se ni kohë edhe osht' leju, edhe preferu, por e mbaj n'mend si detaj. Dhe me këtë du t'them që ka pasë nifare sistemi të vlerave, të funksionimit. Pa hy tash në aspektin politik të përmbajtjes, e çka u msu, e tek u msu se ato i dijmë. Por, megjithatë kur familjen e ke pasë mirë, të ka funksionu mirë, ti gjithëherë e ke pasë, n'thojza, ni tutor që ty t'ka informu. Për shembull, n'atë kohë për çashtje të, le t'them, historike, letërsisë, romaneve, librave, ka mjaftu ni profesor, ni mësues, dy, dhe ka mjaftu që ai me t'mbajtë si me thanë, pak n'atë vetëdijën edhe kombëtare. Po, t'u pasë parasysh se edhe babgjyshin e kom pasë me emën në Vushtrri, atëherë ai m'i ka transmetu, si me thanë, historinat. Dhe unë historinë e parë t'popullit shqiptar e kom msu... bile edhe... pse jo edhe botënor.

Mbaj n'mend që babgjyshi mu m'thojke, m'folke për Kilin, si ni shtet në Amerikën Latine dhe ma bojke... kurrë nuk e harroj, domethanë edhe n'këtë kohë. "Osht' si rryp", thojke, "qishtuqe" {shpjegon me duar} kurrë nuk e kam ditë çka është kjo fjalë, si rryp. Kur jom vetëdisu, e pa, e gjeografi e kom kuptu që po flet për gjeografi edhe për harta. Tani, ai e ka pa dikun atë, po mu si fmi, fjala vjen këtë detaj ma ka thanë dhe kjo ka funksionu në atë kohë. Shkolla fillore ka qenë goxha e pasun, e mbaj n'mend që kem pasë, kom pasë probleme pak me gjuhën serbe sepse ka pasë serbisht landë, serbisht n'klasën e dytë për shembull dhe ka qenë ni problem... unë personalisht, sepse, domethanë, s'jom gjindë mirë në atë landë edhe e kom pasë ni ngatërresë me mësuesen e serbishtës që u kanë shumë e, e, e vështirë se mbahet mend.

Prej klasës t'pestë ka fillu me u msu edhe anglishtja dhe e mbaj n'mend fjalën e parë që e kom mësuar anglisht, *chalk*, *chalk* është shkumësi edhe *blackboard* është tabela e zezë, *window* e tjerë. Domethanë, këto kanë qenë ato pikantëritë që une i mbaj n'mend. Ka pasë edhe edukatë fizike, tani me edukatë fizike pak kom pasë problem edhe pse në natyrë kom qenë sportiv, po si tip për sportiv ma tepër i, mos t'them, jo i elistacitetit shumë edhe i mbaj n'mend ushtrimet që i kom bo edhe s'i kom bo. Edhe pse ma vonë mandej m'ka përcjell ni periudhe edhe ni sportisti goxha aktiv po ajo ka qenë n'shkollën e mesme pastaj.

Aurela Kadriu: Ku e mësojshit?

Adnan Merovci: Po ka pasë, domethanë, sallë të fiskulturës i thojshim na, edukatës fizike. Ka pasë në paralele, ka pasë unaza, ke pasë n'do farë dyshekë me bo sallta. Une do i bojsha përfekt e do që s'm'i dojke loçka s'i bojsha. E tash kom pasë gjithëherë problem me profesorët e edukatës fizike. E mbaj n'mend ni detaj t'vogël, ni mësues që... arsimtar, se tash po flasim për klastë... se mësues i kem thanë deri n'klasë të katërt, mandej arsimtar që... edhe ai ka ndrru jetë pastë ndjesë, ka qenë Xhevat Gjyshinca, Xhevat Cecelia, i cili m'ka dhanë BAT [Bazat e Arsimit Teknik]. Une kom pasë prirje për rrymë elektrike, e kom dashtë rrymën elektrike edhe si fëmi.

Si fëmi, për shembull n'atë kohë une kom bo instalime, kom bo atraksione t'ndryshme. Ka pasë raste kur kom bo edhe gabime se, edhe prej shpisë ma s'mirti e di qysh osht' me t'nxan rryma se m'ka nxan

njo 50 herë po fati që tensioni ka qenë i dobhtë edhe nuk... se thuhet kështu me shkencë që mbi 50W është ma e rrezikshme nën 50W rryma nën tension 50W nuk osht' e rrezikshme për jetë.

Por, m'kujtohet që n'orën e BAT-it t'u fol për do instalime elektrike diçka, po e shkrun arsimtari "Seksionin e tërthortë përçuesit". Ni përçues që përçonë energjinë elektrike m'varet prej seksionit të tërthortë, prej trashësisë t'tij dhe kjo trashësi me gjuhën konvencionale të teknikës po u shkrujka me "Fi" me simbolin φ ose germën F. Dhe ai e ka thanë këtë, e ka shkru n'tabelë e ka fshi edhe... në orën tjetër kur kemi folë, se zakonisht janë përsëritë, kur u ardhë puna te rryma une kam qenë shumë aktiv edhe i kom thanë, "Kjo n'varet edhe prej seksionit të tërthortë...", "Çka është tensioni tërthortë?" "Po...", kom thanë, "Osht' trashësia, osht' diametri i telit".

Diametri osht' dy rreze, se edhe prirje për matematikë kom pasë dhe thashë, "Kjo në shkrim shkruhet me germën F", "E çka osht' ajo F-ja?" Jom dalë n'tabelë veç e kom shkru, po se kom bo F të drejtë po F anash qysh ai e ka bo edhe u mahnitë. Ai u mahnitë edhe ka thanë, "Shko n'vend une s'mundem me vazhdu orën ma tutje, m'ke çmend", kjo, domethanë u... tepër u entuziazmu dhe për shpërblim ma mbylli pesëshe në orën e dytë a të tretë. Dhe në BAT e kom pasë t'mbyllun pesë, domethanë dhe kom shku në...

Tani këto janë gjana që, domethanë pikanteri që kanë ndodhë, se s'osht' nomi ni gja t'tillë me ditë. Por, du t'them që ka pasë edhe atëherë sistem t'vlerësimit që nëse arsimtari është... dhe e ka paraqit mandej në këshill sepse ka qenë pak nifarë, jo thymje e kodit t'notimit por nifarë gjaje e pa parapame a din, "Qysh mundesh ti me ia mbyll notën n'orën e dytë?" Ai ka thanë, "Nuk kom tekst, une muj me ia mbyll në kokë edhe kur t'vjen koha, por s'kom mujt pa e demostru qat' shpërblim që ka qenë". Osht' ni detaj goxha interesant.

Edhe m'kujtohet në gjuhën shqipe ni gabim shumë t'madh që e kom bo, u kanë fjala *popull*, edhe une kom mungu, ka qenë ndarje n'rrokje. Edhe sot me m'vetë e di çka është ndarja n'rrokje, veç ti kqyre qysh t'shkon rrjedhshmënia. Edhe kom dalë n'tabelë (qeshë) edhe arsimtari i gjuhës shqipe, se edhe shumë prirje s'kom pasë për letërsi e kështu n'fillim, thotë, "Qe për këta iu tregon Adnani", se kam qenë i dallum pak n'klasë e t'u mendu ai që une p'e di. Jom dalë kom gabu e kom shkru *pop-ull* edhe desh u çmend ai, po tash e kundërta ke (qeshë) tha, "Ty t'u ka mbyll pesëshe në BAT..." tha, "po duhet me ta mbyll nish në gjuhë shqipe". *My God* [Oh Zot]. Kanë qenë, domethanë këto dy raste kundërthanëse pak a shumë.

Aurela Kadriu: A keni fol turqisht n'shpi, a folshit?

Adnan Merovci: Jo, jo. Gjuha turke n'shpi nuk ka qenë gjuhë e folme e jona, por nuk ka qenë gjuhë e paditun. Pse? Dhe këta nuk po e thom për naj fanatizëm po realisht kështu. Nana ime, në familje t'vet e kanë fol turqishten, dhe kur them e kanë fol, ajo ndoshta edhe si fëmi... tash për gjuhë amëtare se po flasim për kohë.

Aurela Kadriu: Po de. Po, po...

Adnan Merovci: Gjuha amëtare quhet gjuha me t'cilën lindë dhe ajo rrjedh edhe kah trashëgu gjuhën turke, por ajo ka qenë shumë n'fillim dhe mandej kanë dalë shkollat, edhe nëpër shkolla edhe iu ka mbetë. Po kur une jom vetëdijësue në shtëpinë time mënyrën ma kategorike është fol gjuha shqipe, ajo dihet. Por, çka kom kuptu une në ndërkohë kur ka ardhë daja im ndonjhere dhe kur ka dashtë mos me e marr vesh na fëmitë ka fol me nanën turqisht ndonjë fjalë. Por turqishtja mandej u ardhë, u afru n'shtëpinë tonë sepse hallat, dy halla që janë kanë t'martume mandej, ato kanë emigrue në Turqi. Dhe në Turqi kanë emigrue dikund n'vitin '59...

Aurela Kadriu: Po, në '57, në '58...

Adnan Merovci: '59, '59-'60, unë kur kam qenë fëmi krejt dhe t'u qenë atje edhe fëmitë e hallave që kanë qenë edhe moshatare t'mija, mandej kur ka fillu mas gjashtë mujve kanë ardhë hallat që janë... se ka qenë ajo koha e shpërnguljes, e ku ta di. Edhe familja jonë ka qenë e pregaditme, po falë kambnguljes të babgjyshit ne nuk kemi dalë atje.

Përndryshe, mbaj në mend visikat i kanë thanë do dokumenteve ku jemi fotografu për pasaporta dhe me u depërtu, gjegjësisht me u shpërngul. Kjo ka qenë ni projekt që tashma dihet, i shpërnguljes, pak a shumë nifarë marrveshje. Por, këto moshataret, çikat e hallave që i mbaj n'mend, ne kemi komunikue mandej, ato kanë shku si fëmi disa, disa kanë lindë atje dhe gjuha turke mandej ka ardhë osht' bo... une mandej n'fillore, hajde de në t'mesmën... ka qenë edhe çashtja e muzikës, mandej t'u këmbi me to edhe muzika, disqeve t'ndryshme, t'u mos pasë edhe shqip shumë me Shqipni t'mbyllun, nuk i kom preferu këto serbe gjithaq edhe pse ka pasë kangëtare, hite që i kem ndëgju. Kjo turke m'u ka dokë pak ma, si me thanë, ndoshta ma e afërt.

Edhe gjuha turke ka fillu me m'u bo si objekt për me e mësu, tash kur po flasim, une në CV-në tem e shkruj gjuhën turke si njohje, bile krejt notat, në të folun, në të shkrun, në të kuptun i qes pesëshe dhe ata do që janë turq në Vushtrri që tradicionalisht nuk guxojnë mo m'u ni n'gjuhën turke. Sepse e kom mësu me rroj, sikur anglishten në mënyrë, domethonë dhe n'kta m'ka ndihmu t'thashë çikat e hallës. Komunikim me letra, me tekste t'kangëve. Mandej kom shku disa here në Turqi, në Stamboll. Kom vizitu edhe hallat dhe definitivisht gjuha shqipe n'vesh m'flen mirë edhe e zotnoj qaq sa edhe kom dashtë me u avancu, por tani nuk jam najfarë, najfarë eksperti i gjuhës turke, po nuk jam, nuk i frikohna as komunikimit, as shkrimit.

Çka di me folë, di edhe me shkru. Dhe n'familje thashë edhe nihere jo, ka dominu edhe gjuha shqipe por gjuha turke nuk ka qenë gjuhë jabanxhi, siç me thonë, osht' ndi tek-tuk, kur kanë ardhë çikat e hallës kanë folë turqisht me prindët e tyne edhe pse ato sot janë moshatare t'mijat po e flasin gjuhën shqipe perfekt, bile shpesh herë... se une jom kanë nifarë disidenti kështu, s'guxojshin me m'shkru

edhe me m'folë ni kohë mandej turqisht se i thojsha, "Turqishtja u kry, une e kom mësu, e di. Hajdeni ju tash mos e harroni shqipen", e domethanë kanë qenë disa situata t'tilla.

Aurela Kadriu: As në qytet s'u folke turqishtja a? Po m'intereson qikjo...

Adnan Merovci: Në Vushtrri, po...

Aurela Kadriu: A din, nëpër hapësira publike.

Adnan Merovci: Në Vushtrri... Vushtrria njihet si vend që... shife tash, me hi çashtjes të historisë edhe të vet, le t'themi tash, edhe aspektit etimologjik t'familjeve t'ndryshme prej kah e kanë qysh tek. Ne nuk mujm mos me e pranë që Perandoria Osmane në shekullin e XIX, domethanë n'fund ka shku edhe ajo tragjet e veta, gjurmë të veta i ka lanë sido që të jetë. Dhe kjo nuk osht' veç në Kosovë, po n'krejt Ballkanin sepse kanë dominu. Por, si familje, domethanë, ne... në Vushtrri dallohen dy ose tri por është shumë interesant që prej atyne familjeve lindin edhe patriotë ma t'mdhaj, sepse kjo e ka edhe me këtë aspektin pak të statusit të pasunit që i kanë qujt beglerë. Edhe beglerët gjithkush i lidh thu që kanë qenë turk, jo s'osht' e thanun, beg ke mujt me kanë ni shqiptar i mirëfilltë po pasunia t'ka bo beg edhe t'ka bo elitë dhe si i tillë ti e ke ditë turqishten.

Kemi Hasan Prishtinën që osht' i Vushtrrisë, bile shtëpinë e ka pasë afër shtëpisë tonë dhe ajo ka qenë ni shpi e vjetër për fatkeqësi para lufte ni pronar aty e ka rrënu edhe e ka bo krim me atë punë. Por ai ka qenë... e ka ditë turqishten fantazi, por ka qenë ni jurist me fakultet t'krym dhe me... i shkollum në Stamboll. Kemi Ismail Qemailin që nuk ka ditë me shkru shqip e djemtë e tij s'kanë ditë edhe me folë shqip. Pra, kjo osht' ni barametër, osht' ni tregus por e ka shpjegimin e vet. Sido që të jetë dhe komuna e Vushtrrisë, e Gjilanit, e Prizrenit njihen edhe ni pjesë e Prishtinës që gjuha turke osht' folë nëpër vende. Domethanë, n'qytet une kom pasë raste që kom dëgju si fëmi që osht' fol tek-tuk, por n'kohën kur po flasim tash për shembull, s'e di, mund t'jetë ndonjë gjeneratë e vjetër ose mujn me folë por në fakt nuk osht' ni gjuhë e komunikimit.

Mund t'jetë gjuhë e njoftun për dikond dikond, për shembull askush nuk befasohet që une e di turqishten se e lidhin me Vushtrri edhe ajo osht' domethanë në ndërdije që ky vend ka pasë trashëgimi edhe të njerëzve. Se Vushtrria ka qenë si vend, domethanë mas Novobërdës në Kosovë vendi ma i vjetër, ma i lashtë. E ka pasë, domethanë, qysh ka qenë rregullimi në perandorinë prej Sanxhakut e nëpër Kaza... e ka qenë, si bashkimi dhe kanë qenë institucionet e vendosuna në Vushtrri. Edhe sot ka ndërtesa që identifikojnë këto në kohën e Perandorisë Osmane.

Aurela Kadriu: A shkojshit m'i vizitu hallat si fëmi? A u hap ajo rrugë?

Adnan Merovci: Po, veç une për herë t'parë kom shku kur kom qenë në vitin e dytë, të tretë të shkollës të mesme, dikun n'vitet e '70-ta kom shku. Domethanë, si 17-18 vjeçar kom shku për herë t'parë në

Stamboll. Dhe po, kom shku, i kom vizitu hallat. Sepse, tani, kjo është periudhë mas ndërrim jetës të babgjyshit. Babgjyshi ma ka lonë në amanet që për hallat t'kujdesem, t'kem kujdes sepse ai si thojnë, ka shku me marak edhe me zhig t'tyne. Edhe ai ka luftu për me i kthye edhe pse fillimisht nuk i ka pengue me shku për shkak t'lidhjes bashkëshortore, sepse ato kanë qenë t'martume hallat. Hallat kanë dashtë mos me shku dhe kanë dashtë me u nda prej burrave për shkak të vendimit të babgjyshit, mos me nejt...

Po babgjyshi e ka lu në rol, në strategji, iu ka thonë, "Shkoni ju, se vijmë edhe na" dhe kjo ka qenë marrëveshje e thyme prej babgjyshit dhe sot kur po flas. Këtë emision me e pa hallat e mia që janë n'jetë ato mbushen n'vaj sepse iu kujtohet kjo. Dhe ky është në rrëfim edhe i tyne, që domethanë baba i tyne në thojza "i ka tradhët", por babgjyshi e ka bo me qëllim që mos t'i ndaj prej jetës bashkëshortore. Dhe kur kanë shkue, mandej le që s'ka shku babgjyshi... dhe ka pasë aty edhe mospajtime edhe me babën e mixhën se tash edhe vëllau për motër... dhe babgjyshi si kupollë e familjes i ka lu do strategji, do frekuenca t'nalta që edhe djemve t'vet s'iu ka tregu.

Dhe kur ka ardhë çashtja për me u fol kjo punë dhe e ka nxënë ai pozicionin e shtangët që, "Jo, na nuk shkojmë". Atëherë ka pasë pyetje prej mixhës e prej babës, "E qysh i lamë motrat me shkue?" Babgjyshi tanë kohën ka luftue për me u kthye dhe ai babgjyshi e ka ditë gjuhën dhe shkrimin osman. Nuk ka ditë gjuhën shqipe, latine, me shkru. Dhe letrat, hallave, çikave t'veta që ua ka çu, se atëherë komunikimi ka qenë me letra s'ka pasë telefona, ato letra ia kom shkru une gjithë, si fëmi domethanë, dhe e mbaj n'mend titullin e çdo... tre rreshtat e parë çka u kanë.

Gjithëherë kom fillu me shkru pa m'fol ai hiç, se ai ka folë une kom shkru, po qaq shumë ka shkru letra, e kom shkru letra, saqë filloi me kuptu çka po shkruj edhe kanihere m'thojke, "Shkruje, shkruje qishtu se e thashë qishtu" une i thojsha, "Po, po pres se e di që ki me thonë edhe qito." "Shkruje..." thojke, "ti qita", a e kupton, domethanë, si fëmi.

Aurela Kadriu: Çka ishin qata tre rreshtat e parë?

Adnan Merovci: Mui edhe me i citue sepse osht' diçka që n'memorie e kom. Thotë, "Ej, evladë të mi. Nazmie, Nexhmije e Halide dhe Nexhmije dhe Halide..." dhe dhondurve iu ka përmend mandej emrat, Rasimit edhe këtij çausht² tjetër që janë, për momentin nuk po m'kujtohet emri, "po e nisi kët' letër me e shkru, ishalla osht' e fundit dhe po kthehni në Kosovë sa ma shpejtë". U kon refren, domethonë, i pa kontestushëm. Gjithëherë kështu ka fillue letra dhe une kom fillue me shkru edhe hajt m'thojke, "Tash lexoma", domethanë, "Hajt, lexoma" dhe refreni ka qenë, "Ej evladë e mi, Nexhmije, Halide, e Shyqiri, e Rasim..." Shyqa u konë dhondrri i madh Rasimi dhondrri i vogël.

Gjithëherë dy vajzat e para mandej ka fillue teksti, kryesisht spjegim i gjendjes, pyetje, kryesisht pyetje. Letrat kur janë këmbë, gjysa e letrave kanë qenë pyetje, "E kështu, e tregona kështu, e jo kështu" dhe

² Turk.: çavuş, rreshter, në shqip përdoret për t'iu referuar njerëzit ngritun.

ato letra kur janë ardhë, ato kryesisht kanë qenë... se ato hallat kanë ditë me shkru dhe gjithëherë kur kanë ardhë babgjyshi mu m'ka thirrë me i lexu ato, une ia kom lexu babgjyshit. Dhe kjo osht', si me thanë, ni marrëdhanie si e ndërtume me të që definitivisht mu m'emocionin edhe m'kthen, nifare nostalgjie të atyne kohnave.

Aurela Kadriu: Qysh... kur keni shku n'shkollë t'mesme?

Adnan Merovci: Une shkollën e mesme, t'u pasë këto prirjet për rrymën elektrike, për qarqe elektrike këto, babgjyshi, baba më pat' propozu që t'shkoj n'shkollë teknike në Mitrovicë, për herë t'parë n'atë vit. Domethanë, kur unë e kryva klasën e tetë, filloren, n'atë kohë u hap seksioni elektro në shkollën e mesme teknike. Ka qenë shkolla e mesme teknike por jo elektroja. Ka qenë, maqineri, teknologji që lidhet me Mitrovicë.

Për herë t'parë u hap edhe seksioni elektro edhe m'tha baba, kurrë n'jetë nuk e harroj atë moment, kom qenë në ni tavolinë me ni tranzistor t'vogël t'u dashtë me ndreqë, se gjithëherë jom marrë me diçka, edhe m'ka thonë, "Adnan..." m'ka thonë, "ty po t'shkon kjo e energjisë elektrike, rrymës elektrike shumë..." edhe m'ka thonë, "po hapet atje në Mitrovicë..." se baba mu m'ka punue, babën e kom pasë të shkollum për atë kohë. I ka pasë katër vjet shkollë, po katër vjet kanë qenë për kohën të atilla që ai ka punu n'bankë. Ka qenë, kontabilitet ka punu. Mandej, ka punu si drejtor financiar në ni çerdhe të fëmive n'kohën kur une kom shku n'shkollë të mesme dhe i ka pasë njohuritë me Mitrovicë.

Dhe atje kom shku dhe jom regjistru n'shkollën, aso kohë është qujtë "Boris Kidrič", bile osht' ni etimo... ni monografi e shkollës që ka bo ni autor, Hajriz Fazliu nëse s'gabo, i Mitrovicës. Ku ni kapitull ose njo dy-tri fletë m'i kushton edhe mu, se tash ai ka bo por i ka nxjerr do njerëz pak publik që janë t'njoftun dhe ekziston ai fakt. Në shkollën e mesme teknike në Mitrovicë une kom fillu edhe kom banu mandej në Mitrovicë dhe këtu ka fillu nifare shkputje me Vushtrri dhe me shokë. Kështu që, edhe sot kur po flasim une i njoh t'gjithë, po pak ajo periudhë, se qatëherë formohet njeriu kryesisht jom kanë në ambient tjetër edhe kom banue në Mitrovicë. Sepse ni vëlla i imi punonte n'gjimnaz jepte mësim dhe ne bashkë banonim në ni dhomë dhe vikendeve kuptohet që vishim. Por, kjo jep me, domethanë m'ka dhanë rastin që, domethanë me qarqet e moshatarve t'mi të Mitrovicës kryesisht që kom ndejt...

Por këtu s'muj pa e shëputë edhe ni detaj t'vogël, që osht' detaj si i vogël po shumë domethanës dhe mandej që ka ndikue n'përgjithësi n'jetën time edhe që pak e kom të konsumun n'publik osht' që në këtë kohë une n'vitin e parë kur kom shku meniherë kom fillu m'u marr me ni sport aktiv edhe ky osht' sporti i karatesë që une nuk kom fol shumë n'publik me këtë, për këtë send. As s'jom identifikue edhe pse n'kohën kur po flasim i kom kalu disa shkallë edhe e kom thirrjen "Mjeshtër i shkollës t'dytë dhe refer ndërkombëtar" i këtij sporti. Por fillet i kom në Mitrovicë dhe kom qenë... me u marr me ni sport luftarak n'atë kohë ke qenë diqysh i adhurum prej rrethit.

Une kom pasë ndoshta prirje për energji, me, me dhanë dikund energjinë. Po t'u qenë me këtë, kom pasë rast me taku, hiç ma pak as ma shumë, se komandantin legjendar Adem Jasharin. Po flasim për vite të '70-ta. T'u qenë në shkollën teknike ai ka pasë ardhë, tani detajet sakt mund edhe t'i artikuloj, por ai ka ardhë... se ka qenë në gjeneratë para meje, n'shollë teknike përkohësisht diçka, po t'u u marr une me karate... ai e ka dashtë shumë futbollin, neve si sporti na ka lidhë. Tani nuk osht' dashtë ti me ni shok t'ulesh n'bankë që me pasë shok, ke mujt... dhe kjo, po flasim për vite të '70-ta kur une s'e kam ditë kush ka me u bo Adem Jashari, as ai s'e ka ditë kush osht' Adnan Merovci mas 30 a 40 vjetve a sa po flasim...

Por, sido që të jetë osht' pikënisje e njohjes time dhe kjo njohje për çudi na ka përcjellë deri me 5 mars 1998 kur ai ka ra në Betejën e Prekazit. Dhe tash, këtë pse po e përmendi? Po e përmendi se osht' si ni pikënisje dhe kjo ka ecë mandej. Prej atyhit ka ekzistuar ni periudhë e heshtun, mandej kanë fillu vitet e '90-ta ku une jom ritaku me të edhe kështu. Po historia jeme me komandantin legjendar, si njohje dhe si miqësi, bile jo e mangët në atë kohë, kam detaje po, po pa modesti me i thonë edhe spektakulare, detaje spektakulare me komandantin në atë kohë që, domethanë nuk i harroj kurrë dhe disa i kom rrëfy, disa pres me i rrëfy në ni rrëfim të ribotim të librit tim që e kom pasë të botume para gjashtë vjetve, dhe ky është ni detaj që m'ka përcjell si me thonë, rreth kësaj.

Në kohën e shkollës t'mesme, fjala vjen, në Mitrovicë ne kemi mësu edhe ka qenë ni nivel i jashtëzakonshëm. Shkolla e mesme teknike në Mitrovicë ka qenë shkollë e njoftun në Evropë, pse? Sepse osht' e themelume t'u marr parasysh Mitrovicën si vend industrial shumë i zhvillum, t'u pasë Trepçën, t'u pasë shkritoren e zinkut, t'u pasë fabrikën e akumulatorëve, t'u pasë minierat e Stantërgut. Domethanë, ni vend i njoftun në Evropë për teknologji dhe miniera, dhe energji në Mitrovicë. Dhe shkolla e mesme teknike ka qenë bazë për kuadrot e ardhshme dhe kryesisht kuadrot e më vonshme që janë marrë me këtë lami. Shkollën e kanë kry të mesmen në Mitrovicë. Definitivisht, pa kurfarë hezitimi e them se ka qenë ni institucion për dije, për drejtimet, lomitë e teknikës dhe aty kam diplomue.

Mandej, kam qenë nxanës i mirë, hiç problematik s'kam qenë, pak hipik. Kom qenë edhe nxanës i mirë edhe i urtë po edhe pak hipik modern. Kom mbajt flokë t'gjata, e kom pasë gjana nëpër trup, pak nifarë proteste. Shqetësimet kombëtare, siç thashë, fillet i kom prej babgjyshit dhe janë manifestu mandej sepse shumë shpejt i kom pa që, ajo krijesë që osht' ish Jugosllavi për ni aspekt osht' e mirë se neve po vjelim diçka nga ajo, por kjo herdokur ka me i ardhë koha. Dhe mandej i kom taku këtij brezit të gjeneratës të, le t'themi si student i vitit '81 dhe protestave e kështu me radhë.

Aurela Kadriu: E qysh ke qajo shkputja prej qasaj familjes shumë t'madhe tash me shku me jetu veç me vëllaun në Mitrovicë?

Adnan Merovci: Po, ajo... pyetja është shumë e drejtë sepse shkolla e mesme ka qenë ni periudhë kur ti i ki 15 vjet me thanë, dhe në kohën kur po flasim, tani pak para se me shku une në shkollë t'mesme,

baba me babgjyshin, baba me mixhën janë nda, domethanë, janë nda, do t'thotë ai... se ka ndërtu shtëpi tjetër dhe aty ka fillu mandej ndamja. Në kuptim edhe t'reduktimit dhe ne kemi mbetë me babën, me anëtarët e familjes baba me motrat e mia, me fëmijtë... tash, se gjithëherë... Edhe niherë për saktësi ta them, numri i anëtarëve... nuk flas për numër t'anëtarëve t'qasaj shpije që kanë lindë por familje që ka pasë rast me bija, me mesa krejt që kemi ndejtë domethanë, kallabllak ni vikend, a ni javë... përpara bijat kur janë ardhë kanë nejt me javë dhe kjo ka qenë periudhë, si me thanë, e tillë dhe...

Edhe babgjyshi me gjyshen kanë qenë me babën tim, gjegjësisht me neve n'atë shtëpi, se shtëpia e vjetër. Mixha pat' dalë, po mas ni kohe edhe babgjyshi pat' shku me gjyshen te mixha sepse u kanë... tash ni shtëpi e ndërtume në kohë tjetër ku osht' bo ma funksionale për ta dhe ata kanë kalu atje me banu dhe vllaznit e mdhaj kanë fillu... ni vëlla ka qenë ma tepër me punë t'zejeve, vllaznit tjetër t'gjithë kanë qenë t'shkollum, t'gjithë me fakultet. Po flas për ni kohë kur shumë lehtë kanë mujt, pos meje nashta, me qenë t'gjithë bujqit sepse kanë pasë me çka me u marr, por babën e kom pasë... okej, trashëgim shkollimi prej babgjyshit po edhe baba ka qenë n'sistemin e, i zhiglun për çashtje t'arsimit, domethanë.

Fjala vjen, une, motra ime osht' tri vjet ma e madhe se unë dhe osht' ni, tani motër medicinale n'pension, por ajo e ka kry shkollën e mesme në Mitrovicë dhe në fillim ka pasë probleme me u regjistru për shkak të ambientit dhe rrethit, "Qysh me shku vajza, çika n'shkollë t'mesme edhe plus doktoricë me u bo se ka punë me tulifarë..." dhe çka ka ndodhë, baba shumë i meçëm, dhe ka pasë ni protestë për këtë punë prej një fqiu aty për motrën time. Dhe baba për mos me u prish me fqin, çka ka bo, ka shku te ni dijetar në Vushtrri që... se Vushtrria e ka pasë atë parinë e dijetarëve, elita e dijetarëve... tash, pa modesti e them që aty ka qenë edhe babgjyshi im, pse jo edhe baba im, po tash për çashtjen tande ti mendimin e ke lypë prej tjerëve.

Dhe ka shku baba e ka kërku mendimin prej, që e mbaj n'mend edhe unë sot ni dijetarit shumë t'madh edhe bashkëkohor, Haxhi Sabiti i kanë thanë, ai u konë Haxhi po ni njeri shumë i mrrimë dhe dijetar dhe i ka thonë, "Haxhi Sabit, erdha me t'vet kështu, kështu për çikë, çka po m'thu? A te çoj n'mjeksi kështu?" Ai e shiqon niherë n'sy edhe i thotë, "A kem na motra? A kem gra? A na smuhen ato neve? A ma mirë është kur t'shkojnë motrat tona e gratë tona te mjeku e te motrat m'i vizitu e m'i pasë aty çikat tona, e motrat tona t'u kqyrë a m'i pasë veç tjetër?" E kush tjetër janë? Janë serbtë se s'ka pasë tjetër aty tash.

Dhe me këtë fjalë osht' rahat dhe osht' kthy baba e ka çu në regjistrim motrën por edhe përgjegjën ia ka dhanë kojshiut që ka qenë kundër. Domethanë, dhe kjo ka qenë ajo... tash fillimi i shthurjes, n'thojza, i familjes. Prej ni industrie familjare në ni, tash në ni repart ma t'vogël. Njani vëlla në Beograd në fakultet, ni tjetër në fakultet të mjeksisë gjenerata e parë mjekë, tjetri n'gjuhë dhe letërsi, mu ku tjetër pos mas shkollës t'mesme në Fakultet të Eletroteknikë, s'bon tjetër me shku, ku kom diplomu në vitin '81.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë... çfarë qyteti ka qenë Mitrovica qatëherë kur ke shku?

Adnan Merovci: Mitrovica ka qenë, domethanë, une e mbaj n'mend veç nëse flasim... se tash kur thuhet Mitrovica gjithëherë mendtë shkojnë te aktualiteti edhe te qajo ura e Ibrit që i thojmë. Une e mbaj n'mend qat' urën e parë, une që e mbaj n'mend, domethanë, që n'shollë kom shku, ka qenë mbas saj, dikun... a t'përfundoj me këta që osht' sot, në njohje? Ni, dy, tre, katër, pesë, gjashtë. Gjashtë ndërtime kanë qenë t'urës. Kjo që është sot është e gjashta.

Domethanë, si gjeneratë une kur kom shku në vitet e '70-ta pesë here, plus qikjo e fundit. Gjashtë here qikjo urë osht' rindërtu. Sepse fillimisht une e mbaj n'mend kur ka qenë ma primitivja dhe mu m'duket që po eci qanej nëpër urë edhe diçka ka qenë knej, ni fotograf aty, ni xhami u konë n'atanë, knej u konë ni park... Domethanë, e di dhe ka qenë urë, le t'themi, primitive. Osht' ndërtu mandej osht' bo si e hekrit e me anësore e tjera e tjera.

Qyteti i Mitrovicës shquhet edhe për ni aspekt që... me ni rini moderne, bashkëkohore sepse ka qenë vend industrial. Aty në Mitrovicë ka pasë edhe t'huj se industria ka pasë edhe ekspertë t'hujë. Ka qenë i pranishëm edhe elementi serb, por ka funksionu sepse pjesa shqiptare në Mitrovicë që nuk ka pasë veri edhe jug, korza edhe nejat kanë qenë, tash gjeografikisht, po duhet me i thonë n'veri, shkolla e mesme ku une kam qenë n'veri. Në Zveçan, une kom dhanë mësim mas diplomimit. Në Zveçan shqip kanë qenë shkollat. Varrezat janë n'veri të shqiptarve, domethanë po flas për kohën kur kanë qenë. Dhe ka qenë ni elitë edhe në përmasa kombëtare për mos me thanë ndërkombëtare, n'aspekt edhe të kulturës edhe të rinisë e sportit në Mitrovicë dhe ka edhe historina t'tilla.

Në kohën kur po flasim dhe unë si i ri në shkollë t'mesme, për shembull shquhen kangtarët, shquhen artistët, shquhen eksponentë t'jashtëzakonshëm të kulturës edhe artit. Domethanë, kisha... fjala vjen për kohën, se po lidhemi për kohën, për shembull ni prej kangtarëve edhe prej grupeve që kanë qenë, tash nuk them a është e para a e dyta se këto gjana janë tash detaje edhe nuk du me i cikrrue, po osht' historia e rock-ut që buron në Mitrovicë dhe osht' ndër grupet e para grupi "MAK" që ka pasë anëtarët prej Mitrovicës dhe une jom rritë me kangtë e tyne. Ata kanë pasë frymëzime, se ne i kem njoftë edhe grupet botnore Beatles, Rolling Stones-at, Deep Purple, Jimi Hendrix, e tjerë e tjerë. Po fjala vjen ne prej Deep Purple e kemi pa ni grup, grupin "MAK" të udhëhequn prej ni mikut tim, Xhevdet Gashi me kangtarë t'njoftun dhe tash të ndjerë Haki Misinin dhe të gjithë grupet tjera.

Dhe tash meqenëse e përmenda, duhna me përmend se tjetër nuk janë në jetë, është, Bulli si baterist me Mehmet Tupellin që konsiderohet i zhdukun dhe ende i pagjetur, dhe osht' Sejdi ni solo gitarist, Isufi nëse nuk gaboj mbiemrin edhe ai ka ndrru jetë dhe osht' Halil Bajraktari që në bas gitarë ka qenë në grup dhe tash është në Amerikë edhe jeton në New York. Bile vjet kom qenë edhe e kom taku atje. Dhe sot prej qatij grupi janë dy, osht' udhëheqësi i grupit, edhe udhëheqës artistik ka qenë Xhevdeti,

dhe Xhevdeti ka qenë rogula atëherë si me thanë sot n'atë ritmin ose n'piano, rogula kanë qenë, dhe Halili janë n'jetë dhe t'gjallë.

Dhe fjala vjen, kanga e parë, Xhevdeti ka qenë n'shkollë t'mesme kur e ka komponu "Plakut" dhe osht' ni video bile që qitet në Radio Prishtinë edhe n'televizionin që e ka bo, "Po na shkon te plaku me ni mal të madh" edhe domethanë, edhe sot m'kujtohen ata tinguj edhe në pjesët, n'vendet ku kanë ushtru ata me do farë instrumente halla-halla, do farë bateria, do teneqe, do tang-dung-dan, por gjithëherë t'frymëzum prej... n'këtë rast kangën folklorike, kangën burimore, t'u e përfshi edhe "Pojatën" këtu, "Moj e mira te pojata" të bam dhe me ritëm dhe me vijë melodike dhe me trend...

Pjesa e Dytë

Adnan Merovci: Ushtrimet domethonë që jonë bo nëpër ambiente të ndryshme t'këtij grupi, në kushte t'cilat... Po ma vonë u afirmu edhe u bo një, një grup shumë i njoftun, i cili mandej kishte edhe paraqitje n'ambiente, mas ambiente le t'themi, nëpër këto *iadat* e shumta... Ekonomiada, elektroia, hajde jurispo... Edhe tjera nëpër neja t'organizue që i thojshim ne n'këto farë... Edhe këta shkojshin bojshin muzikë dhe i kanë...

Mandej shquhet edhe me një sukses shumë t'madh, se patën fillu mandej edhe në "Akorde [të Kosovës]" me marrë pjesë. Për herë t'parë grup rock me marrë pjesë në "Akorde". Edhe për sherr ku shkojshin merrshin shpërblim, edhe merrshin... Bile kryesisht prej publikut. M'kujtohet kanga "Qenke rritë moj, s'të zen këmisha" ka qenë një kangë brilante, që ka marrë vend në "Akorde", e tjera. Dhe Mitrovica domethonë i ka këto specifika dhe i ka pasë. Këtu shquhen edhe, edhe, edhe eksponentë tjerë, domethonë edhe t'muzikës, të artit, e këto. Pra, Mitrovica i ka pasë këto specifika.

Por një detaj që po du me ritheksu këtu osht' çashtja e e koekzistimit me moshatarët edhe me serbët. Në Mitrovicë ka funksionu ky koekzistim, po gjithëherë ka qenë në nivel modern veç të artit edhe kulturës. Përndryshe, pa me dashtë me eksagjërë, por ty edhe vija e komponenta patriotike tani t'them vjen shumë e theksime prej anës të Mitrovicës. Domethonë nuk po flasim për një vend n'shoqni, le t'themi t'integrum e kështu e, t'mashtrume ose të Jugosllavizume ose ser... në asnjë mënyrë. Por kjo ka funksionu si shumë selektive, jonë ditë rrethanat, po ka funksionu shumë mirë dhe definitivisht kjo osht' pa edhe sot deri sa po flasim. Domethonë çka jonë pretendimet për këtë nocion që po quhet sot Mitrovicë dhe u bo çashtje edhe në Këshill të Sigurimit mo.

Pikërisht për shkak të resurseve natyrore një, që jo në minierat, e uzinat, e fabrikat që i kanë çelë për kohën, por edhe të potencialit njerëzor. Se një vend shquhet, domethonë një vend shquhet me traditë, me mentalitet, me dhunti... osht' një trevë që fjala vjen, osht' një fshat atje te Suhareka, Mushtisht, tonë knojnë, nga ku osht' këngtarja e mirënjohur, Shkurte Fejza. T'gjithë knonjnë, domethonë tonë katuni,

duhet ajo osht' dhunti. Edhe në Mitrovicë domethonë osht'kjo dhunti e potencialit të resursit njerëzor në përgjithësi që në këtë rast unë e kapa veç elementin e kulturës.

Aurela Kadriu: A dilshit?

Adnan Merovci: Po kem dalë në korzë i kem thonë, dhe korza ka qenë në veri dhe ka qenë pjesa shqiptare e dame, pjesa serbe e ndame. Dhe korza ka qenë një shesh, një vend ku ti ke mujtë me u pa me shokë, po pse jo edhe naj simpati që ka mujtë me qenë, hiç pa folë veç me pamje edhe me shiqim, edhe s'kanë mungu këto situata. Qajo ka qenë vendi, s'ka pasë telefon, s'ka pasë... Mundësia ka qenë e komunikimit me urime për vit t'ri, qato i kem pasë që ka t'drejtë me t'ardhë një letër a një kartë postale me urime me naj *nickname* a diçka, "*I love you, Xhemile*" për shembull.

Aurela Kadriu: N'cilin vit, n'cilin vit keni shku në studime?

Adnan Merovci: Në studime kam shku n'viitn '76, 1976, '75, m'fal, se '75-76, se qysh janë këto dy vite duhet me i thonë, gjithë i gaboje edhe me shekull, kur thuhet shekulli i XIX gjithmonë mendoj që 1900 e, a osht' shekulli i XX, i gaboje. Studimet, dhomethonë nuk kom pase dilema që fakulteti elektro-teknik osht' ardhmënia jem...

Aurela Kadriu: E qysh, po m'doket shumë çuditshëm se manej, çka ka ndodhë me juve manej osht' jashtëzakonisht larg prej fakultetit teknik...

Adnan Merovci: Po une...

Aurela Kadriu: A keni pasë ma herët prirje...

Adnan Merovci: Si fëmijë thashë une e kom pasë elektron dhe...

Aurela Kadriu: Prirje për në të folur, në komunikim, në... Ma herët a keni pasë...

Adnan Merovci: Po rrethin edhe shoqinë i kom pasë t'gjithë krijues, vet nuk jom konë krijues, në kuptim edhe artistik... Po krejt, edhe sot shoqinë kryesisht i kom njerëz jo të estradës, jo artista, jo krejt t'kësaj... po une vet jom me do dana e një shrafciger në dorë, që osht' elektro-teknika, si me thonë zanat. Dhe prej fëmijnije domethonë qajo dhuntia për, për kurreshtje t'pjesëve elektrike. Baba në shkollë elektro-teknike t'mesme, dhe unë n'fakultet të elektro-teknik në Prishtinë. Dhe kjo osht' domethonë ajo zanafilla, dhe, dhe domethonë aty s'ka pasë dilema që unë shkoj studioj diçka tjetër. Edhe pse i kom do marake, do zhigje me studiu diçka...

Aurela Kadriu: Çka?

Adnan Merovci: Vujë për shembull aktrimin me pasë studiu, kisha pasë qef, e du, e du këtë pjesën si me thanë të momentit psikologjik me hy me një rol tjetër e shprehjes të emocionit. Edhe, po... e du artin, e njoh... E du edhe e ndi, qajo osht' me rëndsi. Edhe shpesh herë edhe miqëve që i kom, si qitash Xhevdet Gashin, mik t'ngushtë e kom Sabri Fejzullahun, Sinan Vllasaliun, e plotë të tjerë, domethonë ata e din që kjojnë ma mirë se une t'gjithë, po asnjoni s'dëgjon ma mirë se unë, dhe këta ata ma pranojnë domethonë. Se shpesh herë i kritikoj, e i vlerësoj e... edhe pse unë s'kom njohuri profesionale n'këto sende, por jom njëfarë kritiku i vështirë.

Aurela Kadriu: Çfarë muzike e dëgjoni?

Adnan Merovci: Kryesisht, kryesisht rock edhe ato hard rock. Bile e kom bo një postim njëherë të Metallicës nëse nuk gabo, po u konë ultra hard, edhe ju thashë, "M'falni se në mëngjes nuk shkon, veç m'kapi një nostalgji". Edhe sot për shembull une si me thonë i kom eksponentët që... Për shembull Jimi Hendrixin dhe kitara e tij. Për kohën kur po flasim, shkollë t'mesme, thojshin që osht' kitare që vet lunë. Domethonë vet kitarja lunë, nuk lunë ai n'dorë, sepse qaq shumë ai osht' i dhanun mas kitarës sa që kitarën e ka shëndrru tani në një lodër që ajo vet po lunë.

Edhe m'kujtohen ato introfunksionet e tij që edhe sot çmendna për to. Ka qenë një, një kitarist i kohës të studimeve John McLaughlin, që shumë e kom adhuru, dhe gjithëherë po flas të instrumentaleve që kryesisht që shkojnë, konverzojnë kah rocku, ty, ty u fokusu edhe në rockera të shumtë. Tash sa dushë ka andej e këndej, po Stingun s'e jep bash lehtë, kush jonë tjerët hajde...

Aurela Kadriu: A keni ra ndonji instrument?

Adnan Merovci: Bono Vox-in e... kom provu, Xhevdetit ja kom marrë njëherë një kitare, bile bollero ka qenë, ritëm kitarë edhe... Me Xhevdetin shoqnohna dhe tash. Dhe kom provu, dhe m'ka mënu një kangë, "Drenusha ime", me bo me pasë kitarën edhe qitash di, amo veç qato edhe qaq, mo s'di... Që do të thotë jo. Fyllit i kom ra, por fyllit vet i kom ra dhe sot di një melodi me bo, edhe e boj veç mos me zgjatë shumë, se si te zgjati shumë tanaj... Sikur këta gjuhën a e ke pa, thotë, "Une e di po... diqysh e kuptoj krejt po me folë s'po muj". Edhe une dej qaty muj, mas tani mos m'shti.

Po e du artin, m'flen, e ndi ne formën time. Sot kom eksponentë, s'di, prej vendorëve s'muj pa e përmend Eugent Bushpepën, një çmenduri të rockut, një emën që definitivisht i ka shpërthyer edhe barrierat ose orbitat ndërkombëtre. Një njeri që na përfaqësoi me një kangë... Okej, ajo ke njëfarë rock balade, por sido që t'jetë edhe e kom mik edhe e du atë farë mangupi, sepse m'ka pushtu. Domethonë definitivisht Eugent Bushpepa osht' një emën për mu e krijimtarisë në përgjithësi... Megjithatë, tash une e kom një fanatizëm për këta, edhe qysh thashë për Stingun fjala vjen, jo, jo Bon Jovin, a Paul McCartney a, Mick Jaggeri, a ku ta di une. Por prej vendorëve definitivisht...

Tash une e kom nostalgjinë për Haki Misinin, por Haki Misini nuk ka qenë rocker, pop këngëtar ka qenë, po tjetër o që Xhevda ia ka qitë do me shrafcigera, me çekiqa, do teneqe, do kongë, do ritme, e ka shti në rock. Por edhe aty ka brrylue. Por, sot për sot, edhe pse ka rockera në Kosovë, osht' Xuxi, osht' BB Poqi, ka plotë rockera edhe tjerë, rocker për mu ka qenë edhe Genc Salihu, por ai kaloi në një zhanër tjetër, shumë i mirë dhe... Por tani kur po flasim Eugenti m'i ka rrëmby t'gjithë edhe kur ia ndi "Merre vetën nën kontroll" osht' diçka që unë shpërthej, dhe shpeshë herë shkoj e shoh, dhe ia shoh koncertet live dhe jom fans i tina kështu.

Aurela Kadriu: A u zhvendosët në Prishtinë kur erdhët për studime?

Adnan Merovci: Po. Kom ardhë në studime siç thashë n'vitin '75-'76. Herën e parë kom banu në qendër të studentëve, kanë qenë ato barakat, ka qenë koxha privilegje me kalu, se ka qenë edhe pavijonet dhe konviketet. Vitit të parë maksimumi ke mujtë me arritë deri te barakat edhe aty ka qenë një konkurim, një sistematizim, suksesi, prej nga po vjen, e tjera, e tjera. Tash aty ka mujtë me qenë hendikep se ka qenë edhe aspekti financiar, financiarisht unë nuk kom qenë keq, po këto poenat tjera kanë bo... Edhe kur po t'them kështu pa t'ngjofshëm, e pa intervenime, e pa... thjeshtë një rangim...

Edhe fakulteti teknik ka pasë emra dhe kom qenë më tre cimera n'vitin e parë, madnej n'vitin e dytë kemi kalu në konvikt, dhe këtu fillon ajo historia edhe me Xhevdet Gashin, Muhamet Hajrizin, e Bedri Ramën, i ndjeri një mik i imi që s'muj pa e përmend, se kemi qenë shokë t'pandashëm në kohën e studimeve. Xhevdeti ka qenë atëhere aktiv në muzikë edhe na e kem pasë njifarë adhurimi, po diqysh u konë i ftoftë ai, edhe sot o qashtu. Bile këta që bashkëpunojnë me to, i thojnë që si akull o, qashtu u metë. S'kom najfarë spjegimi për to se... por, megjithatë ai osht' një personalitet edhe një pjesë e jetës tem, së bashku me shokët tjerë.

Aurela Kadriu: Çfarë qyteti ish Prishtina për juve që vishit prej një prapavije Vushtrri, Mitrovicë tash një qytet i ri?

Adnan Merovci: Tash me Prishtinë mu m'lidhet fëmijëni. Dhe kjo e ka një histori, motrën time e kom pasë t'martume në Prishtinë dhe si fëmijë kom ardhë. Dhe kur them si fëmijë, ka ndodhë që në sezonë të verës kom nejtë një muj. M'thirrke me lujt me fëmijët, dilshin ata me dhondrin nëpër mramje e neja, une me ja u kqyrë fëmijët e vegjël.

Aurela Kadriu: Në cilën lagje e ka pasë motra...

Adnan Merovci: Ajo e ka pasë në rrugën Bihaçi, te tregu. Aty kanë banu në një shtëpi...

Aurela Kadriu: Te tregu n'qytet t'vjetër?

Adnan Merovci: Te tregu n'qytet t'vjetër, te tregu i gjelbërt. Por atë që e mbaj n'mend dhe e di, se menza e studentëve ka qenë ku osht' sot krejt, krejt në një vend tjetër, përballë me të, ku osht' ky Galeria e Arteve, qaty dikund ka qenë një menzë e studentëve... Dhe prej rrugës të Bihaçit, se ai dhondri, burri i motrës ka punu në menzë të studentëve, ka qenë drejtor komercial atëherë... Une visha n'kamë dhe krejt pjesa e rrugës "Agim Ramadani", prej ku o Ministria e Kulturës deri te Menza ku osht' kjo e reja, u konë njëfarë lloqi i paspjegum që ka po flas po m'doket që po m'ngjitët komve. Nuk ka pasë domethonë... lloq, tamon u konë lloq. Dhe e mbaj n'mend atë periudhë.

Menza e studentëve ka qenë një barakë... definitivisht Prishtina ka qenë, e ka pasë qatë pjesën te "Unioni", se ajo prej kohës të austro-hungarezëve le t'themi... edhe jo muzeu, xhamiat që kanë qenë të kohës të perandorisë. Dhe këto mas Luftës të Dytë Botnore të ndërtume, jo Komiteti, jo do ndërtesa, jo do... fjala bjen Lakrishtja kur u bo jom konë veç edhe student gati qatëherë kur osht' ndërtu edhe kompleksi i Lakrishtës. Ma herët, n'fund të viteve të '70-ta dikun osht'.

Po Prishtina ka qenë vend... jo shumë i theksuemë, ka qenë, ka qenë, se po flasim gjithëherë për fillimin e zhvillimit edhe administrativ edhe institucioneve që kanë qenë t'kohës kur ka fillu me marrë formën e vet, sido që të jetë. Por tu qenë student, se studentat i kanë do përparësi, por i kanë edhe do hendikepe. Ti mundesh me konë katër-pesë vjet në një vend student dhe kurfarë përshtypje s'ki për atë vend se je në një botë, edhe në një qark krejt tjetër të mbyllun. Dhe me qenë student në elektro-teknikë u dashtë me mësu shumë, me konë menxi me pritë vikendin me ju gju librave, me punu, e shumë ligjerata, e shumë ushtrime, e shumë detyra... dhe knej mos me qenë fare.

Atë që e mbaj n'mend ka qenë futboll, ndonjëherë kur kom shku me shokë dhe ndonji kinema, me Kokakolla dhe Bronhi karamela blejshim me shokë. Se e kem pasë një shok që sa herë... Tash osht' në Australi, me Xhevdetin, Muhametin e Bedrinë, Abaz Zukiqi, shkojke, ai e ka pasë për detyrë n'atë kohë me i ble katër kokakolla edhe katër kese me... Edhe ato e kem pasë domethonë për kinema, filma t'ndryshëm me pa, dhe mandej mi koment...

Aurela Kadriu: Ku shkojshit ju?

Adnan Merovci: Në kino ka qenë, kjo Kino Rinia ku osht', edhe Shtëpia e Armatës ku i thojnë kapun me Grandin, kanë qenë këto dy salla që kryesisht kemi shku. Veç ka pasë rregull, ka pasë, t'them ka pasë filma t'mirë. Se kanë funksioni, disa sende kanë funksionu n'atë kohë, kanë qenë ato rrjetet distributive të kinematorafisë, dhe tash ato kanë qenë në përmasat e një federate që u qujtë Jugosllavi që kanë funksionu dhe ish Jugosllavia ka qenë njëfarë perandorie edhe në aktivitete të shumta. Edhe kuptohet tash shqiptarët sa kanë mujtë më qnuk qaty mas viteve të '70-ta dikun, kur osht' bo në '74-tën edhe në kuptim të ngritjes kulturore, edhe një pasport i kuq që atëherë ka qenë, ka qenë domethonë vizë për krejt botën me shëtitë. Dhe privilegj i madh ka qenë ajo.

Ka qenë treni Akropolis që ka shku prej Selanikut në Mynhen, veç pak je idhnu në shpi i ke kcy trenit je shku në Gjermani. Domethonë, po flasim për kohnat që liria ka qenë e shëtisë, e lëvizjës, veç a i ki do lekë hypë edhe... Bile edhe pak me ju ikë kondukterave ke mujtë mos me pagu biletë hiç, po jo u duftë me ju ru kontrollës mandej se ka mujtë më të... Dhe domethonë po flasim për kohën kur shqiptarët dhe gjenerata ime kanë qenë prezent edhe në vende tjera, në Beograd kom pasë shumë shokë që kanë studiu se ka pasë lami, sidomos lami të artit e të... këto drejtimet shoqërore për regji, e për dramë, e ku ta di une. S'ka pasë në Prishtinë hala.

Mandej në Zagreb kryesisht kanë qenë, dhe ky Zargebi ka qenë për dy arsye, njo si ma prestigjioz renome, po diqysh edhe me kroatë i kem pasë disa historina edhe njëfarë, le të themi simpatije n'krahësim me këtë botën serbe, që sido që t'jetë, e thanun, a e pa thanun, kemi pasë antogonizma. Edhe urrejtje të thanuna, a të pathanuna, ose mosdurime t'them ma mirë me i thonë kështu, pak ma modern. Por sido që t'jetë kem ecë. Edhe definitivisht gjenerata jem që i përkas, '81-shit, se në vitin '81 kanë ndodhë demonstratat siç mund ta dini, bile, bile diploma mu ka shty. Dhe shpesh herë si n'humor, me shaka thojsha ja u pashë sherrin se mu shty diploma. A flitet ashtu? Jo.

Domethonë dihet çka kanë qenë ato, po ka qenë një kulminacion i zhvillimit në përgjithësi të, të aspekteve kulturore në ngritje. Sepse marrëdhënjet me Shqipëri kanë qenë shumë të afërta dhe praktikisht u deshtë me shpërthi diçka sepse ka qenë ë padurushme ajo. Edhe për elementin serb, sepse kanë pa ku po shkojnë sendet, sido që të jetë nuk du t'them që serbët i kanë organizu demonstratat, por du t'them që i kanë shfrytëzu edhe ata momentet dhe momentumin, pakanqësinë e shqiptarëve dhe mandej ju e dini që pikënisje '81-shi ka qenë për të gjitha ato deri në vitin '90-ë.

Aurela Kadriu: A keni udhëtu para '81-shit? Dalim ma vonë te '81-shi, se po kom qef ka të '70-tat m'u nalë edhe pak. A udhëtojshin nëpër Jugosllavi si t'ri?

Adnan Merovci: Po, kemi udhëtu. Une nuk jom konë fort i këtyne aksioneve, se ka pasë do aksione ju thojshin, rinia e organizume. Domethonë, çdo institucion nëse ke qenë, çdo institucion, dhe institucion quhet shkolla, quhet puna, quhet institucioni shkollor, i punës, i çerdheve të fëmijëve, ka ekzistru struktura dhe e partisë. Kështu që, ti nëse ke qenë aty, ti njëfarë automatizmi ke qenë edhe në parti. Tash nuk du t'them qe unë jom konë, a s'jom konë a... se s'jom konë i angazhumë atëherë kërka, por po du t'them që n'kuadër mandej të organizimeve tjera, ka pasë qeso lëvizje nëpër ish Jugosllavi, që i kanë thonë aksionet e verës. Dhe të ritë kanë shku në një aksion, por ka pasë edhe pjesë artistike, muzikë e koncerte.

Une nuk i kom praktiku ato shumë, por nuk o... sporti pak m'ka ndihmu, se atëherë jom marrë, koxha aktiv me sport. Në fillim s'ka pasë sistem t'garava, se sporti i karatesë ka qenë hajt veç qashtu kem ushtru për veti. Ka fillu mandej stemi i garave dhe në stem të garave mandej jonë bo nëpër vende t'ndryshme në ish Jugosllavi. Po, kom udhëtu në Beograd, në Zagreb, e në Bosne, në Sarajevë, në Shkup mo mos t'flasim. Dhe ka pasë edhe seminare, tash po flas për veti, të sportit që kom shku edhe

vet. Po kom shku mandej edhe në referim, masandej kur kom kalu si refer. Kom pasë këto lëvizje. Edhe sot i kom ato nostalgji të udhëtimeve sepse qaq sa ka qenë ka funksionu. Domethonë, ke shku, je ndi, ai që ke mujtë m'u ndi, por nuk ka pasë diçka, diçka të theksime në kuptimin e padurushmërisë. Edhe pse veç kush t'rren, se gjithëherë kem qenë të veçumë edhe në kuptimin negativ të fjalës.

Gjithëhere, ku... n'çdo mes, a je konë shqiptar ti e ke pasë ni... por këtë kryesisht ku kanë dominu pjesa serbe dhe, edhe grupet tjera por pro serbe. Ka qenë këtu një... ne mund tani t'flasim sa t'dushë, si me thanë me fjalor diplomatik, po një padurueshmëni ka qenë. Sidomos në suksese, se shqiptarët kanë qenë shumë të dhanun, të afirmumë... n'diçka nëse... Po flas për veti, kom marrë pjesë unë n'diçka, ja u duftë me konë i pari, ja i dyti, e dy jonë konë krejt (buzëqeshë). Kur jom konë i dyti kom thonë i dyti, a kur jom konë i pari kom thonë i parafundit, se me mshefë pak garën. Domethonë gjithëherë shqu... Si me thonë kemi pasë garë në çkado që kemi mujtë me le t'themi me luftu qatë element t'padurushmënisë.

Aurela Kadriu: E a ka qenë, fakulteti teknik kur u hapë?

Adnan Merovci: Fakulteti teknik tani sakt s'po muj e di... vitet '70-ta...

Aurela Kadriu: S'keni qenë ju gjenerata e parë...

Adnan Merovci: Jo, jo, jo...

Aurela Kadriu: Ju s'keni qenë gjenerata e parë?

Adnan Merovci: Jo, jo se une kom qenë gjenerata e tretë a katërt si elektro po... se elektroja osht' hapë ma vonë. Por si fakultet teknik saktë nuk e di, mund të jetë në vitet '70-ta dikun, të '70-tat sigurt.

Aurela Kadriu: Cili vit?

Adnan Merovci: Po saktë nuk po e di, saktë.

Aurela Kadriu: A ka qenë kjo ndërtesa që osht' sot?

Adnan Merovci: Jo, jo. Ajo osht' ku osht' minis... ins... ky akademia...

Aurela Kadriu: Instituti Albanologjik?

Adnan Merovci: Jo. Ku osht' Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, ajo ndërtesa tjetër.

Aurela Kadriu: Mbrapa?

Adnan Merovci: Jo, jo. Karrshi. Dy ndërtesa që jonë, Akademia a çka osht'. Domethonë, qaty ka qenë, dhe kjo osht' rrënu vonë, domethonë osht' rrënu mas lufte...

Aurela Kadriu: Kjo është një ndërtesë ma heret...

Adnan Merovci: Ka qenë, edhe kanë qenë sallat e shumta. Ne i kemi shfrytëzu edhe sallat e Fakultetin Juridik naltë, jonë qujtë sallat B. Por ka pasë edhe nëpër pavijone andej ka Mahalle e Muhaxherëve, ka qenë kopshti i Fakultetit Teknik. Mandej u bo ndërtesa e re, por unë kom diplomu deri sa kom qenë këtu në ndërtesë t'vjetër. Mandej dikun në vitin '81-'82 osht kalue në këtë...

Aurela Kadriu: Qysh ju nxen '81-shi? Çka ndodhë? Çka, çka i paraprinë '81-shit?

Adnan Merovci: Tani në aspekt të asaj, të vet energjive të brendshme psiko-fizike të rinisë edhe të kohës kemi qenë, kanë qenë kryesisht Shqipëria, ideologjia enveriste, grupet ilegale, ideali kryesisht. Dhe ne vet, gjeneratë kemi qenë dhe kemi thonë që ne jemi komunist, por jo në LKJ, jo në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë. Dhe mos të më befasohen shokët dhe miqtë e mi se ja u nxo sytë secilit për këtë që po e thom. Domethonë, ne definitivisht s'e kemi mohu çashtjen e përkatësisë komuniste, pikërisht të ardhurit t'ushqym prej Shqipërisë, se komunisti osht' i mirë, i barabartë, t'gjithë t'barabartë, punojmë sa mujmë, hajmë sa na vynë, dogma t'hatashme. Po flas gjithëhere për periudhën rinore.

Dhe masandej të indoktrinum pak prej disa revistave të ndryshme, për shembull ka qenë në atë kohë një aktivitet i tresheve u qujke në Ilegale, domethonë une... mu dikush m'ka shti, dhe m'ka thonë, "Gjoj tre shokë". Qaj qe m'ka thonë, "Gjoj tre shokë, edhe qata tre shokë nuk duhet me i ditë sendet tjera, po veç ju tre..." Po secili prej tyne tonaj edhe ka tre, por une mos me i ditë e ai... ka funksionu ky.

Une nuk kom qenë në ato treshet e organizume. Por shokët e mij, njo prej tyne, një shok i ngushtë ka qenë dhe ai tash m'u pa konë në treshe m'ka informu dhe m'ka furnizu me materiale. Kanë qenë ato materiale gazeta "Çlirimi", e do revista tjera që për herë t'parë domethonë ti i ke pa në ekstrem çashtje kombëtare, të intensifikume, çashtjen e gjykimit të Lidhjes se Komunistëve të Jugosllavisë, e lavdatat e Enver Hoxhës, komunizmit, enverizmit. Domëthonë kjo ka qenë periudhë dhe si ideologji.

Në ndërkohë, ne kemi kuptu tash kush, qysh ka ardhë prej familjeve. Fjala vjen baba dhe babgjyshi jem çashtjen e komunizmit nuk e ka dashtë. Edhe sociallën, si thojke, "Ku ka sociallë aty s'ki çka han". {përplasë duart} dhe ajo që s'ka çka han e ka lidhë me aspektin djathtist, të pronës, se deri sa prona trajtohet në komunizëm e socializëm ndryshe, në djathtizëm ndryshe dhe në demokraci osht' ndryshe, prona osht' e shejtë e...

Pra edhe une motivet knej prej shpije i kom pasë djathtiste, por knej n'shoqni i kom pasë pak majtiste, njifarë rokeri tu ngu kangë... Hajde t'msoj turqisht te msoj edhe gjuhën e mos t'msoj serbisht. Domethonë, kjo ka qenë si gjendje edhe prej qarkut ku jom konë, nuk kom qenë i thellum fort po njifarë, njifarë le t'themi tregu ku merr erë ka ta merr mendja, dhe si formim. Dhe në këto celulat e ndame edhe me shokë mandej, tash shoku me shokun, edhe hajde cili po bohem ma patriot. Njani, "Jo Adnani s'bon me ditë këta se mos..." Ky tjetri, "Jo bre e njoh Adnanin duhet". Domethonë kanë qenë kështu, dy njerëz kur kanë folë kanë kqyrë anash kush o i treti, se liri shpirtnore s'kemi pasë. Idealin ke mujtë me pasë kush ma patriot se tjetri, por t'libër jo, sepse i kemi besu. Kjo ka qenë domethonë edhe si dogmë edhe...

Dhe në atë situata osht' pa mandej, kanë ardhë informacionet që ka, ka organizime, ka grupe, ka kështu... Por jo shumë t'përhapne, në ilegjitet, jonë ditë eksponentë. Fjala "Adem Demaçi" përshebull nuk u thonë me zo kurrë. Gjithëherë jem ru, me t'thonë unë ty përballë "Adem Demaçi" u dashtë me kqyrë kon {shikon prapa vetës} e kom afër, a po e ndin ose kom mujtë me thanë "Ademi" (pëshpëritë). Kush o Adem Demaçi? S'e kem pa kurrë kërkush, po qenka autor i një libri "Gjarpërinjë e gjakut", që tek o kështu, e tek o n'burg e kështu.

Dhe kjo periudhë dhe kjo kohë mandej krejt si e tillë është konvergju në ato ngjarjet e '81-shit. Edhe për mos me hi tash eksponentë, e qysh, jo menza, jo kushtet e ato krejt jonë konë pretekste, sido që të jetë... Por një organizim ka ekzistuar, ne nuk kem qenë drejtë për drejtë organizatorë se s'mujmë me thonë, por pjesëmarrës po, definitivisht në protesta. Sepse atëhere, atëhere ato u fuzionun domethonë prej mujit mars e mandej murrën, edhe murrën karakter gjithëpopullor.

Dhe aty ma s'pakti ken mandej për çështje të studentëve dhe kushteve, u artikulu në kërkesë politike dhe ka qenë "Kosova Republikë", për të cilën njerëzit kanë marrë burg veç pse në një kerr të pluhnosun e kanë bo fjalën "KR" edhe "Kosova Republikë" edhe ka pasë gjykime për qato dhe provë ka qenë veç pse ti e ke shkru fjalën "KR". Domethonë kjo osht' një realitet. Në jemi ndodhë mandej në njëfarë le t'themi, pse jo edhe njifarë entuziazmi, po shumë shpejtë mandej kem fillu me i kuptu gjanat realisht qysh jonë që, "Okej na mujmë më shpreh paknaqësinë por duhet pak me kokë ma të... me kokë ma të ftoftë".

Tash prej familjës po kthena prapë, fjala vjen në atë aspektin e, e liderizmit edhe të idenave edhe mbështetjes të referencës të Enver Hoxhës, une s'e kom pasë t'pengume prej shpije. Babgjyshi e ka dashtë shumë, bile ka pasë edhe... t'them kështu, se besimar ka qenë, po nuk ka qenë edhe i dhanun shumë mas riteve fetare si me thanë. Bile, ai, s'pe mshefi hiç se po flasim gjithëhere për kohën, se tash muj me lulu qysh dushë, po ai e ka pasë njifarë sure, njifarë, sure thuhet recitimi kuranor që i kanë thonë, "La ilaha illallah Muhammadur rasulullah", e ai thojke ndryshe, ai thojke, "La ilaha illallah Envere rasulullah".

Domethonë e ka pasë Enverin si t'idealizim, dhe une sot kur e mendoj dhe për njohuritë ai që i ka pasë osht' lidhë në vlera njerëzore. Osht' mendu që në Shqipni nuk vidhet, nuk ka padrejtësi, ka barazi, ka pastërti dhe askush nuk duhet askujt me ia pa për t'madhe me qito përshkrime nëse idealizohet... Edhe ideja te na ka qenë i vetmi shpëtim, mos t'them tash nga asimilimi se s'ka mujtë kërkush me na asimilu, po na asimilojnë sërbët, po njëfarë asimilimi i dhunshëm në kupitmin e rrethanave dhe t'kushteve.

Dhe ti kur e ke pasë referencë ideologjinë e Enver Hoxhës si referencë vetëmbështetëse, nuk ka pasë kurgjo t'keqe. Na veç jemi referu andej dhe i kem grahë sendeve tona, tash çka? Shkollimin e kem bo, identitetin kombëtar e kem rujtë t'jashtëzakonshëm, aspektin fetar e kem respektu, dhe feja ka qenë rit familjar. Domethonë, nuk i kem bo dallimet, po çashtjen e fesë e kem mendu si përcaktim shpirtnor edhe individual edhe kolektiv, po kryesisht kolektiv.

Pjesa e Tretë

Aurela Kadriu: Çka ndodhë me juve mbas diplomimit?

Adnan Merovci: Domethanë dikur në tetor të vitit '81, dhe duke qenë bursist i Bankës së Bashkuar të Kosovës... Banka e Bashkuar e Kosovës n'atë kohë ka qenë bankë komerciale, por bankë shtetërore. Ka pasë edhe bankë që i kontrollon ato dhe ka qenë Banka Popullore e ashtu quajtur, sikur sot qe osht' Banka Qendrore. Banka e Bashkuar e Kosovës, ose filialat që kanë qenë në BankKos të njoftuna si rrjetë në të gjitha qytetet e Kosovës kanë... domethonë këtë afarizmin ose veprimtarinë bankiere të një shteti që ka qenë.... Domethonë n'atë kohë kemi pasë bankë të shtetit dhe kjo pak a shumë e vërteton atë çashtjen e statusit të Kosovës që ka qenë.

Dhe Banka e Bashkuar e Kosovës ka qenë anëtare e Bashkësisë së Bankave të ish-Jugosllavisë, me t'drejta dhe obligime dhe kompetenca t'barabarta domethonë siç i kanë pasë t'gjitha republikat tjera edhe Vojvodina. Dhe në atë kohë, domethonë si bursist ju kom lajmëru institucionit që m'ka shkollu, m'ka dhonë bursë, dhe m'ka pranë në punë. Kom hy si bashkëpunëtor i lartë profesional në qendrën llogaritëse elektronike osht' qujtë atëhere. Ka qenë qendër e madhe kompjuterike e cila osht' marrë me përpunimin e produkteve bankiere, kredinave, kredinave investive, kontabilitetit, t'kursimeve devizore, kursimeve dinarike, atëhere dinarike, se dinari ka qenë valutë në Kosovë. Dhe une kam qenë i punësuar aty, dikun rreth, përafërsisht dhjetë vite, nantë vite, dhjetë kam punu.

Në ndërkohë, domethonë në vitin '81 kom punu edhe në Shkollën Normale, që osht' qujtë Shkolla Normale që ka qenë shkolla për nxanësit me mësim të orientuar, si gjimnaz matematikor, kom dhonë mësim. Kryesisht landë kompjuterike, tani teknologjia ka qenë ndryshe atëhere. Dhe kam dhonë domethonë mësim n'shkollë t'mesme disa landë. Prej aty kom shku edhe në Zveçan, domethonë pak a shumë tre vena, katër vena t'punës i kom mbajtë njikohësisht.

Puna e rregullt e imja ka qenë në Bankën e Bashkuar të Kosovës, prej shtatë deri në tre ka qenë orari. Prej 3 e 45 m'kanë fillu orët, domethonë prapë kom shku në Normale. Ka ndodhë që në të njejtën ditë kom pasë orë edhe ne Zveçan. Dhe mbi t'gjitha këto e kom pasë edhe një servis te teknikës t'bardhë në Vushtrri. Po flasim për kohën deri sa unë kom... kurse vitet e ardhshme, vitin '83 kom shku ushtar. Vitin '84 jom kthy.

Aurela Kadriu: Domethonë në mes të kohës që ishit tu punu?

Adnan Merovci: Po, n'mes t'kohë. '83, '84 jom kthy, edhe në vitin '84 mas ushtrie jom martu, vitin '85 kom pasë fëmijun e parë...

Aurela Kadriu: Ku ke qenë në shërbim ushtarak?

Adnan Merovci: Në Kërçovë kam qenë, në Kërçovë. Tërë kohën në Kërçovë kom qenë ushtar.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit ka funksionu Shkolla Normale në Prishtinë?

Adnan Merovci: Po nëse nuk gaboj dikun deri në... ajo ka qenë si mësim i orientum, ka ekzistuar deri, deri me thonë, edhe deri n'mbylljen e shkollave në vitin '89, por ka vazhdu mësimi, siç ka qenë mësimi paralel i orientum, ka ekzistuar deri në kohë t'luftës për në rrethana krejt tjera.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë qajo përvoja, BankKosi ka qenë këtu afër, Shkolla Normale ka qenë atje te Gërmia, a po?

Adnan Merovci: Po e vërtetë. Une kom udhëtu shpesh herë me veturën time, edhe pse ndonjëherë edhe me autobus, ka pasur autobusa të ashtuquajtur afarist, që ka qenë vetëm për punëtorë prej Vushtrrisë, se në Vushtrri kam banu. Dhe domethonë nëse jom ardhë më veturë, shpejtë me veturë nga parkingu i bankës kom shku në Normale. Normale njihet si shkollë e ashtu quajtur në Sofali. Dhe kom vazhdu me një entuziazëm t'madh, dhe definitivisht kanë qenë gjenerata, jo pse kam qenë arsimtar, por kanë qenë gjenerata shumë t'mira. Dhe mësimi osht' zhvillu edhe me përkushtim shumë t'madh.

Fjala vjen, unë në fakultet landë kompjuterike që i kom pasë, i kom spjegue me qatë plan program po pak t'reduktum. Bile nxanësve ju kom thonë nëse nuk e merrni tetëshe pa mësu fare, mos m'flisni rrugës, "Si je, profesor?" Dhe me këtë kom dashtë t'ju them që ky osht' obligim i imi, sepse në shkollë t'mesme shkohet me mësu, dhe në këtë aspekt mësimi, mësimi i takon mësimdhanësit, jo nxanësit.

Domethonë mendoj që kam qenë mjaft atraktiv, te ne s'osht' modesti me thonë, por kom ekzemplar, kom nxanës. Sot jonë edhe figura publike që kanë qenë n'shollë t'mesme, domethonë n'vitin e tretë dhe t'katërt dhe kanë pasë diplomën tek une. Ka qenë provimi n'shollë t'mesme i diplomës që ka

qenë ngjarje për nxanësa, sepse sa ma shumë ti japësh rëndësi asaj pune, ma shumë respekton nxanësin. Fjala vjen, ka qenë Dukagjin Gorani një prej tyre, ka qenë Lirak Çelaj, ka qenë Lulzim Peci. I përmenda disa kështu që mu kujtunë disa emra pak a shumë publik që kanë qenë nxanësit e mi.

Aurela Kadriu: Domethonë kur, kur po përjashtoheshin shqiptarët prej vendeve t'punës edhe formohet sistemi paralel ju jeni përjashtu në të njejtën kohë prej dy punave?

Adnan Merovci: Jo, në fakt, në fakt jo. Une n'vitin dikun '84, '85, nëse nuk gaboj dikun rreth '86 e kom lonë mësimin sepse kom qenë me preokupime t'mëdha tjera. Dhe mandej kam planifiku organizimin e jetës time. Domethonë, në vitin '98 kom ardhë në Prishtinë me banu me familjen, ndërkohë domethonë jom martu dhe kom pasë fëmijë, dy fëmijët e parë. Mandej, domethonë mësimin në shkollë e kam lanë vet, sepse kam punu jom angazhu ma shumë në bankë.

Dhe viti '89-'90 pastaj kur ka ardhë, banka ka qenë në kushte... domethonë, politika, segregacioni, rrënimi i autonomisë t'gjitha institucioneve. Dhe kur i ka ardhë rradha bankës, banka ka pasë një, le t'themi një qasje speciale, ka shku në proces të falimentimit. Kjo nuk mund t'thuhet për bankë, tash në aspektin sindikal edhe t'drejtave t'punëtorit, nuk mund t'thuhet që osht' organ i dhunshëm si proces, por osht' ditë prapavija.

Une kom qenë i angazhuar në atë kohë në Sindikatën e Pavarur të Bankës. Sindikatat e Pavarura në atë kohë kanë qenë institucioni i parë, le t'themi popullor, që ka dalë para të gjitha partive politike, para LDK-së e tjera, e tjera. Po flasin prej rrënitit të autonomisë, dhe n'qatë periudhë sindikata e pavarur ka qenë domethonë ai pishtari, ai veterani i aktiviteteve të ndryshme. Edhe pse fjala sindikatë ka t'bëjë me t'drejtat e punëtorëve, megjithëatë aty ka pasë pak edhe politikë, ka pasë organizim, ka pasë ekzekutim, ka pasë solidaritet edhe në kuadër të sindikatave.

Dhe duke qenë anëtar i Kryesisë të Sindikatës të Bankës, domethonë ne kem qenë pak edhe në shënjestër të pushtetit sepse dihet me çka osht' marrë sindikata, organizim, me jetën, jo najgo tjetër. Dhe aty kem pasë debate t'ashpra me paln edhe me organin që ka ardhë për, për, për me falimentu bankën. Bile jonë një dy dëshmi që i kom paraqitë unë në atë kohë, të cilat retroaktivisht i kom shfrytëzu gjatë dëshmisë sime në Gjykatën e Hagës kundër Millosheviqit, edhe pse unë kom qenë dëshmitar politik, po e kom përfshi periudhën prej '81 deri në kohën e bombardimeve, si dëshmi në Hagë, tani mos t'shëtis shumë në kohë.

Por po kthehna te Banka, ku kanë qenë, kanë qenë dy momente, një ka qenë që organi, domethonë ky për falimentim bankën që e ka çu ka imponu disa fletëhyrje ku kanë shkru me alfabetin cirilik, dhe ka pasë aty disa njerëz pak ma revolucionar që kanë thonë s'po dojmë me i pranu. Unë kam qenë më disa shokë tjerë në sindikatë aty, koxha kambëngulës që mos t'trajtohet si pengesë se ne edhe ashtu kanë me na largu, po mos t'jetë ajo sot, t'jetë sot një javë. Pse t'ia lehtësojmë qaq lehtë? Kjo ka qenë motoja.

Nji, e dyta, deri sa nuk shkohet dhe preket e drejta e punëtorit ose e drejta, le t'them edhe kombëtare po thellë që preket mos të... se qëllimi ishte në proces të falimentimit me një potez që t'na lirojnë të gjithëve, dhe ata të kryjnë punën e vet t'lirohen rreth asaj. Kështu që, unë kom qenë një prej atyne që... por i njëjti kam qenë edhe ai që kom demolu dyert në kohën e, e, kur po flasim sepse organi kish vu një punëtor aty për me ndalu punëtorët pa ato fletëhyrjet, e ato veç serbët i kishin marrë, shqiptarët jo. Aty pak njëfarë revolucionit t'vogël e kom bo, pa modesti prapë, unë kom qenë kryesori që e kam demolu derën, dhe kemi hy brenda dhe ajo punë osht' shujtë, menjherë kemi shku për t'i marrë fletëhyrjet, por ma fletëhyrjet s'kanë qenë valide. Domethonë e kanë pa që ai potez s'po ju shkon. Qajo ka qenë një moment.

Momenti tjetër ka qenë që në atë kohë unë kom qenë një kuadër me një përvojë, dhe atëherë u ndajshim n'banesa nëpër organizata punuese, unë kom qenë i parapamë. Dhe vjen një kimsite, një serbe me kimi, domethonë shkencat e kimisë i kish studiu, n'kompjutera. Dhe si e shpërngulne, si e kthyme ka qenë njëfarë aksioni, dhe ajo morri banesën time. Aty kom protestu unë koxha shumë. Aty e kem pasë pastaj një konflikt me udhëheqësia dhe ka mjaftu një videoxhirim që drejtori sot m'ka pa me Rugovën në një konferencë për shtyp, m'thërret në zyre, thotë, "Ti o me bankën, o me Rugovën". Sepse fillunë me i largu t'gjithë punëtorët tani si tepricë teknologjike se banka në falimentim, po kjo tepricë ishte veç për shqiptarët. Asnjë serb, të gjithë shqiptar.

Meqenëse unë punojsha në punë kyçe, që ishte qendra llogaritëse nuk i ngucshin shqiptarët që punojshin, që ju dufshin, një prej tyne kom qenë edhe une. Po ajo në, në, paraqitja me Rugovën në konferencë për shtyp ka bo që m'thërret ai dhe thotë, "O Rugova, o banka!"

Aurela Kadriu: Në cilin vit?

Adnan Merovci: Ky osht' viti '90. I thom une, "Une jom me të dyjat, edhe banka, se banka osht' e imja edhe puna jem..." Dhe e dyta ka qenë, "Edhe Rugova imi, bile edhe i yni edhe une edhe me të jom". Dhe ata kanë zgjedhë që une t'jem veç me Rugovën. Domethonë, të nesrit e kom pasë vendimin në tavolinë i përjashtim nga puna. Me atë rast unë kam qenë në një sistem të SWIFT-it...

Kaltrina Krasniqi: M'fal veç pak, për çfarë arsye?

Adnan Merovci: Arsye... po tani saktë ai vendimi ka qenë, nuk ka pasë vendime t'shkruhet për arsye që ky osht' me Rugovën, vendimi ka qenë tepricë teknologjike, se kuptohet se kanë shkru. Po në n'bisedë kur kemi shku, se një organ falimentues nuk jep shpjegime se pse mendoj që në një vend pune jonë tre vetë, edhe e len veç një, s'i jep shpjegim kërkon se e ka një komision që vlerëson. Edhe kam qenë në bashkësinë e bankave edhe përfaqësues i bankave për projektin e SWIFT-it. Nëse e keni parasyshe SWIFT-i osht' një projekt bankier për transaksione ndërkombëtare dhe kur u fliste këtu njëzëit nuk e dishin që SWIFT ka pasë Kosova në atë kohë. Unë jom konë udhëheqës i SWIFT-it në atë kohë.

Dhe një komunikim m'thrret një sloven, se ne kemi komunikuar, i thom, "Nuk jom mo n'bankë se me dhunë..." Edhe ai tekstualisht m'ka thonë, "Nuk je n'bankë?" "Po." "Kush e ka bo këta?" "Organi". Thotë, "Dhe kush janë ata?" I thashë, "Të gjithë serbë". Dhe m'ka thonë, "Sa serb ki me i vra ti për vendin e punës?" Edhe i them, "Çka po thu?" Thotë, "Po, për vend t'punës bon me e vra njeriun". Kjo ka qenë diçka njifare solidariteti, kohë për mu, le t'them vetëdijësuese, pak kom fillu me mendu ndryshe, që po bojka... tani nuk them me shku n'akte të vrasjes e t'dhunës, po me t'vërtetë puna osht' send i shenjtë.

Por ne n'atë kohë e shtymë sa mujtëm edhe unë n'këtë rast i kom shpëtu disa punëtorë, sepse edhe një argument tjetër e kom pasë që dikun rreth 150 mijë euro n'mujtë ne ja jepshim Serbisë nëse dilshim qashtu kolektiv prej punës. Dhe sa punëtori ish pa punë, dhe sa minatori, se u largun, e sa... Mandej ne kemi organizu njifare solidariteti dhe i patëm ndihmu njerëzve n'nevojë me rroga tonat. Ne rrisim me punu dhe gjysën e rrogës e ndajshim dhe ne si sindikatë ju ndihmojshim njerëzve. Dhe këto jonë dy momente që lidhen me këtë organ dhe me këtë si me thonë procesin e falimentimit të bankës që m'ka ndodhë mu n'atë kohë.

Aurela Kadriu: Qysh jeni taku me bashkëshorten?

Adnan Merovci: Bashkëshorten e kam taku në bankë. Ajo ka qenë nxanëse, ka ardhë në vitin e fundit në praktikë. Në praktikë kanë ardhë grupe studentash, nxanësish. Dhe në bankë, në praktikë që kanë ardhë dikun ka dhjetë ditë grupe t'ndryshme. Pas kryerjes t'praktikës kemi pasë një ndejë dhe unë kam shku në, në... Ju kom afër afër dhe i kom thonë, "Ki me qenë bashkëshortja ime". Ajo është skuqë e tëra dhe ajo sot osht' nanë e katër fëmijëve tonë. Se kur po folni [i'u drejtohet intervistuesve] kështu po du me ju këqyrë dyajve se *eye contact* kom zakon me këqyrë, po për shkak t'pyetjes e po t'drejtohna veç ty...

Kaltrina Krasniqi: S'ka problem. Para se me kalu tash në këtë periudhën e viteve të '90-ta, çfarë efekti ka pasë viti 1981, sidomos në sektorin bankar, n'qatë dinamikën ekonomike të Kosovës?

Adnan Merovci: Viti '81 ka qenë vit, le t'themi politik, por politik n'kuptimin e pretekstit se ne duhet... Bile ka kalu një kohë e gjatë dhe perceptcionet mund të jenë t'ndryshme, por ka diçka që edhe na bashkon si mendime. Definitivisht domeonstratat kanë qenë shprehje e paknaqësisë edhe u konvergjunë ka politika, edhe projekti i politikës të Kosovës, në vazhdimësi prej '68-tës, por me gjithë atë nuk mundemi pa me pranë që ka qenë edhe një mikpritje e elementit sllav dhe serb... Sllav jo, por serb se kur thuhet sllav osht' kuptim i gjanë, por serb dhe disa pro Jugosllav që e kanë shfrytëzu këtë moment për të i stopu dhe ndali zhvillimet dhe përparimet e shqipëtarëve që po shpërthejnë në mënyrë rapide, çka?

E para dhe kryesorja ma s'shumti që ju ka pengu ka qenë çashtja e shkollimit, zhvillimit, natalitetit t'shqipëtarëve, dhe në veçanti marrëdhانيت me Shqipërinë. U bo njëfarë marrëveshje osht' bo për këmbime kulturore, dhe me të madhe kishte rrjedhje, si rezultat i kësaj fjala vjen une në fakultet dy provime i kom prej profesorëve të Shqipërisë. Dhe kjo ishte diçka e padurueshme për sistemin. Dhe demonstratat e vitit '81 janë shfrytëzu, por kjo në asnjë mënyrë nuk e zbehë si me thonë misionin dhe atë energjinë e konservume t'shqiptarëve për kërkesa politike si të tilla.

Dhe kuptohet që serbët masnej dhe regjimi serb... tash une po i them serbë edhe pse ka qenë ish Jugosllavia atëhere po e dominum prej, prej rrymave serbe, në këtë aspekt me Kosovën. Sepse krejt masat çka kanë qenë kundër Kosovës dhe shqiptarëve në Kosovë kanë qenë në emër të ish Jugosllavisë. Fjala vjen në çdo sektor kanë qenë të Sllovenisë, Kroacisë, por edhe këtu nuk, nuk e shoh prej kësaj distance kohore ngative, se fjala vjen policët, ka pasë policë, edhe policët slloven vijën t'shërbejnë këtu. Ata e kanë pa qe çdo osht' n'rregull me këtë popull, ky popull pe don veç një farë lirie, po e don njëfarë realizimi të vet politik, dhe jonë vetëdijësu edhe ata. Edhe kjo shumë ka ndiku, si te Kroatët, si... po flas tash politikat e nalta e këto i kanë ditë gjanat, por populli... edhe opinionet krijohen edhe prej këtyne njerëzve edhe këtyne gjanave.

Dhe duke qenë kështu definitivisht në çdo segment të jetës ka pasë ndikim negativ. Nuk eliminohet këtu edhe sistemi bankar në përgjithësi, edhe pse në vitin '81 e ma tutje, domethonë prej '81 një periudhë ka pasë presion, por kanë qenë edhe periudha kur edhe elementi shqipëtar në pozita kyçe kanë mujtë me e tregu vetën. Dhe një prej këtyne osht' një drejtor që ka qenë, Ilaz Ilazi, i ndërë tash, nga Ferizaji, i cili osht' një hero i bankave edhe i BankKosit sepse ai... tani une duhna t'them që e ka ndërru strukturën nacionale, por e ka bo reale, pak ma reale.

Fjala vjen, ai e ka ekuilbru dhe numri i punëtorëve në bankë ka qenë ma i madh se i serbëve deri sa n'fillim kanë qenë më 10-20 përqind. Dhe tani kësaj sado le ti vije era politikë, osht' një politike reale sepse po flasim për një popullatë 90 përqind. Dhe ky zhvillim shumë i madh, edhe për, edhe mas të '80-tave domethonë, por nuk ka qëndru edhe shumë sepse masat kanë qenë qaq t'ashpra që ka ardhë një moment kur, kur masat e tyne i kanë dhonë efektet negtive për neve. Sepse ka pasë diferencime të mëdha, ka pasë afera të mëdha, diferencim për intelektualisht, e njerëzisht, e familjarisht me veprime të shumta.

Tani këto jonë qesharake por të vërteta. Në qoftë se një parking t'veturave ku ka pasë pluhun ose dimnit nëse i ke shkru dy germa "KR" dhe... bile, bile edhe pa dëshmi t'mëdha njerëzit kanë përfundu nëpër burgje, "Kosova Republikë". Kot ti thuj, "Jo kom shkru Kranje këtu". Ja, "Kom dashtë me shkru diçka tjetër". Osht' domethonëse, gjendje e tillë ka qenë.

Kaltrina Krasniqi: Ku keni qenë në ditën e demonstratave të '81-shit nëse ju kujtohet?

Adnan Merovci: Po tash këto jonë... se demonstratat e '81-shit, '81-shin kanë ndodhë pak... Por dita e parë kur osht' rrëzu kjo pjata e ushqimit prej të parëve aty që kanë qenë në Menzë të Studentëve, une kam qenë në konvikt, kom qenë në konviktin numër tre. Edhe pse osht' vitit '81 kur unë i pata kry studimet edhe provimet, por e kisha diplomën. Dhe si i tillë në konviktin tre e kom pasë një dhomë, garsonjerkë të ashtuquajtur atëherë, sepse katër vjet e gjysë kanë zgjatë studimet me provime, gjysë viti ka qenë, kështu fakultativ, ka qenë diploma.

Dhe unë kam qenë në, në konvikt. Nuk kom qenë me shokët sepse siç thashë viti i fundit dhe kush anej, kush këndej. Disa kanë diplomu para meje sepse kanë qenë ma agjil në ato... Mu m'nxunën këto demonstratat pak n'mars, n'prill dhe afatet mu shtynë deri n'tetor të vitit '81. Por kom pasë kumunikim me njerëz. Domethonë, jom konë bash n'qendër t'studentëve kur, n'ditën e parë të demonstratave.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë atmosfera?

Adnan Merovci: E ftoftë, në kuptimin e transparent. Gjithëhere po flasim për vitin '81 edhe osht' vështirë tani edhe opinione ose edhe njerëz që pak a shumë nuk kanë edhe njohuri ose nuk kthehen së paku në retrospektivë me u mundu me imagjinu si rrethanë, si kohë. Jashtë edhe n'transparencë ka qenë një zbehje, ka qenë një ftoftësi. Mirëpo, brenda njerëzit kanë ndryshu. Tash nëse mund t'themi çashtje e manifestimit t'gjendjeve t'brendshëm osht' edhe manifestimit i tyne jashtë osht' moment psikologjik për secilin, secili n'forma t'ndryshme.

Tani nuk dua t'them por kur flasim për vitin '81, flitet për një kohë dhe një moshë t'formimit tim, kom qenë veç i formum, në t'shmajhtë, a në t'djathtë, a poshtë, a naltë osht' çashtje tjetër, por i formum po. Dhe formimi deri në atë kohë ka qenë, mendoj i drejtë, me disa avancime. Fjala vjen çashtjën, dhe shqetësimet e çashtjës kombëtare unë i kom marrë si fëmijë, edhe paraqitjen time në këtë projekt, edhe prej babëgjyshit edhe babës, por edhe nga shoqëria mandej në studime. Dhe ka qenë ai sistemi siç e thashë edhe ma herët, i tresheve ilegale, une nuk kam qenë i përfshirë, po e kam pasë një shok t'ngushtë t'përfshirë, dhe ai shok i ngushtë mu m'ka njoftu. Qaq kem qenë të afërt që nuk m'ka obligu t'boj treshe, po e kom ditë veprimtarinë, dhe ai m'i ka lonë produktet e lexume dhe disa fletushka që kanë qenë "Çlirimi" e tjera, nën tepih dhe kërkush s'e ka ditë. As ai mu nuk m'ka thonë që po ti... një herë m'ka thonë, "Aty i ki". Dhe gjithëhere i ka ndërru vet. Ka ekzistuar edhe kjo formë.

Pra krejt si rezultat ka qenë, domethonë t'gjithë e kem pasë një dhimtë por manifestimi ka qenë i ndryshëm. Dikush ka qenë, pse jo, njerëzore osht' me konë frikacak, ma frikacak, dikush ka qenë ma i vendosun, dikush e ka pasë një, një motivim ose një shtytje, ose një përkrahje prej familjës edhe për një revlucionaritet ma t'madh. Dikush ka qenë pak ma i qetë, dikush ka qenë ma individualist, dikush ma kolektivist. Domethonë, këto jonë situata ose manifestime varësisht prej vet qenies njerëzore edhe individit n'përgjithësi.

Kaltrina Krasniqi: Kjo ka qenë në një periudhë kur njerëzit, sidomos për këtë janë burgosë?

Adnan Merovci: Po. Në fillim, në fillim osht' mundu njifarë komunikimi me qenë me ta dhe dihet historia si ka qenë. Por, kjo u konë problem se çdo herë që, çka ka qenë publike dhe nëse ka dalë një politikan, siç ka ndodhë ka dalë Mahmut Bakalli, dhe ka folë dikush, edhe kanë folë disa tjerë, jonë mundu me qetësu situatën. Ata kanë premtu qetësi e le t'themi {bënë thonjëzat me gishta} amnesti, e ku ta di unë... por ato dihet si kanë përfundu. Studentat masnej në heshtje jonë burgosë, jonë arrestu, jonë malltretu. Dhe kjo ka qenë me t'madhe domethonë dhe eksponentë sot që dihen që jonë, që kanë pësua nga kjo... Tani n'atë valën osht' diçka tjetër, mos t'harrojmë që ka pasë edhe të vramë n'demonstrata edhe ka pasë...

Por, procesi mandej edhe preteksti nga kjo ka qenë rrezik për neve, dhe ne e dijmë tash me qindra, mija njerëz të marrun, të arrestum, në pyetje, të plagosun, të përdhunum e tjera, e tjera. Domethonë, ka qenë një, një dhunë edhe në heshtje, edhe me za kur osht' dashtë që, si me thonë të manifestohet ajo fushatë më za, osht' manifestu, por edhe nëntoka ka punu mjaft. Domethonë, njerëzit... ajo që ma së shumti ka pat fillu pak me lulëzu e mandej u shkaput, osht' liria shpirtërore, që njerëzit nuk kanë qenë t'libër mandej edhe n'komunikim. Domethonë, dy vetë, i treti u konë tepër për me folë.

Mu m'kujtohet në vitin '89 kur osht' përmend në zyre Adem Demaçi fjala vjen, në vitin '89 po flasim tani, po reflektoj tona e knej... Adem Demaçi ka qenë një njeri që na kurrë s'e kemi pa, por kemi dëgju si gjeneratë për të, kemi lexu diçka për të. Gjithëherë kemi shiqu anash mos i treti se po përmendet emri i Adem Demaçit. Flitet për një situatë jo shumë normale.

Kaltrina Krasniqi: Ju keni qenë, sipas të gjitha gjasave keni ardhë në Prishtinë në kohën kur Prishtina ka fillu valën e vet t'dytë të ndërtimit në shekullin XX-të?

Adnan Mervci: Pak a shumë, po. Po, pak a shumë po.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni ashtu veç me na dhonë një... paramendojeni që na jemi fëmijë që kanë lindë mas të '80-tave, domethonë në '81, '90-të e shumë ma vonë. Paramendojeni që jemi tu e bo një dokumentim vizuel të një qytetit në ndërtim. Mundohuni veç me na dhonë njifarë...

Adnan Merovci: Po. Tani unë fëmijërinë nuk e kom kalu në Prishtinë...

Kaltrina Krasniqi: P'e di, veç keni ardhë...

Adnan Merovci: Po me këtë dua t'them se me kalu nuk e kom kalu, po shumë kom qenë prezent. Fjala vjen, çdo vjet kam qenë, ka ndodhë dy ose tre mujë i kom kalu në Prishtinë. Se siç e thashë motrën e kom pasë këtu, dhe kom ardhë gjatë kom ndejtë te motra. Une i kom pa këto lëvizje si me thanë dhe në temen që po flasim. Prishtina ka qenë një vend me ndërtesa t'koncentrume. Fjala vjen ajo që m'kujtohet jonë tre rrokqiejt që jonë në Ulpianë, domethonë ata tre rrokaqiejt kanë qenë grandioz te

fontana. Dhe gjithëherë e kanë simbolizu Prishtinën edhe nga çdo anë që t'hyjshe në Prishtinë, si nga Veterniku, si nga ana e Mitrovicës, sikur ka ana e Vranjevcit që vihet... se po flasim për periudha kur ndërtimet kanë mungu, këta tre rrokaqiej janë dukë.

Edhe janë duke minaret e xhamive, që e kanë domethonë identifiku Prishtinën pak. Ndërtesa e kuvendit, munumenti i Bashkim Vllaznimit a çka osht' qajo përmendorja qaty që kanë qenë. Domethonë, unë si fëmijë aty i kom gjetë, po flasim për, për dëshmitë e mija. Dhe lagjet kah Ulpiana, dhe kah qendra disa, domethonë rruga ku osht' sot sheshi ka qenë një rrugë me kubëza, ku kanë qarkullu veturat anej-këndeje dhe koxha e ngushtë ka qenë.

Dhe po vijmë deri te viti '70 e diçka kur osht' ndërtu Lakrishtja. Ajo çka une e mbaj n'mend osht' pesë hyrjet e Lakrishtës. Sepse edhe në Lakrishtë kom punu masnej, se një vëlla i jemi ka marrë një banesë aty. Por atë që muj me e përmend tash osht' çashtje e infrastrukturës. Domethonë, kanë qenë të koncentrumë në disa grupe ndërtesash, por infrastruktura ka çalu. Fjala vjen kur po flasim, edhe kjo e "Agim Ramadani" ku osht', "Ramiz Sadiku" i kanë thonë përpara, ai krahu i ndërtesave, aty ka qenë deri në Ministrinë e Kulturës, rruga ka qenë e parregullume, rruga ka qenë më një lloq që osht' si humë e ashtuquajtur, si lym, dhe ka qenë tmerr për me ecë. Dhe aq e gjatë m'u ka dukë n'atë kohë ajo rrugë, që tash kur t'shkoj, se ndonjëhere me nostalgji eci asaj rrugës edhe m'duket se fizikisht osht' zvogëlu. Se kur t'ndërtohet edhe t'rritet dinamika e njerëzve gjanat shkurtohen, se kjo e ka spjegimin edhe t'vetin, kjo çka po e them.

Dhe definitivisht Prishtina ka qenë, i mbaj n'mend semaforat e parë. Semaforat e parë janë qujtë semaforat kryesor. Edhe sot i thojnë...

Kaltrina Krasniqi: Ku kanë qenë?

Adnan Merovci: Ata kanë qenë n'qendër t'qytetit qita. Dhe këtu nuk janë bo herët, po koxha vonë, domethonë po flasim dikun, tash mos t'gabohem po rreth viteve të '80 ose mas '80-tave dikun...

Kaltrina Krasniqi: Te katedralja, a po?

Adnan Merovci: Po, te katedralja. Ata kanë qenë semaforat e parë dhe t'vetëm. Semaforat, domethonë përpara i kem thonë te semaforat, se një parë kanë qenë dhe dihet. Ka qenë interesant. Merreni me mend une nga, i Vushtrisë kom qenë, edhe si i ri kom qenë domethonë, e kom pasë një ideal, a thu ndonjëhere bohet një semafor në Vushtri. Sepse thu se semfori ka qenë një, një barometër i zhvillimit ose një simbol i zhvillimit t'vendit, a po kupton? Domethonë andërr e kom pa me e pasë, dhe kurrë s'kom mendu që në Vushtri munit me ardhë koha e një semafori fjala vie. Dhe në Prishtinë me kohën, tu u shtu semafora tjerë fillunë me ju thonë semaforat kryesorë, edhe sot i thonë të semaforat kryesor.

Prishtina ka... Domethonë edhe historikisht me marrë Prishtinën jashta pjesës antike që osht' Ulpiana te Graçanica, që, që historiografia e spjeron këtë... Domethonë një qytet {bënë thonjëzat me gishta} artificial i krijum për shkak të statusit të kryeqytetit dhe ku gravitojnë institucionet shtetërore dhe kjo e bëjnë domethonë që detyrimisht qaj qytet do të zhvillohet, do të rritet, do të bohët dhe... Për fat t'keq, por tash muj t'konsiderohna si prishtinali, por nuk e ka ru njifarë identiteti t'vet, sido që të jetë domethonë. Hiç monumeteve t'vjetra që kanë qenë, dy xhamiat e mëdha, hamami që ka qenë aty, çarshia e vjetër, ndërtesa aty te teatri ai Unioni, muzeu prej kohës, domethonë ato stilet astro-hungareze.

Duhet t'them që Prishtina nuk ka ndonjë memorie shumë t'madhe ose kujtesë, le t'them edhe në krahasim me qytetet... E di une, vi prej një qyteti t'vjetër koxha, mas Novobërdes, Vushtrria osht' ndër qytet ma t'vjetra në Kosovë. Domethonë, tjera identitete kanë... kur flasim tash edhe për t'kalumen. Prishtina disi ka qenë si një *artifice* pak a shumë, edhe i ndërtum mandej njerëzit kanë fillu me gravitu dhe tash e ka bo identitetin e vet. E ka sido që të jetë, por duhna me u kuptu shumë drejtë diqysh... Në krejt botën ma s'shumti e du Prishtinën, po kur t'ndalna me mendu s'kom ku ngjitna diqysh.

S'po du me folë naj fjalë tjetër, e du shumë, por i mungon shumëçka. Dhe tash kjo mungesë shumë çka, as s'e ka pasë kurrë, as s'ka ditë me rue diçka që osht' pasë. M'duket osht' kombinim i të dyjave. Se sot, për shembull nuk i ke tri shtëpi, një lagje nuk e ke që mund ta qujsh qytet i vjetër. A ke, ke pasë, diçka pa mbetë, jonë do rrënoja... fjala vjen çështja e konservateve. Osht' konservati, ka konservat serb në Prishtinë. Tani veç pak me dashtë me lodhë kokën, çka do të thotë kjo, e qysh bre, qysh Prishtina, e qysh Kosova? A s'u kanë gjithë nën Serbi a? Domethonë, jonë gjana të cilat veç kështu ta, ta, ta rrotullojnë memorien, e dijen e... e ato a mos me i ru sot, a mos me i pasë? Une e di ku jonë ato konservata që kanë qenë. Domethonë, këtu duhet të kemi si me thonë kujdes ndaj ktyne edhe strukturat relevante t'qytetit.

Klatrina Krasniqi: Ju mandej në vitin 1989 keni ardhë më jetu në Prishtinë, a po?

Adnan Merovci: Une si i martum me tre fëmijë në Vushtrri, nusën n'kamion, senet, teshat kom ardhë në Prishtinë në një banesë fillimisht në Dardani, afër ndërtesës së postës. Aty kam banu një vjet e diçka. Mandej kam ndërtu një shtëpi në lagjën e Vreshtave, por s'kam mujtë me banu se s'ka pasë banorë. Edhe s'kom mujtë familjen atje... Por kam marrë një troll me leje ndërtimi, se ka qenë problem atëhere edhe pak jom kanë në sy. Dikun në vitin '89, '90 e kom përfundu atë shtëpi.

Mandej kom shku te vllau, te... në Lakrishtë kom banu, pak me qira në Lakrishtë. Aty domethonë kom pasë edhe mundësitë edhe ai kontakti pak ma i afërt... Pastaj edhe me një protagonist që m'ka shku një dekadë e jetës pastaj me të, që e ka emrin Ibrahim Rugova.

Aurela Kadriu: Cila ka qenë lagjja e Vreshtave?

Adnan Merovci: Lagjja e Vreshtave osht' te "Prroni i Popit", ty shku prej rrugës të Proleterit në fund, Kolovica, Kolovica, okej. Kolovica, "Prroni i Popit", Vreshtat qishtu dika i kanë, si tri emërtime i ka pasë. Atje e kom pasë shtëpinë e parë, mandej atë shtëpi e pata shitë dikun n'vitin '96. Kom banu njihere me qira këtu, e hajde qashtu... kom lëvizë shumë domëthonë, por Lakrishtja osht' edhe si vend, se para se me ardhë si student kom banu se vëllau e pat marrë një banesë në katin e shtatë.

Dhe gjatë asaj kohe kom pasë rast në të njejtën hymje, une në katin e nantë n'fakt, Ibrahim Rugova ka qenë në katin e shtatë. Aty jemi taku shpesh. Dhe Rugova ka qenë një intelektual në atë kohë që për qarkun e shokëve t'mi ka qenë i njoftun si ma ndryshe. Ne e kem përfolë, kem folë për Ibrahim Rugovën, pa kanë as kryetar, as LDK as, para... vitin '82, '83, '84. Me shkrimet e tij, se ka pasë ai botime ne revistën "Bota e Re" dhe ne si shokë jemi marrë me këta njerëz që kanë shkru pak ma ndryshe. Dhe e kem pa që ky njeri osht' pak ma ndryshe se të tjerët.

Tash preokupimi nuk ka qenë shumë i madh për Rugovën sa vet refleksioni i tij, por masandej mu vet fati m'ka lidhë me to. Dhe zanafillat nuk janë edhe krejt t'rastit, domëthonë Rugova nuk osht' një njeri që veç m'ka shpikë qashtu. Disa rrethena i kanë kontribu asaj afërsisë tonë, dhe ajo ka qenë hyrja domëthonë, e kom pasë fqi si me thonë se kom banu te vllau aty si student një kohë. Dhe mandej jeta na ka çu atje ku na ka çu.

Kaltrina Krasniqi: Qysh u lidhët me Rugovën?

Adnan Merovci: Në vitin '89, dhe ato lëvizjet dhe komunikimet përmes Shoqatës të Shkrimtarëve që i ka pasë Rugova vet, kanë qenë ngjarje që ne edhe, edhe presjet e pikëpresjet i kemi lexu. Se e vetmja mënyrë ka qenë leximi i atyne çka janë publiku. Dhe publikimet kanë qenë kryesisht nëpër gazeta t'ndryshme, edhe të Serbisë, dhe këto kanë qarkullu, i kemi gjetë, kemi lexu. Se kemi pa që shkrimtarët dhe Shoqata e Shkrimtarëve si institucion, jashta lëvizjeve tjera çka ndodhëshin në Kosovë osht' një, një, me thonë një arenë ku zhvillohet taman një luftë intelektuale dhe po preken senet në esencë për herë t'parë pak a shumë, po flas për herë t'parë ne si gjeneratë duke ndëgju. Dhe definitivisht aty lindi një simpati, nëse mund të thuhet intelektuale për Ibrahim Rugovën e qarkut t'njerëzve ku, ku une rrisa dhe shokët.

Dhe Rugova ishte një njeri i njohur. Dhe kontaktet e para, takimin e parë me të e kam pasë ndoshta n'rrugë dikun. Ka qenë karakteristik, me një karizmë, domëthonë flokët ma t'gjata, shallin edhe palltë... se po e flas kohën kur une e kom taku, u konë si ftoftë, me një palltë dhe një çantë t'zezë. Domëthonë, ai osht' Rugova, domëthonë i ditëve t'para kur unë e kom taku. Mandej osht' komunikimi në banesë ku shpesh, mos t'them tash për çdo ditë jemi taku në lift fjala vjen, ashensor. Dhe kurrë s'kom mujtë me i fole unë i pari, gjithë ai ma ka grabitë diqysh, janë do njerëz që s'mundesh.

Edhe n'emën m'ka thonë, për mu ka qenë befasi kjo, ky po ma din emrin mu. Definitivisht ndoshta edhe sot jom pak pa përgjigje, si ky njeri me ma ditë mu emrin? Por, si duket janë kta njerëz që kanë... Rugova ka qenë pak, jo pak, po koxha shumë kristal prej memoriës, domëthonë memorie t'hatashme.

Dhe ka mjaftu fëmijët aty m'i... edhe vllaun Hakiun e ka njoftë mo, se vëllau im ka banu aty, po mu n'emën me m'thonë, "Adnan, si je?"

A din çka do t'thotë, një njeri në atë kohë që ti e ke adhuru pak, s'ke pasë kontakt me të, dhe ai t'thotë, "Adnan, si je?" Ka qenë për mu diçka... domethonë une e kom pa që, edhe pse ne kem dallu n'moshë pak, dikun dy-trembëdhjetë vjet ka qenë ma i vjetër se unë, por si njeri i tillë, ka qenë i adhurm hiç pa qenë n'skenë, as pa qenë n'publik shumë. Në publik ka qenë qaq sa ka qenë.

Dhe kur fillunë këto lëvizjet mandej, pluraliteti që u legalizu në Kosovë, dhe ngazhimi i tij, Shoqata e Shkrimtarëve ishte instrumenti strumbullar i krejt ktyne dhe iniciator...

Kaltrina Krasniqi: M'fal, ku gjindej Shoqata e Shkrimtarëve?

Adnan Merovci: Shoqata e Shkrimtarëve osht' gjindë te stadiumi, ku sot osht' Muzeu i Pavarësisë, afër lokalit që quhet Tiffany, ajo ka qenë Shoqata...

Kaltrina Krasniqi: Po mendoj pak me na përshkru qysh ka qenë...

Adnan Merovci: Shoqata e Shkrimtarëve ka qenë një ndërtesë 120 metra s'di a ka qenë, 100 metra katror e tëra, bile ai e quante i vetmi territor i lirë në Kosovë. Ka qenë një barakë, se tash një gjysëm barake ka pasë edhe ndërtim t'fortë edhe ksi t'butë. Një ndërtesë karakteristike si e rumbullakt pak, do zyra me qyshe, me... një sallë e madhe, edhe një zyre ku tash i ka pasë mbetë Rugovës, edhe pse Rugova edhe si kryetar i Shoqatës të Shkrimtarëve e ka pasë qat' ambient ku ka vepru. Ma herët kanë qenë diku tjetër, por në kohën kur po flasim '89, në këtë ndërtesë...

Por kur filloi aktiviteti mandej dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, ma s'pari aty u themelu n'atë sallën me tri zyre rreth. Domethonë si t'hysh nga oborri, një korridor i vogël, drejtë hyn në një sallë, dhe i ka ajo sallë, me do koridore t'vogla nja dy-tri zyre. Edhe sot osht' pak a shumë qashtu. Ka qenë një ambient ku rrijnë njerëzit pa fonde t'mëdha, pa financa t'mëdha, po njerëz t'vullnetit t'mirë edhe pse atëhere këto pak kanë funksionu në një mënyrë, por për periudhën kur po flasim kishin kalu nantë vjet prej vitit '80, '81, ishte, si me thonë ishte... Mo edhe institucionet jonë konë t'lodhne, edhe le t'themi nashta edhe politikisht edhe financiarisht, e moralisht e... Por ja që Shoqata e Shkrimtarëve osht' mbajtë si institucion.

Dhe aty mandej u pat themelu Lidhja Demokratike dhe unë tu e pa Rugovën që, që osht' n'krye t'punëve dhe tu e pa që, që nuk ka diçka t'organizume, të paraorganizume, njerëzit në mënyrë vullnetere shkojshin në Shoqatë të Shkrimtarëve me i pa qato komunikimet dhe paraqitjet e tij publike që i mbajke. Hyke, dilke kushdo, as s'kish rend, as s'nalke kush, as nuk t'vetke kush as, hishe n'sallë, vishin do gazetarë, dilshin. Ishte njëfarë...

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë naj orar ditor kur ai ka bo paraqitje, apo qysh...

Adnan Merovci: Po. Ka qenë, ajo osht' përcjellë mandej gjithëhere t'premtëve në ora 10:00, ka qenë në mëngjës. Mirëpo... dhe me qëllim e pat zgjedhë t'premtën si ditë, si para vikendit që t'i thom qito çka kom me i thonë për qetë javë t'premtën, vikendi le t'na shkon, e java tjetër le t'vjen... dhe kështu ka qenë, kështu ka fillu. Mandej kjo u institucionalizu dhe e premtja në ora 10:00 ka mbetë institucion, sot osht' historik që Serbia dhe bota e ka kuptu artikulimin e kërkesave të shqiptarëve të përsëritun në çdo t'premtë n'ora 10:00.

Dhe unë mandej tu e pa, tu shku prej vullnetit t'mirë me shokë më pa çka po flitet, tek po thuhet... Tani tu e pa që s'ka shërbim, me dashtë do ujë duhet vet me marrë, kqyrë s'ki gotë, hajt të i marrim do gota, të i blejmë do gota. Diçka ka funksionu aty se e ka pasë një staf Shoqata e Shkrimtarëve, ka qenë një Sekretar Teknik i Shoqatës, Jakup Shala, i ndjeri. Sekretar i Shoqatës të Shkrimtarëve ka qenë ky Milazim Krasniqi, profesori. Ka pasë tash edhe anëtarë, por s'ka pasë, si me thonë njerëz tjerë të cilët jonë kujdesë. E aty pastaj patën fillu njerëzit me kontribute, dikush diçka, hajde kafe, çaj, qashtu osht' sjellë. Ka qenë edhe një punëtor i kafës bile, që ka punu ka qitë kafe, për fillimet po flas.

Mandej fillo... pashëm që nuk o kujdesë askush për kryetarin, edhe... se menihere kemi fillu kryetar me i thonë, ai me të 23 u zgjedhë ne qatë grupin iniciativ dhe prej...

Kaltrina Krasniqi: Me 23 të cilit muj?

Adnan Merovci: Me 23 dhjetor, 1989. Dhe prej atëhersh deri ka ndërru jetë, për shembull une edhe shokët, edhe disa çka kanë qenë bashkëpunëtorë t'tij, kryetar e kem thirrë, dhe gjithëhere... Tjetër në gjuhën e shkrume që i thojnë president, atribut, president historik e tjerë, por për mu edhe në komunikim osht' krytar ka qenë, kryetar i kem thonë. Dhe e kom pa që nuk po kujdeset, edhe një ditë qëllimisht... ky osht' fillimi i vitit '90, kom ndejtë deri në fund, dikun ora 14:30, 15:00, dhe po del ai, po del me shku, dhe unë po i thom, "Kryetar, a po shkon n'shpi?" Tha, "Po, Adnan". Thashë, "Po shkojmë bashkë". Tha, "Po shkon edhe ti në Lakrishte a?" Thashë, "Po".

Edhe jom hy, e kom pasë një Zastava 101. Ka qenë hera e parë kur ai ka hypë në veturën time. Edhe kur hypi në veturë unë thashë, "A po ulesh mrapa?" "Jo, jo", tha, "A je vetëm?" "Po." Para po ulna". U ul para dhe shkumë në Lakrishtë. Dhe kur shkumë në Lakrishtë, e lashë kerrin afër hymjes t'tij, unë kom qenë në hymjen e pestë, se tash me qira banojsha, edhe pse n'hymjën e dytë e kom pasë vëllaun. Ai e dinte që unë jom n'hymjen e pestë, tha, "Adnan, hajt po dal unë qetu..." Thashë, "Jo, jo..." E ndala veturën edhe po dal une, tha, "Hajt, ditën e mirë Adnan". Thasë, "Jo, do t'vi me ty". Ai pak si u befasu, pak si i pëlqej, pak... Thashë, "Jo, du me t'përcjellë deri naltë, n'katin e shtatë". Tha, "Po hajt bre Adnan se shkoj une, po hajt se shkoj.." "Jo, jo", thashë, "Po shkojmë bashkë".

Edhe u nisa une para tij. Kyr hyna para tij ja nxuna rrugën te ashensori, edhe ai po m'kqyre, thashë, "N'komë po shkojmë". N'atë moment veç m'ka kqyrë n'sy... Edhe ai e pa që unë e kom njifarë kurajo, njifarë vendosëshmënie, tha, "Ani bre Adnan, hajt..." I erdh keq me m'kthy, se m'pa shumë i vendosun. Se këto unë i pata marrë mandej si vendime, edhe tu shku hajde, hajde, hajde... Ai ka qenë tip që ka folë, nuk u konë tip... ka komentu e, për shkak njifarë krijimit t'ambientit social, ka dashtë me folë me... ka folë me njerëz.

Edhe shkumë, *xërr* {onomatope} zilës, "Hajt ditën e mirë, Adnan". Une *xërr* {onomatope} apet zilës, kur dulë zoja Fanë, gruja e tij, Uka i vogël, djali, "Ditën e mirë!" "Ditën e mirë! Mu m'kanë njoftë tash lagjja pak aty, "Ditën e mirë". Thashë, "Nesër kryetar kur dilni?" "Hajt", tha, "Adnan se s'ka problem. Hajt se shkoj me Metin, a vjen dikush, jo shkoj vet, a s'di a shkoj në Institut a..." Thashë, "Ani mirë, nesër unë paraqitna". T'nesërmën... "Ditën e mirë!" "Ditën e mirë!"

T'nesërmëun unë në ora nantë e kom thirrë n'telefon, m'u ka lajmëru Uka, ma ka dhonë Fanën, i kom thonë, "Kur del kryetari? Ka thonë, "Në ora dhjetë". I thashë, "Ani, thuj që unë e çoj me kerr". Ia nisha zonin thonë që... "O, jo, jo, thuj le t'shkon". Edhe une kom dalë në dhjetë e gjysë te dera naltë, veç kom nejtë gjysë ore. Kur ka dalë s'ka mujtë me besu, po don te lifti, thashë, "Jo n'komë po shkojmë". "Po shkojmë Adnan me lift se..." Thashë, "Jo, jo, erdhëm n'komë dje, edhe sot po shkojmë..." Kemi zbritë poshtë, kur kem shku kom dashtë me e ule mbrapa n'kerr, ka thonë, "Jo, Adnan, kur t'osht' shoferi vetëm, nuk bon me lonë shoferin vetëm. Me konë dikush tjetër isha ulë prapa, po përpara".

Jemi dalë në Lakrishtë, jemi kthy, "Ku po shkojmë kryetar?" Tha, "A po m'çon dej në Institut Albanologjik pra? Thashë, "Po, po t'çoj në Institut Albanologjik. T'u dalë prej Institutit i thashë, "Kryetar a t'pengon nëse t'pres këtu?" "Po, jo bre Adnan hajt se s'ka..." "Jo", thashë, "Unë kom vendosë. Po..." thashë, "E kom një kamerë me veti, ti e paske sot një tubim, a bon, a t'pengon nëse e marr edhe e xhiroj une qata?" Tha, "Merre Adnan edhe bo çka dushë. Veç një send po ta thom, t'i kishim pasë do sende edhe do letra n'histori ndryshe i kishim pasë punët. Kështu që, merre dhe regjistro. Veç një send dije, kanë më t'thonë shqiptarët për kond po punon. E ni ngofsh ata, jetë kërkah, a ne paq përnime grahi edhe puno". Qiky ka qenë amaneti i Rugovës për mu, prej atëhershit që edhe sot m'përcjellë, çashtja e dokumentaritetit.

Kom hy mrenda, kom bo do xhirime manej me kamerë, e kom pasë një kamerë magnetike, temën, me kasetë. Dorën n'zemër, për atëherë me pasë një kamerë me dalë n'qytet ose me ta nxonë policia ka qenë sikur sot me dalë me një gulinov rrugës. Domethonë, ka qenë, kamera ka qenë mjet i rrezikshëm me ta gjetë policia, gazetarëve, le mo njerëzve. Okej, e kom pritë, ka dalë, dikun një orë, mas një ore në veturë edhe në Shoqatë të Shkrimtarëve, rrugës m'ka thonë, "Adnan, po duhna me dalë edhe në Institut se po ndalin rrugës". Pak si me humor m'tha.

Aty e ka vrejtë që unë s'po du me ju nda atij njeriu, kom hy brenda. Këtu mandej... unë atëhere kom qenë në Bankën, ende s'ka ndodhë ky përjashtimi. Mandej prej në të premtëve ka qitë televizioni, unë kom qenë afër tij, edhe ka ndodhë kjo që ka ndodhë.

Pjesa e Katërt

Adnan Merovci: Fushëveprimtaria jem... domethanë, ka qenë protokoli dhe siguria që une me ni fjalë e qujmë, e quj, mbarëvajtje e zyrës...

Kaltrina Krasniqi: Çka nënkupton? Se për dikon, për dikon amater si une përnime osht' e pa njoftun...

Adnan Merovci: Po...

Kaltrina Krasniqi: Krejt puna...

Adnan Merovci: Okej, qe e thom une të zbërthyme. Ibrahim Rugovën me takue një, Ibrahim Rugovës me ia çu ni letër. Dy, Ibrahim Rugova me hecë në t'shmojtë a në t'djathtë, para, a mas, a me prit. Tre, Ibrahim Rugova me vesh garderoba. Katër, Ibrahim Rugova me shku ose mos me shku në ni vend, Ibrahim Rugova me shku me ni vizitë n'qit' ditë, me nejt qikaq ditë qitu e me shku qika, mandej me fluturu qikaq, e qikaq me nejt edhe ni ditë edhe m'u kthy n'qit' ditë. Ibrahim Rugova me i taku kolektivisht kryesinë e partisë t'vet, kshillin e përgjithshëm, me kryetar të degëve, me popull, me njerëz, me institucione. Jashta çka flet ai dhe çka osht' zyrtare, dokument aty ka shku nëpërmes durve t'mia. Pra, qikjo osht' mbarvajtja e zyrës dhe veprimtarisë tina.

Në fillim e kom vozitë dy vjet me veturë time private, me shpenzime t'mia, po le t'thuhet e le t'dihet. Masandej kemi hy nifarë sistemi edhe t'pagesave, e kemi marr ka ni kompenzim veç edhe e kemi pagu 3%. Mandej, jem mundue me i bo do vetura, i kem bo, kurrë s'kem mujt me i bo tri vetura t'njejta. Njo t'mirë, njo përpara ma ndrysh... tri vetura, Ibrahim Rugova osht' vozitë si me thonë.

Vet ka qenë n'mes, shoferi, une edhe Ibrahim Rugova mas meje, kjo ka qenë. Pra, une e kom lu rolin edhe n'aspektin e sigurisë si ni shoqërus kryesor gjegjësisht, siç i thojnë n'këtë' farë gjuhën truproje ose bodyguard. Por tek çashtja e truprojës une e kom pak nifarë, nifarë zbërthimi tim t'kësaj, edhe mu hiç s'më pengon kur t'thojnë dikush, "Ky ka qenë truproje e Rugovës". E kom ni konflikt t'brendshëm rreth kësaj dhe kjo osht'... nderi shumë i madh osht' për mu edhe Rugova me e pasë ni *Master Degree* [Magjistraturë] edhe ni dhetë vjet përvojë pune, ni njeri mesatar truprojë i tij.

Por, fjala truprojë nuk shkon me aktivitetin tim, sepse Rugova nuk ka pasë trup me ia ru. Rugova ka pasë ide. A ka kuptim me thanë, unë jom kanë ide rujtësi i Rugovës? No. Pra, Rugova ka pasë ide dhe ideja e tij ka rrjedhë valëve, s'ka pasë fizikalitet, e trupi i Rugovës, nuk ruhet. Kur ideja osht' shumë e

madhe, triumfuese dhe ka dalë fitimtare historikisht, nuk i shkon atij njeriut me pasë trupprojë. Dhe këtu une e mbështes këtë çështjen e trupprojës, nuk ka lidhje kjo me punë të nivelit t'tillë. Unë kom qenë lustrus i këpucve t'tij dhe osht' në rregull.

Unë ka ndodhë që jashtë ia kom la jakat e kmishës se krejt kmishën s'kishim vakt edhe veç jakën me sapun, edhe me terë pak, edhe m'u mundu, edhe me vesh prapë me ni takim. Pra, po flas për çashtjen e veprimtarisë dhe zbërthimit krejt t'ksaj. Për herë t'parë n'histori të Ibrahim Rugovës, si kryetar i zgjedhun me vota, për herë t'parë edhe n'historinë ekzistuese të shqiptarëve në Kosovë, tri fjalë me tre emna që i ka me i taku liderit i tyne i kom shkru une me ni fletë që i kanë thanë protokol. Çka ka me ndodhë n'qit' ditë? Në 10:00 ora konferenca për shtyp, në 11:00 ora takimi me degë, 13:30 intervista me gazetaren gjermane Renate Flottau, për shembull.

Këta e ka pasë t'shkrume n'letër, n'tavolinë. Këtë e kom bo unë, s'më ka thanë kerkush, me vetë iniciativë. Kështu ka qenë prej fillimit dhe mandej ka fillu t'u u avancu. Çdo aktivitet që osht' zhvillu në atë shtëpi, si n'zyre, si mandej në residencë në Velani osht' dokumentu dhe osht' xhirue. Kjo ka qenë aktivitet i jemi i dytë, se une n'fillim e harrova me thanë që aktiviteti jem i parë te Rugova saherë jom shku, me kamerë përmas n'dorë e kom majt. Edhe kom vozitë, edhe jom kujdesë për to po edhe *çkrrap* {onomatope} kamerën edhe kom xhirue çka kom mujt. Por, jo edhe veç Rugovën po n'kohën tjetër kur ai ka qenë n'banesë çka ka ndodhë nëpër Kosovë jom mundu me qat' kamerë tem me xhiru.

Si dhunën, si ato... une kom dramë... osht' dramë, ni grup teatro ka dhanë në Fakultet Filozofik ni dramë, n'qato rrethana hala pa i përzanë, po flasim për fillimet. Dhe, krejt kjo, domethanë e përshkrinë këtë veprimtarinë pak a shumë ose zbërthimin e krejt kësaj. Mandej, osht' çashtja e takimeve t'ndryshme, vizitave jashtë Kosovës, në çdo vizitë, domethanë protokolin e vizitës, kontaktet me ambasadë, me institucion jashtë ka pasë, dikun 90 përqind të takimeve kanë qenë të organizume, 10 përqind i kem organizu edhe na, i kem inicu na.

Nëse Rugova ka shku në Norvegji dhe e ka taku Ministrin e Jashtëm, ne e kem bo edhe me ni shoqatë atje ni takim që na ka lidhë ni kontakt kesi hov, se ka mjaftu ni gazetar i njoftun që ka qenë me neve, i ni vendit e kam thirrë, e kam pasë kontaktin, i kom thanë, "Rugova do t'jetë këtu dhe..." kam lypë, fjala vjen, edhe kso gjanash, domethanë kanë... pra, që me thjeshtësu po jo me mbaru, unë kam qenë ni mbarvajtës i punës t'tij. Në hotel kam qenë çdo here me të. Nëse jo n'dhomë me të, se ka pasë raste edhe n'dhomë me të, kam qenë me ni dhomë ma afër me *connecting door*, me derë lidhëse, që jep me kuptu që i mirë e i keq, çdo mëngjes, e mramje, ditë, e saba figurën tem e ka pasë përpara.

Edhe shpesh herë bojsha shaka me të i thojsha, "Ti lirinë vetit ia ke marr, po lufton për lirinë tonë. Për ty dhe për lirinë tande dhe lëvizjen tua po vendosi unë. Unë po t'thom zbresim poshtë tash, ti s'po mun zbret ma herët. Unë po t'thom zbresim tash ti s'po mun thu e lojmë ma vonë. Pra, kjo osht' liria që ti s'e ki mo, por kjo osht' sakrifica jote, ke zgjedh vet". Kem bo edhe humor. Kur kemi qenë shokë

edhe me njerëz ose grupe... kuptohet une s'kom nejt tash m'i kry te ai, e kom pasë vendin tem por kurrë ai ni lëvizje nuk e ka bo, s'paku pa m'shiqu mu dhe pa marrë miratimin tem.

Domethanë, definitivisht, definitivisht Rugova e ka njoftë punën time dhe ka nxjerr vlere t'mija që unë i kom manifestu dhe nuk ka ma mirë se ndjesia kur ti e sheh që ni virtyt e paske edhe dikush po ta nxjerr edhe ti po e manifeston. Sepse, njeri është psikologji n'veti ka... dhe edhe tash kur flas, mos mendoni që po flas kështu me emocion se une i kom gjanat e tejkalune t'gjitha. I realizum n'familje, i vdekun njo pesë-gjashtë herë, i ngjallun prapë *I'm fine* [mirë jom].

Por, realisht, realisht ky osht' ni figurë që për ni periudhë dhjetë vjeçare ka bo, domethanë me idenë e tina me ndrru n'përgjithësi pikëpamjen. Mënyrën qysh duhet me iu qasë, fjala vjen, strategjive për t'ardhmën e ni vendi që osht' në okupim total që ka përkrahje prej, prej qarqeve t'mëdha dhe i cili atë përkrahje veç e ka rritë dhe e ka shndërru në ni strategji t'pranume. Dhe ni njëri që, domethanë ka pasë fanatizëm ekstrem në projektin e tij politik, n'kuptim të përcaktimit. Domethanë, Ibrahim Rugova e ka pasë ni çifteli t'prisht me ni tel, ni Kosovë e pavarun, e hapun ndaj Shqipërisë dhe Serbisë projekt që sot në 2018-tën po diskutohet dhe po flitet e tjera, e tjera, e tjera.

Dhe, definitivisht kjo ide e tij ka bo që njerëzit i kanë besu dhe është goxha vështirë n'hipnozë me e majt dhetë vjet, dhetë vjet me e majt ni popull. Për me e zbërthy figurën dhe aktivitetin e Rugovës, mirë osht' me u marr edhe me kundërshtarët e tij politik dhe ato çka ata i kanë thanë. Sepse, kundërshtari politik osht', politikisht t'kundërshton, t'akuzon, t'thotë... dhe kto nuk janë t'panjohura për publikun dhe tash pa me dashtë me i qit' në ni terezi me i matë, po shkurt shqip, me ni procesor, me ni rrjedhim logjik të atyne, çka Rugova kritikohet dhe osht' kritiku dhe të tjerëve që, që, fjala vjen, e kanë përkrahë Rugovën.

Rugovën e kanë përkrahë t'ritë, t'rejat, plakat, gratë, njerzit e meçëm, njerzit e pameçëm, njerzit edhe me t'meta mentale e kanë dashtë Rugovën, po nuk o kualitet edhe vlerë ajo, a po jo? Por, shumica absolute e kanë përkrahë. Edhe, e kanë përkrahë për disa arsye, ni prej tyne ka qenë politika e tij publike, transparente çdo gja, s'ka msheft te Rugova dhe ajo s'ka msheft osht' pavarësi. Me ktë ti e zbeh dhe e shfryn ni kategori t'njerëzve që quhen bashkëpunëtor me regjimin.

Çka ka pasë hajr Serbia me qenë unë bashkëpunëtor i... njeriu ma i afërt i Rugovës, me qenë bashkëpunëtor i shërbimeve sekrete serbe, çka me iu thanë une atyne? Rugova çka po don po t'tregon çdo të premten n'ora 10:00. Bile me ni rast ka thanë, se tash mora shkas me folë. Kur i kanë thanë, "Kush është bre qiky djalë që po t'rrin mas e po vjen e, mos e kanë çu shërbimet serbe? A e njeh mirë a?" Ai si n'humor i ka thanë, ka thanë, "Po nashtë, n'koftë bile ma nimon mu pak. Para meje shkon iu kallxon..." çka është puna e bashkëpunëtorit me ngu çka po thotë, ku je, me i tregu atij atje. Thotë, "ma leton pak mu se une t'premtan ai nashta ma i shpejtë o", po i kanë thanë, "Jo seriozisht po mendojmë" a din, ka thanë, "A seriozisht po mendoni a?" "Po". "Po..." ka thanë, "s'ka bre gajle". "Qysh more s'ka gajle kryetar?" "Po s'ka gajle, se n'koftë osht' njeri ma i afërt i jemi edhe p'e di. Po thuni ju te

k'osht' edhe e di që osht' po çka me bo që mun ka edhe tjerë edhe s'e di kush janë". E kanë mshel gojën. Qe filozofia e Rugovës.

Pra, n'koftë që kryespiun mes shqiptarëve, ai vetën e ka qujt kryespiuni, se une po kallxoj çka po don populli, se shërbimi çka don, çka po zhvillohet ku je ti me ditë ai. Dhe me këtë, domethanë që ni ide e tij qysh reflekton është shumë e thjeshtë. Motoja ime, ose moto, a doktrinë, a qysh t'dush, une e kam krijue nifar' kombinimi t'fjalëve "Në hap me Rugovën" dhe unë i mbaj në mend tre hapa t'Rugovës deri sot.

I pari, që osht' shumë i randsishëm osht' thyrja e mitit serb mbi Kosovën. Kur kanë fillu sërbitë me thanë n'vitet e '90-ta që juve s'ju takon pavarësia. Pavarësia u konë sen i pashmangshëm, këta e ka arrit Ibrahim Rugova me e bo. Thyrjen e mitit serb. Serbët kanë thanë, "Kosovo je srpska kolevka", pra është djep i Serbisë. Kur e kanë pshtet për muri Rugovën me fjalë edhe t'hujtë ka thanë, "Po, mirë de. Le ta pranojmë që osht' djep i Serbisë, por fëmiu osht' shqiptar në atë djep". A nuk osht' ky thyrje e mitit? Një.

E dyta, Ibrahim Rugova e ka rujt qenien njerëzore shqiptare. 500 vjet perandori edhe ma herët romakët, e prej antikës e këndeje, e serbitë masandej, nuk kanë mujtë me e zhba qenien, qenia nuk zhbahet. Por, në kohën e '90-tave deri n'vitin 2000, ka mujt qenia njerëzore shqiptare, s'po thom m'u zhduk po shumë m'u paku. A nuk osht' meritë e Ibrahim Rugovës rumja e qenies njerëzore? Derisa ne po flasim sot në Kosovën e pavarur, le t'themi, edhe pa merita të Rugovës. Hiç ai, Rugova s'e ka asni meritë që ne në 2018-tën qenkemi t'pavarur.

Po e ka ni meritë, që ka rujtë qenien njerëzore dhe ai dhe vetëm ai dhe me mushkni t'tij ka marrë frymë Ballkani a? Mos harroni vitet, fillim vitet e '90-ta kur Sllovenia n'luftë, Kroacia n'luftë, Bosnja n'luftë. T'ish impliku Kosova n'luftë kish hye Greqia, Bullgaria, Turqia. A nuk osht' kjo ni luftë Ballkanike ose ni luftë botërore, a nuk osht' Ibrahim Rugova njeriu që e ka rujt qenien njerëzore, le t'më lejohet t'mendoj kështu, a po thuni rinia, le t'mendojë rinia.

Dhe, hapi i tretë osht' orientimi properëndimor. Definitivisht elektronat tona kaotike... ne gjithë themi, o bre flota... prej babgjyshit tem, flota e gjashtë, e flota e gjashtë, "Amerika në tokë e Zoti në qiell e..." Por, historikisht kemi qenë në t'shmajhtë, e në t'djathtë, e poshtë, e naltë... a osht' e vërtetë që kjo dekadë para lufte i tregoi botës dhe i tregum na vetvetës që definitivisht orientimi properëndimor po betonohet te shqiptarët?!

Kjo osht' ai hapi i tretë që definitivisht osht', le t'themi, meritë e një njeriu me ide. Ibrahim Rugova për çdo gja tjetër, për çdo gja tjetër, përpos idesë dhe strategjisë politike që e ka pasë, për çdo gja tjetër ka qenë në mungesë, nuk ka pasë mekanizëm. Nuk ka pasë media, nuk ka pasë ushtri, nuk ka pasë polici, nuk ka pasë vetura, nuk ka pasë pare, nuk ka pasë fonde, nuk ka pasë armë. Le t'më lejohet t'them diçka, e ka pasë veç ni Adnan. Shko bone qita, a bohet qikjo, le t'bohet qikjo.

Dhe ni Adnan, pa vetura, pa pare, pa afera, pa t'njekun, pa tankse a nuk osht' kjo ide? A nuk osht' edhe kjo përcaktim? A nuk osht'... Le t'pytën gjeneratat e reja tash, le t'i pytin prindtë e tyne ose gjyshërit e tyne për Rugovën, meqenëse po bohet kjo bisedë tash me mu le te hjekim modestinë edhe për Adnanin. Secila derë e shqiptarit ka qenë e hapun për Adnanin për ndonjë nevojë, se osht' ditë që Adnani osht' me Rugovën edhe paska ni nevojë, dhe kurrë najherë në historinë time dhjetë vjeçare s'ia kom trokitë derën. Nëse dikush ka dashtë me ndihmu ka ardhë edhe ka ndihmu.

Vetura që osht' vozitë Rugova, osht' kontribut i ni njeriu, ni shqiptari që ka sjellë veturën dhe ne e kemi shfrytëzu. Por, infiltrimet, afera, gjana negative nuk ka ekzistuar në dekadën... për këtë arsye Rugova e ka pasë emrin e madh.

Kaltrina Krasniqi: Domethanë, ju keni vazhdu me qenë në Lakrishte a po? Ka ardhë ni moment kur praktikisht Rugova osht', ka shku në Velani. A mundeni me na spjegu pse ka ndodhë qajo?

Adnan Merovci: 24 maj në ora... 1992 në ora 11:00 kemi dalë prej shtëpie, banesës në Lakrishtë me shku me votue ka qenë dita e votimit. Dhe osht' votue tek do baraka te kombinati i "Ramiz Sadikut" poashtu në Lakrishtë. Gjatë kthimit, prej qatij vendit ku është votu dhe ekzistojnë xhirimet sot dhe fotografitë e vendvotimit ku ka votu, Rugova t'u e shti votën e vet, kuptohet unë mu afër tij.

Gjatë kthimit me vetura, dhe me ekipin tim, dhe njerëz se kom pasë... une e zhvillova mandej. Në fillim kom fillu vetëm, mandej i kom marrë edhe njerëz e bashkëpunëtorë kom pasë ni ekip. Duke hy n'hymje të Lakrishtës dikund në atë platonë, gjysë metre-ni metër përpara ka eksplodu diçka dhe n'eksplozim çka kom bo une? E kom kapë Rugovën edhe kom hy n'hyrje që kanë qenë hyrje njo katër-pesë metra prej vendit ku ka ndodhë. Me niqind peripeti, diqysh shkallve edhe naltë. Jonë shkepë njerzit, e kom fut mrena edhe une s'iu kom da prej atyhit, i kom pasë do radiolidhje me veti dhe fati...

Me pasë radiolidhje atëherë u kanë sikur me i pasë nja dhetë tenka me dalë qisajt, bile bohet *show* se t'qesin gazetatat edhe kurgjo, t'qojnë e t'marrin... a atëherë me e pasë ni radiolidhje ka qenë ma vështirë se me e pasë ni automatik me qitë n'qytet, se radiolidhja osht' element i pa lejum dhe duhet leje. Dhe kom komunikuar me ekipën tim, çka po ndodhë. Ka ra ni kavanoz, tegëll siç i thojnë n'popull, i madh kaq {tregon me duar} ka gju ni serb prej terasës. Kuptohet ai s'e ka gju Adnanin, ai e ka gju Rugovën. Ai s'e ka ditë kush është aty afër, se kom pasë edhe njerëz tjerë afër aty t'u ecë, po unë ma s'afërti.

T'më kish ra mu, une sot s'isha, t'i kish ra Rugovës s'ish ai, kujtdo që te kish prek... sepse ni peshë e tillë me ni shpjetësi kaq t'madhe... Kjo ka bo që une atë natë e kom marrë Rugovën e kom hjek prej Lakrishtës, familjen ia kom lanë aty, Rugovën e kom hjek prej atyhit. Unë kom pasë organizu sigurim të ndërtesës krejt edhe janë njerëzit eksponent sot edhe do t'njoftun n'publik që i kom pasë angazhue.

E kom marrë e kom çu në Sofali te ni baxhanak i tij, te ni vëlla i grusë t'tij, Nexhat Shabani. Gjashtë muj Rugova ka ndejtë në Sofali, në ni dhomë. Të nesërmen ia kem marrë edhe anëtarët e tjerë t'familjes, ma në Lakrishtë ai s'ka hy kurrë ai n'jetë t'vet. Dhe atje ka banu dikund gjashtë muj, shtatë në ni dhomë me nanën e vet, se e ka pasë nanën gjallë, edhe sa, pesë-gjashtë anëtarë të familjes.

Që kur shkojsha une n'mramjeve u dufke me i kalu fmitë ratë, e nana ratë qaty edhe me shku te kryetari qatje. Ai me do, shpesh herë me nifarë drite t'vogël se edhe u ndalke rryma, s'di çka u bojke. Ka qenë situatë e rondë. Derisa mandej ia kemi gjetë shtëpinë në Velani. Shtëpinë në Velani ia kom gjetë unë, une e kom kontraktu, ka qenë përzgjedhja jeme, osht' njo prej punëve që e kom kry, detyrave t'mia.

Fillimisht e kemi marrë me qira mandej osht' kontraktu dhe osht' ble. Me niqind peripeti po osht' kry edhe ajo punë dhe kjo osht', si me thanë, arsyeja pse ka lëvizë prej Lakrishtës edhe vendosja. Vendimi jem për me vendosë Rugovën në Velani ka qenë, te fus në mesin e studentave, sepse studentat janë ata që e mbrojnë Rugovën, gjenerata e re, sepse Rugova ni produkt i studentave. Në vitin '89 në demonstrata, në protesta të studentave për minatorë në hallën e sporteve, n'mes tyne ka qenë edhe Rugova. Por, gjanat lëvizin mandej dhe mujn qata studenta, politikisht, me dalë n'rrugë edhe me ni...

Kaltrina Krasniqi: Kur po thoni studentave...

Adnan Merovci: 1 tetor '97...

Kaltrina Krasniqi: Aty nuk ka qenë Universiteti i Prishtinës.

Adnan Merovci: Nuk ka qenë, po ka qenë, ka qenë rektorati edhe ka pasë shtëpi t'lhume për mësimë edhe ka pasë qarkullim të studentave shumë.

Kaltrina Krasniqi: Sqarojeni pak çfare ka qenë atmosfera në Velani, për shkak se njerëzit prej kësaj perspektive sidomos për ata t'ritë t'cilëve jeni t'u iu drejtu shumicën e kohës, nuk e dijnë çfare ka qenë.

Adnan Merovci: Velania ka qenë ni lagje moderne, e ndërtume prej do njerëz pasanik, ni prej tyne ka qenë edhe pronari i shtëpisë, tash i ndjeri Jusuf Krasniqi. Aty kanë qenë do eksponentë, secilën shtëpi i kom ditë kush osht' pronari krejt se kuptohet që e kom bo ni hulumtim të asaj. Por, edhe shumë shtëpi kanë qenë t'leshume për studime, studenta, fakultete... ka pasë njësitë ku janë mbajtë ligjeratat e ushtrimet. Bile, njana shtëpi poshtë ka qenë n'rrugën e dytë si rektorat aty ka ndejtë rektori, Statovci e ka pasë... mandej edhe kta studentat Albin Kurti, Driton Lajçi, Muhamet Mavraj...

Kaltrina Krasniqi: Domethanë, sqarojeni edhe nihere pse keni vendosë që Velania osht' qajo lokacioni...

Adnan Merovci: Mas...

Kaltrina Krasniqi: I përshtatshëm ku osht' dashtë me vendosë.

Adnan Merovci: Mbas ngjarjes që na ndodhi me 24 maj 1992 rreth mesditës kur praktikisht ishte në sulm ndaj jetës të Rugovës, unë vendosa që atë ta zhvendosi. Dhe fillimisht ka ndëjtë në Sofali për disa muj mandej u murr iniciativa për me ia gjetë në vend për me banu Rugova. Dhe kush pos meje ka me u interesu për këtë punë domethanë, dhe une i pata disa kriterë. Kriteri i parë ka qenë që vendi ku ai rrin t'jetë mundësisht etnikisht i pastërt, shqiptarë, dhe t'ketë njerëz pak a shumë, le t'themi tash, si komunikativ që pak i njoh se kom naj referencë.

Dhe elementi kryesor që m'ka bo konfident që Rugova duhet t'jetë aty ka qenë që në shtëpi të ndryshme u organizojshin ligjeratat nga fakultetet e ndryshme. Tani fakultetet vet të organizume nga sistemi arsimor i Kosovës, sepse siç dihet, domethanë pas rrënimit të autonomisë fillun me u rrënu edhe t'gjitha institucionet, t'u fillu prej atij të arsimit ose dijes që osht' universiteti e shkollat e mesme, n'përrjashtim disa shkolla fillore që i kanë lanë si objekte.

Pra, nga objektet zyrtare, le t'themi, që kanë qenë krejt gjithë ai... disa dhjetë mijë studenta jonë organizu, domethanë n'mënyrë vetanake nëpër shtëpi. Dhe kto shtëpi kryesisht kanë qenë... në fillim patën fillu pak dhe dikur ma shumë t'koncentruara kah Velania. Dhe t'u marrë parasysh që studentat janë rini dhe janë shqiptarë e kom konsideru si element pozitiv për sigurinë e Rugovës, që Rugova t'banojë aty, kjo ka qenë arsye.

Bile edhe në shtëpi ka shërbye si hapsinë ku ka ndëjt rektori Statovci me disa bashkëpunëtorë t'tij, n'krahësim me vendin ku e ka pasë në Universitet, qendër, këtu ka qenë t'pushtun domethanë. Ne po flasim kohën kur totalisht Kosova ka qenë e pushtune me, me, me tankse në, prej, dhe t'përrzanun shqiptartë nga gjitha institucioneve. Prej institucioneve arsimore, shëndetësore, policore, organizata t'ndryshme, fondacioneve t'ndryshme e tjera e tjera. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse une kom vendosë që bash në Velani t'vendoset Rugova. Dhe une mendoj që nuk kam gabu dhe mandej ka qenë çashtja e trajektores të lëvizjes. Se prej aty deri n'zyre, domethanë mirë e kom mendu rrugën kah të lëvizim me vetura sepse aspekti i sigurisë osht' jashtëzakonisht i ndishëm në kto rrethana.

Kaltrina Krasniqi: Mundohuni me na kriju ni, ni ide se qysh ka funksionu ajo lagje n'atë periudhë.

Adnan Merovci: Tani, fillimisht une kom bisedu me fqinjët e parë para se me shku. Niherë jom marr vesh me pronarin dhe pronari ka qenë i gatshëm dhe ka bo ni vepër vetë-mohuese që thojnë për lavdatë. Ai meriton lavdata sepse edhe me ia lshu shtëpinë Rugovës ka qenë goxha nifarë rrezikimi i madh, sepse je identifiku që n'shtëpinë tande po rri Ibrahim Rugova, gjithëherë le t'dihet që po flasim për vitin '93 tashma, veç mrriu viti '93 kur po flasim.

Dhe viti '93 ka qenë viti i famkeqit Arkanit. Arkani ka qenë ni paramilitar që ka bo kërrdi dhe i dënum dhe i akuzum n'gjyqe t'shumta botnore dhe ai me ekspedita t'tij ka shëtitë nëpër Prishtinë, nëpër lagje të Prishtinës t'u i frikësue, e t'u i provoku në situata t'ndryshme. Dhe vendimi i pronarit nuk ka qenë vendim i lehtë por ka qenë vendim, domethanë vendim i pa kalkulim, meniherë osht' pajtu.

Punën e dytë, para kësaj une kom marr hetime te komshitë. Kom shku kom trokitë në dyrë t'fqijve dhe me secilin pronarë kom majt ka ni bisedë, ka ni, mos me e qijtë seancë tani se kjo fjalë seancë po e merr konotacion tjetër. Por, ka ni bisedë e kom pasë t'u e njoftu edhe t'u marr pëlqimin për eventualisht pasojat që mujnë me qenë sepse për ni moment mundet me qenë edhe cak shtëpia e Rugovës për, për, për ndonjë t'keqe.

Nuk mbaj n'mend dhe nuk ka asnjë njeri përreth aty që ka kundërshtu dhe që s'e ka vu vetën, shtëpinë dhe familjen e vet n'disponim për çdo gja që ka nevojë. Por, atëherë une i kam pasë shumë t'koncentrume dhe t'monopolizume çashtjet e operimit n'aspekt të sigurisë. Domethanë, nuk ka pasë njeri tjetër që ka mujt me folë ose me komunikue, ose me negociu naj gja që ka t'boj me siguri të Rugovës përveç meje.

Këtu kom qenë i pa kompromis dhe iu kam thanë që, "Askush nuk osht' relevant me ardhë me bisedu për asgja. Nëse ka diçka t'ngjashme atëherë me m'njoftu meniherë" dhe kjo ka funksionu. Telefonat fiks nëpër shtëpia t'gjithëve i kom pasë, i kom njoftu t'gjithë dhe praktikisht une i kom regjistruar. E kom lexue qat' lagje krejt dhe shtëpitë kanë qenë t'mira dhe ka qenë ni elitë, sido që të jetë, pak ma urbane, pak ma me standard n'përgjithësi.

Ka pasë qasje t'shumta, qasja prej Taslixhes ka qenë prej udhëkryqit, ka pasë qasje prej rrugës Robert Gajdikës, prej Varrezave të Dëshmorëve, ka pasë rrugë andej prej Matiqanit... i kam mendu... Ka qenë edhe ni Lagje e Romëve që i kanë thanë ka Vellusha edhe... domethanë, kjo ka qenë e mendume goxha mirë, mënyra qysh kemi qarkullu edhe si logjistikë edhe me vetura në atë lagje.

Kaltrina Krasniqi: Cili mendoni që ka qenë ndoshta momenti ma dramatik në dekadën e viteve të '90-ta?

Adnan Merovci: Po tani si, si, si moment...

Kaltrina Krasniqi: Ose ndoshta kështu...

Adnan Merovci: Lufttrat...

Kaltrina Krasniqi: Ose ndoshta kështu, m'fal. Viti '95 Kosova nuk përfshihet n'bisedimet e Daytonit, kjo me siguri ka qenë...

Adnan Merovci: Tash une e boj ni kronologji, po. Tani, akti ma, le t'themi, dramatik edhe ma vulgar, edhe ma brutal që e ka përjetu Kosova ka qenë rrënimi i autonomisë dhe nuk ka qenë rrënim me tankse dhe mos t'harrojmë se kanë qenë dy momente. Ka qenë ni moment kur ndrrimet kushtetuse janë votu prej kuvendit dhe prej njerëzve. Dhe këtë Serbia e ka përdorë si argument n'botë që veç shqiptarë i kanë ndryshue po meniherë mas disa mujve, domethanë protestave dhe zgjedhjet e ardhshme dhe anëtarët e Parlamentit të Kosovës, të zgjedhun n'mbikqyrje të Serbisë, për mos me thanë njerzit e Serbisë.

Qata t'njejt i kanë rrënu ato ndryshime kushtetuse. Dhe e dijmë, domethanë prej deklaratës për pavarësi në oborr të Kuvendit deri në Kushtetutën e Kaçanikut dhe që osht' monument në këtë periudhë është çashtja e referendumit që osht' organizu në '91-shin. Si rezultat i kësaj, zgjedhjet parlamentare tani në kuadër të pavarësisë dhe referendumit dhe zgjedhjet presidenciale që i kanë kunorëzu me 24 maj, 1992.

Po flasim për kohnat e fillimit të luftënave në ish-Jugosllavi, domethanë i vike era barut Ballkanit. Dihën rrymat edhe tendencat e popujve tjerë në ish-Jugosllavi për shpëtim, definitivisht po flasim edhe për periudhën e pak ma t'hershme të Genscherizmit. [Hans-Dietrich] Genscher ka qenë Ministër i Jashtëm gjerman dhe ai ka premtu dhe osht', si me thanë, ni vulosës i Pavarësisë së Kroacisë. Dhe këtu, domethanë ato çmenduritë serbe që vetëm me forcë me e rue atë krijesë artificiale, ku ata kanë dashtë me dominue që u qujt ish-Jugosllavi. Dhe luftat qaq sa kanë ndodhë në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje.

Por, në këtë luftë nuk flitet për ni luftë të mirëfilltë tabori andej dhe kënde, po merreni me mend kanë qenë kasarnet e përziera me ushtarë t'ndryshëm. Ka pasë shqiptarë dhe për çka po lufton ai shqiptar? Ai shqiptar aty osht' eduku me luftu për kufinin e jashtëm të ish-Jugosllavisë, a preket Sllovenia, a Maqedonia... por me luftue n'mes veti dhe ti si kasarne jonë nda ose je përcaktu andej e kënde kanë qenë tmerre t'mëdha. Dhe, si rezultat i krejt kësaj, jo vetëdijësim po thjeshtë ni, ni përcaktim i shqiptarëve krejt çka kanë qenë. Mos t'harrojmë që çdo i katërti ushtarë në ish-Jugosllavi ka qenë shqiptar, çdo i katërti, ni, dy, tre, shqiptarë, ni, dy, tre, shqiptar, ni, dy, tre, shqiptar. Të gjithë këta kanë qenë në forma t'ndryshme dezertorë të pretendimeve të serbëve, gjegjësisht Millosheviqit për luftat që janë bo.

Dhe, definitivisht Kosova ka qenë pikënisja dhe osht' mendu të fillohet dhe t'kryhet në Kosovë, pa me u bo luftë dikund tjetër, se kanë mendue që me atë çka po ndodhë në Kosovë marrin mësim edhe popujt tjerë, republikat tjera dhe nuk krijojnë. Kjo nuk iu ndezi me ni arsye t'vogël, vegjëlsia e tij ni njeri me 50 kilogramë peshë, Ibrahim Rugova i cili luftën në Kosovë e shmangu. Tash nuk osht' që e zhvendosi dikund tjetër se shpesh herë thojnë, "E shtyu luftën prej Kosovës". Rugova s'ka qenë për luftë askund, por sido që të jetë popullin e vet, vendin e vet e shpëtoi nga kjo katrahurë dhe dihet historia si ka qenë.

Pastaj pas kësaj vjen çashtja e vet ogranizimit t'shqiptarëve dhe n'këtë periudhë po flasim për organizim të arsimit. Tani derisa po flasim ose edhe gjeneratave përpara me iu pasë folë ka qenë ni utopi, si mundet ni sistem i arsimit i gjitha niveleve me u bo në formë... okej, po i thojmë paralele edhe pse une s'kom qef me e qujtë këtë fjalë paralele. Paralele kanë qenë t'serbëve sepse ne n'kontinuitet kem shku, ata na kanë qit' me zor. Kur t'qet me zor vazhdon atje, ti nuk je paraleli, ai osht' paralel i yti. Por, sido që t'jetë hajde le ta thojnë edhe paralele.

Shëndetësi, a mundeni me e marrë me mend që n'maternitetin e "Nënës Terezë" në Vranjevc ose Kodrën e Trimave që po i thojnë tani, kanë lindë 20 deri 30 mijë foshnje n'vit. Në shtëpi private, me vet mohim dhe me dije sepse mjektë me dije i kem pasë t'aftë dhe me ndihma t'ndryshme që kanë ardhë dhe osht' kriju ni maternitet dhe me të gjitha klinikat në rrethanat çfare kemi mujtë. Kirurgjia ka ekzistue, domethanë operimet janë bo.

Çashtja e solidaritetit, ka pasë ekipe dhe komisione për solidaritet. Nuk ka pasë shtëpi që vunë për bukë në Kosovë n'atë kohë, në qato rrethana ka qenë solidariteti top. Nuk mjafton vetëm solidariteti si afinitet, si fisnikëri, si atribut njerëzor duhet edhe organizimi i tij dhe ky organizim ka qenë përmes, LDK-së le t'jetë, ni Lidhje Demokratike e Kosovës edhe politikën e ka pasë LDK-ja pra edhe politikën por të tjerat kanë qenë... une s'du m'i dhonë tash ngjyrimet partiake se... Por ka pasë komisione t'u organizu sepse mbi t'gjitha kto edhe patriarkisht por edhe shtetërisht n'krye ka qenë Ibrahim Rugova.

Tjetër, çashtja e sportit, ka pasë sport. Merreni me mend n'atë kohë legjenda e futballit që quhet Fadil Vokrri, që s'mund t'besoj që ka ndrru jetë e kom pasë mik të ngushtë dhe ka qenë mik edhe i Rugovës. Në atë kohë Rugova e ka përmend anëtarësimin e Kosovës në FIFA, *my God* [Zoti jem]. Njerëzit bonin humor, "Çka po thotë ky njeri, kur atje n'fshatin Llukar dhe në Dragodan ose në Arbëri u mbajshin do futbolla nëpër do fusha të improvizune, e ky p'e përmend FIFA-n". "Duhet me përmend se pa e përmend edhe pa e kërku s'e fiton kurrë", thojke Rugova.

Dhe, edhe veprimtari tjera tash artistike, do teatra janë majtë. U majtë jeta, ka qenë lufta për jetë edhe osht' punu për këtë punë. Kjo osht' madhështia e krejt kësaj. Katrahurat kanë ndodhë n'luftë, populli ka vuajt, ka qenë nën represion, ka pasë të vramë, ka pasë t'plagosun, ka pasë t'rrahun, ka pasë t'marrun n'biseda informative. Informimi ka qenë n'nivel, s'ke pasë televizion tandin, radio tanden, s'ke pasë mjete t'mirëfillta t'informimit, informimi ka rrjedh në rrethana që... sepse informimin kush e transmeton? Njeriu, fjala munet me shku edhe vesh për vesh, mos t'harrojmë, vesh për vesh.

Se n'kohën e Skënderbeut tri pikat Trela, e Durrësi, e Kruja kanë folë me drita, me baklada, me... Këtu osht' folë edhe gojë për gojë. Ka dalë ni komision i ni lagje atje, ka marrë t'dhana çka po ndodhë, i ka grumbullu, i ka thanë shefit t'vet, shefi vet ka ardhë në Shoqatën e Shkrimtarëve, i ka shkru ni letër i ka dhanë. Dhe mrena ditës janë grumbullu informacionet prej krejt Kosovës n'qatë kohë. Ka ekzistue ni faks edhe ni telefon fiks në Shoqatë të Shkrimtarëve që Serbia e lejonte për me na përcjellë veprimtarinë.

Nëse ni shuplakë ka ndodhë në fshatin Metehi në Podujevë për dy orë ka marrë vesh Këshilli i Sigurimit. N'pastë dashtë me u marr me to informatën e ka pasë nëpërmes qatij faksi dhe kjo osht' falë organizimit të edhe punës... pra kjo le t'kuptohet që kanë funksion... Domethanë, kemi qenë në okupim, okupim i tillë por ne kemi funksionue. Nëse francezët tonë ditën kanë punu për gjermanët n'kohë t'luftës e tonë natën kanë punu për veti, ne ditë e natë kemi punu për veti edhe kem qenë nën okupim.

Pra, nuk osht' ni politikë pasive edhe me nejt kamë kryq e me shku botës aeroplanave me shëtit Rugova me propogandu çashtjen e Kosovës, por osht' organizu edhe populli. Shkojmë ma tutje. Çka po ndodhë me atë që osht' kryesorja, që i ka dhimtë gjithkujt dhe osht' çashtja e Kosovës, liria jonë, çashtja e pavarësisë. Ni projekt, le t'themi si kërkesë maksimaliste, racionale, se mos t'harrojmë projekti i cili ka qenë i Rugovës. Në rrethana t'caktume projekti ka lëvizë.

Fillimisht në ish-Jugosllavi, ka dashtë Rugova Kosovë t'barabartë me t'gjithë si opSION. Nëse preken kufijtë e brendshëm projekti i tij ka qenë, të gjithë shqiptarë etnikisht ku jonë në ish-Jugosllavi në ni republikë, në ni shtet t'vetin n'kuadër të Jugosllavisë... se qenkan prekë kufijtë e brendshëm. Nëse preken kufijtë e jashtëm të gjitha territoret shqiptare në ish-Jugosllavi me u bashku në Ballkan, me Maqedoni dhe Shqipëri. Pra, Rugova ka qenë, nuk ka qenë ni revolucionar i çmendun por ka qenë ni patriot shumë racional. Bile, bile n'këtë rast edhe n'kufijë të ekstremeve.

Pra, bashkimi kombëtar si opSION ka ekzistuar dhe ky, ky projekt me kto tri pika ka qenë n'kuadër të ni këshilli kordinues të partive politike shqiptare në ish-Jugosllavi, ku ka qenë kryetar Ibrahim Rugova, dhe sot ekziston dokumenti me nënshkrim të gjithë anëtarëve. Këtu ka qenë edhe Nevzat Halili i Partisë për Prosperitet Demokratik të Tetovës që osht' formu atëherë, këtu ka qenë edhe i Malit të Zi ka qenë nifarë Bardhi, ka qenë Lul Zhuraj, këtu ka qenë edhe i Preshevës, Riza Halimi për Veprim Demokratik, domethanë po flasim për projekt politik të tillë dhe vjen viti '93-'94.

Po hecin gjanat, s'po hecin, lufta po fillon në Bosnje me t'madhe dhe tragjedi shumë t'mëdha në këtë pjesë ka Bosnja e Kroacia, dhe po vjen ni Konferencë Ndërkombëtare që quhet e "Dejtonit". Pak zhgënjyse për shqiptarë, t'u i përfshi edhe bashkëpunëtorë ma t'ngushtë të Rugovës, po pse jo edhe mue. Kosova nuk osht' në "Dejton" ka qenë tush i ftoftë kolektiv, për me e thanë n'gjuhën e kuptushme, me na pre t'gjithëve gjak s'qitshim.

Ka qenë periudha, Ibrahim Rugova dhe t'gjithë... vetëm Ibrahim Rugova dhe t'gjithë kundër tij *including myself* [përfshi edhe vetën], edhe une kundër tij politikisht t'u mendu përfundoi kjo punë. Veç ai i ka besu idesë të pavarësisë. Për këtë arsye sot kur po flas me plotë gojën thom Ibrahim Rugova osht' baba i pavarësisë të Kosovës, shtetit. Ka ekzistuar pra ni periudhë, jo veç në Kosovë n'krejt botën kanë besu që s'ka prej kësaj pune kurgjo, ai ka besu.

Kaltrina Krasniqi: Po m'intereson qysh ka qenë atmosfera intimisht, se diqysh kosovartë kanë prit që kanë me qenë pjesë e kësaj konference.

Adnan Merovci: Po.

Kaltrina Krasniqi: Edhe ju gjeneralisht tregoni që ka qenë ni tush i ftoftë definitivisht, po qysh ka qenë intimisht, qysh ka qenë me qenë afër Rugovës n'qatë moment?

Adnan Merovci: N'qatë moment ka qenë gjithçka ftoftë dhe ai, qe fjaltë e tina autentike në ndonjë rast, në ndonjë nej, "Çka keni që jeni bo krejt qymyra? Kadale se kto punë shkojnë kadal, mos harroni që n'qiell e kem Zotin e në tokë e kemi Amerikën. Nuk na len Amerika". Por, na e kishim ni hendikep n'krahësim me to ose dy hendikepe. I pari osht' çashtja e besimit, që na s'i besojshim qasaj ideje, le t'themi mas '95-tes ai i besojke, dhe e dyta osht' çashtja e informacionit. Ai njeriu kishte informacion që amerikanët i kishin thonë që, "Rrini t'qetë sepse ni konferencë e posaçme ka m'u organizu për juve".

A guxoj une tash n'vitin 2018 me thanë që krejt ato hidhërime dhe ato ftofte t'mijat personale që kanë qenë, kanë qenë të pa qëlluara dhe paskam pa deri në hundë sepse fatkeqësi kish qenë për shqiptarët sikur Kosova t'ish përfshi në "Dejton", po t'flas në vitin 2018. Gjanat shpjegohen ma vonë. Pse? Dhe them, fati që Kosova nuk ka qenë në "Dejton", ishte konsideru si element tercial, as sekondar jo, superioritet ka qenë mbarimi i luftës në Bosnje, ky ka qenë qëllimi.

Kosova ish trajtu si *second hand issue* [çështje e dorës së dytë] dhe çka po dojnë atje do shqiptarë, hajde do t'drejta do... Millosheviqi ka vu bast ka thanë, "Përmendet fjala Kosovë une e lëshoj mbledhjen". Megjithatë Amerika nuk osht' e dvobekt karshi shqiptarëve, *outer wall of sanctions*, muri i jashtëm i sanksioneve për Kosovën u vu në "Dejton". T'i thojmë këto se njerëzit nuk po i përmendin. 1995 Kosova nuk osht' përfshi, por osht' ni modul ni murit t'jashtëm sanksioneve që sanksionohet Serbia për shkak të Kosovës.

Dhe Rudolf Perina dhe Strobe Talbott i çojnë informacion Rugovës që do t'mbahet ni konferencë për ish-Jugosllavi, ni konferencë posaçërisht për Kosovën, një. E dyta, delegacioni serbo... delegacioni shqiptaro-amerikan prej New York-ut kanë shku në Ohio, në Dejton dhe t'njeja gjana iu kanë thanë. Ka shku Hajri Bajraktari, Rustem Ibra dhe nifarë Gegaj nëse nuk gaboj. Dhe ka pasë keqkuptime këtu, keqinterpretime iu kanë thanë kështu, iu kanë thanë kështu. Dhe kjo ka jep me kuptu që Amerika nuk po na lëshon, por çka me i bo popullit, si me e mbajt popullin?

Popullin e mbanë mandej veç besimi i madh dhe definitivisht ky besim ka ekzist, por pak i zbehun. Kur ta them që edhe njeriu fizikisht ma i afërt i tij që, megjithatë ka pasë tru dhe ni rezon t'vetin, kam qenë skeptik që po përfundon, s'di çka do me u bo me neve, sepse dy arsye. Njo, s'i pasna besu mirë idesë t'tij dhe e dyta s'kom pasë informacion. Rugova edhe nuk ka qenë fort shumë që i ka shpalosë

informacionet, goxha u konë nifarë rugovocentrik rreth... se thojke, “Nuk bon edhe krejt senet m’i qitë, kadalni se shkojnë kto punë si kadal”.

Tjetër, çka duhet t’ndodhë komfor politikës t’tina, t’kërkume bile edhe prej amerikanëve që t’mos hapet fronti i jugut qysh e kërkojke presidenti kroat Franjo Tudjman. Në ni takim ku kom qenë prezent në Zagreb dhe thotë, “*Dobro, dobro*” n’takim, “Mirë, mirë” dhe e prek e ndreq shallën edhe m’thotë, “Adnan, çohëm se s’ka bukë për neve këtu”. Takimi i dytë ka qenë [Franjo] Kuharic një kardinal, aty dhe ka qenë Zef Marku n’takim edhe n’takimin tjetër ka qenë edhe Tomë Berisha, ushtaraku Tomë Berisha. Dhe kërkimi i hapjes të frontit dhe ai president Franjo Tudjman që masandej boni marrëveshje me Millosheviqin për ndamjen e Bosnjes në Karadjordjevë, qe kujt u duftë Ibrahim Rugova me i ndihmu me e hap frontin apo? *Nein* [Jo], sepse edhe amerikantë i kanë thanë jo dhe iu ka nënshtrur politikës t’tyne po ai e ka ditë zotnia që s’të len n’lloq.

Shkojmë ma tutje, nifarë dhurate e vogël jo karrem, dallon dhurata prej karremit. 1996 ni dëshmi që Rugova osht’ përpjekë, marrëveshja për arsim me Millosheviqin. E inicume prej ni komuniteti St. Ediggio në Romë të Vatikanit. Rugova mirë e ka ditë që ajo punë s’ecë, por t’vetmën dëshmi që une jom paqësor dhe me paqë ka qenë, po e nënshkrujë ni marrëveshje me u kthy n’shipi tem. Ku ka ashtu? Ti je pronar i shkollave, i ndërtesave, me okupator po mirrna vesh, “Hajde po kthehna”. Por, ai e ka ditë që kjo ka me i mbetë n’fyt dhe shpërblimi ose dhurata osht’ hapja e zyrës amerikane.

A mundeni me marrë me mend 1996 ni flamur amerikan me valvitë me ni lagje etnikisht t’pastërt, që quhet Dragodan ose Arbëri, ni flamur? Dhe jo rastësisht e zgjedhim aty dhe përzgjedhjen e kësaj lagje e ka bo zyra e Rugovës dhe n’zyrën e Rugovës kush osht’ kujdes për çashtje logjistike, teknike, shërbimeve? Adnan Merovci. Dhe Adnan Merovci ka caktu vet në ato rrethana State Departmenti ia ka leju Rugovës nëpërmes të cilit Adnan Merovci e cakton, e ka caktu shpinë. A nuk o kjo punë e vogël?

Dhe n’atë kohë ka qenë këtu ni regjim serb që ka sundu, ni Këshill Ekzekutiv serb. Anglezët, amerikanët kanë majtë kontakt edhe me ta. Ata i kanë propozu ndërtesën e Ibër Lepencit sot që osht’ në qendër t’qytetit. Dhe mu ma kanë pru m’kanë thanë, “Qe çka po na dhojnë serbët”, i kom thanë, “Ajo osht’ e shqiptarëve, ajo ndërtesë osht’ e shqiptarëve, por shqiptartë i kanë përzanë prej asaj ndërtese prej pune. Ju muni me qit’ flamur këtu, por ni shqiptar ka me thanë, ‘Qitu e kom pasë zyren’. Nuk besoj që amerikanët qesin flamur n’zyre të njerëzve që janë t’përzanun. Lagja dhe shpija juj osht’ në Dragodan”.

M’ka thanë, “Ami tri fakte pse në Dragodan?” Steven Blake sekretari i ambasadës amerikane i kom thanë, “Nji, ajo lagje qatje kanë me u ndi ma me fat në histori t’vetën, janë etnikisht t’pastërt. Atje nuk osht’ n’qendër të qytetit ai flamur nuk shihet shumë, ma kish me u pa dikun në qendër po qendra osht’ e pushtume, një. E dyta mbi qat’ lagje osht’ ni kasarne e ushtrisë dhe Prishtina sigurohet ose e ka ni ngrohtësi prej qatij flamuri se thotë për me ardhë qata me na vra neve qitu duhet me kalu kah ai flamur amerikan. Dhe e treta, dhe e treta, dhe e treta çmimi osht’ shumë racional i qirasë”. Domethanë,

jom bo pak komshi t'mirë edhe n'këtë aspekt. Dhe ata kanë vendosë që t'hapet zyra amerikane e cila krejt atë lagje mandej e shndërroi në vend të diplomacisë.

Ni vendim i zyrës të Rugovës boni që krejt Dragodani... e dini mandej historinë si ka rrjedh që osht' bo sektor krejt diplomatik prej t'hujve. Kjo ka qenë arsyeja. Po shkojmë ma tutje, po vjen '97-ta, në vitin '96-'97 çka po fillojnë disa pluma *tek tuk* {onomatope} me këristë në Kosovë. Ni shpirt i konsevim luftarak i grupeve, njerëzve, patriotëve që i qujke Rugova n'fillim lokal, të paknaqun me gjendjen edhe me ecurinë edhe n'aspektin e statusit të Kosovës kanë fillu me u organizu edhe vetorganizu. Dhe çka mendojmë ne tani sot? Mendojmë që kto organizime edhe kto çashtje kanë qenë si rezultat i ilegalitetit dhe panjohurive të Rugovës dhe Amerikës rreth kësaj, n'asni mënyrë, s'ka shancë!

Qita njerëz që t'partë i kanë kap armtë kanë qenë njerëz që, tash s'du t'thom dijet e para, po shkurt shqip dhetë vetë t'kofshin kanë, pesë vetë t'kofshin kanë, 30 vetë t'kofshin kanë, 40 vetë t'kofshin kanë kanë qenë në Ushtrinë Ushtarake në Shqipni. Me dije, me marrëvedhje të Ibrahim Rugovës me Ramiz Alinë, në poligonet e Surrelit e të Dajtit ku kanë qenë. Ku kam qenë edhe une me komandatin legjendar që po i thojmë tash, Adem Jasharin. Revolën që e kom edhe sot, e e kom me leje se po m'vjen policia n'shpi, që e ruj me fanatizëm, ni revole që ia kanë dhanë grekët Rugovës si dhuratë. Une e kom në shtëpi.

Me t'njejtën revole kom gju me komandatin legjendar në ushtrime atje, domethanë une s'kam qenë ksi ushtaraku me ta me Rugovën, po kur kemi qenë atje jom shku ndonjëherë. Dhe tani si t'thuhet që kta pluma që fillun '96, '97 qenkan t'ardhun prej qiellit, të Kosovës jonë kanë, t'njerëzve të Kosovës. Por, porosia amerikane ka qenë, "Do t'bohet, do t'lejohet, do t'nicohet, do t'mirëpritet ni luftë e vogël në Kosovë". Me fjalë t'thjeshta, por po du me i thonë të artikulume...

Kaltrina Krasniqi: Kta e kanë thanë direkt apo ka qenë diçka që osht' nënkuptu?

Adnan Merovci: Jo direkt, por Rugovës iu osht' thanë. Rugova ka qenë njeri me informata...

Pjesa e Pestë

Adnan Merovci: Nëse ni politike paqësore po i vika fundi, çka mbetet tjetër diçka? Mbetet ni plumb dhe miti i plumbit duhet të shkrihet për t'ndodhë diçka. Kjo osht' qajo luftë e vogël dhe ka qenë projekt i parapamë dhe i konstruktum prej amerikanëve, në komunikim me Rugovën. Por Rugova ka marrë rolin e njeriut të luftës paqësore dhe të komunikimit me botën për projektin e tij paqësor. T'u mos i pengu t'luftës, ditë dhe ata punën e vet ky punën e vet, paramendojeni.

Dhe amerikanët kanë qenë të interesum për ni luftë t'vogël, se ju e dini që reagimin e tyne t'menjehershëm, '97-ta aktisionet e para. Çdo aksion që ka ndodhë, Rugova e ka ditë përpara. Mos

t'flas tash edhe për aksionin që ka ndodhë në Drenas me policinë, mos t'flas për aksionin e Papoviqit kur ka ndodhë n'fund, mos t'flas edhe për aksione tjera. Shumicën... ekzistojnë njerzit e gjallë sot, e kanë emën edhe mbiemën të cilët kanë pasë kanale tjera, por edhe nëpërmes meje e kemi njoftu Rugovën, janë njerëz me emër e mbiemër.

Une muj me i thanë edhe me emën janë, domethanë njerëz që ekzistojnë. Dhe lufta e vogël ose ni luftë e vogël nuk ka mujt me qenë ni luftë n'ballë edhe n'krye të cilës udhëheqë Ibrahim Rugova. Këtë na duhet ta kuptojmë tani.

Kaltrina Krasniqi: Pse?

Adnan Merovci: Pse? Sepse edhe stërgjyshi yt e i imi, e baba, e babgjyshi, e miku, e jarani ishin çu n'kamë dhe nuk i ka vye Kosovës ni luftë gjithë populllore. Mbani n'mend, po flasim 20 vjet mas lufte, bon me folë diçka, diçka. Pse? Sepse projekti amerikan ka qenë ni luftë e vogël, intervenimi amerikan dhe pavarësia te dera. Jo me humb qenien njerëzore. Dhe me u vu në mënyrë publike Ibrahim Rugova n'krye t'ksaj lufte krejt populli n'kamë ishin çu.

Nuk du t'them me këtë që Rugova e ka ndalu edhe ka stopu po ka shku komform t'përmasave të cilat kanë lejue ni luftë t'kontrollume. Dhe e fundit, dhe e fundit, a mundeni me e marrë me mend sikur Shqipëria si shtet t'ish përfshi në luftë çka kish ndodhë? Kish ndodhë tragjedia e Kosovës, a e dini pse? Sepse kish intervenu Këshilli i Sigurimit për ni luftë në Ballkan mes Shqipërisë dhe Serbisë ose ish Jugosllavisë. Se ish-Jugosllavi osht' qajtë ajo edhe me Mal të Zi dhe Serbi.

Dhe si e tillë, dhe si e tillë ish trajtu ni luftë mes Shqipërisë dhe ish Jugosllavisë, ku kishin mbetë shqiptartë? Shqiptartë kishin dalë fitimtarë, të Kosovës n'qit rast a? Dhe kjo kish me ndodhë sikur Ibrahim Rugova t'ish konë n'ballë t'luftës n'kuptimin edhe publik e t'thirrjes t'mobilizimit sepse...

Kaltrina Krasniqi: Këtu ka qenë ni moment... m'falni që po ju nderprejë...

Adnan Merovci: Po.

Kaltrina Krasniqi: Këtu ka qenë ni moment shokus për opinionin publik kur mas paraqitjes t'parë publike të UÇK-së, Rugova në ni konferencë i ka shfaq dyshimet e veta për këtë grupacion. Ka shumë versione që tregohet, kështu që kisha pasë qef me e pa perspektivën e juj edhe sqarimin e juj.

Adnan Merovci: Idriz Recaj i cili ende s'osht' i gjindun, ka qenë kryetar i LDK-së në Skenderaj. Ai nuk osht' n'mesin tonë...

Kaltrina Krasniqi: Ai osht' i zhdukun?

Adnan Merovci: Osht' i zhdukun, për këtë arsye s'mundet me u përmend si dëshmitar. Sot si dëshmitar mundet me u përmend Gani Koci, ni njeri që ka qenë n'strukturë, a s'di ni eksponentë i Partisë Demokratike ka qenë edhe në LDK, Halil Geci ni luftarë i denjtë, ni veprimtar i LDK-së, ni, sot osht' gjallë e tjerë, e tjerë. Janë njerëz që kanë informue, tekstualisht informatat m'i kanë sjellë mu dhe ia kom përcjellë Rugovës. Dhe nuk mundemi me folë për padije, çfaqje publike e UÇK-së, ka qenë si akt dhe i njoftun dhe i pranum dhe krejt n'rregull. Por nuk mundet me qenë akt ose UÇK-ja dukuni e panjoftun për Ibrahim Rugovën në krye t'politikës, e çdo ditë të Zotit me ka ni amerikan u takue si të shërbimeve, si i ardhun prej Ambasadës Amerikane në Beograd. Dhe nuk po dika Ibrahim Rugova çka osht' UÇK-ja, kush janë në UÇK, çka po dojnë të UÇK-së?!

Paraqitja me 28 nëntor atje me rastin e vorrimit të, të Halil Gecit ka qenë, mësusit, ka qenë ni akt edhe i, i aspektit politik edhe të UÇK-së, se edhe UÇK-ja ka udhëheqë nifarë politike edhe ata, n'kuptimin e publikimit të transparencës jo gjithaq për faktorin e brendshëm apo t'jashtëm. Ibrahim Rugova i ndodhun n'krye të politikës të Kosovës dhe në marrveshje me amerikanët kjo luftë nuk bon me u rritë, me dalë jashta kontrollit dhe jashta përmasave, për arsyt që i ceka.

Çka duhet t'reagoj në këtë rast? A ka qenë ai me kushtetutë komandant i forcave të armatosuna, n'u bofshin najherë ato forca, dhe si mundet tash ni njeri në komunikim publik, në komunikim publik t'vetin mos me u çfaqë dhe mos me bo thirrje për luftë pastaj. Dhe thirrja për luftë... shifni, përcepioni i ktyne gjanave edhe shpjegimi n'detaje dhe n'analizë të thellë bohen gjakftohtësisht, përndryshe edhe mu shpirti e zemra m'ka gufue n'ato situata edhe si i ri e temperament.

Por, politika osht' diçka tjetër, marrja e përgjegjësisë osht' diçka tjetër. Dhe tash e fundit, çka sikur Ibrahim Rugova t'kish thirrë për luftë? Na e kem pavarësinë, a ishin vra ma pak? A kish ndodhë tragjedi ma e vogël, a ma e madhe? Duhet gjanat me i mat tash edhe me kto si pasoja që kanë ndodhë. Politikisht osht' diçka tjetër, por politikisht krejt janë pollavra me thanë që Ibrahim Rugova s'paska ditë që ka organizime t'grupeve, që po luftojnë, që e kanë qëllimin e mirë.

Ai osht' mundu në vokabularin e vet publik dhe diplomatik dhe politik me ia gjetë vendin atyne dhe vendi ka qenë, kta janë disa djem patriotë që po e mbrojnë pragun e shpisë. A e din çka osht' maksima, pragu i shpisë? Osht' thikë me dy teha. Ni aspekt i thu prag i shpisë, nuk ka ushtri, s'ka organizim, s'osht' qashtu. Osht' thanë për aspektin tjetër, që jemi zatetë. Armiku po t'vjen n'shpi, po të troket n'shpi dhe ka ni reaktion normal të njerëzve.

A nuk osht' zhvillu ni platformë në Prekaz, a nuk osht' zhvillu ni platformë e luftës, a nuk osht' ni rast unik n'botë kur osht' mbrojtë plakë, e i ri, e e re, e nuse, e plak në ni shtëpi t'barikadum, jo të vetëflijum dhe të masakrumë kanë luftue për ni kauzë. Dhe a nuk osht' bejeta e Prekazit ni hyjni e shqiptarisë n'përgjithësi dhe ktë nuk e din Rugova? Jo e din shumë mirë. Dhe projekti i tina, për mos me hap luftën n'përmasa jashtë kontrollit ka sjellë deri te rumja e qenies dhe mos involvimin e Shqipërisë si shtet n'luftë.

Involvimi i Shqipërisë kish qenë katastrofë prej neve dhe une prej kësaj distance kohore, dy sende i them. Një, pjesëmarrja e Kosovës në “Dejton” që atëherë jom çmend e kom pa që gabim kish me qenë dhe e dyta, në ni kohë dhe n’periudhë Sali Berisha ka thanë, “Nëse ndodhë vrasje e masakra e luftë në Kosovë do t’reagojmë si ni popull”. Kështu ka qenë e Sali Berishës. Dhe edhe atëherë une jom çmend si nuk po intervenon Shqipëria krejt, domethanë po t’flas me ni, me ni eufori, me ni mendim euforik.

Por, tash po e shoh që përfshirja e Shqipërisë n’luftë kish qenë shumë në dam të Kosovës sepse mandej ish trajtu si luftë... edhe Këshilli i Sigurimit, a e din çfarë disponimi ka pasë, e ka e na i dimë ato gjana. Ky ka qenë ni projekt amerikan dhe erdhëm deri te viti ‘97. ‘97 me 1 tetor studentat në protesta, para “1 Tetorit” 1 tetor. Para “1 Tetorit” vjen për ta taku Ibrahim Rugovën, Albin Kurti, vjen për ta taku Bujar Dugolli, Driton Lajçi, Muhamet Mavraj, osht’ edhe ni i pesti që s’po m’kujtohet emri dhe dojnë me taku Rugovën.

Une i fus ata mbrenda dhe hy te Rugova edhe i thom kështu, kështu, une e disha programin që ka edhe takime tjera tha, “Adnan, thuju le t’vijne nesër” dhe dal une i thom Bujarit edhe Albinit, kta dy, me kta dy kom komunikimi i thom, “Nesër do t’takoheni sepse...” ky Bujari insistonte thonte, “Jo, na po dojmë qitash me u taku”. Edhe n’atë formën pak agresive, kishe dojmë me hi edhe s’mun me pa pengu kerkush. Dhe tha, “Jo, na po dojmë me hie” thashë, “Jo, me hi s’mundeni ju ashtu,” tha “A po na pengon ti a?” Thashë “Po...” thashë, “për ata që dojnë me hie pa leje une jom këtu me i pengu ata” tha, “Po na po dojmë me takue”, thashë, “Kond po doni? A mu a Ibrahim Rugovën?” Tha, “Ibrahim Rugovën” a thashë, “Mos po doni mu me m’taku” thashë, “Me m’taku mu e vendosi une, me taku Ibrahim Rugovën vendosë ai. Ai ka vendosë nesër me iu pranë dhe une jom këtu për mbarvajtje të takimit nesër. Ejani nesër!”

E ka kapë për setre Albini tha, “A p’e sheh që njeri po t’thotë që takimi osht’ nesër”. Janë kthy edhe janë ardhë nesër n’takim. Dhe Rugova osht’ mundue veç me e shty për ni kohë ka thanë, “Pritni edhe ni kohë”. Por ata nuk kanë ndëgjju mandej me të parin... dhe nuk ka pasë asgjë t’keqe këtu. Rugova i ka përshëndetë, i ka përkrahë nuk ka qenë n’kuptimin as deklarativ kundër. Por, definitivisht protestat e 1 tetorit në vitin 1997 kanë qenë ni reagim, jo edhe veç kundër Serbisë, jo edhe vetëm kundër shtëpive, fakulteteve, jo edhe ndërtesat që nuk u bon e nuk u lirunë, e ku ta di unë, pse n’përgjithësi arsimit.

Por edhe kundër gjendjes n’përgjithësi ni protestë, ni, ni reagim por edhe kundër politikës t’udhëhequn pse jo edhe të Ibrahim Rugovës. Jo n’kuptimin kundër, n’kuptimin ekstrem po ni kritikë, ni vretje, ni sepse ajo, ai demonstrim dihej që do t’përfundojë me ni dhunë siç edhe ndodhi. Dhe une mendoj që definitivisht ajo edhe historikisht dihet, studentat s’mujnë me pasë keq. Ni vendim i studentave duhet t’futet... kush nuk e ka fut nën sqetull ni vendim të studentave edhe pse n’moment mujn me mendu që osht’ i gabushëm, ai osht’ dekadent, humb kështu historia fundi fundit m’ka...

E tash ni produkt i studentave që quhet Ibrahim Rugova po i ndodhun në politikë, nuk do t'thotë edhe në asni mënyrë une nuk e kom kuptu drejtpërdrejt kundër tij por n'përgjithësi ni pakënaqësi, por edhe sygjerim që ne nuk durojmë ma. Dhe çka ndodhi, tani mund t'themi te aksionet e intensifikume, lufta e cila ka ndodhë, organizimet që kanë qenë, Prekazi, marrëveshjet, mos harroni ka qenë marrëveshja e Holbrook me Millosheviqin, KDOM-i [*Kosovo Diplomatic Observer Mission*] misioni verifikus.

Krejt ato kanë qenë paralajmërime të, edhe përgaditje sepse nëse ni i hujë vjen në Kosovë e pin makiato me ty mos mendo që ai s'mirret me ty dhe ka dalë veç me keshë ose me cakrru, por ata kanë regjistru krejt gjendjen edhe n'aspekt të sigurisë e kanë përgaditë krejt terenin, kanë ndodhë Reçaku si pretekst, a dini, cilësimi i Reçakut dhe ngjarjes të Reçakut si, si krim kundër njerëzimit, gjenocid prej ambasadori Walker, thirrja e Konferencës të "Rambujesë".

Po realizohet Talbottqë po thotë, "*There is going to be a special international conference in Kosovo*", "Do t'organizohet ni konferencë speciale ekstra veç për Kosovën". Në vitin '95 në Dejton në Ohio iu ka thanë shqiptaro-amerikanëve në protesta dhe n'tubim që ka qenë... Dhe nëpërmes kablllo-grameve i ka ardhë informata dhe kontakti me Chris edhe... Chris Hill edhe Nick Hill, se vëllau i Christopher Hill, Nick Hill, Nicholas Hill ka qenë sekretar në Ambasadë. Ai ka ardhë dhe i ka përcjellë krejt këto porosi që po flas, dhe Konferenca e Rambujesë që ishte çdo gja përveç pavarësisë të Kosovës.

Dhe këtë u duft ni kohë në Rambuje për t'a kuptu delegacioni, që nuk osht' Konferenca e Rambujesë pavarësia e Kosovës, por osht' çlirimi i Kosovës. Gjuhën tonë ni hijeshie si gjuhë perëndie, fjala liri dhe lirim osht' e vetmja që nëse ia shton ç-në veç e forcon atë, s'e negon. Dhe ne u çliruam por për t'u lirue duhet kohë ende. Motoja e Rugovës, "Liri, Pavarësi, Demokraci" e shifni demokracinë e ka lanë n'fund. Duhet me u lirue, m'u pavarësue, me punu për demokraci. Si projekt prej fillim viteve të '90-ta.

Kaltrina Krasniqi: Ku iu gjeti lufta? Bombardimet?

Adnan Merovci: 21 mars, 1999 ka qenë ditë e diel, n'ora 2:00 në Velani me plotë gazetarë t'u u kthye prej procesit të Parisit ku u nënshkru Konferenca e Rambujesë, "*Now is time for NATO*," fjaltë e Rugovës për gazetarë, sugjerim i imi që t'mos ndalet me folë gjatë sepse mu m'informun që shumë ka gazetarë që po e presin në Velani dhe fjaltë e tij që... edhe kur po flas se ka xhirime që nihen këto fjalë, "*Now is time to act!*" Kështu diçka ka thanë me anglishten e tina dhe hyni brenda, e diele, 21 mars, 1999.

E hane, e marte, e merkure në ora 20:00 bomba e parë, "Filluan, filluan" janë fjaltë e katër fmive t'mi në lagjën Dardania, afër ngrohtores ku une ndodhesha me ni fqj...

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë bomba e parë?

Adnan Merovci: Bomba e parë për mue ka qenë në Hajvali në asetet ushtarake të Hajvalisë. Dhe njeriu i parë që m'ka thirrë n'telefon atë natë osht' Halil Matoshi sepse i kish krisë fort afër, dhe m'thotë,

“Adnan çka osht’ ka bohet bre, a çka ka ndodhë, a çka me bo, a qysh me bo?” Unë e pys, “Si jeni?” “Mirë...” thotë, “po u shashtrisë se zhurma t’mëdha” dhe m’u kujtunë fjaltë e Wesley Clark që para

nisjes nga Parisi ka majt ni grup i delegacionit takim në Bruksel ku s’ka qenë Rugova, s’kam qenë as unë po kur u kthynë na e transmetun, ka qenë edhe Edita Tahiri aty, ajo na tregoi që Wesley Clark i kishte thanë, “Ni javë ditë runu vet se ka zhurma t’hatashme që qenia njerëzore osht’ vështirë me i durue, mas ni jave jemi ne aty”. Realiteti ishte ndryshe, s’ia ka qëllu Wesley Clark zgjati ma shumë. Dhe atë natë n’ora 11:00 me 24 mars e mërkure, i kom hyp kerrit dhe kom shku në Velani.

Fillimisht i kom thirrë n’telefon ekipin tim që ka qenë aty në kujdestari, kom thirrë edhe fqinjë dhe kom shku edhe vet. Kur kom hi e kom pa Rugovën në, me anëtarë tjerë t’familjes në sallonin e vet edhe e kishte ni kafe t’u pi me duhon edhe e kishte ni shishe venë përpara. Kur shkova une tha, “Merre Adnan pak Coca Colë qaty...” se Coca Colë ka majt gjithë thashë, “Po, po bojnë dam Coca Colat kryetar bre se e gazume”. E kem pasë nifarë humori n’ato situata. Tha, “Hajt se edhe une Coca Colë” edhe ai kish pasë Coca Colë me kafe, “Gëzuar, gëzuar për bombën e parë”. Kurrë n’jetë nuk e kom pa ma t’gzumë, se që gëzohet Ibrahim Rugova si fmia dhe i keshë ftyra, i pa artikulum prej gëzimit e ngadhënjimit, osht’ momenti ma t’gzumë që e kom pa n’historinë time dhjetë vjeçare, çdo orë 24 orë.

Dhe tha, “Ku je ti? Qysh je? Qysh o familja, mirë? Zoti na nimoftë...” tha, “se edhe n’qiell...” tha, “se Zoti n’tokë ka fillue prej qiellit me na nimu”. Dhe kto kanë qenë ngazllimet fëminore t’tij, edhe n’pytjen e dikujt se kur u gëzu Rugova ma s’shumti osht’, domethanë tash kur po flas po e shoh figurën e tij edhe atë daljen nga kontrolli... a din njeriu kur osht’ i ngazllumë shumë i gzumë, kur e hup artikulimin, kur, kur, kur... dhe situatë që s’e kisha paramendu.

Kaltrina Krasniqi: E ju zotni Merovci? Qysh u ndjeshit ju?

Adnan Merovci: Une rashë në ndikim të përgjegjësiave t’mia që familja edhe fatin ma t’madh e kisha që fëmijtë i kisha t’vegjël, ende fëmi dhe t’u qenë fëmi ata nuk e dijnë shumë. Unë, ta them shumë sinqerisht, t’u pasë informacion, t’u qenë në Rambuje, t’u ditë çdo bisedë, çdo... a m’besoni osht’ si ni student kur nuk e mëson provimin e jep jo, por kur e mëson provimin e jep, a din që s’i doket shumë interesant. Ti e din që diçka po ndodhë, mirëpo thu se e meritoj une ata, pa modesti po ta thom ose pa lajka po shumë sinqerisht. Diqysh m’u ka dokë pak si normale se jom kanë i bindun që i ka ardhë momenti edhe po ndodhë. Momente të para shumë.

Mandej jom ra në ndikim t’njerëzve, domethanë të familjes, të fëmive. Fëmijtë fillun me u gëzu pa ditë çka po ndodhë veç prej ndjesisë t’u na dëgju neve që do bomba e kundër... domethanë, edhe t’i sillë... edhe përgjegjësitë mandej sepse une shumë jam friku prej pasojave që mujn me ndodhë t’u mos pasë mekanizëm. Rugova vendosi me u kthy edhe pse u ofrue që krejt delegacioni t’rrijnë në Paris edhe t’shkepen dikund në Europë, sepse ni gja e tmerrshme do t’ndodhë tani në Kosovë. Dhe amaneti i babgjyshit, “Flota e gjashtë, flota e gjashtë”, që une si fmi kurrë s’e kom kuptu. Dhe flota e gjashtë

është Amerika dhe perëndimi dhe ni pohim i tij që tash une muj t'ju thom t'rive që ai m'pat' thanë, "Fati ma i madh i yti osht' Adnan që nuk e ke taku Hasan Prishtinën".

My God, "Fat i imi që s'e kom taku Hasan Prishtinën?" "Po..." thotë dhe qante babgjyshi me kto fjalë. "Fat i madh për ty që s'e ke taku Hasan Prishtinën" "Pse?" "Sepse ti sot nuk e din kush nuk osht' në jetë, kurse unë që e kom taku e di kush nuk osht' në jetë". Dhe rrokullisja ni *deja vu*, ni rikujtim i krejt asaj ku kanihere për situata t'tilla une s'kom të ndërtum mit për Ibrahim Rugovën, por diku i marr lakmi që s'e ka taku. Tani ky osht' momenti i bombave që me pasë taku n'qat' rast sot mërzinë e ka njeri ma t'madhe.

Dhe tani m'reflektohet ajo porosia e babgjyshit dhe për çdo natë une disave këtë ndjenjë nuk ia kom thanë kurrë kërkujt, po për herë t'parë po e thom, shpesh herë i marr lakmi disa njerëzve që s'kanë pasë rast me taku Rugovën, sepse nuk e dijnë kush ma tash nuk osht' n'jetë. Kjo nuk do t'thotë që vetëm, që vetëm mu po më mungon Rugova po i mungon edhe Kosovës. Por, megjithatë mendoj se Rugova e ka kry misionin e vet dhe mu m'dhimet vetja që unë kom mbetë pa ni shok timin, mbi t'gjitha unë Ibrahim Rugovën e kom pasë shok.

A lejohet t'thuhet kështu? Mund t'thuhet nëse n'fillim thashë që minimumi osht' jeta që e kisha dhanë për të, mandej thashë e kom dashtë shumë dikur thashë që jo profi du t'mirrem me të as t'mos vdes as mos te du, sot m'dhimet vetja për mungesën e ni shoku dhe ofshaj me këtë të thënë. Ibrahim Rugovën nuk ka nevojë me dashtë, siç Adem Jasharin duhet me ndje, Ibrahim Rugovën duhet me provu me njoftë. Kjo osht' porosia jem në ofshama.

Kaltrina Krasniqi: Zotni Merovci, ato ditë n'vijim kanë qenë... mas festës së bombardimeve që e patët bo me Rugovën, ditët mandej kanë qenë shumë dramatike.

Adnan Merovci: Po, shumë e vërtetë osht' dhe në kohën kur kanë ndodhë vrasje, deportim t'njerëzve, tragjedia ma e madhe e shqiptarëve të Kosovës me 1 prill 1999 në ora 07:00 në ni BMW me regjistrim të Beogradit...

Kaltrina Krasniqi: Mëngjes, mramje?

Adnan Merovci: Mëngjes... dhe ni shofer me ni punëtorë t'sigurimit përpara ulur në vendin tim ku une gjithë... dhe osht' ndoshta hera e dytë ose e tretë n'jetë që me Ibrahim Rugovën jom ulë mrapa n'veturë, rrugës për Beograd. Nëse këtij i themi "Gandi i Ballkanit" për t'a taku kasapin e Ballkanit, ni qingj që po i shkon ukut në oborr. Dhe rrugës t'u shku une e preku me gju dhe i them, "Hajt kryetar hajt, në Beograd a?" Ai e ulë kokën edhe s'flet asgja, une e preku prapë ai thotë, "Çka ka Adnan?" Pak me nervozë, "Jo, jo kurgjo..." thashë, "po po shkojmë në Beograd".

Ai s'bon zo hiç, edhe ambiente rrugës, bomba, do ura t'prishta. Herën e tretë kur e kom prekë, “Çka ka bre Adnan?” Thashë, “Mos ta nin kryetar...” thashë, “populli shqiptar dhe kosovartë nuk janë në nivel t'tillë mos me kuptu ni kryetar t'vetin dhe me e hudhë poshtë për ni takim t'dhunshëm por a ki armë me veti”, i kom thanë dhe armtë e tij...

Kaltrina Krasniqi: A ka pasë armë me veti?

Adnan Merovci: Po, gjithë i ka pasë. Armtë e tija, po. Dhe armtë e tija kanë qenë fjalte, ai ka qenë doktor i fjalëve dhe doktor i fjalëve i thojke vetit dhe une këto ia thashë, “A i ki armtë me veti? A ki fjalë me folë se ti po shkon atje me luftu me to me armë tua, armtë tua janë fjalte”. Dhe unë ktu para këtij opinionit që sot po m'dëgjojnë unë jam edhe n'përfundim t'librave t'mija për kto po qe po e qes si, si, le t'themi, për herë t'parë, për informim, as qetësim, as lojalitet, as triumfalitet po veç për informim. Dhe une jom i prirur veç me informim me ilustru jo me zbërthy tash edhe unë kërkoj falje jom njeri s'muj mos me thanë që për herë t'parë n'jetë dhe në kto intervista me qindra e mija që i kom thanë, nuk m'ka ndodhë me u emocionu si sot. Ibrahim Rugova në takimin me Millosheviqin ishte heroj i fjalëve t'veta.

Kaltrina Krasniqi: Vetmëm pak...

Adnan Merovci: Po.

Kaltrina Krasniqi: Nuk keni ide sa çuditshëm po m'tingëllon që po e takoni ni njeri i cili me qëkaq sinqeritet po vendosë me tregu ni moment jashtëzakonisht shumë intim. Prej Prishtinës deri në Beograd janë gjashtë orë rrugë...

Adnan Merovci: Tri orë e diçka, katra.

Kaltrina Krasniqi: Në kohën kur s'ka pasë...

Adnan Merovci: Katër orë kena bo se ishim me polici.

Kaltrina Krasniqi: Sigurisht keni qenë edhe t'përcjellun, nuk keni qenë veç ju me qat' veturë...

Adnan Merovci: Po, ka pasë vetura tjera.

Kaltrina Krasniqi: A mundeni veç me na dhanë sa ma shumë detaje n'lidhje me qat' rrugëtim se ka qenë i randë si i tillë. Ma s'pari ju sigurisht nuk e keni pritë që qajo ka me ndodhë, me siguri qajo ka qenë sendi i fundit që keni prit që ka me ndodhë.

Adnan Merovci: Une thashë edhe pak ni mënyrë si, le t'themi, teatrale kalova prej saj në ilustrim për ndryshe asaj i ka parapri ni natë, se me 31, me 31 mars '99 na ka hi n'ora... dikun n'ora 11:00 dhe une kam qenë aty në Velani. Po flasim tash, 21-tin thamë jemi kthy e hane, t'mërkurën kom fillu kto dhe me 31 mars na ka hi policia në Velani t'u e pastru lagjën edhe i erdh rendi shtëpisë dhe unë kam qenë aty. Tani krejt n'detaje n'çdo sekuencë duhet orë e orë me shpjegu, po megjithatë aty ka qenë ni katrahurë e madhe.

Për fatin tonë ka qëllu ni gazetar gjermane që une kur e pashë çka don me ndodhë... se une e pashë nga teracat që po vijnë policia dhe do t'i vjen rendi shtëpisë tonë. Une e ndala...

Kaltrina Krasniqi: Zotni Merovci çka shifshit prej dritares?

Adnan Merovci: Shisha ekspeditat e policisë se une n'qat' mëngjes edhe kom ardhë aty me grunë time edhe jom kanë i maskum. I kom hjek mustaqet që i kom mbajt gjithmonë n'jetë, kom vu syze me dioptri t'madhe, kam luftë rolin e njeriut me hendikep në t'ecun, kam pasë grunë time të veshun me ni sheshir, me ni *make-up* [grim] që kurrë n'jetë ma s'e ka qit edhe rrugës kemi folë serbisht. Ni gru me ni *make-up*, me ni sheshir t'tillë n'kohë të bombardimeve në atë gjendje s'mund t'jetë shqiptare dhe ni njeri me atë gru n'krahë s'mund t'jetë shqiptarë. Dhe ai osht' Adnani për me arrit ni qëllim me mrrri deri në Velani, se e kom pasë t'vështirë se kanë qenë kohna t'merrshme, po flasim për ditën e gjashtë-shtatë të bombardimeve.

Dhe hyj brenda, ekipi veç kish shkue dhe i sigurisë edhe ni njeri që ish konë disa ditë e lirova, shkoi dhe mbeta vetëm unë. Pastaj pashë rrugës, kto ekspeditat, por jo bash te Rugova aty se une hina nëpër rrugë dytësore, nëpër shpi mas shpie dhe mrrina te Rugova pa m'ndalu policia. Fati, domethanë që n'vende publike ku u dufke dikund me ecë n'kamë prej vendit ku isha në Dardani nuk ish lehtë se kish makina pa regjistrim e mjaftojke veç me t'ndalu dikush edhe ta kish jetën n'dorë.

Qëllimi im ishte i vram, i vram po bile n'oborr të Rugovës. Dhe kur kemi hy brenda aty kur m'ka pa Rugova u çmend, ka thanë, "Qysh mrrive, Adnan?" Se prej teracave u shishin ekspeditat, ekspeditë me pinzgauera, me makina t'blindune ka dy a tre, ka dhetë-pesëmbëdhjetë, 20 njerëz me uniformë, pa uniformë, me uniforma t'gjelbërta krejt kto përshkrime kanë qenë objekt i dëshmisë sime në Hagë dhe e pashë se po na vijnë, domethanë po ofrohet, po na vjen rendi. Dhe i thashë kryetarit, "Kryetar edhe na kem me u ndodhë në këtë situatë, por jom une këtu, ballafaqohna une me këta". "Ani, kujdes Adnan, kadale, mos u acaros mos..." E gazetarja nuk dike dhe une me ni rast po i thom, "Kështu, kështu kanë me na ardhë".

Dhe duke e pasë parasysh që ishte ni gazetarë Renate Flottau që ishte ni korrespondente për Ballkan dhe njoftëse e mirë e t'gjitha luftënave në Jugosllavi. Unë me qëllim për me e majt që le t'na nxojnë ata me to aty, s'mujsha me i thonë rri se po na vjen policia, se ajo e kryjti ni intervistë me Rugovën. I thashë, "Qysh duhet me reagu n'këto raste? Me pasë qenë në Bosnje ke pa situata?" M'ka thanë, "Veç

duhet me qenë t'qetë, edhe jepju informacione hala pa t'vetë, n'kuptimin..." por tha, "meqenëse nëse janë në uniformë puntë i keni mirë, ma mirë se kta paramilitartë". Dhe n'atë moment janë ardhë te dera, i kom thanë kësaj, "Hyp naltë" dhe aty jom ballafaqu. E kanë thy derën e parë, derën e dytë kom piskatë, "Këtu ka njerëz" katrahurë ka ndodhë aty. Pse s'më kanë vra s'di, qysh, çka ka ktu... kto janë rrëfime që i kom bo edhe n'forma t'ndryshme.

Dhe në katin e naltë kanë qenë krejt anëtarët e familjes të Rugovës me dy, dy, dy baxhanakat e tij me fëmi krejt komplet, dikun rreth 20 anëtarë. Une me familjen time, fëmitë une masandej i mora se kur na ndodhi ajo une kërkova me i marrë fëmitë edhe m'lejunë me i marr fëmitë dhe i pruna aty atë natë. Dhe domethanë, për me spjegu shumë thjeshtë domethanë, as n'tualet fëmitë nuk i lejshin me shkue. Nihere kishe po kontrollojmë ka armë, s'ka armë. Aty katrahura poshtë ndodhi me mu dhe osht' minimumi me përdorë atë malltretim.

Veç e di që njeri s'mujke me u rrzu pa u rrzu. Ata m'sulmojshin une mujsha me qëndru, s'mujsha me, u tutsha me u rrzu thojsha ftyrën me rue e qishtu e ma bojshin, m'shajshin, "Tek je i fortë, e tek je kështu e..." qisi farë. Ftyren ma kanë ru, n'fityrë s'kom pasë sheja po ni ndihmë e kom pasë. Dhe tani, kur, i kom thanë, "Shtëpia e Rugovës..." "E a keni armë?" "S'kemi armë" e qisi pollavra dhe i thashë, "Na jem nën vëzhgim të NATO-s, s'mundeni ju kështu me u sillë!" U trimnova pak në ato momentet e para kur veç dola prej rrezikut, se rreziku ishte n'fillim domethanë, që me shku pa dëshmitarë që thojnë.

Atëherë fillova me u trimnu edhe m'erdh gjaku edhe hiç... aty e kom pa qysh osht' me vdekë, e kom pa Zotin, e kom pa jetën. Njeriu... mos m'thuj që jom trim se s'e kom ditë. Edhe trimnia nuk osht' domethanë ni virtyt, ni atribut, osht' ni moment psiko-fizik që secili njeri e ka, po a t'vjen a s'të vjen n'jetë... mu m'ka ardhë dhe e kom përjetu. Për qata janë kuajt edhe çdo sekond e kom tepër n'jetë thashë, çdo sekond po jetoj... krejt i kom kry.

Dhe janë mandej, i kom thirrë ata naltë m'kanë thanë, "Thirri anëtarë e familjes". Kemi zbritë qaty katër orë kemi ndejtë, ka qenë ni komunikim që une e kom ilustrue nëpër librat që kanë me dalë. Jo krejt t'detajume, dihen sot në opinion po kto libra kanë m'i... se e kom librin, e kom librin e Konferencës të Rambujesë dhe të arrestit shtëpiak mandej. Praktikisht na u arrestum edhe aty na kanë mbajtën të gjithë një muj e gjysë dikund, na kanë mbajtë në atë shtëpi aty.

Kaltrina Krasniqi: Çka bojshit për ushqim?

Adnan Merovci: Ushqimin, kem pasë rezerva mjaft. Për ironi t'fatit nihere katrahura kem pasë, n'mramje katrahura, t'nesrit kanë sjellë pampersa për bebë, se ka qenë ni bebë 8 mujshe. Edhe këtë detaj t'pampersave që kanë sjellë Millosheviqi e ka përdorë kundër Rugovës, po mendoj si dëshmitarë kundër tij domethanë, qysh i burgosun ti pampersa... ti mundesh me pru edhe bakllavë aty e knej i burgosun e po t'a bi do bakllavë, e jo s'je, po çfarë osht' ajo... domethanë, ka pasë ksi farë lëvizje, e kso

farë... Por ushqimi kryesorë ka qenë, rezerva ka pasë se na e kem ditë pak a shumë dhe ushqim i thatë dhe s'po u hajke fort buka në ato rrethana (qeshë).

Se e di prej ma vonë na ra imuniteti fillum kapak me u smu edhe me u... ka qenë situatë e randë se ni dhomb me t'dhimtë kur s'ki imunitet t'shkatërron edhe si rezultat i dhimbjes e ramjes t'imunitetit ngjallet ni diçka, mandej ajo diçka s'ka mekanizëm me u shëru, me u mbrojtë osht' rondë. Kanë qenë momente t'vështira dhe mandej kanë ardhë do njerëz, "Nesër me u taku në Beograd" ne i kem refuzu n'fillim, t'nesërit kanë ardhë t'kanë lanë pesë minuta edhe kanë thanë, "Po iu pret presidenti i shtetit e ju po shitni këtu osht' kohë lufte edhe dihet n'kohë lufte..." domethanë, kështu kërcnim total edhe në moment...

Rugova nuk osht' njeri që qet gjyks edhe thotë vramni ai osht' ni dijetar, ni njeri i urtë, ni... le t'themi edhe filozof dhe ka qenë... për me qit gjyks jom kanë une, po edhe une jom kanë nifarë pengu i tij se çka me bo une me qit gjyks. Dhe ka ndodhë kjo që ka ndodhë por, tash nëse e kalojmë këtë kanë ndodhë beteja dhe beteja osht' biseda, takimi. N'takim fillimisht une s'kom qenë gjysë ore, ata dy janë taku, mas gjysë ore...

Kaltrina Krasniqi: Ku keni qenë?

Adnan Merovci: Nuk kom hy n'takim...

Kaltrina Krasniqi: Po ku keni ndejtë?

Adnan Merovci: Kom qenë jashtë, domethanë me grupin tjetër protokol e siguri qaty. Bile biseda, une folsha për ndërtesë e për... ka qenë Pallati i Bardhë, ai Bjeli Dvor i njoftun. Ata m'pytshin gjana tjera ata grupi, për shembull vetshin për Adem Jasharin. Ata ishin njerëz që e kishin pa Prekazin çka ka ndodhë jashtë e kanë ditë, une isha njeri që e njifsha Ademin. Dhe për mu ishin ata interesant se me kuptu çka ka ndodhë jashtë, atyne, ata ishin t'çmendur kur iu thojsha që e kom pasë shok e e njoh, e e kom njoftë. Por, në një moment mas nja gjysë ore po m'thrrasin me hy edhe une n'takim. Dhe kur kom hy une po eci mendova që përfundoi takimi e po m'thrrasin, "Hajde..." edhe qysh osht' njeri e merr një... une tash jom në protokol, ai osht' *my principal* [superior i imi] që thojnë anglisht edhe me ecë. Kur hina mrena ai, Rugova po m'thotë, "Hajde Adnan, hajde se une t'thirra".

Hina aty erdh edhe ky shefi i protokolit t'tina mandej edhe Millosheviqi aty po ma jep dorën, une as s'e kqyra mirë te kryetari a din kishe që... "Adnan une t'thirra, kadale kadale". Gjithë qishtu m'ka thanë, "Kadale, une t'thirra. Kadale..." mos po boj naj kushlluz. Kadale midis Beogradit, në Bjeli Dvor te Millosheviqi po boj kushlluz, a din, ka pasë... edhe aty ka, osht' zhvillu, ka ndodhë ni komunikim i joni. Ai m'ka pytë rreth, "Kush po i shkakton... bombardimet e NATO-s po e shkaktojnë deportimin e njerëzve..." i kom thanë, "Kjo s'osht' e vërtetë dhe për këtë osht' ni argument..." thashë, "edhe në Mal të Zi po bombardohet edhe në Vojvodinë e asnjë s'po ikun edhe ata janë njerëz. Njeriu tutet si në

Kosovë si... n'koftë dyfishi, dhetë fishi në Kosovë ni fishi le t'osht' ko. Pse ni njeri nuk u lajmëru a dhetë njerëz që e kanë lshu Vojvodinën që po tuten prej NATO-s e kho milionat e njerzhtë e..."

Tani ai m'tha, tha, "Ti, kom ni që je nifarë inxhinieri..." tha, "po ti s'paske lidhje për politikë" a din, qit' fjalë e mbaj n'mend që ma ka thanë. Mandej ni letër u kanë dhe kryetari diqysh si e gjetë mënyrën kishe po t'thras për qat' letër. Ajo ish ni deklaratë e përbashkët, *zajednička izjava* në serbisht i thojnë, që gjaja se u takum edhe përcaktimet tona që n'rrugë paqësore t'zgjidhen qasjet e *tërrta*, *vërrta* {onomotope} qisi sene tri-katër fjalë edhe si deklaratë për shtyp nifarë mënyre. Edhe une i thom, "Deklaratat për shtyp nuk nënshkruhen..." thom, "une ky..." iu drejtova atij t'protokollit, "na i dijmë kto sene..." bile thashë, "munesh me thanë ti n'mjete t'informimit çka t'dush e na me demantu". Folsha une sikur me kanë, jo n'liri po n'trimni t'madhe, po ta jepke njeri nifarë fuqie, edhe me nënçmim kështu.

U ulëm edhe pak edhe e ndëgjova kur i tha, "Zoti Rugova..." tha, "çka po mendon..." tha, "qysh dilet prej kësaj shtate?" Ai ish brutal edhe në njerëz edhe këta udhëheqës të, të botës i shante liderët, me Clinton, me Schroeder, me Chirac. Për t'gjithë nga ni fjalë banale e thonte. Dhe Rugova i tha, domethanë po flas për ata që i kom ndëgjju me vesh, jo bisedën që e kanë zhvillu ata. Thotë, "Je hi n'luftë me botën, mekanizmat ndërkombëtarë janë në lëvizje, ata kurrë s'nalen ma pa i plotësu kushtet. Kështu që, plotësoji kushtet edhe t'shpëtojmë t'gjithë..."

Kaltrina Krasniqi: Çfarë gjuhe folshit?

Adnan Merovci: Serbisht, gjuhën serbe. Edhe, "Jonë principet e Rambujesë e edhe Rambujenë e refuzove," u çu n'komë tha, "Qysh bre!" Tha, "Qysh po mendon me hi NATO-ja krejt..." tha, "a din me ma marr Kosovën, a e dini që Kosova o djep i..." ia nisi qit' thanjen a e din se po flet me ni shkrimtar. A muni me marrë me mend që n'buzëqeshje Rugova i ka thanën që, "Nëse osht' djepi serb beba osht' shqiptare," n'takim. Dhe definitivisht kjo ka qenë për mu ni shprehje edhe ni, ni armë e madhe e Rugovës edhe e kom pa fitimtarë n'ata edhe Millosheviqi inferior karshi tina domethanë, intelektualiteti, ajo dija, aspekti dietar i Rugovës...

Ni njeri që i shante tjetër karshi Rugovës ish si pa fuqi, si... dhe megjithatë edhe ai njeri u konë. Ka pasë tashti ktu edhe biseda tjera do farë asi... Po e fundit osht' që kur u çumë n'komë me ecë, ai thotë, "A doni me nejtë për drekë?" I tham, "Jo". Na dha ka ni sendviq udhës. N'fund i tha Rugovës... kjo ma s'mirti bjen me e thanë n'gjuhën origjinale serbe, une po e thom serbisht po edhe p'e përkthej se n'serbisht m'kujtohet thotë, "*Odredio sam jednog čoveka da će mi glavom odgovoriti ako tebi jedna glaka smeta... fali*". Pra, "E kom taktu ni njeri që m'përgjigjet me kokë nëse ty t'mungon ni qime e flokut".

Edhe une n'atë rast kom reagu edhe i kom thanë, "Kjo osht' kërcënimi ma i madh që mundet me iu bo Rugovës", edhe ma ka dhanë dorën edhe jemi nda. Veç m'ka kqyrë qishtu... nuk e di a m'ka kuptue dhe

une kta e kom përdorë n'gjyq të Hagës, sepse definitivisht osht' kërcënim shumë i madh për Rugovën. Kur n'rrethana t'tilla ty t'thotë ai farë kasapi që, "Qy ti ki me konë mirë se po t'garantoj se ni njeri m'përgjigjet me jetë", po punë e madhe ni jetë e tij n'shkoftë e qatij për Rugovën, ai osht' kërcënim kështu n'gjuhë shumë t'sofistikume.

Jemi dalë prej atyhit edhe une Rugovën e kom ndi... a m'besoni që e kom pasë ni lehtësim nga krejt ajo dhe metë i kom pasë çka po ndodhë në Kosovë dhe e kom ditë që në atë kohë edhe në atë ditë ka masakra, ka vrasje, ka deportime në Kosovë. Ibrahim Rugova po takohet me Millosheviqin. Sekuencat që janë qit' nga takimi nuk janë origjinale, s'osht' e vërtetë që Rugova qeshë. T'qeshnet janë nga takimi ma herët kur u bonën me amerikanë, ni vjet përpara pa shku në Amerikë me Aganin e me... aty veç ni gja ka qenë kur i thotë... edhe n'media, kto edhe mediat e kanë qitë thotë, "E kishe shpinë e mirë në Prishtinë..." a din thotë, "ahh..." Rugova i thotë, "Osht' e ni drejtorit, shpija e drejtorit të Dardanisë..." atij Sufra se ai ka qenë drejtor.

Thotë, "Po a osht' ajo shtëpi që ti banon?" Thotë, "Po, po banon". Thotë, "Shtëpija jote?" Thotë, "Po shtëpija e jemja..." "Po..." thotë, "une banoj po shtëpia e Kosovës". Domethanë, edhe n'qat' rrethanë edhe... Rugova s'u dorëzoi edhe ni fjalë bile pa ia thanë. Dhe harrova me thanë që n'atë fjalën, n'atë deklaratën e përbashkët kur e mora e lexova ajo ish kurgjo hiç edhe p'i thom une, "Po na e nënshkrujmë me kta". "Jo..." tha, "na duhet me nënshkrue", po i thashë, "Kryetar kjo s'te ko kurgjo", n'shqip tash p'i thom, a din, letër tri fjalë.

Edhe aty ishte Kosovo i Metohija, a din, edhe mu Rugova tha, "Qita Metohija p'e fshi" po ia thotë, a din, tha Millosheviqi, "Fshije ti për veti une për veti s'pe fshijë". Kopja sot e qasaj...

Kaltrina Krasniqi: Deklarate?

Adnan Merovci: Deklaratë n'origjinal osht' n'qit zyre ku po flasim.

Kaltrina Krasniqi: Mandej?

Adnan Merovci: Mandej jemi kthy në Kosovë, jemi kthy dhe rrugës kur jemi kthy... dhe une e kom pasë ni kërkesë, kemi folë tash edhe gjana tjera. Kom folë për Aganin, "Ku osht' Agani, ku janë kta? Bajram Kelmendi?" "Po kom ndëgjue edhe une në mjetet e informimit..." Ia ka shkru emrin Aganit n'paqetë t'cigarës dhe une e kom përmend n'gjyq të Hages thashë, "Ia ke shkru emnin n'takim dhe mandej e ke vra". Ka qenë argument shumë i fortë për gjyqin e Hagës, provë e madhe qiky moment, se e kom përmend në takim dhe ai se ka mohu që ia ka shkru emrin Aganit se une vet i përmenda, "Ku janë kta njerëz masi po thu bombat s'di pse..."

Edhe e kom pasë ni kërkesë. Kërkesa ime ka qenë me na e kyç telefonin se na e ndalën, na ndërprejnë telefonin n'shpi dhe kur kom shku ka qenë telefoni t'u punu dhe ka qenë gëzimi ma i madh i jemi.

Njeriun e parë që e kom thirrë osht' Christopher Hill, ambasadorin amerikan në Maqedoni e kom thirrë n'telefon dhe kur ma ka ni zonin ai u çmend prej gëzimit dhe tha, "Adnan..." tha, "po thojnë lajmet që je taku në Beograd..." tha, "çka osht' kjo montazhë a çka?" Thashë, "S'osht' montazhë, osht' e vërtetë jemi taku". Nuk i ka ardhë mirë hiç.

"A osht' e mundun?" Thashë, "Po osht' e mundun" "au, au, au *unbelievable* [e pabesueshme]" ia spjegova rrethanat e krejt. Po, megjithatë u gëzu që iu lajmërova. Dhy ky telefon ka funksionu kohë mas kohe sido që të jetë. Domethanë, herë e ndërprejshin kur s'dojshin me na lonë me komuniku, kom dhanë intervista t'shumta në Deutsche Welle, Europa e Lirë, CNN... domethanë se m'kanë thirrë, se u identifiku ai numër. Mandej jepshin dikur kur u bombardu posta, se ndërtesa u bombardu u ndrru numri e qishtu. Kanë qenë rrethana t'randa, t'vështira, n'pritje pa dije çka po ndodhë me neve, familja aty, vështirë, momente të vështira me ndejtë me Ibrahim Rugovën i arrestum problem ka qenë. Por, megjithatë thojshë Zoti osht' i madh.

Kaltrina Krasniqi: Por, Rugova nuk ka nejt në Kosovë deri në fund apo?

Adnan Merovci: Po, jo se gjithëherë na kemi kërku me shkue n'çdo takim, edhe n'takim të Millosheviqit se kur ndodhi ajo na hinën qashtu. Na s'kem pritë lula, por jo me ardhë me na hi n'shpi e me na nejt n'dhomë. Se na e kem ditë që ka me qenë rrezik e krejt, po na n'shpi tonë duhem me nda fatin me popull po jo me t'hi... kur t'hin ai n'shpi ti çka? Lypshin me na liru, s'na lirojshin kishin arsyeime t'ndryshme, dikur kom folë une edhe me, me ni përfaqësues të Vatikanit, m'ka thirrë n'telefon, ka arritë me fol dhe mandej u bo e madhe.

Kjo gazetarja gjermane mandej krejt e ka pa situatën qysh, na edhe takimin ia rrëfym dhe kjo mas pesë ditëve ka dalë aty... ka ikë se erdh ambasadori rus n'takim te Rugova e mbajtën ni konferencë për shtyp, i prunë do gazetarë t'vet kishe me autobus dhe e shfrytëzum rastin edhe me dalë Renata, se msheft. Nuk e kanë vrejt Renaten që ka qenë, se ajo kur kanë hy e maskoi vetën me ni shallë e u bo kishe osht'... e ata nuk i identifikun njerëzit.

Dhe mandej ambasadori [Yuri] Kotov, ka pasë ardhë n'takim dhe e organizova une që me dalë dhe i thashë, "Mos shkruj derisa ne t'shpëtojmë". Por ajo e ka bo mandej ditarin e vet, se Joschka Ficher e ka prit në zyre ia ka tregu gjendjen ka thanë, "Po m'vyn për Europë me i dëshmu që Rugova osht' peng se s'po kem, na fjalë po po..." dhe ai ditari pak ka ndikue mandej në acarim sepse ka qenë vështirë shumë rrezik kemi qenë sepse, qysh me qenë ni gjermane aty e mos me ditë qarqet serbe? E tash krejt ato shigjetat te unë, pse ti që po ndërmjetëson s'ke kallxu që ki gjermankë këtu?

Për me pranu ata që ka qenë ni gjermankë i kish shku krytë njanit atje se gjendje lufte, pse s'e ke ditë? Dhe u kanë nifarë periudhe ashtu, nifarë situatë që për shkak t'qasaj ndoshta... se kurrë jetën mu s'ma kishin falë se shumë kom pasë telashe. Tash s'po du me e personifiku krejt kta po definitivisht une jom marrë me, unë kom qenë agresiv me ta (qeshë). N'takat tem qaq sa... Edhe mandej Renata ka dalë, e

ka dhanë ditarin, ditari ka qenë mbrojtja ma e madhe politike për Rugovën. Aty osht' dëshmu që ai ka shku me zor n'takim, ajo krejt e ka përshkru gjendjen çka ka ndodhë. Dhe unë mendoj që nuk ka send që n'qatë kohë e ka lanë Rugovën ma shumë se qajo politikisht dhe mos t'thom tash edhe ditari im që çdo detaj ka me e zbardhë që ka ndodhë aty.

Edhe mandej presioni shumë i madh tek Millosheviqi nëpërmes ambasadave të ndryshme për me liru Rugovën, se kërksa jonë ishte veç me u liru. Une çdo bisedë telefonike me kond folsha thojsha, "Boni presion te qarqet e juve, ka t'muni, tek t'muni me na liru" se s'kish mo jetë aty. Mandej dikur kanë bo presion shumë t'madh. [Massimo D'Alema](#) e shpjegon, domethanë që ka qenë kryeminister italian thotë, "Dërguam dy avion, ma n'fund u pajtu mas presioneve t'mëdha Millosheviqi", dhe ni avion e ka çue Italia dhe kemi shku. Ni natë përpara kemi qenë ne, ka pasë, ka pasë tendenca me nda familjen dojshin veç mue edhe Rugovën me na liru e aty une e kom bo ni heroizëm t'vogël, shumë t'vogël, qikaq {tregon me duar}.

Nëse, krejt hallall e krejt obligim me punë ni rezultat timin e shoh, e dalloj në krejt kto çështje. M'ka punu koka edhe Zoti m'ka ndihmu që, që nuk kom leju me nda sepse tash jo Millosheviqi po edhe ata klyshqit rreth tij dojshin me nda familjen prej Rugovës edhe meje. Mu edhe Rugovën me na leju me shku në Itali, familjen me nda që me shantazhu. Aty ka qenë ni betejë e jemja kështu e pakompromis edhe nuk ka qenë lehtë edhe ia kom arritë n'fund. I kanë sjellë edhe anëtarët e familjes dhe krejt n'ballon edhe në Itali në Romë. Dhe këtu përfundon ajo odisejada, Kosova po bombardohet ende, ditën e nesërme mandej ka ndodhë rasti me Aganin.

Njeriu i parë jom që ia kom komuniku Rugovës edhe muj me thanë që nëse atje thashë bombardimi i NATO-s ngazllim dhe komunikimi i lajmit për Aganin ka qenë njëri ndër rastet ma t'randa që e ka përjetu edhe për mu shumë vështirë që ia kom thanë dhe mandej aktiviteti politik i Rugovës pritja gjithkah njerëzit anej këndeje.

Pjesa e Gjashtë

Kaltrina Krasniqi: Po vazhdojmë prej qatij momenti kur e keni marrë vesh që po punon telefoni kur jeni kthy.

Adnan Merovci: Kur u kthym n'shtëpi, hyjmë n'shtëpi Millosheviqi nga ai takim kishte mbajtë ni premtim dhe ai ishte telefoni i cili nuk punonte deri atëherë dhe ishte rikyç. Punën e parë që e kom bo, e kom marr telefonin dhe e kom njoftu ambasadorin Hill, Christopher Hill, ambasador i Amerikës në Shkup, me t'cilin kemi mbajtë kontakte edhe edhe ma herët, në t'vërtetë tash ma herët jo se ai ni ditë përpara na kishin rrëmby po kishim mbajtë kontaktet komunikimit prej fillimit të bombardimeve.

Dhe ai u gëzu shumë kur ma nditi zanin dhe une fillova me i referu thashë, “Posa u kthymë prej Beogradit, takimit”, e pashë u step për ni moment n’telefon dhe thu se nuk i besoi asaj që po i them une, dhe ma shprehu duke thanë, “Po, kanë tregu lajmet dhe nuk kam besue kam mendue që osht’ trillim, n’kohë lufte edhe kto i bon...” tha, “Millosheviqi”. Thashë, “Jo edhe pse osht’ 1 prilli...” thashë, “e vërteta osht’ se ne kemi qenë n’takim. N’takim, në vendim për t’shkue n’takim nuk ka marr pjesë Rugova. Ka qenë ni takim në rrethana çfare jemi...”

Tash, muni me marr me mend osht’ e nesermja që na kishin arrestue dhe që ne e dishim dhe e ndishim po edhe jo në mënyrë eksplicite e thonim. Sepse mendonim diqysh n’sheptësi me iu dalë prej durve. Nëse fjala vjen opinioni ose njerzhtë nga kureshtja pyesin atëherë thojnë, “Pse nejtën? Pse nejtët ju aty? Pse keni kërku me dalë kohë mas kohe?” Se çdo herë ka kërku Rugova mandej me dalë. Osht’ arsyeja pse n’fakt Rugova ka dashtë me e nda fatin me popull po t’u mendu që osht’ gjendja kapë e s’janë, mund t’ketë edhe skena t’pakandshm,e po jo me ardhë, me t’hi n’shpi edhe me t’arrestue. Kur ti je në arrest, ti, ti me doemos e lyp lirim dhe kjo ka qenë arsyeja pse.

Me ambasadorin Hill e kem mbyll biseden dhe ai m’ka lutë me e thirrë çdo herë që kom mundësi me e njoftu për çdo gja. I kom tregue që telefoni çkyçet kohë pas kohe por kështu u ndamë. Ai përtej krejt asaj që nuk i pëlqej që ishte mbajtë takimi edhe ata ma shprehi. Në atë rast, domethanë nuk foli as me presidentin Rugova, sepse Rugova vet edhe si natyrë edhe përpara edhe n’rrethana krejt tjera me telefon pak ka komunikue gjithëhere, ky osht’ diçka që e ka karakterizu për mos me thanë hiç. Fjala vjen, ka mbajt kontakte t’regullta me Sali Berishën kurrë s’mbahet n’mend n’dhetë vjet niherë që ka folë në Prishtinë.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka komuniku?

Adnan Merovci: Po ne kemi lëvizë shumë në Tiranë, domethanë se lëvizjet nëpër botë i kemi zhvillu nëpërmes aeroportit të Tiranës dhe kjo ka ndodhë mas, dikun n’vitin nëse s’gabo ‘92-‘93 pas, pas dy tragjedive me aeroplan në Ohër nga Shkupi dhe i patëm ikë hapësinës ajrore të Maqedonisë dhe patën vendosë krejt lëvizjet jashtë me u bo prej aeropotit të Tiranës. Dhe duke ndodhë kështu lëvizjet e shpeshta, ishin kontaktet e shpeshta. Mund t’them që mjaftonin ato por osht’, domethanë si ni e dhanë që Rugova s’e ka praktiku telefonin, domethanë...

Kaltrina Krasniqi: T’a boj edhe ni pyetje të vogël këtu se në vitin 1990 n’princip kosovartë kanë qenë të izolium. Çka keni bo për dokumentacion? Pasaporta? Viza? Osht’ me randsi me ditë qysh...

Adnan Merovci: Po tash viti, bash viti ‘90 për mos me thanë edhe viti ‘91 deri në ‘92 regjimi i vizave nuk u konë pasë apliku ende në pasaportat ish-jugosllave dhe atëherë u jipshin pasaportat ish-jugosllave dhe kanë qenë, domethanë pasaporta goxha të respektum n’kuptim të lirisë të lëvizjes. Por ndalojshin n’kufi siç e kuptojshin sepse ishte qytetarë me ni pasaportë t’ardhun prej ni regjioni ku po bohet luftë, e ku po do me u bo luftë. Po flasim për vitin ‘90- ‘91- ‘92 dikun.

Dhe kjo ka hecë, ka mjaftu fjala vjen ni arsyetim, ni justifikim n'kufi, domethanë nuk t'ka pengue ajo kompania me hypë se s'ka pasë regjim t'vizave. Problemin e ke pasë kur ke shku në shtetin, kontrollë policore ka ndodhë që i kanë kthy. Ne gjithëherë, unë për këtë kom pasë kujdes domethanë, ne prej Tirane tani po flas. Në këtë kohë ka qenë edhe aplikimi i vizave, por ndonjëherë kur kem pasë rast kem pasë si ftesën me veti që ka mjaftu ose qaty për qaty domethanën në... une e kom justifiku udhëtimin. Ndoshta kemi pasë ndonjë vizitë dikund mas disa ditëve dikund tjetër, jo n'shtetin ku po aterojmë por une i kom shpjegue arsyet logjistike që po kalojmë nëpër këtë shtet dhe kështu ka mbetë.

Përndryshe, Rugova ka pasë pasportë të ish-Jugosllavisë dhe asni tjetër kurrë hiç. Kom pasë telashe t'mëdha me të sepse i dulë afati i pasaportës dhe ishte problemi i vazhdimit t'tij. Pasaporta për Rugovën ishte si oksigjeni, domethanë pa pasaportë Rugova ka qenë sikur mos me qenë i gjallë sepse pasaporta ka qenë mjet për t'udhtu jashtë. Dhe kam shku në shërbimet serbe të pasaportës vetëm një herë dhe në sportel kam pytë, kom thanë, "A mund ta dorëzoj, kërkesën e pasaportës të Rugovës?"

Nuk kanë dashtë me ndi aty ni zyrtare ka thanë... bile keq që nuk e thirri policinë për me m'arrestu, se tha, "Çka je hy këtu me prit pa punë?" Kështu veç pse e përmenda Rugovën. Okej, u largova. Mandej fillova me lypë mënyra tjera edhe, si me thanë, u forcova dhe ia mësyva vet shefit të pasaportave. Thashë, ai njeri osht' edhe ai. Shkova, trokita n'derë. Tani, n'fillim askush s'më ka njoftë, por n'moment aty kanë lëvizë edhe shërbimet serbe të inteligjencës që edhe figurat tona që janë sillë ka Rugova na kanë njoftë. Edhe fati ka dashtë që kur kom trokitë, dera ka qenë çelë edhe jom hi une, jom hi kështu si...

Edhe si jom hy e kom mbyllë derën, mbet ai shefi po m'kqyrë. Ai m'njifte kush jom unë i thashë, kështu kështu kështu une jom filan fisteku tha, "Ty t'njohin gjithë". Thashë, "Une t'erdha pak pa paralajmërim, nuk je i obligum me m'pritë..." u mundova, domethanë pak kështu si, pak si me ni mirësjellje, "po e kom ni hall. A ka mundësi me ma pranë dokumentacionin e Rugovës për pasaportë?" Ai m'tha tha, "I ki dy alternativa. Ibrahim Rugova pa ardhë qitu me kamë t'veta nihere nuk bon. Zgjedh ti, a po don me ardhë kur të aplikon apo vjen kur t'vjen me marr?"

Edhe une fillova, tash kjo m'bike diqysh sikur a p'e don do bukë bajat qitash a do taze sot ni javë, m'bike... e une isha i untë shumë. Tash une kisha qef mos me shku Rugova aty po dojsha me e hjek atë punë prej rendit t'ditës. Me shku n'fillim thojsha ky m'thotë, "Jo, hajde edhe niherë", por me shku pa të kur shkojmë mandej intersona s'ma bon, thotë ja... dhe une vendosa me shkue n'fillim. Tani une vendosa, megjithatë Rugova vendoste për atë punë por une ia heca. T'u e njoftë natyrën e tij që ai kto far' popullizmat e kto, le t'themi, patriotizmat e pa nevojshme s'i ka pasë dhe ai s'ka qenë n'shpirt....

Revolucionalitet ka pasë karakteri i tij patriotik e intelektual, jo kështu popullist, sido që të jetë. Dhe i them, kryetar kështu kështu kështu, duhet me shku... Thashë, "Boll u mundova..." edhe ma lëshoi ni fjalë tha, "S'po punoni hiç edhe ju". Edhe kjo fjalë ka qenë që, domethanë osht' dashtë me gjetë

mënyra... për mos me thanë tani, prej kësaj distance kohore une vonë e kom kuptu çka m'ka thanë ai. Kështu që u duftë, a me hi me folë me ta? A me kilimavë? A me korruptu? A me bo?

Megjithatë tha, "Po une jom i gatshëm me ardhë". Jom shku prapë te ai i kom thanë, "Ka me ardhë Rugova... kështu kështu, veç a po ma jep fjalën e nderit që n'zyre s'ka me qenë askush?" Ajo ka qenë ni marrëveshje me to dhe e kom marr Rugovën dhe veç une e ai kemi shku edhe jemi hy n'zyre. Kur kom hy n'zyre me Rugovën, ka qenë vetëm ai shefi i pasaportave aty. E kom mbyllë derën prej mbrendshit, e kish pasë çelsin.

Edhe kanë ardhë tash njerëzit plot me e hap aty, se ai e ka lajmëru sigurimin shtetnor se m'ka kallxu, "Nuk muj..." tha, "me..." Sigurimi shtetnor për ato kohna, për regjimin serb thojke quhet, serbisht bile i kanë thanë *stariji brat*, vëllau i madh. Dhe vëllau i madh pytet për çdo gja ose njoftohet për çdo gja. Kështu që, shërbimet e kanë ditë që Rugova do t'shkojë dhe ata kanë ardhë kishe rasisht se dhe iu kanë friku asaj situatës, "S'muj me marr n'pytje Rugovën kur shkon për pasaportë, po me e pa, me bo naj sqenë pse kështu, jo pse s'po pret ky n'sportel" e qisi sene domethanë, po unë e mbylla derën.

Ata e kapi pak panika, atë shefin e pasaportave tha, "Pse e mbylle derën?" Thashë, "Po rrijmë qitu..." thashë, "te kryjmë qit' muhabet..." thashë, "qitu sa jem, okej?" "Okej!" Dhe atë që muj me thanë osht' që e mbushëm atë kartonin, se krejt ka qenë ni karton me nënshkru. Dhe po, une tash po e them m'u vërtetu kjo nashta edhe munet, ka mundësi, por le t'jetë në ndërgjegjën time a po e thom të vërtetën. Nuk e lash Rugovën me nënshkru, nënshkruva une n'vend t'tij dhe kta e pa drejtori i pasaportave dhe u bo kishe s'po na sheh, nuk e ka shkru qat' sen. Ai Rugova nuk e ka ditë që une po e boj trik qaty, ai ka mendu që une jom marr vesh me to qashtu, me qikaq përfundoi. Rugovën për krahi edhe në Shoqatë të Shkrimtarëve, bile qaty afër ka qenë.

Kaltrina Krasniqi: Në cilin vit qenë kjo?

Adnan Merovci: Kjo ka qenë dikun n'vitin, nëse nuk gaboj, '92 ose '93 saktë nuk p'e di, n'vitin '92 m'duket. Pse edhe po e ceku këtë? Sepse ishim në Tiranë dhe i them kryetarit, "Kryetar, po e marrim ka ni pasaportë të Shqipnisë qitu" se ai ish kategorik tha, "Jo, krejt bota e dijnë që une udhëtoj me pasaportë serbe. Nëse ma ndalon Serbia, ma ndalon! Une po luftoj për me e bo ni pasaportë të Kosovës". Dhe ka pasë filozofi t'preme dhe ka refuzu nënshtetësinë e Shqipnisë n'atë kohë, por jo edhe une.

I thashë, "Kryetar une nuk jom në politikë, une jom n'shërbime..." tha, "Ajo osht' punë për ty". Sot une e kom dekretin prej Sali Berishës në vitin '92 për nënshtetësi. Bile, bile edhe nënshtetësi familjare dhe e kom pasaportën e Shqipërisë me nënshtetësi. Ia kom pa hajrin Sali Berishës edhe Rugovës, po të zinjte e ullinit e kom hjek mandej për mungesë të atij pasaportit për zotin Rugova edhe masandej... se sido kudo për me marr viza, se u dufke me marr viza, nuk ish se ishte problem n'kuptimin me dhanë viza, por procedura. Dhe ku procedura... tash ti për... me pasaportë jugosllave u dufke në Beograd dhe

tash për Rugovën ata bojshin përjashtim se edhe në ambasadë, po e nxojmë, të Norvegjisë në Tiranë i qitshin po ishin procedura tjera.

Ta kisha të Shqipërisë e kisha mush me viza në Tiranë në ambasadë dhe ishte lehtësim, po Rugova ka qenë kokëfortë (qeshë) dhe nuk ka dashtë dhe ka pasë qëndrimin e vet t'fortë, "Jo nuk du nënshtetësi, nuk du pasaportë të Shqipërisë. Po luftoj për ni pasaportë dhe nënshtetësi të Kosovës". Kjo ka qenë moto e tina.

Kaltrina Krasniqi: T'kthehem tash, m'u dukë që osht' me randsi si informacion

Adnan Merovci: Po, qartë osht' me randsi.

Kaltrina Krasniqi: Mandej u kthytë...

Adnan Merovci: U kthym në shtëpi, pas bisedës me ambasadorin Hill me folë prej kësaj distance kohore, tani jemi relaksu pak. Une në moment e kom ndi nifarë ngazllimi t'brendshëm sepse i shpëtum asaj rrëmuje n'fillim dhe ni vendimit t'sheptë. E kuptumë, domethanë ishte ni thikë me dy teha në ni mënyrë, po thika shumë e mbrehtë edhe thojsha masi osht' thika qaq e mbrehtë dhimtë jonë pak ma t'vogla edhe me u pre me to krejt. E çka do të thotë thika e vrazhdë në këtë rast? Do t'thotë me shku pa dëshmitarë, domethanë pa sebeb.

Në qat' rrëmuje, në qat' sheptësi se dijnë ndonjëherë me ndodhë ngjarjet, le t'themi edhe t'rastit ato kurrë mandej nuk mujn me u vërtetu ndryshe, mbesin, po kurrë nuk i dihet si mund t'ndodhë. Edhe thojsha ndodhë ni vendim i ni nivelit t'ultë të policisë apo të shërbimeve, hajt te marrim Adnanin sonte nja dy netë mos te lojmë me flejt qitu, edhe për mu ka qenë vdekje. Vdekje për mu ka qenë ndamja me Rugovën, nëse m'kishin nda me Rugovën dhe une sigurisht kisha gjetë mënyra për mos me jetu, sepse s'kish pasë mo efekt në përgjithësi jeta.

Dhe kjo ka qenë edhe përcaktim dhe ni relaks që këtë punë e murr Millosheviqi n'dorë. Jeta jonë osht' n'durë t'tij, e tash me qenë ni qingj n'dorë t'kasapit edhe me shku te kasapi e ai s'po të pren ti fillon pak ngazllehesh edhe thu tash une p'e pres thikën kurdo që t'vjen. Tani, ambasadori, gazetarja gjermane që ish aty Renate Flottau, që e mbante ende shallin n'kokë se e kishte vu për m'u masku, sepse kishte policë aty gjithandej domethanë, edhe nëpër dhoma, edhe nëpër skuta.

Krejt shtëpia ka qenë e mbushun polici, e ushtarë, e jashtë vetura hajde de. Kemi folë me të dhe e kemi shpjegu krejt ngjarjen edhe komunikimin që u zhvillu me Millosheviqin, qashtu t'u shushullat, domethanë t'u bo shusha. Ajo natë nuk ka qenë e kandshme edhe pse vijshim prej takimit, sepse okej ni anë ishin bombardimet tani nuk osht' se ne bombardimet... tani se ndryshe ti gëzohesh kur je vetëm edhe ti rrin e din se po ndodhë ajo mrekulli, por kur t'je ti i arrestum edhe ni bombë atje irritim

osht' për kta që janë me ty, osht' pak ndjenjë e vështirë. T'u marr parasysh që ka pasë edhe fëmijë, e ka pasë që thashë ni fëmijë 8 mujsh ka qenë... dhe ndonjëherë ai gagatke.

Osht' interesant puna e fëmive, ndonjëherë qeshte me ata edhe polictë ndonjëherë edhe qante. Pastaj na kanë detyru me ra me fjetë n'tokë me u shtri, jemi shtri, kjo osht' nata e dytë, siç thotë populli, përdoret ni fjalë si sardina. Tamon kemi qenë t'paketum kështu edhe jo me zgjedh kush kue. Vetëm se Rugova ka qenë me ni divan, i shtrimë dhe gjithëherë une e kom lypë pozitën që me ia pa ftyrën edhe figurën e tij dhe ka qenë vështirë, domethanë ka qenë n'kushte... Dhe aty kemi shushuritë me Renatën, kemi folë çka, tek, qysh, çka na tha Millosi, çka i tham, çka ndodhi. Ka pasë edhe fjalë kur na jena... domethanë prej tyne, "A s'po fleni a? Fleni se na jem këtu, për me ju rujt juve". Ka pasë qisi farë fjalësh, sido që t'jetë.

Dhe kështu ka qenë, n'ditë e ardhshme mandej ka pasë do tendenca, jo do farë iniciativa, jo kishe edhe apet do takime me do tjerë, e do kurgjo hiç. Ajo që vlen me u theksu osht' me 5 prill takimi me ambasadorin Yuri Kotov, rus në Beograd. Ai ka qenë edhe ma herët në Prishtinë e ka taku Rugovën në takimin në Shoqatë të Shkrimtarëve para bombardimeve dhe e ka njoftë. Ardhja e tij me të tregu të drejtën mu personalisht m'ka gëzu se megjithatë po vjen ni aleat i serbëve t'cilët ne do t'i bijmë n'dy guj. Bile une edhe personalisht e njijsa, thashë u ardhë momenti që thojnë me iu shtre krejt veç me gjetë mënyra me u liru prej këtij ambienti. Erdh ai, e kish marr ni autobus me veti, serbë, me do gazetarë me improvizim dhe këtu ka qenë edhe përgaditja për Renatën për t'ikur dhe ka ndodhë kjo. Ajo ka bo ni ditar mandej rreth kësaj dhe...

Kaltrina Krasniqi: M'falni, qikjo osht' shumë interesant për shkak se Renata ka qenë aty ilegalisht. Qysh e ka, qysh ka përfundu në autobus të gazetarëve?

Adnan Merovci: Ajo, ne, ne ni natë përpara e kuptum që po vjen Kotov dhe na thanë do t'vijnë edhe gazetartë, do t'ketë konferencë si për shtyp, si deklaratë të përbashkët. Ishin kta gazetartë t'pregaditun, domethanë ni grup prej gazetarëve bile, bile disa i kom njoftë se gazetartë që e kanë kry këtë punë dhe për show up. Domethanë, krejt ka qenë veç sa me tregu gjaja se qe Rugova qe po shkon, po vazhdon nifarë vizite, nifarë s'osht' i arrestum, ka jetë në Kosovë, Kosova e pavarun.

Dhe frika e Renatës me ndejtë sepse thojke zyrja jem në Beograd e çon peshë krejt diplomacinë, "Ku osht' Renata", dhe rriten shërbimet dhe rritën dhe me u kuptu se ajo osht' këtu osht' rrezik për të mandej. Në anën tjetër une kur kesh në Beograd e realizova ni bisedë telefonike, me 1 prill se kjo ka mujt me m'shpët, në zyren e Renatës në Beograd ajo ma dha numrin... numrin edhe e kom pasë se i kom ditë n'atë kohë numrat t'gjithë po kom thirrë edhe kom thanë, "Renata osht' mirë në Prishtinë" dhe kjo e ka qetësu pak Renatën me 1 [prill] sepse ajo dojke me u çmend ajo dojke edhe demonstrativisht me dalë se thojke, "Ma mirë osht' sepse..." por ne mendojshim ndryshe sepse tash ishte nifarë gjendje pak e pa thanun n'heshtje.

Knej une u frikojsha që m'thojnë, "Pse ti s'ke tregu që e ki ni gjermane këtu", në anën tjetër thojsha, "Ata qysh kanë me e justifiku ekzistencën e ni gjermaneje te eprorët e vet" dhe këtu, dhe këtu osht' tash ni rrezik shumë i madh. O ia hjekim krytë ksaj që t'mos dihet, e marrin e arrestojnë edhe arrestimi i saj e likuidimi i saj osht' ni, përkatësisht edhe likuidim i najnjanit prej neve ose dyve. Kto mendtë e kanë ni t'mirë edhe ni t'keqe që udhëtojnë e lëvizin pa viza ka t'dojnë, kërkond s'ki nevojë me e pytë.

Dhe n'këtë rast u morëm vesh që... edhe me Rugovën e bisedum kta në shpejtësi qaty që në konferencë dhe kur ka gazetarë Renata me u përvindhë, domethanë me u përvindhë me gazetarë edhe mandej ajo, ajo le te gjenë. Ajo nuk e kishte atë problem domethanë, sepse e provume nëpër lufta, nëpër... ajo nuk... problemi ish gati ma shumë me neve që, mos dil gjithqysh, ki kujdes, ruju e tjera. Kështu edhe ndodhi, une e kom pasë rolin kryesor n'kta sepse une me Rugovën ishim që dilshim në takim, ku tash me ardhë edhe ni grue po vjen me neve.

Se n'vëndin ku rrijmë tash ne niherë hypëm lartë n'dhomë ku u takum mandej zbritëm poshtë me ni kishe si konferencë dhe ajo u përvindhë. Me përvindhje ajo tanaj ka ditë se edhe e mëçme ka qenë edhe u rujt pak prej do... se problemi ishte po e njohin gazetartë edhe po i thojnë, "Ka dole ti këtu?" A p'e din. Po ajo çka ka bo? Ajo veç që osht' përvindhë pak edhe nuk ka nejtë në konferencë, por ka dalë poshtë. Tash kur ka dalë poshtë, aty ka pasë njerëz, policë, autobus, e m'the... po ata s'e kanë ditë tash se ata s'i kanë regjistru, kanë mendu që dulë ni gazetares. A po del se kjo edhe e ka pasë lëvizë me ni aparat n'dorë. Po kjo për ma tepër nuk ka hypë në autobus, por u lshu Velanisë teposhtë ngadalë.

Në fillim askush s'i ka folë ka ecë disa hapa dikush i ka thanë, "Prite autobusin", ka thanë, "Jo, po shkoj n'kamë", edhe kjo ka shku në Grand, se në Grand e ka pasë kerrin, dikund në parkingje të Grandit sakt. Po kur ka shku në Grand, tash ajo ka mendu se edhe atë kurajon prej gazetares edhe nifarë trimnie profesionale, ajo s'ka ditë çka ka ndodhë që katrahurë n'tona antë, çdo lëvizje, çdo njeri shihet edhe... dhe e kanë dikt shërbimet që o shku në Grand disa edhe e kanë njoftë edhe e kanë ndalue. Kur e kanë ndalue, ata tash s'kanë ditë kush osht' ajo a kah po vjen a, ata e kanë kuptu që osht' Renata. Domethanë se osht' prezantu po kah edhe e kanë marr në pyetje do të sigurimit edhe kjo ka tregu drejt.

E mandej ata kanë tregu dhe këtu ka fillu ai tash, tash, tash ato kalkulimet m'i tregu atij bosit t'madh, jo mos t'i tregojmë se na e hjek krytë dikush duhet me pagu gjendje lufte gabimet e tilla... qysh ju keni hy? E ka pa ni sy i hujë, ni gjermane krejt çka ka ndodhë. Na p'e rrejmë botën, po i thojmë kështu, kështu e andej e këndej e ju nuk e keni... domethanë, këtu ka qenë rreziku. Për këtë arsye na i kem thanë Renatës, "Mos shkruj, derisa të lirohemi se shkrimi yt i irriton kta edhe po na ndodhë diçka".

Çka ka ndodhë mas disa ditësh, Renata e ka bo ditarin e vet, ka shkru aty ia di për nderë se rolin tim pak e ka minimizu sepse edhe sot ditari osht', sepse qysh m'ka thanë që, nifarë tipi i interkomunikimit kom qenë une me ta, jo Rugova. Rugova ka qenë *principal*, kryesori krejt, por komunikimet ata me mu i kanë bo. Ka pasë raste kur kanë dashtë edhe drejt me Rugovën, po une jom mundu qashtu me... edhe

si me thanë, ai target për me punu me Rugovën edhe mos t'thom me manipulu, po me qenë ma t'lehtë me Rugovën ka qenë menjanimi jem.

Ka mjaftu veç me m'kapë për krahi me thanë, "Hajde n'kerr ti, rri n'kushte ma t'mira" dhe kjo ka qenë tragjedia që une e kom... po s'ka ndodhë për fat. Mandej kanë ardhë me demantu këtë çashtjen e ditarit ni ekip televiziv, Rugova nuk ka dashtë me folë. Kanë pranë me folë une edhe une kom folë e kom dhanë ni intervistë. Ajo intervistë ekziston sot edhe qajo intervistë ka qenë objekt i shqyrtimit në gjyqin e Hagës dhe mendoj që e ka lu, e ka lu rolin e vet?

Kaltrina Krasniqi: Kush iu ka intervistë?

Adnan Merovci: Ni gazetar shqiptar, Fatmir Sheholli i cili ka ardhë. Ai ka punu me ni radio lokale këtu ka marr urdhna prej pushtetit që me shku Rugovën me intervistë, "Qe pytet ku i ki", kur ka ardhë Rugova nuk ka dalë edhe kemi komunikë. Une Fatmirin nuk e kom njoftë, si emen po, po se kom njoftë personalisht. Iu kom thanë mandej disa tjerëve jo ktij, ky ka nejtë poshtë atje te salla, disa tjerëve iu kom thanë që, "Rugova s'po mundet me dalë edhe nuk ka çka me thanë, so i interesun me dalë në publik. Nëse ju doni diçka si konfrimim ose ndonjë deklaratë për këtë çka duhet sqaroj qitu jom une, nëse ju pranoni une jom i gatshëm".

Se une vendosa me Rugovën tha, "Adnan, t'lafshin ty asi mos prito dil fol vet. Ti lem mu". Ata e pranun kta edhe zbrita une poshtë, kur e pashë ni gazetarë me kamerë, kamera ishte. Dhe po m'drejtohet shqip tha, "Une jom Fatmir Sheholli" si emër e kisha ni, kurrë n'jetë s'e kom pa edhe ai shqip m'u ka drejtu. Ka qenë ni ambient i randë, salla ka qenë me katër-pesë njerëz civil me kallashnikovë, e me uzi, me automatikë. Bile shpesh herë ndëgjohen se intervista ekziston, ajo lëvizja e armëve, nifarë presioni ashtu për çka? Në mënyrë që prononcimi jem me qenë pak në favor të serbëve.

Mesin e pyetjeve kanë qenë çashtja e bombardimeve, kush po i shkakton bombardimet, që ta kena alibi, domethanë kush p'e shkakton lëvizjen e njerëzve, shpërnguljen, a janë ato bombardimet e NATO-s? Mandej edhe për ditarin e Renatës, ni fjalë kështu *by the way* se s'dojshin edhe shumë ata me e prek atë punë se e dishin që n'faj janë vet se s'e kanë zbulu. Ajo intervistë osht' sot, unë ndihna goxha mirë. Tash s'du të flas për to, le t'flasin tjetër edhe eventualisht kush e ka pa, se ajo u bo veç publike në do raste edhe në Hagë osht' bo publike.

Por atë që unë muj ta them tash që e kom ndëgju edhe që e ka thanë publikisht osht' ky Fatmir Sheholli që sot osht' aktiv edhe në jetën, le t'themi, këtë pak të karakterit organizativ ka ni institut për hulumtime të marrëdhanieve ndëretnike, osht' nifarë publicisti del shpesh në televizion, ka punu domethanë, ka qenë... sot kontribon zhvillimit të shtetit të Kosovës, demokracisë edhe osht' ni njeri goxha i devotshëm për këtë punë edhe i afërt me qarqet shqiptare udhëheqëse këtu te na.

Ky me ni rast ka thanë për mu meqenëse e ka thanë une po e citoj n'këtë rast s'osht' edhe shumë shumë... se osht' jo modeste po thotë, "Nuk lindë nana njeri n'rrethana të tilla n'pytje t'tilla me dhanë përgjegje çfare ka dhanë Adnani" okej, tash...

Kaltrina Krasniqi: Qysh e keni njoftë ju? Kur po thuni e kom njoftë si emer, qysh?

Adnan Merovci: Fatmiri ka qenë ni familje edhe... se ky ka punu në shërbime deri në vitin mos gabofsha deri në vitin '92 ose '93 ma s'shumti, ka punu n'sigurim shtetnor, n'sigurim shtetnor ka punu edhe ky na ka njoftë neve dhe emri i tij osht' njoftë në publik. Mandej ka pasë paraqitje edhe televizive, por une s'e kom njoftë, s'e kom, veç osht' ditë që osht' nifarë Fatmir Sheholli se shqitpartë kanë qenë t'rrallë. Nuk kanë qenë edhe t'rrallë që kanë punu në shërbim sekret po, domethanë kanë qenë njerëz për atë kohë për shumicën si të papranum, si njerëz që... por nëse flasim tash për Fatmirin une s'du t'i bohem avokat atij, por definitivisht ai osht' ni njeri që ka kontribu edhe në ato rrethana të atëhershit, ka punu sepse koha tash i qet gjanat.

Ai edhe sot e jep kontributin e vet në këtë punë dhe ai edhe vet m'ka thanë edhe kemi bisedu masnej mas lufte, po flas që ai ka qenë i detyrum dhe i ka marr pyetjet, nuk ka pasë të drejtë me bo pyetje. Por këta ia ka thanë dikujt tjetër këtë vlerësimin për mu, po ma ka thanë edhe mu mandej. Bile mu ma ka thanë pak ma tërthortë, "Kisha pasë qef me i pa do komandanta t'sotshëm në qato rrethana qysh kishin..." e mandej i kom thanë, "Mos më qit' edhe mu prej grupit të komandatave se edhe unë i kom do merita" "Çfarë merita ki?" Po thashë, "Jom major i ushtrisë të Shqipnisë", thashë "po jom kanë komandant që kom nejt me Rugovën" "Jo, po s'jom shumë patriot se s'kom qenë n'burg". Tha, "Jo more, je kanë n'burg", edhe ma qiti n'mend.

Thashë, "Po jom konë shkurt n'burg, dikun rreth ni muj po puna e burgut..." thashë. Me Rugovën e pata fol në vitin '95 thojsha, "Kryetar jom bo kajl, jom bo po pajtohna me hi n'burg veç le t'besojnë shqiptartë që edhe Rugova ka patrioti bre që nëse t'merr Serbia n'burg te kje patriot". Po ajo edhe ka ndodhë në fakt, në vitin '95 dikund ka shtator-tetor që fillimisht ka qenë pretekst kthimi prej jashtit. Në rrobat edhe ato koferat, krejt ato valigjet i kem lanë në Shkup kur jemi kthy me Rugovën me kerre në Shkup që janë ardhë me na marrë shërbimet që i kom udhëheq. Une ne jemi kthy krejt bagazhet në kerre kanë qenë zbrazt gjithë.

Pjesa e Shtatë

Adnan Merovci: Une kto bagazhe gjithëhere i kom orgniazu të nesërmen ose edhe qat' natë po i kom çu shoktë tjerë, anonimusa, që i kanë marr kto farë koferat tonë dhe i kanë pru. I kanë sjellë me gjasë që policia n'kufi mos t'i ndaloj dhe mos t'i kontrollojë, se kofera të Rugovës edhe të shoqëruesve t'tij. Kështu kom vepru. Çka ka ndodhë me ni rast, kam çu ni mik timin, i cili ka shku me bashkëshorten e vet, ai ka shku dhe i ka marr koferat, ai e ka ditë atë punë se s'ka qenë hera e parë. Fati ka deshtë, në

kufi ia kanë çelë dhe kur e ka çelë ni kapak ka ra ni fotografi dhe ka qenë fotografia e Rugovës. Kjo ka ndodhë që ata e kanë arrestu atë natë, domethanë për ni fotografi edhe grunë e tij. I kanë malltretu edhe fizikisht dhe une t'u i pritë koferat dhe t'u u vonu ai e mora vesh që ata e kanë arrestu atë natë.

Okej e kanë mbajhtë ni ditë a dy dhe e kanë lirue. Por ajo ka qenë pretekst që kishe do materiale aty edhe m'kanë marr nesër mu n'pytje, sepse të nesërmen unë u sillsha shumë ka policia. Dhe ata niherë i kanë ndalë n'kufi i kanë mbajhtë atë natë edhe une dola nëpër... rrugës për kufi me pa mos po vijnë edhe ata m'kanë vrejtë që po iu shkoj mas edhe m'nalën. Kështu në kuptimin, "Pse po na përcjell neve?" A din, thashë, "P'e përcjell shokun tem". Okej, ai ke ni arrestim me shkas. Policinë ti s'ki të drejtë fort me përcjellë edhe pse ata ishin policë civil të shërbimit sekret, sigurimit. Edhe m'murren mu, m'ndalun edhe thanë, "Nesër me ardhë n'kaq ora n'zyre".

Kaltrina Krasniqi: Në bisedë informative?

Adnan Merovci: N'bisedë informative. Edhe shkova n'bisedë informative veç sendet çka i kom pasë edhe njo pesë-gjashtë filma që i kom pasë kanë zhvillu dhe fotografi. Llaf e muhabet, "Kush osht' qiky? çka osht' qiky?" Dhe aty une kom këndu si bilbili domethanë, absolutisht. Bile njëni masandej, se tash kto janë gjana që janë fol e përfol masandej, i kish pasë thanë që, "Njeri me i mbajt në mend emnat e mos me na gënij për çashtje teknike çka janë, nuk kem pasë në polici kurrë".

Pse? M'kanë pa me Azem Hajdarin, "Kush osht' ky?" "Azem Hajdari" "Çka osht' ky?" "Kryetar i Komisionit për Siguri" "Çka e ki kta n'dorë?" "Radio lidhje" "Po qysh radio lidhje? S'guxon me pasë" "Po në ni shtet tjetër nuk osht' armë, unë kom pasë edhe armë." "Qysh ke pasë armë?" "Armë kom pasë në Shqipni, në territor të Shqipnisë e kom..." Domethanë, e kësaj natyre ka qenë biseda. Nuk më kanë ngucë, s'kom pasë malltretime fizike e tash psirike do farë *trick questions* [pytje provokative] kanë qenë, po m'kanë liru. Me kaq ka përfundu kishe.

M'kanë thanë me u paraqit edhe niherë tjetër, me ni termin tjetër edhe mandej si duket e kanë hap ni rast edhe ni dosje, "Ti ke dashtë... ti e ke ble ni armë në vitin '92..." tri vjet përpara, "edhe për këtë ngarkohesh, n'gjyq dhe je i arrestum". Edhe domethanë, m'i ngjitën prangat se në bisedë informative pranga s'ngjesin, por kur e merr urdhnin që ti... prokurori që arreston t'i ngjet prangat. Fjala vjen, veç sa me t'kallxu që t'burgosa edhe t'çon n'burg. Mas dy-tre sahat t'marrin apet sigurimi shtetnor, t'blun qaty do netë derisa të del në seancë gjyqësore.

Edhe mandej t'merr dhe... nuk kom pasë momente t'kandshme, fizikisht s'jom malltretu, psikikisht jo fort. A m'besoni që veç ni, ni pikë i kom pasë mendtë, "A kom mo vend une te Rugova?" Sepse gjithëherë kom thanë, unë nuk bon me bo veprime që hi n'burg, je shqiptar edhe për që je shqiptar hin n'burg po, por unë nuk duhet me hi n'burg. E tash, shtrojsha pytjen, çka osht' rasti? Se krejt konflikti me ta ka qenë... se ata thojshin, "Ne t'marrim n'pyetje, hetuesi jemi tash na, na s'jem sigurim

shtetnor...” Edhe pse t’sigurimit shtetnor ishin, “Na jem n’hetuesi, gjyqi na ka përcaktu me t’marr n’pyetje ty për qita”.

I pata thanë une mandej, “Qitmani armën te shoh, qitmini paret që i kom dhanë edhe njerit që ia kom dhanë...” para tri vjete, “as s’e keni armën, as s’e keni njerin për armë”. Në fakt, në esencë tash nëse e zbërthejmë si rast nuk osht’ që s’kanë pasë ata t’drejtë pak. Ka qenë nifarë këmbimi me armë, por jo me pare, po ajo armë ka qenë e dedikume, domethanë e kom pasë ni ekip ilegalisht edhe armë tjera. Bile me atë armë edhe dy tjera ka qenë, ai i sigurum në kohën e zgjedhjeve që kemi folë ma herët në vitin ‘92 që i kom pasë njerëzit e caktum.

Kanë qenë armë, domethanë heklera, që janë do automatik t’vogël gjerman që janë shumë t’përshtatshëm për mbrojtje, vetëmbrojtje edhe sulme, le t’themi, nëpër rrugë, se tash kto fjalë s’shkojnë shumë sidomos për temat edhe për... që lidhën për, për kto çashtje. Dhe m’kanë mbajtur dikund rreth, ma pak se ni muj. Po m’ka gjyku i pari, e ai gjyqi i parë që t’bohet tani m’ka çu në Lipjan. Me t’thanë t’vërtetën kom pushu pak do ditë edhe jom knaqë me ata tjetër t’burgosun, po m’ka ardhë keq.... Rasti ma i vështirë ishte kur t’vjen lajmi që lirohesh ti edhe i lenë shoktë aty, ajo ka qenë tragjike për ata shokë që i kom lanë.

Kaltrina Krasniqi: Tash po kthehem prap (qeshë) te 1999, mas kësaj, këtij takimit me ambasadorin rus, ju në përgjithësi e keni pasë kërkesën me iu leju me dalë prej Kosovës...

Adnan Merovci: Po, në çdo rast, edhe ambasadorit rus domethanë, këtë takim masi që dul Renata shkoi dhe biseda u zhvillu, dulën gazetartë mandej. Kryetari i tha ambasadorit rus që, “Na po kërkojmë edhe n’takim me...” që i binte me thonë para katër-pesë ditëve me Millosheviqin “kemi kërku dhe po presim përgjegje ende s’po na jep përgjegje”. Dhe shkurt e luti rusin i tha që, “T’kisha lutë që t’bojsh edhe ti presionin e nevojshëm se jemi me fëmi këtu edhe ma s’kom jetë une, këtu s’kom bashkëpunëtor, nuk po zhvillohet këtu ni aktivitet kurgjo”.

Ai shprehi goxha keqardhje, ambasadori rus osht’ ndi shumë keq në atë takim. U ndi pak si bashkëfajtor se u dike që osht’ artifice çdo gja, osht’ nifarë improvizimi kishe nifarë takimi kurgjo hiç. Dhe shkoi ai ne pritëm prapë... Mandej n’krejt këtë katrahurë osht’ kyç nënkryetari i ish Jugosllavisë Nikola Sainović kanë qenë edhe me Ratko Marković kanë ardhë niherë edhe presidentin sërëb Milutinović osht’ organizu ni takim tjetër mandej me Milutinović. Mandej, ai ka ardhë prapë në Kosovë. Edhe, domethanë ka qenë situatë pa situatë, domethanë ka qenë situatë e randë sido që të jetë.

Rugova ka qëndru, por njerëzit, ajo... vetë fakti që u dike që ne jemi të burgosun ishte dekurajues për njerëzit në Kosovë. Edhe dikush që ka pasë kurajo pak dikund me u mshef, e me u rue, kjo ka ndiku negativisht. Bile kjo intervista që e thashë une, pak njerëzit i ka ngjallë se e kanë pa që jemi gjallë, e po flas une pak ka qenë nifarë elementi inkurajues. Por me kohën mandej ata patën improvizu, jo ne me i bo do farë organesh, hajde për me u kthy njerëzit, qisi farë pollavrash prej presioneve të

bombardimeve. Rugova asnjëherë në historinë e vet nuk e ka kërku ndaljen e bombardimeve, osht' ni keqkuptim e keqinterpretim e çkado... kur thuhet keqkuptim thuhet, osht' thanë por osht' keqkuptu.

Jo, jo, s'ka thanë Ibrahim Rugova kurrë me u ndalë bombardimet për asni çast hiç. Nëse ti e merr ni deklaratë për shtyp dhe ku shkrun, le t'themi, edhe n'rrethana të presionit po e nënshkrujshe dikund t'u e heq fjalën Metohi edhe thue që, favorizohet zgjedhja paqësore edhe bombat kanë ra për shkak t'paqes për me u arrit paqja. Kështu që, çka ka aty? Por, kërkoj ndaljen e bombardimeve dhe të fillojë procesi paqësor a qisi pollavra, Ibrahim Rugova i gjallë me shpirt nuk e ka thanë. Dhe këtë le që e thom me përgjegjësi, po e thom, e thom me vetë, me qenie, sepse në asni sekond, në asni sekond, domethanë sa osht' ni sekond Ibrahim Rugova nuk ka qenë jashta syve t'mi, edhe kur ka fjetë najherë bile une çutë e kom kqyrë me sy. E le mo që ai paska folë dikund e une s'e pasna ni.

Kështu që, osht' keqfolë kjo punë, e jo... bile kjo osht' përcjellë edhe deri jashtë se masandej kur kanë, kur ka ndodhë lirimi edhe jemi liru kem dalë jashtë, pyetja e parë u kanë, "A ke kërku..." dhe ky ka kërku sqarim. Pse? Këta e ka bo prapaganda mediale serbe. Ata, për shembull, në takimin me Milutinović në Prishtinë ekziston sot AP-ja e ka në video material, ku del Milutinović thotë, "Jemi pajtue bashkarisht që të ndalen bombardimet". Dhe aty në sfond ndodhet Rugova, Sainović, une... duket aty, janë pamjet që duken sot. Dhe qe kështu e kështu, flet diçka kur te merr fjalën Rugova, Rugova flet ndryshe e qysh flet le t'shihet në fotografi. Në asni moment s'thotë që kem kërku, jo pajtohem për ndalje të bombardimeve.

I thotë do fjalë, ni doktor i fjalëve që boll thjeshtë i ka thonë, po kurrë s'i mbaj në mend pa i ngue, si t'i ngoj i kuptoj. Sepse kjo osht' edhe ajo refleksi edhe aftësia dhe zhdërvjelltësia e Rugovës që në moment ta krijoj edhe ndërroj, e ta imponoj, e kompozoj ni frazë të kuptueshme ku në asni mënyrë s'lenë as me nënkuptu bile këtë gja. Dhe kjo për çashtje të mbrojtjes të figurës të Rugovës në sensin që me ia pasë thanë ai ish korit, se bash bash edhe me pasë thanë tash nuk ish kanë kumeditë, në rrethana çfare ka qenë. Se fundi i fundit aty osht' zhvillu jeta për luftë, për vdekje ose jetë.

Na e kem zgjedh... Rugova, na e kam zgjedh jetën, por me ftyrë. Dhe këtu ka qenë, domethanë Rugova ka qenë definitivisht peng i regjimit serb, goxha shpesh m'ka ra n'mend me ra në këtë bashkëbisedim, me përdor fjalën, jomodesti por prapë po e thom, unë kam qenë peng i Rugovës. Përndryshe, në rrethana tjera kisha vepru ndryshe. Jo vepru në kuptimin që Rugova m'ka detyru me veprue keq ose... por sigurisht se kam qenë ma temperament, kam qenë ma agresiv, sigurisht, sigurisht m'kishin vra.

Kaltrina Krasniqi: Shumë interesant që arritëm deri këtu. Komenti kryesor i cili osht', edhe vet e mbaj në mend, komenti kryesor në raport me ... ka qenë pse Rugova nuk po e vret vetën, nëse e ki ni qasi detyre, ia ke dhanë vetës ni qasi t'drejte domethanë, mbrojtjen e integritetit, t'qatij popullit që e ke udhëheqë për dhjetë vjet ke ardhë me ni pozitë kur je i izoluar... ai nivel i përgjegjësisë, çka ka qenë, nuk jom e sigurtë se edhe ju jeni ballafaqu shpesh me diçka t'tillë.

Adnan Merovci: Fillimisht, a mujm me kuptu me tri fjalë edhe me zbërthi figurën e Rugovës, ne po flasim për Rugovën. Në atë moment Rugova ka qenë koka, shpirti, gjaku, trupi, mendja edhe ai ka qenë njeri si t'gjithë ne, por ni njeri me disa tipare ose t'veçanta. Rugova ka qenë dijetar, i urtë, ni filozof dhe në rrethana t'tilla ndryshe reagon ai, ndryshe reagoj unë. Unë isha vra me ta, isha rre me ta edhe kisha thanë, "P'e boj për heroizëm a s'di a..." Rugova u kanë ndryshe. Rugova s'qet gjyks me thanë, "Vramni, jo s'e boj qita. Jo une e boj qita".

Edhe me kërkuj prej Rugovës osht' jo njerëzore, nuk osht' njeri i gjyksit. Rugova njeri i fjalës edhe i mendjes, edhe idesë. Adnani njeri i muskujve. Për qata une kam qenë peng i tij, e u duftë me shukatë, kurrë s'kisha shukatë, une isha dalë automatikut me gjyks pesë pare s'i kisha dhanë edhe jo për naj trimni, jo për naj... po shkurt shqip si detyrë, se po flasim për vitin '99 kur une ma nuk e kom dashtë Rugovën qysh e kom dashtë n'fillim, nuk e kom pasë atë ndjesinë qysh e kom pasë, por e kom pasë përcaktimin. Unë jom kanë i pjekun me Rugovën n'atë kohë edhe dhanja e jetës për ni situatë t'tillë ku osht' Rugova m'u kish dokë pesë pare.

Problemi osht' që une ata e kisha bo edhe muj, kom mujtë me bo, por nuk, nuk... jom kanë peng i dikujt dhe une s'kom pasë lidhje me regjimin serb në atë moment, n'kuptimin psikologjik po flas. Une jom kanë me Rugovën, për mu m'ka interesu jeta e Rugovës. Fati ka deshtë që s'më kanë shti laknave, lakna tash... veç kom thanë kokën nuk e ruj, ftyrën e ruj dhe sot ballë hapun flas... se ftyra shpesh herë ndeshet me kokë, por shumë ma e shtrenjtë edhe ma e vlefshme osht' ftyra se koka.

Dhe une kom pa këso momente, kur e kom pa ata që atij *vërr* {onomotope} nuk i bon syni për jetë dhe me çiltërsinë dhe urtësinë ma t'madhe, momentin e vështirë kur, qe po na ndajnë neve, po na vrainë në oborr e fëmija e tij po e shohin vrasjen e tij, ai po e nxjerr paqeten me cigare po ia jep ushtarit ni cigare, ai po i thotë, "Jo s'e du". Ni moment tjetër, ni tjetër p'e hap ni kanaqe të Coca Colës edhe tash kur po flas ajo frika e Teutës si fëmi që ishte aty sepse iu duk si armë që shkrep. Dhe n'qito rrethana Ibrahim Rugova *vërr* {onomotope} s'i ka bo syni, domethanë në aspektin njerëzor.

Ku tash prej qatij njeri me lypë me bo vetëvrasje, *what for* [Për çka?] Tjetër, te aspekti i vetëvrasjes për fjala vjen, për mos t'u ballafaqu me qito sene tash po hyj në aspektin tjetër edhe p'e lidhi ma shumë te une. Edhe për me u vra edhe bash me pasë dashtë, qysh m'u vra? Nuk mundet njeri me u vra me, me Budën edhe t'u meditu, m'i mshel sytë edhe me thanë po vdes. Duhet me pasë ni gozhdë, e gozhdë s'ke mujt me pasë, nuk t'kanë lanë se ata e kanë ditë që... ata t'kanë trajtu si të arrestum, por s'të kanë thanë gojarisht se a kom mujtë... une s'kom mujtë me dalë me shku në WC, fmitë s'kanë mujtë me shku në WC pa leje.

Rugovën s'e kanë lanë në WC me hy vetëm, "Jo, hyn edhe ti". A e kuptoni? Domethanë, ai nëse don me t'vra edhe vendosë me t'vra, të vret në formën tjetër, por nuk t'lejon veprime jashta konturave t'veta dhe kjo osht'. Dhe e fundit, e fundit nuk e ka vlerësuar as Rugova, as une i ndodhun me to, as familja tjetër që ne jemi në ni sprovë për me humb. Edhe pse, edhe pse rrugës në Beograd, siç edhe e kom

përsëritë i tham që... kom thanë edhe në prononcim, në radio të ndryshme në telefon që, “Populli shqiptar nuk osht’ në vetëdije t’tillë që me hudh ni president për ni takim të dhunshëm”. *Come on!* Nuk mundën senet me u rrënu deri n’atë...

Mandej tjetra, a e thojmë tjetrën tash? Ku metën njerztë, ku janë njerztë, ku janë dy milion shqiptarë 15 ditë për Rugovën? Hajt s’po e shtrojmë kështu se s’ka kuptim, se Rugova mu nuk m’ka mësu, as nuk m’ka udhëzu, as nuk m’ka leju me organizu une garë të armatosun. Dhe ne e kem dhanë ni fat rrugës të Rugovës. Ai në ditët e para m’ka thanë, “Adnan je i lirë me shku edhe ti në Shkup si t’gjithë. Ki familje edhe dhjetë vjet ke nejt me mu. Je i lirë”. I kom thanë, “Jo, dhimbjet e mia janë shumë ma t’mëdha me shku në Shkup me nejt i lirë e ti këtu, se sa une me nda fatin me ty. Po duhesh me m’pranu me ardhë këtu me familje”. Dhe m’ka pranu, dhe m’ka pranu. Une qaty i kom pasë venet, e hapsinat, e zyret e me vite, po ku duhet ni dhomë me ndejtë me të.

Kaltrina Krasniqi: E mandej qysh ndodhi qiky momenti kur, faktikisht çka e bindi Serbinë me iu leju me shku në Itali?

Adnan Merovci: Okej. Tani Millosheviqi fillimisht ka dashtë Rugovën me e shfrytëzu, për *show up* qe une me Rugovën, Rambujea, s’u bo, u bo, qe na tash po bojmë diçka kishe. Dhe e ka pa që zbrazët, s’ka asgja. Domethanë, prej këtuhit fjala vjen edhe prej ambasadorit Kotov e ka kuptu që Rugova po lypë veç me dalë jashtë, s’ka këtu kurgjo hiç. Ai e ka ni djalë ngat vetit Adnan Merovcin, kërkond tjetër hiç. Tash u patën mundu ata me i gjetë do njerëz, e jo osht’ ky këtu, e jo Ilaz Kurteshi, Abdyl Rama, jo Blerim Shalën n’kufi t’shkretin e kanë ndalë e kanë thirrë me telefon, “Çka po thotë Rugova, a p’e kthejm lirinë në Prishtinë?” se si kishe bashkëpunëtor, e si kishe Rambuje tha. Rugova thotë, “Jo more, lëshone njerin...” domethanë s’ka çka asi... Edhe fati ka dashtë që ka pasë fat se edhe ai kish përfundu si Agani edhe Blerimi.

Fati e ka shpëtë Blerim Shalën edhe momenti domethanë se jo edhe veç fjala e Rugovës që ka thanë, “Osht’ vendim i tij e s’ka çka me u kthy e krejt”. Se edhe në një moment ma ka përshkru Blerimi këtë rast shumë afër dhe si rezultat i këtij presioni tash edhe t’jashtëm. Se tash ka fillue pak edhe mërgata edhe qarqet e jashtme edhe ka thirrë ambasada italiane që ish aktive në Beograd, na ka thirrë n’telefon ambasadori Seca. Edhe këtu zani ma kumbus që na ka ardhë osht’ i ni zyrtarit të Vatikanit, ni njeri i njohur për Kosovën, Monsignor Vincenzo Paglia, i cili ka qenë në komunitetin St. Egidio i njoftun me marrëveshje të arsimit, i cili m’ka thirrë. Tash m’ka thirrë, po e personalizoj pak se n’telefon kom folë veç une. Niherë ka folë me Chris Hillin, kryetari edhe Chrisi me shqipe t’vet edhe ajo ka zgjatë ni minut. Kurrë ma Rugova s’ka folë n’telefon me askënd.

Dhe m’thurret Monsignori, thotë, “Adnan mos keni merak se po bojmë çmos për lirim e ju”. Me Chris Hill-in domethanë, n’biseda une çdo herë n’telefon i kom thanë... dhe osht’ ni situatë që s’bon me u kapërcy pa u përmend. Në takimin me Milutinović në Prishtinë, ai dojke me çdo kusht me e inicu, kishe po bojmë diçka, kishe do organe diçka, kishe me i kthy njerztë, “Hajde t’i bojmë bashkë, qe ju andej.

Hajde t'i bojmë do organe të përkohshme, veç t'hojmë kishe po bojmë diçka edhe për çashtje humanitare. Mandej lypim me u nalë bombardimet, e paqja këtu. E fillojmë mandej çashtjen e marrëveshjeve, e statuseve, e qityne seneve". Qito kanë qenë.

Dhe Rugova ka qenë kategorik, "S'kom njerëz këtu. Adnani m'ka qëllu qëtu, s'ka këtu jetë politike. Ju lutem me na liru, e me na asi..." ata e qitën idenë me shku Adnani, me shku Rugova, jo me shku Adnani. Me shku Adnani në Shkup edhe me i thirrë bashkëpunëtortë e Rugovës me ardhë. Kjo ka qenë rasti ma i palogjikshëm që mundet me ekzistë edhe kom reagu une kështu n'mënyrën ma brutale, banale, "Çfarë t'shkumi, qysh shkoj une në Shkup? Une nisna në Shkup edhe ma s'muj kthethna, qysh, çka osht' kjo punë?" Meniherë e pash vetën në tendencë me m'shkëputë prej tij. E kanë pa që s'jom i dobishëm, që po hahna me ta edhe po shtyhna. Te lojmë kta, e me Rugovën qishtu poshtë e naltë enem na. Ka qenë, domethanë kjo ka qenë ajo vdekja që e kom pa me sytë e mi, vdekje psikologjike le t'themi domethanë, shpirtnore krejt.

Domethanë, insistimi për me shku në Shkup mandej u manifestu për ni rrëmuje në qat' natë n'mramje ku inskenojshin, domethanë sulme thu se po na sulmon dikush në shtëpi ku jem në pikë t'natës. Rrymë s'kish dhe i patën qit' do bllefa, t'u thanë, "Po iu sulmon UÇK-ja, dojnë me vra Rugovën" edhe çka bojshin, 17, 18, 20 anëtarë sa, hajde me ni dhomë dy me tri. Nuk kish domethanë situatë ma t'randë. E kom përshkru pak këtë send, që me qenë domethanë me gra t'huja me ni dhomë njo mi njo me qenë, osht' tmerri i tmerreve edhe unë t'u u kujdes me Rugovën, t'u u kujdes mos po vrahët ai a, *my God* [Zoti im], do situata t'randa.

Okej, kaloi rreziku naltë n'dhomë, por meniherë veç kur dilshin në terasë edhe qitshin me automatik, nuk ka presion ma i madh se automatiku me u qit n'terasë natën edhe kur ka pak qetësi që nuk osht' kjo zhurma e natyrës, e kerreve, e njerëzve përpos bombave t'natës. Kërset ai thi shumë keq edhe fmija edhe krejt ato i bojshin kur kërkojshin diçka e na refuzojshim, ja e prolongojshim. Brenda e kanë pasë si stil të komunikimit, domethanë nihere kanë zgjatë derisa na kanë bo me dije derisa ma iu kom thanë, "Bollni bre ma, na e prut shpirtin qitu {tregon me duar} se i keni krejt improvizime për me shku në Shkup", a e kuptoni domethanë.

Dhe kjo u kanë sene që janë ndi mandej dhe Rugova m'tha, "Adnan, a po shkon amani t'koftë sa s'na kanë tranu qita fmi?" Thashë, "Unë kryetar me fjalë tane shkoj, veç ni gja dije, që çdo lëvizje e jem prej qisaj shpije ni hap nuk osht' garancë e kthimit tim. Dhe une nuk e kom problemin me ty personalisht, me vetvete, çka boj une nëse m'çojnë në Bllacë kta m'lojnë anej edhe une s'muj hi në Kosovë. Çka ndodhë me mu? Ku kesh une? Çka bona deri tash? Qysh lahma une? Edhe në aspektin, edhe në publik po edhe vetvetes çka i thom? Çka ndodhi me mu?" "Definitivisht..." tha, "Adnan po t'kuptoj".

Kaloi ni natë, jo në Shkup po n'kamë me u nisë në Beograd... tash në kto rrethana, prej kësaj distance kohore kur po e mendoj ata domethanë po m'kap tmerri, po m'kap tmerri çfarë situata kanë qenë. A din, veç thojsha, kur t'i marrin fmitë edhe thojnë shtynu qiknej, qitni në teracë e t'qesin plumba ngat

qaty m'i shashtrisë hala, a din. Edhe e pashë me ni moment... edhe gruja e kryetarit ndonjëherë u konsultojshim me ata se në rrethana t'tilla ti si n'burg flet. Edhe po m'thotë, "Pse s'po shkon bre Adnan? Shko..." a din, thashë, "O une shkoj, nuk ka problem. As s'po lypj urdhën prej Rugovës se s'kom nevojë une kur duhet edhe mendoj edhe shkoj s'e obligoj as ate me thanë m'ka urdhnu Rugova. Problemi osht' që s'ka prej kësaj kurgjo e nashta ma bojnë si *trick*".

Bile diqysh thojsha ma mirë le t'më dajnë qitu zhagasi me asi se bash qashtu. Domethanë, kjo tash kjo s'ka t'ndalun si përjetim, po shkurt-shqip vendosa me shku n'kerr, kom thirrë në telefon ambasadorin edhe i kom thanë, po vjen ambasadorin Hill kjo osht' domethanë ni çashtje që komunikimi me Amerikën ka qenë i çdo gjaje. Ka dashtë me ma qit kerrin n'kufi i kom thanë, "Jo, se i kom thirrë do shokë në Shkup", janë ardhë me marr, prej atyhit jom shku ku e kom pasë grunë edhe fëminë tash. Se grunë edhe fëminë m'i kanë lirue prej... kom mbetë vetëm aty e kom bo rrëfimin ma herët dhe kom shku në qat' shpinë ku i kom grunë edhe fëminë dhe i kom pa grunë e fëminë edhe 50 anëtarë tjerë.

Ajo osht' shtëpia e Nush Shekerliut, ni vend ku kemi nejt niherë në Shkup. Prej atuhit t'nesërmen e kom thirrë ambasadorin Hill, t'nesërmen kom shkue te ambasadori Hill katër orë kom nejtë edhe zoni i tij ka qenë, ka qitë kafe, ne kemi fol katër orë kështu për të gjitha gjanat. Dhe veç ni citat po e nxjerri këtu, ia kom shpjegu krejt çka ka ndodhë me neve, qysh po ndodhë, tek po ndodhë. Ai m'ka tregu, m'ka thanë që, "Krejt i kemi t'kjtë edhe po bojmë presion në forma të ndryshme te Millosheviqi me iu liru". Edhe une i thom, "Çashtja e Rusisë", ai thotë, "S'ka problem Rusia". Nifarë mënyre bombë atomike me gju veç munet me bo protestë, a din veç me protestu ashtu. Që jepke me kuptu që kto janë sene që, që kanë marr rrjedhen e tyre edhe...

Jom taku edhe me disa eksponentë të LDK-së e do... ata e kanë ditë pak a shumë misionin, se une pata dalë meniherë në intervistë aty, po askujt unë nuk i kom thanë që jom ardhë, a m'ka çu Rugova me ardhë me iu thirrë, veç iu kom tregu që jom ardhë për me e lanë t'qetë qat' familje edhe me iu pa juve edhe me u kthy. Asni njeri nuk ka që mund t'thotë u ardhë Adnani m'ka thanë m'ka çu Ibrahim Rugova hajde kthenu. Misioni ose ajo që e ka pregadit regjimi ka qenë kjo, që t'flas me njerëz edhe t'ju thom "Hajdeni!"

Nuk ka njeri i gjallë... tre, katër njerëz dhe fillun ata kapak me ikë prej takimeve, dikur apet... se une pata nejt disa ditë, ato dy-tri ditë derisa i takova... dhe nuk ka pasë shtëpi televizive vendore, ndërkombëtare, gazetë që nuk iu kom dhanë intervistë. Domethanë, gati jom kanë nifarë ylli mediatik, medial qatëherë shumë i kërkom CNN, e BBC e hajde. Sepse ishte ni njeri i vetëm që po del prej Kosovës në qatë kohë, se tash mo Bllaca e krejt ishin thatë, se ishin deportu, ai deportimi krejt tash, ishin kohnat e bombardimeve të ashpëra...

Kaltrina Krasniqi: Ni pyetje zotni Merovci, iu kanë intervistë t'gjithë. Çka guxojshnit me kallxu?

Adnan Merovci: Une atë çka kom folë, kom folë dhe që janë dokumentat rreth kësaj, kom folë gjendja qysh osht' në Kosovë, që osht' ni mister që Prishtina s'përngjanë në qytet që ka qenë, që njerëzit po deportohen, që ka ekspedita të policisë. Domethanë, une me agresivitet nuk kom folë, por kom folë me qetësi dhe urtësi por 101 përqind kundër regjimit. E kom ditë që iu shkojnë n'vesh, e kanë njerëz, e ka mujt me pasë njerëz që dikush iu ka përcjellë po osht' çashtje që dy durë për m'i kry edhe s'ki çka ti aty.

S'muj me dalë para kamerës të CNN-it edhe me belbu aty, *bël bël bël* {onomotope} çka me bo, çka me thanë, na jem mirë atje edhe... "Jo, na jem në *house arrest* [eng - arrest shtëpiak]" edhe aty e kom pasë qit' i pari fjalën, "Na jem në *house arrest*" publikisht kom thanë. *House arrest* i pa thanun, domethanë i nënkuptum edhe i kom tregu situatat, "Çka ke ardhë? Pse misioni yt? Çka ke ardhë?" "Une jom detyru me ardhë..." kom thanë, gjaja se me bashkëpunëtorë po nuk ka asni iniciativë rreth kësaj, "Une shkurt e shqip jom ardhë me kry ni detyrim të insistum prej tyne, sa me shpëtu na gjallë. Une do t'kthehna..." dhe këtu ka qenë domethanë ajo situata që qysh do me u kthy, kah me u kthy, çka me bo.

Kom marr n'telefon n'shpi u lajmëru baxhanaku i Rugovës dhe ai aty m'ka thanë, "Adnan, qitash po ta besoj," qitash i ka rreh telefoni orë e çast e veç ai u marr, "Tash po ta besoj edhe mungesa jote". Thashë, "Une nesër po vi, thuju atyne le t'dalin, ata tarzanat le t'më presin në kufi qysh më kanë qit". E kom mledhë vetën, kom pasë shumë presione prej njerëzve, prej shokve edhe prej... që mos me u kthy hiç, "Osht' kohë lufte pse po kthehesh? Familjen e ki këtu, kurgjo mo s'ndihmon ti, nuk t'lojnë me hi, t'lojnë, t'vrasin pse s'po rrin, je dëshmitar i gjallë..." ka qenë diçka e pa... *my God* [Oh Zot]. Kur kom shku me shumë...

Kaltrina Krasniqi: Veç pak...

Adnan Merovci: Po.

Kaltrina Krasniqi: Çka po pritet në liri me thanë, mas bombardimeve ka qenë e vetmja shansë për juve me tregu çka po ndodhë, luftën veç para mediave sigurisht edhe bashkëpunëtorë tjerë edhe përmes informacionit...

Adnan Merovci: Po, po, po.

Kaltrina Krasniqi: A ka pasë edhe ndonjë mënyrë tjetër qysh e keni dokumentu rrëfimin e ju?

Adnan Merovci: Po në telefon une kom folë, i kom dhanë Detsche Welles, Europës së Lirë, RFI-së i kom dhanë ka dy herë intervista me telefon prej Prishtine dhe aty une kom tregu për... fjalori jem ka qenë i, me nënkuptim për qata e ndërprejshin telefonin...

Kaltrina Krasniqi: Po mendoj, e kuptova këtë, çka po mendoj osht' e keni pasë të vetmen shansë që me rujt informata të sakta pa censurë, a po m'kuptoni?

Adnan Merovci: Qartë, po e vërtetë osht' qajo ka qenë.

Kaltrina Krasniqi: A keni gjetë, a iu ka punu truni qashtu në qat' moment? A po m'kuptoni çka po du me thanë?

Adnan Merovci: Po, po, po.

Kaltrina Krasniqi: A iu ka punu truni qashtu n'qat' moment sa, qysh me rujt informatën, me shkru a... qysh me komuniku pa censurë [rreth asaj] çka osht' t'u ndodhë pernime?

Adnan Merovci: Jo, une e kom thanë pa censurë edhe pa kurrfarë bllokade. Senin e parë e kom dhanë intervistën në ni gazetë "Fakt" që osht' edhe sot, e kom në fijokë qaty n'zyre, ku them edhe titulli osht', "Rugova ndodhet kambë-kryq në Prishtinë, aty ku i ka rrënjët" dhe e kom spjegue krejt *tak, e tak, e tak, e tak* {onomotope} gjendjen qysh osht' pa kurrfarë censure e frike as hiç. Se janë kanë... une e kom ndi që na po afrohem i te fundi: o te lirimi e te shpëtimi, o te vdekja. Dhe s'ke pasë ma ti aty çka me manipulu.

Në fillim jemi rujt shumë, jom rujt edhe une, ka fundi dikur na e patëm marr nifarë, me t'thanë nifarë ferdolluku jo negativ, që bile, bile t'flasim e t'i thojmë sendet. Dhe kjo ka ndodhë edhe n'atë rast. Në televizione lokale, e kom taku Ministrin e Brendshëm të Maqedonisë. E ka kuptu ai që jom aty, m'ka thirrë n'takim, ia kom tregu gjendjen e çka po di unë... dhe televizionet e huja, e kom taku ambasadorin Walker, e kom takue këtë Petritsch, Wolfgang Petritsch, Eichinger, ambasadorin në Francë. Krejt kta janë njerëz që aktiv kanë qenë në Rambuje dhe une mas disa ditëve po takohna me ta krejt në rrethana tjera. Kom shku, m'kanë çu miqtë e mi deri në kufi, m'ka prit vetura. Jom hi në veturë me njerëz që s'i kom njoftë...

Kaltrina Krasniqi: Çfarë veture ka qenë?

Adnan Merovci: Vektra e zezë, kurrë s'e harroj hiç. Ni vektër e zezë dhe këtu fillon ni dramë e vogël.

Kaltrina Krasniqi: Sa njerëz kanë qenë?

Adnan Merovci: Tre edhe une i katërti, dy përpara. Drama fillon në udhëkryqin në Ferizaj-Prishtinë, jo aty te ura e Vitisë po ai tjetri ku vetura e policisë, ajo ishte e policisë e jona, në fakt policë civil ishin, bon ndeshje me ni veturë të policisë që shkrujke "Policia" në udhëkryq. Edhe në anën e derës time, n'derë domethanë, tash s'muj i thom që m'ka lëndu po dera m'ka prekë. Tash une ndash edhe thom m'ka lëndu, po jo me m'lëndu se lëndimi osht' tjetër.

Edhe janë ndalë dy veturat, dy orë ka zgjatë qajo katrahurë edhe qaty ka qenë drama, qaty e kom vra vetën, qaty m'kanë vra, qaty jom çu, qaty kom folë me Zotin, pse e thashë? Kta me gjithë analizat që i kanë bo, kanë përfundu që Adnani osht' negativ, s'ka prej tij kurgjo, s'po e çojmë kta te Rugova ma, e bom ni ndjeshje, në ndeshje humbi jetën tragjikisht zotni Merovci dhe kjo m'u ka sillë n'kokë dhe kom thanë, "Mu Zoti m'tha para do ditëve tjetër diçka, sot s'po i majka fjaltë Zoti", kështu kom thanë.

Jo Zoti i mbanë fjaltë, dhe kjo ka qenë kurajoja ime dhe kom qëndru edhe kom nejtë. Kurrë s'di me spjegu pse! Veç ni sen iu kom thanë, "Gjendja e luftës osht' dy kerre të policisë po bojnë ndeshje, ju po pritni..." që thojshin, "Po presim procedurat për me ardhë hetuesia me e bo landë këtë send". Domethanë, qitu mendoj që ka qenë nifarë komunikimi i tyne çka e qysh e tek. Zoti u kanë me mu, ti n'kerr edhe veç jena nisë. Nuk kom besu që po m'çojnë kta edhe aty edhe frika ma e madhe tash, që s'më çojnë tash në, kanë, kanë provu...

Se veç thash, qitash si te shoh ni kerr të ndihmës t'shejtë une e di që marova, qato e pritsha, veç thashë tash kur t'bon *viu viu viu* {onomotope} kishe diçka veç sa me bo, me improvizue, nashta me xhirue me bo që nesër, masnesër me thanë, në ndeshjen kështu kështu kështu... ni injeksion ta jepin edhe hajt, a çka dush, a qysh dush a s'osht' me randsi. Dhe kur jena shku thashë, "Eh e paskan ndrru mënyrën". Tash, gjithëherë ajo frika edhe mënyra edhe osht' e randë, a din, tash në formë tjetër e paskan bo, tash jo mo ndeshje po kumeditë çka e tek.

Megjithatë, Zoti dashti e pashë vetën në Velani edhe kur m'ka pa kryetari, veç m'tha, "O hajde Adnan. A erdhe a?" Fjaltë e tina, kishe që a mujte me ardhë a. Ai ka qenë njeri i tillë s'ka tash hajde mirë se erdhe, a bravo t'koftë, s'ka ni fjalë edhe ia kom pa nifarë kureshtje meniherë, edhe familja, gruja e tij, Fana e Uka si i ri e qashtu t'u m'i hapë sytë, çka ka? Tash edhe për ata ishte interesant. Edhe une me spirozitet, me humor, me... se e kom pasë atë ves gjithë me to edhe në situata të randa, domethanë gjithëherë me kriju atmosferë.

Thashë, "U ktheva kryetar kështu nëpër Serbi..." qisi fjalë unë gjithë në këto situata me Serbi e Beograd, qysh ishin. Senin e parë m'ka pytë, "Qysh osht' Afërdita?" Zoja jem, sepse Afërditën e ka dashtë shumë për arsye se ne kemi shku, kemi majtë komunikime karakterit urues për Vitin e Ri, gjithëhere e kom marr nusën me veti edhe kemi shku ia kem bo, "Për hajër Viti i Ri, kryetar. N'vjet niherë qikjo gru po vjen po t'sheh, boll qikaq".

Edhe tjetra ka qenë në kohën kur na kanë hy policia edhe ushtria na kanë zbritë poshtë, bashkëshortja ime i ka thanë kryetarit, "Mos u mërzit se na jemi këtu" e thanun prej ni femre domethanë, t'ka dhanë kurajo ni femën. Une veç e kom kqyrë që, çka po m'trimnohesh ti këtu, por i ka burue. Kur ni femën ta thotë ni fjalë t'tillë dihet që ti je i mbrojtun edhe prej Zotit. Femna osht' shumë e fortë, osht' shumë trimneshë. Pra, "Mos ki merak se na jemi këtu", domethanë, na nuk lejojmë. Femna me vendosë diçka *it's done* [u kry] edhe te Zoti edhe te robi.

Edhe e ka pasë nifarë simpatie edhe për to, “Qysh osht’ Afërdita? Qysh janë fmija?” Mandej këtu, se me retrospektivë s’po du me e lidhë, por kom pasë niherë ni debat rreth çashtjes së ashensorit, siç thashë une në ashensorë kur kem lëvizë me kryetarin nuk e kom lanë me hypë në ashensorë dhe me ni rast, krejt rastësisht t’u folë osht’ çelë ky muhabet edhe i ka thanë Afërdita grusë të kryetarit, “Ky as neve s’na len me fëmi me hyp bashkë në lift...” edhe këtë gjithëherë une e kom pa si rezultat i asaj që megjithatë lift osht’, nuk ka shpirt.

Edhe vet t’u kanë nifarë inxhinieri i elektros, e t’u ditë qysh punon lifti, qysh i ka ata frenat e sajllat gjithëherë thojsha këtu munet me na ndodhë... edhe iu kom tutë diverzionit. Domethanë, seni ma i rrezikshëm që munet me ndodhë në kuptim të organizimit naj atentati osht’ lifti edhe në mënyrën ma t’qetë edhe t’urtë. Se mundet ajo sajllja me u kputë kadalë, e me t’lshu kadalë, ni njeri me punu aty, naltë ose poshtë, se lifti i ka dy pozita ku mundet me punu edhe nuk kom leju, domethanë në lift Ibrahim Rugova kurrë me lëvizë.

Edhe në Lakrishtë, po u lidha tash te rasti kho kur u ktheva prej Shkupit që, që masandej të nesërmen erdhën sërëbtë, Sainović e Marković, do qisi që vishin e u enshin e rreth çashtjes së Shkupit, “Çka ka tre? Çka thanën?” Thashë, “E dini ju ma mirë se une. S’ka kurgjo as kërkush s’don me ardhë as nuk besojshin kurgjo...” Thashë, “Po qe ni letër ta ka çu Chris Hill” dhe Chris Hill osht’ sot gjallë, une kta po e thom publikisht në...

Para se me shku Sainovici m’ka thanë, “Thuj Hillit nëse ka ndonjë porosi për mu le t’thotë ty” i kom thanë Chrisit. Chrisi e ka marr ni letër edhe e ka shkru me dorë edhe ma ka lexu qat’ letër edhe e ka shti në zarf edhe ma ka dhanë me ia dërgu. Vetës s’ia fali që s’e kom marr me fotokopju me e pasë sot ni kopje veç si dëshmi, por megjithatë përmbajtjen e di. Aty ka qenë... se Chris Hill edhe Sainović kanë bashkëpunu shumë në kohën e asaj Shuttle Diplomacy, kur u mendu nifarë dialogu me qenë. Dhe aty i thotë që, “I keni pesë kushtet e NATO-s. Plotësoni pesë kushtet e NATO-s edhe ndalen bombardimet”. Domethanë, letër e thjeshtë e shkru me, decidive. U konë çmend Sainović. Ia dhashë letrën edhe e pamë që edhe prej Shkupit s’ka kurgjo hiç.

Krejt mas pak ditëve ndodhi mandej na erdh lajmi që po lirohni edhe na kanë thanë vetë, “Po lirohni me shku” a din, edhe tonaj pak si, “*Vi ste oslobođeni, idite gde ste želeli!*” [Ju jeni të lirë, shkoni ku të doni!]. Kështu na kanë thanë. Dhe une bile, s’më ka mungu refleksi edhe në atë moment me thanë, “Vendi ju e ka ni president që e ka emrin Slobodan, e *slobodan* domethanë...” thashë, “liri...” e thashë, “mirë që po e pranoni që po lirohemi që do të thotë s’kemi qenë të lirë”. “*A uvek ti nalaziš neke argumente* [Ah, ti gjithë po i gjen do argumente]. Ky ka qenë komunikimi, se pak u... na erdh pak langu vesh edhe na mandej pak që thojnë këtë gjuhën pak të rockut, u frajerizatshëm pak. Une sidomos, se Rugova i njejt ai, ai ni sokrat, ni filozof qaty i ndejtun në përjetime t’veta, mendimtar.

Kaltrina Krasniqi: Dhe mandej?

Adnan Merovci: Dhe mandej kemi shku në Beograd prej Beogradit me aeroplan italian...

Kaltrina Krasniqi: Veç detalet zotni Merovci, se na i kemi të randsishme detalet. Qysh keni shku në Beograd? A keni shku me shofer? Me kerre? Me kombi?

Adnan Merovci: Jo, në Beograd kemi shkue... Millosheviqi ka dashtë me kapitalizue tash këtë send, ai e ka ditë çka do t'thotë lirimi i Rugovës dhe ky lajm dhe ka thirrë ka thanë, "E du Rugovën në Beograd me ia komuniku vet". Kemi shku une edhe Rugova me avion, me kerr me të njejtat kerre dhe kemi shku në villë edhe na ka thanë, domethanë tekstualisht, tekstualisht...

Kaltrina Krasniqi: Prapë në Bjeli Dvor?

Adnan Merovci: Jo, në një villë qeveritare, por jo në Bjeli Dvor. Në kuadër të villave saktë nuk e di, por atë që e di osht' se villën e Millosheviqit e kishin pasë bombardu goxha afër me qaty, kompleks i villave saktë jo në Bjeli Dvor. Bjeli Dvor osht' Pallati i Bardhë, ku ai edhe zyrën e ka pasë, se edhe ka ardhë edhe na ka thanë, i ka thanë kryetarit domethanë, diqysh si, si e çeli derën e hini ia nisi me folë, "Ju keni dashtë me dalë jashtë, jeni të lirë prej këtij momenti me shku ku t'doni edhe qysh t'doni. Kështu që, e keni të komunikume prej meje këtë send". U ulë njo pesë minuta qaty, une meniherë kom kcy kom thanë, "Familjen e kemi në Pirshtinë", "Ani..." ka thanë, "e gjeni mënyrën".

Dhe drama e dytë dhe finalja ka qenë lufta e Sainovicit për me e nda Rugovën edhe une me familje. Ai donte që mu edhe Rugovën me na qit' në ballon edhe me na çu në Europë, kurse familjen me e ndalë në Prishtinë. Kjo ka qenë triku pse edhe Rugova osht' thirrë atje, por duhna me thanë t'vërtetën jo i Millosheviqit. Këtë trik e ka bo Sainovici dhe kjo osht' metodë Leniniste, t'ia kapërcej shefit, t'boj une diçka e ti thom atij, "Kqyre une e kom bo kta edhe me shantazhu Rugovën jashtë". Rugova s'ka pasë nevojë me u shantazhu, as ma mirë as ma keq s'kish folë e s'kish vepru çka ka vepru.

Krejt familjen me pas pasë në Prishtinë njejtë kish vepru domethanë, sepse kanë gabue. Nuk osht' Rugova që bjen në ndikim të shantazheve, flitet për një njeri që s'ka... osht' i amputum prej atyne farë... edhe ai ka qenë njeri, familje e krejt, dhimbje e krejt, por definitivisht në aspektin politik ai... Dhe aty ka qenë beteja dhe lufta jem mandej, sepse une e kapa momentin, tash pa t'keq po une jom kanë njeriu aktiv që jom marrë me kto. Rugova ka qenë, i ka thanë dy fjalë ka nejt qaty, të koridoreve e të seneve kanë mujt me u bo sendet ndrysh. E kom vrejt tendencën e Sainovicit që po don me e bo këtë veprim edhe une aty kom shpërthy, për fat Millosheviqi kur u dalë ka thanë, "Nëse keni naj problem, qe villa këtu..." ku ishim ne, "i thirrë në telefon kta t'shërbimeve aty" edhe shkoi.

Metëm na, tash çka me bo? Na ishim në Beograd, erdh masditja mramja, a po kthehemi në Prishtinë? A po rrijna në Beograd? A po vjen familja sonte? Fluturimi ish të nesërmen. Edhe u konë pasë mendue ma herët në Cyrih me na çue. Neve na kanë thanë, "Po iu thret Millosheviqi edhe pregadituni po

shkoni në Cyrih”. Mirëpo, masandej osht’ ndrru në Romë ka qenë. Dhe këtu ka qenë ni betejë ose rundi i fundit i krejt kësaj finale, ku ne kem mujt me marr një *knockdown* [rrënie] që kurrë s’ishim rehabilitu. Ajo ka qenë ndarja e fundit dhe këtu ka qenë... Edhe nëse për asgja tjetër, për asgja tjetër, nashta Rugova e familja se ajo u kanë tjetërsi, por nëse dikush don najherë me ma çue ni fjalë miradie rreth vendimit tim me e nda fatin me Ibrahim Rugovën, krejt lavdatat e poenat le t’mi çon në rundin e fundit që kom arritë mos me e nda familjen.

Nuk e kom pasë lehtë, por fyta-fytas jom kap me Sainovicin edhe iu kom kërcënu midis Beogradit, se i kom thanë, “Nuk shkojmë na edhe e vraj vet Rugovën qitu në Beograd, une e vraj ata edhe nuk shkojmë ndamas”. Edhe ai u çmend krejt. Edhe çka kom bo une qashtu pak temperament, i nervozum i kom thanë atyne, “Thirrma Millosheviqin në telefon!” E kom thirrë në telefon edhe i kom thanë, “Çka osht’ me familjen tonë?” Kurgjo s’po din tha, “Familja me shku, po, po shkon, por ju vet keni kërkue me shku ju vet” “Jo...” Thashë, “S’kena kërkue, kjo osht’... “*Ne, vi idite*” [Jo, ju shkoni]. E aty, Sainović s’ma kish falë ma jetën t’ish mvarë prej tij sigurisht, por nuk u mvarë. Kjo, domethanë... veç pak, hajt se po shkojmë, po jo po qe s’po lojnë, e aty unë fyta-fytas jom kapë. Domethanë, goxha ndihna mirë që e kom bo qat veprim.

Fati u konë që e kom kuptu me kohë, se a din si, ditë t’vështira, t’randa, ti s’din thotë, “Qy, a po doni...” tash ish lufta çka me bo na? A me ndejt a me shku, m’u kthy? Thojsha njeriu që vendosë osht’ Millosheviqi, Millosheviqin mo s’e ki në Prishtinë, ti s’ki mo kontakt me to, t’lujn kta tjetër...

Kaltrina Krasniqi: Ku kishit nejtë?

Adnan Merovci: Si?

Kaltrina Krasniqi: Nëse kishit ndejtë?

Adnan Merovci: Na kemi ndejtë...

Kaltrina Krasniqi: Okej.

Adnan Merovci: Na kemi ndejtë, unë po du me të tregu qaty n’qat villë edhe ky ka qenë vendim i imi, vendim i imi. Ne me Rugovën kemi vendosë bashkë, por mos t’kisha dashtë unë nuk kishim nejtë. Por e kom vlerësu dhe kta e ngjehi si fitore, domethanë që ne po rrijmë sepse e kemi njeriun që vendosë edhe qiky vetvendosë qitu me neve, le t’na ndodhë neve çka t’na ndodhë në Beograd ose familjes në Prishtinë, por jo me na qit’ në rrugë. E me bo ky tjetër diçka, tjetër se ti kurrë nuk e din çka osht’ shërbimeve, ti kurrë s’e din edhe Millosheviqi çka munet me t’pregatit.

E nuk po thom une që une ia kom ndrru atij skemën atij, po tjerëve po, tjerëve po. Se bojnë skema edhe shtresa e dytë, niveli i dytë bojnë, a e kuptoni? Domethanë, bojnë se ata mujn me vepru ndryshe.

Të madhit s'guxojnë shumë me ia prishë e menojnë nifarë konstruksioni knej e anej ia prezantojnë atij. Dhe këtu, unë mendoj që e kom dhanë provimin edhe me ndihmën e Zotit kemi ndejtë atë natë aty. Të nesërmen e kom thirrë në Prishtinë i kom tregu Nexhatit, baxhanakut të Rugovës se ai ka qenë njeri me t'cilin kemi komuniku.

Domethanë, ne po rrijmë sonte, por nesër në ora 7:00 iu vjen, iu vjen vetura me iu marr. I kom thirrë në ora 6 e gjysë kanë thanë, "Adnan, s'po vijnë?" I kom thirrë në ora 15 në 7, "Jo s'jonë..." i kom thirrë në ora 7:15 m'u ka kyç faksi edhe e kom kuptu që ata janë nisë edhe n'fakt... se ka qenë faksi, nëse s'të lajmërohet n'telefon, s'osht' kërkush, s'u lajmëru. Edhe dikund kah ora 11:00, 10 e gjys a? Kanë mrrri krejt familja, jemi shku n'pistë në aeroplan edhe via Roma. Kjo ka qenë liria jonë edhe çlirimi në përgjithësi i krejt asaj drame, që nuk i besojsha vetit mandej, nuk i besojsha vetit. Ka qenë e randë, u kanë si situatë si gjendje e randë, goxha shumë e randë.

Aurela Kadriu: E familja ju?

Adnan Merovci: Familja jem ka qenë në Shkup atje, ne kemi shku në Romë mas disa ditëve une kom shku me aeroplan... me të njejtin aeroplan, se ai aeroplan na u la neve. Tonë kohën Ibrahim Rugova e ka pasë si taksi qat' aeroplan. Taksi ku unë i thojsha, "Jo shko knej, jo shko anej". Kurrë n'jetë...

Kaltrina Krasniqi: Aeroplan i Serbisë?

Adnan Merovci: Jo, aeroplani italian, i qeverisë italiane. Se e kanë gabu këtu njerëzit e kanë thanë, "Slloba e ka çu me aeroplan Rugovën". Jo, jo, qat' privilegj s'e ka pasë ai. E ka çu Italia, qeveria italiane, e ka çu Massimo D'Alema, kryeministri i cili para disa muajve ka qenë në Prishtinë dhe ka tregu si e liruam Rugovën. Janë materialet që ekzistojnë, video materialet edhe tash.

Kaltina Krasniqi: Për me vazhdu me Italinë, po më intereson... nëse...

Adnan Merovci: Po, po...

Kaltrina Krasniqi: Në vitet e '90-ta figura e Millosheviqit ka qenë figura ma e errët për shqiptarët, ju e keni pasë rastin me e taku intimisht edhe në momente shumë t'randë, disa herë...

Adnan Merovci: Po, disa herë. Herën e parë në vitin '92.

Kaltrina Krasniqi: Çfare ka qenë Millosheviqi? Ju jeni dikush që jeni marr me studimin e njerëzve se e keni mbrojtë ni njeri prej do njerëzve tjerë...

Adnan Merovci: Tani nëse vazhdoj me përjetim me ta thanë, atëherë më nxehet krytë, po po e thom meqenëse disi ka të boj kjo me dokumentaritet, por e ka pasë kokën e madhe edhe ballin e madh. Dhe

i ndodhun në takim në Beograd me 1 prill 1999, dikund rreth mesditës kur kom hy në takim si *deja vu* m'u ka kthye ngjarja e Adem Jasharit në Currel, ku kemi ushtruar me revolën të cilën e kom edhe sot dhe iu thashë pak a shumë. Me veti kom pasë në telefon, celular nuk ka qenë, por mobil. Se në atë kohë u bonën do mobila e ai u konë i telefonisë fikse, po mundësia me u shfrytëzuar në distancë dhe në Beograd edhe në Kosovë, domethanë në Serbi edhe në Kosovë se u kanë projekt i Serbisë. Dhe unë e kom pasë me veti, ajo ka qenë madhësi ma e madhe edhe ma e randë se në revole e vogël që ka mbetë. Dhe në kokë m'u ka sjell situata ku atje m'ka thanë Ademi, "Paramendo kokën e Millosheviqit edhe gjuj" edhe kom gju. Dhe unë e kisha kokën e tij përballë dhe e pashë që për në veprim t'tillë njeriu duhet t'lindë edhe pse s'kisha armë me veti po kisha pasë mujt me pasë armë. Shyqyr që s'e kom ditë që kom mujt me pasë armë, se sigurisht s'e kisha marr prapë.

[Rrëfimi vazhdon në pjesën në vijim]

Pjesa e Tetë

Adnan Merovci: Sigurisht, domethonë mirë që s'e kom ditë që muj me marrë se nuk e kisha marrë, sepse për me marrë po dufke me lindë i tillë, dhe aty e kom pa që unë s'jom ai, që muj me shkrep n'ballë t'tij. Që i bie, se sot kur e mendoj atë situatë nuk o çashtja e heroizmit a ku ta di unë, po një veprimi që kish, ndoshta rendin shoqëor në botë e kish ndërruar. Mos harroni se krejt bota ka qenë n'kamë, një veprim i tillë... dhe tash nëse ai ka qenë për mu një cak i imagjinatës tem n'atë moment po m'pysni ju, "Kush ka qenë, qysh ka qenë Millosheviqi?" Une po ta them me tri fjalë... Definitivisht, definitivisht ai ka qenë njeri, domethonë në formën e vet, me do dërrasa eksik, që i thojmë ne. Domethonë, ai ka pasë një pati, tash a ka qenë sociopat, a ka qenë psikopat, a ka qenë naj pat tjetër, nuk e di, një lloj po.

Fundi i fundit ti për tonë njerëzit mundesh me thonë që e ka një rrem... sepse ai ka dashtë me majtë pushtetin e vet edhe qatë grumbull popujsh me territor me forcë. As s'e ka kuptuar ai që atë forcë nuk e ka, këtu e mbështeti atë, një. E dyta, ai definitivisht në popullin serb ka me metë një heroj, sepse ai Kosovën nuk e ka dhonë me marrëveshje, ne mund të themi çka t'dojmë, nuk e ka nënshkruar Rambujen, ai ka nënshkruar një marrëveshje teknike për ndaljen e bombardimeve. Dhe rezultat i krejt qasaj sot jem ku jem, edhe në 2018, në dhjetor kur po flasim që i bje se Kosovën nuk e ka dorëzuar me marrëveshje, dhe e ka lonë një dritare t'hapur, "Me bomba ma keni marrë, me luftë kom m'u kthy". Nuk osht' shekulli i kaluar, gjërat ndryshe ecin tash, nuk është ai trend.

Por, megjithatë si vetëkuptim, si filozofi, edhe sot regjimi serb i rehabilitum, se osht' rehabilitu, ne duhet t'a pranojmë që osht' rehabilitu, se deri vonë serbët nuk u prezentojshin si serb prej turpit çka kanë bërë në Ballkan. Por u rehabilitun, dhe sot ata, ju e dini vet sjelljen e tyre. Kështu që, Millosheviqi për ta mbetet një hero. Ndaj Rugovës duhna me thanë që ka qenë korrekt, dhe nëse e kërkon, nuk kom nevojë me t'bindë, se ndash beso, ndash jo, po e kom ndoshta vështirë me justifikuar korrektësinë e tij,

what for [për çka], pse ai me qenë korrekt me Ibrahim Rugovën? Nuk ka tjetër spjegim, përpos inferioritetit. Këta njerëz të ndërtumë me kësi ndërtimi psiko-fizik, këta i kanë disa dobësi komplekse, ai kompleks e ka pasë diturinë edhe intelektualitin e Ibrahim Rugovës.

Kiro Gligoro osht' president maqedon i cili në takimet e fillim viteve '90-ta me Rugovën, që vazhdimisht ka kërku me u taku, i kish pas thonë Millosheviqit në ato kohnat e hershme, "Takoje Rugovën, se osht' një njeri prej t'cilit mundesh me mësu". "Gjashtë mujë", Kira tha, "nuk m'ka folë Millosheviqi". Për fillim. Dhe në opinon serb, Rugova ka qenë "*Serbožder*", thojnë, përbindësh, kanibal i serbëve, n'aspektin politik, se ky njeri po don pavarësi. Dhe me kohën kur e kanë pa, une s'po thom që edhe Millosheviqi s'e ka ditë kush o e çka osht', por kur u dorëzu... Se opinionet punojnë, pa marrë parasyshë. Atëhere, ky e ka pa që ka t'bëjë me një njeri t'urtë, të mençëm, intelektual dhe të butë. Po një njeri me një çifteli t'prisht, që veç një kangë e din, Kosova e pavarur dhe neutrale... me do pikanteri e melmesa të shtume.

Mos harroni që çashja e hapur ndaj Serbisë dhe Shqipnisë, Rugova në projektin e vet e ka shtu pak ma vonë. Dhe hapja e Kosovës si shtet i pavarur më Shqipni edhe Serbi sot po manifestohet. Osht' e njejta si në '93-tën kur e ka përmend rrugën Prizren-Lezhë, e njerztë thojshin, "U tranu kryetari". Ose kur ka kërku me hi Kosova në FIFA me Fadil Vokrrin e thojshin gjinja, "Kryetari po qet' muhalife" e tjera, e tjera gjana. Pra, definitivisht Millosheviqi osht' vështirë me u përshkru, por nuk ka qenë qaq kompleks sa, fjala vjen, me u lodhë. Shkurt e shqip, ai ka pasë diçka eksik. Në raport me Rugovën ai ka qenë inferior, domethanë e ka pasë... në takim nuk ka pasë burrshtetas që nuk ka sha. Mu nuk ma zë goja në këtë dokumentaritet, se ai ka thonë une veç e citoj, po as me citu s'muj çka ka thonë për Clinton, Schroeder, Chirac, për Madeleine Albright, për Tony Blair. Kur vinte te Rugova që e kishte njeriun që e kish sillë punën qaty e kishte ni inferioritet. Kjo është ni psikologji e thellë.

Pra, edhe ai si kasap i Ballkanit që e dike mirë që osht' kasap i Ballkanit rrike para një njeriut të cilit iu çu në kamë dhe i tha, "Qysh bre po m'thu NATO e... Rambujenë me pranue, kur Rambujeja ka parapa me m'hie tankset nëpër *srpskoj kolevci*" në djepin e Serbisë. Rugova veç e kqyrke qishtu edhe me atë stilin e vet kaniherë, edhe kur e kryjt ai në fund tha, "Srpska kolevka ali beba je albanska". Fëmiu është shqiptarë në atë... Që i bjen që edhe pse e din mirë ti që nuk osht' djep i Serbisë, qe po ta pranoj po çka osht' sot trendi, sot osht' beba. Pra, pak a shumë u mundova veç me ilustru se në bazë të ilustrimeve mundën njerëzit e dishëm edhe njerëzti e fushës me zbërthy figurën e Millosheviqit. Por nuk ka qenë qaq kompleks. Ai veprimet që i ka bo... vendimet, domethanë që e ka kallë Ballkanin dhe që osht' fajtori kryesor për vrasjen e mbi 300 mijë njerëzve. Definitivisht nuk ka qenë qaq kompleks. Si duket kjo osht' çashtje edhe e njerëzve. Tash une nuk po du me bo këtu konspiracione, por nëse e merr para këtij ka qenë Lufta e Dytë Botërore dhe Hitleri, fjala vjen. Edhe Hitlerin me dashtë me zbërthy nuk osht' kanë qaq kompleks figura e tij. Problem është me ia qëllu tri katër seneve për ata me zbërthy, i njejti osht' edhe Millosheviqi. Për qit' arsye osht' goxha vështirë, goxha vështirë.

Domethanë, ni njeri që i thotë Fehmi Aganit, “Kom pritë me fol me ty në ‘98-ën... e kështu”, e ia shkrin emrin në paqetë të cigarës edhe e vret mandej. Për shembull, nuk ia fali që i ka ndodhë çiftit tim, por edhe mikut tim, njeriut me shumë merita dhe kontribute Bajram Kelmendit. I cili me dy djemtë dhe çifti i Bajram Kelmendit mos me e ditë që jetën nuk e ka të falun prej Millosheviqit, por rrin në Prishtinë. Atij dritë e nur i qoftë shpirtit të tij sot. Por, megjithatë Bajrami ka qenë tjetër, Fehmi Agani ka qenë tjetër. Fjala vjen, Bajramit nuk ia ka falë jetën edhe ka dashtë edhe me rrojë, edhe djemtë edhe fëmijun 16 vjeç me ia ekzekutu, por çka i ka bo Fehmi Agani? Ni njeri që nuk ka kriju armiq kurrë, nuk ka pasë njeri ma i sjellshëm ndaj serbëve se Fehmi Agani, po ai tru i ka vy Kosovës, e qat’ tru s’ka dashtë me ia lanë Millosheviqi. Për këtë arsye... dhe qe ni ilustrim për Millosheviqin që osht’ goxha vështirë me interpretu edhe shpjegu.

Kaltrina Krasniqi: Mandej shkutë në Itali. Në cilën datë keni shku edhe kur ka përfundu, po mendoj në raport me... po du me ditë datën sa iu ka ra me pritë kur kanë përfundu bombardimet?

Adnan Merovci: 5 maj 1999 kemi ateru në Romë. Në Romë ose Europë kemi ndejtë jo deri më 12 qershor. Une mas do ditëve jom ardhë vetëm në Kosovë. Rugova ka vazhdu me ndejtë. Qershor- gusht u ardhë ni takim edhe u kthy apet, u ardhë apet e u kthy. Definitivisht u ardhë mas dy mujve, qershor, korrik, gusht. Në fund të gushtit dikund nëse nuk gaboj saktë se tash duhet pak me shoshitë mendjen edhe me dokumente me kqyrë saktë me data. Po kështu ka qenë.

Kur kem shku në Itali ka qenë, domethanë mysafirë të qeverisë italiane, jemi vendosë me ni objekt edhe me ni vend andërr që osht’ edhe për italianët, që italianët lindin e vdesin e s’hijnë aty, osht’ Villa Pamphili, osht’ ni villë mesjetare që është e jashtëzakonshme. Domethanë, edhe osht’ monument shumë atraktiv edhe për turista edhe për turizëm. Ekziston edhe sot. Me hi në Villën Pamphili me pa osht’ andërr. Aty kemi ndejtë, kemi pasë zyret në Via Veneto, në lagjen ma elitare në Itali afër Ambasadës Amerikane.

Kem pasë ni aeroplan, veç njo me veti. Nuk kish ma problem se me kanë në aeroplan vetëm. Ni pilot, ni kopilot edhe ni stjuardesë. E kisha problem, a t’rri qiknej, a qiknej se ekuilibri. Dhe qeveria italiane e ka vu në shërbim të familjes time. Kom shku e kom marrë familjen dhe jemi kthy në Romë dhe jemi bashkangjitë e kemi nejtë prapë, por tash jo më të burgosun. Dhe kemi... fmitë tash që jonë rritë i kujtojnë shpesh ato mendime, ato raste qysh kemi ndejtë.

Edhe aty ka qenë nifarë suate, edhe aty ke qenë nifarë kontrolli e siguri e krejt, por t’lirë për me lëvizë. Bile kemi pasë edhe situata kur dikush na ka thanë, “Ju edhe këtu gati si të arrestum në nifarë mënyre”. Por, në fakt ne kemi qenë... se bombardimet kanë vazhdu, por Rugova ka vazhdu aktivitetin. Ka taku Schreger, Joschka Ficher, Tony Blair, Cedomir Dinin, Madeleine Albright. Por ka pasë edhe vizita të Thaçit edhe Qosjes që kanë ardhë.

Ata kur e panë pak Rugovën që dulë jashtë, fiksonin me ia marrë primatin Rugovës si autoritet jashtë edhe ata fillun me i zhvillu, me u intensifiku në takime të ndryshme. Ka pasë takime të përbashkëta me Madeline Albright në Koln me kta tre. Pak si pasardhës të Rambujesë po edhe si lider që pritet. Po flasim për ni periudhë kur në Rambuje ish bo nifarë marrëveshje për ni qeveri të përkohshme e cila në mënyrë të mirëfilltë nuk osht' formu kurrë po filloi pak prej grupit tjetër.

Rugova nuk qe shumë bashkëpunues për atë qeveri, në fakt. Por, sido që të jetë ajo s'ka pengu, fjala vjen, që në takime edhe në... me qenë edhe bashkë, por jo edhe rrallë herë me qendrim të ndryshme. Domethanë, pikëpamje të ndryshme edhe në takime për çështjen e të ardhmës së Kosovës, jo në kuptim të statusit e krejt. Por, u sillshin puntë kryesisht te çashtja e trajtimit të realitetit edhe qysh e çka ma tutje.

Kaltrina Krasniqi: Kur u kthytë në Kosovë mandej?

Adnan Merovci: Une vet personalisht jom kthy dikund tri-katër ditë mas çlirimit, mas të 12-tit [qershor]. Jom ardhë vetëm dhe jom ardhë për me e pa shtëpinë e banesën time edhe me u mundu me i kriju kushtet për me u kthy Rugova, se normalisht s'kemi mujtë na meniherë me ardhë. Shtëpinë e patëm lanë në dorë të ushtrisë e policisë, [shtëpinë] të Rugovës. Banesa ime e katrahuraftë, e thyme, e vjedhne, e bome...

Artikulli ma i kërkuam që ka qenë atëherë mas bukës, ka qenë, kanë qenë kto çelsat edhe bravat e dyrve. S'kish me ble kërkuam. Goxha biznes ish bo me i pasë ble njo dy shlepera brava, sepse krejt t'thyme, t'vjedhme, t'bome... E kem organizu... kom shku në KFOR, mandej me KFOR-in e kemi pastru shtëpinë, e kem bo atë farë *clearance*, që osht' pastrimi prej... mos ka naj material eksplozues a diçka.

I kom caktu do njerëz, ka qenë kohë shumë e vështirë se njerëzit vishin, s'vishin. Kishin ndryshu realitetet. Për dikond Rugova ishte njeri që ka humbë edhe prej shumë njerëzve, por sido që të jetë krejt kësaj, si me thonë, i ka shërby fundi. Le të themi, fatmirë që edhe Rugova u kthy dhe fillun mandej qashtu. Pak me improvizime, UNMIK-u, KFOR-i, formimi i atij grupit tranzitor *transitional institutions*, Institucionet e Përkohshme të Kosovës, a diçka qishtu u kanë.

Ku u kanë Qosja, Rugova edhe Thaçi edhe secili e kanë pasë ka ni *aid* [ndihmës], afër ka ni *associate*, ka ni bashkëpunëtor. Rugova m'ka pasë mu, Thaçi e ka pasë nifarë Bilall Sherifi, kurse Qosja e ka pasë ni Ismije Beshiri edhe ni, prej Maqedonie ni shqiptarë e cila ka shërby. Edhe gjithëherë i mbaj në mend këta gjashtë njerëz kanë shku nëpër takime të ndryshme. Dhe protokollin, sigurinë, njerz të tjerë sepse kanë ndryshu gjanat. Korriku, gushti...

Kaltrina Krasniqi: Veç ni moment, kur thu kanë ndryshu gjanat, a i bjen kjo që bashkëpunëtorët e afërt që i keni pasë janë distancu prej Rugovës, apo veç thjeshtë kanë qenë nëpër shtete tjera...?

Adnan Merovci: Janë dy momente. I pari është që është i njëjtë me kohën e bombardimeve. Kur kanë fillu bombardimet, ka ra me thanë kështu në thojza “sistemi”. Secili i ka pa puntë e veta. Dy durë përmë krye, familjen edhe ma s’ka shërbime, s’ka Rugova, s’ka me shku n’punë, s’ka! Kqyre familjen tande! Kur janë kthi e njëjta gja. Shtëpitë, gajlet e veta, dikush me ambicie, dikush pa ambicie, dikush i zbehun, dikush me trauma, dikush me destabilitet ekonomik në sensin që s’rri ma me... LDK-ja ka dështue, kanë bo... edhe ksi sene ka pasë. Domethanë pak prej bashkëpunëtorëve janë kthi, disa s’janë kthi. Unë po flas tash edhe për shërbim tem ku kam qenë në protokoll e në siguri. Disa janë që janë kthi, disa... mandej unë e kom improvizu grupin se u kanë e vështirë me gjetë edhe njerëz në qat’ shpejtësi. Për shembull, kom pasë problem me lanë njerëz shtëpinë me rue, shkurt-shqip me rujtë shpinë sepse arsyt janë kanë të shumta.

Mandej ka fillu kjo mënyrë... takime, shumë takime, shumë vizita e kanë vërshu Rugovën. Edhe e dijmë ajo pritja si i osht’ bo Rugovës. Definitivisht, ai këtë triumfalizmin, ai s’e ka dashtë si natyrë, por ka pasë definitivisht statusin triumfal ia kanë dhanë. Atë duhet ta themi se ia kemi borxh atyne që populli e ka mirëpritë, e dini atë histori ose keni ndëgju. Dhe shumë takime, domethanë. Takime me t’hujtë, takime me administratën ndërkombëtare që ishte instalu në Kosovë, takime me sigurinë, KFOR-in, me shqiptarë, me bashkëatdhetarë të cilët u vërsulën në Kosovën e lirë, siç i thoshin ata, “Mirë u pafshim në Kosovën e lirë!” Në vitin ‘92, ‘91 na thojshin.

Dhe... sepse kontributi i tyne nuk mund të neglizhohet, domethanë ni pjesë e lirisë së Kosovës duhet t’i atribohet atyre, mërgimtarëve tonë të cilët definitivisht kanë kontribu shumë. Dhe mandej partia u ringjall, disa njerëz u kthynë, do s’u kthynë, fillun do mledhje të improvizume të partisë, kryesisë. Filloi ma jeta. Dhe mandej, tash s’po du me personaliziu po edhe çashtja e fatit tim personal, e kom pytë vetën, ku je edhe çka po don edhe kush je edhe kush po don me kanë?

Kaltrina Krasniqi: Pse kto pyetje?

Adnan Merovci: Sepse kalun dhetë vjet, s’ka ma Serbi, s’ka ma rrezik për Rugovën. Tash ka ambicie për pushtet, ka ambëlsina. Në ambëlsina vrapojnë shumëkush, e unë kom dashtë si kampion me u tërheqë prej Rugovës, qysh kam hy edhe si kampion. Kto mu ma s’pakti m’bjen me e thanë, por *I am sorry* [eng - më vjen keq]. Pak i takoj ni, s’po du me thanë fjalën popull se osht’ fjalë e madhe, po edhe shtresa e njerëzve që t’rrethojnë pak me xhelozina, me, “Tash ky s’len njeri me u afri, tash ky e shpallë vetën heroi, i vetmi që ka nejtë me Rugovën”. E jo, unë jom ai që kom ardhë pa e vet kërkond, kom nejtë edhe kom punu vet, por edhe tërhiqna pa e vet kërkond. Por...

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë ky... ky duhet... sigurisht momenti ma dramatik që keni pasë në jetë...

Adnan Merovci: Në fakt nuk osht’ dramatik, por osht’ ni vendim shumë i... shumë ndikus edhe n’jetën tem, n’personalitetin tem, n’figurën tem. Nëse po flasim për diçka para 20 vjetëve, para 20 vjetëve ka

ndodhë qikjo që po e flasim qitash përafërsisht. Dhe une prapë, jo që po e kom problem, po unë po duhna me dhonë shpjegim. Çashtja osht' shumë thjeshtë, shumë osht' ma e thjeshtë se që mundet me ndodhë.

Dhe, meqenëse ia kom nisë me këtë pa modesti prej fillimit në këtë farë paraqitje, du mos me u nalë hiç edhe me iu kallxu. Nuk kanë vdekë ende njerëzit. Të gjithë që e kryjnë ni punë me nderë e me pastërti e mendojnë që ma nuk kanë vend aty, dhe i kthehen shpisë e familjes. *That's it!* [Eng - Kjo është!] A muj une qita me justifiku? E tash ti thu ose dikush thotë, jo ka aty diçka, osht' ni arsye. Cila arsye mund t'jetë? E ka kërcënu UÇK-ja? E ka përzanë Rugova? Tek jonë idhu? Tek jonë sha? *My god, what is this? No.* [Eng - Zoti im, çka është kjo? Jo.] Jo, jo, jo. S'ka.

A kalun 20 vjet? Le t'del, le te thotë dikush ni fjalë rreth ksaj se s'rrijnë senet e mshefta. Shkurt edhe shqip ambicia jem për politikë ka qenë zero. Une ma koridoreve s'kom mujtë me nejt. As mosha, as figura, as... vike Schenger, ambasadori Christopher Hill, mu m'trajtojke si... a e kupton? Tash nuk jom une ma njeri i koridoreve, qysh prej... krejt osht' n'rregull po kanë ndryshu senet. Po une s'kom ndryshu në kuptimin e ambicies. Se une te kisha pasë ni ambicie për... kisha mbetë, një. E dyta... se dhetë arsye t'i tregoj, por njo s'di me ta tregu edhe vet sot me të vërtetë po, a dhetë po. Tjetër, a u kry ni punë, ni mision, a jom dëshmitar i çdo gjaje? *He doesn't need me anymore* [Eng - Atij nuk i nevojitem më]. A mundesh me kuptu qit' sen?

Kaltrina Krasniqi: Po.

Adnan Merovci: U kry puna. Une tash ja duhet me pasë ni ambicie edhe me sfidu edhe ata e me thonë *I am somebody* [Unë jom dikush] e me nejtë dhe ai me mbulue vetëvetën, mos t'thom tash po i mbron postet rreth Ibrahim Rugovës, se postet janë marrë me punë e kontribut. S'ka pasë nevojë ti me i thonë atij, t'bona qiky t'bona... ti ke punu edhe ti ki me qenë ai që je. Në struktura të partisë une nuk jom perzi si strukturë. LDK-në s'e kom mohu kurrë, bile kur kom thanë nihere, "S'kom mujtë me u anëtarësu formalisht". Ma kanë marrë në publik, m'ka kushtu me karrierë. T'u thonë, "Ky p'e mohon LDK-në". No. Por, une kom punu, veç kom punu.

Dhe ni moment është këtu pak i karakterit material dhe ka të bojë me angazhimin tim. Atëherë Kouchner³ pat' vendosë me m'bo udhëheqës të Telekomit të Kosovës. Kemi folë sepse u kanë... po flasim për vitin '99. Në fund dhe fillimi i 2000-tës, domethanë '99 ku donte ni njeri që e njef, sepse telekomi ishte veprimtari që s'munet me u vendosë ni, "Hajde ni konkurs te shpallim". Jo, jo, shkon me nominim dhe ata e vendosë Kouchneri. Niherë do këshilltarë të Kouchner-it kanë folë me mu dhe nifarë mënyre nifarë gjysëm pranimi e kom pasë une. Po kur kom folë me kryetarin m'ka thanë kryetari, "Ani Adnan edhe atje edhe këtu" "Jo," i kom thonë, "dyjat s'shkojnë, s'ka kohë ashtu, s'ka mundësi". Por, nuk osht' që e kom lypë lejën prej tij, nuk osht' që kom kërkim miratim prej tij, por veç osht' përmend kjo.

³ Një ndër administratorët e parë të Kosovës nga radhët UNMIK-ut, në Kosovën e pas luftës 1999.

Masandej unë i kom bo... kom kërku ni pushim prej tij. Ia kom formu të gjitha. Me kerre, sigurim, me komunikim, me KFOR e me të gjitha. I kom thonë, “Nja dhetë ditë po m’vyjnë me iu kthy familjes se... banesës, e bravës”, qityne seneve se 24 orë isha naltë në Velani. Tha, “Ani Adnan, mos u vono”. Edhe unë e kom kry qat’ farë pune, e kom mendue vet vetëvetën edhe ni vendim të paralajmërum vetëvetës ma herët ia kom vendosë edhe kom thonë, “Osht’ fundi im ku une du të tërhiqem, sepse unë s’kom mo çka me dhonë ma shumë. Dhe une po i kthehna vetëvetës dhe profesionit në PostTelekom”. Në ndërkohë ndodhën disa situata me çashtje të telekomit. Se në fillim e kishin vendosë dikond tjetër, tanaj e vendosën Agron Didën e në vitin... mas ni kohe mandej une u zgjodha. Drejtor tash veç i postave të Kosovës dhe unë vazhdova karrierën tem. Nifare profesionit që s’e kisha punu edhe kështu ka fillu çdo gja edhe jeta jem.

Mandej jonë ndërta faza, e fantazma e fjalë. E kom ditë, kom qenë i vetëdijshëm që mujn me lindë këto farë fjalësh, por nuk e kom ditë deri në qat’ masë që njerëzit... se ka të tillë që e dijnë që, “Kadal bre se njeri e ka kry ni punë edhe e ka kry”. Kanë thanë, “Qe prej qituhit deri qitu e kryva, tash po shkoj dikund tjetër”. Kjo osht’ arsyeja, *there is...* absolutisht s’ka tjera. Sepse këtë pyetje ia boj unë edhe vetit shpesh herë. A m’besoni që vetit ia boj qit’ pyetje? Dhe gjithëhere nuk e kom ni përgjegje, por janë disa.

Kaltrina Krasniqi: Çka keni bo brenda këtyne viteve?

Adnan Merovci: Shumë kom pasë turbulenca edhe në karrierë, domethanë... une jom ni njeri i realizum në jetë, se ndihna... realizimi në jetë është ndjenjë, ndjesi, nuk osht’ ngjarje. Jo, jo, ti s’e din une a jom realizu, se ti s’e din as a po realizohna qitashti. Realizimi osht’ përjetim i mbrendshëm, moment psikologjik. Dhe nëse qenka kështu, dhe unë po thom për veti kështu, atëherë unë jom i realizum se jom kompetent me folë për veti. Nashta po gënjej, por nuk lejoj epitelin e të parealizumit. Dhe kur thom, nashta po gënjej sepse osht’ ndjesi e brendshme, njeri din edhe me gënjy. Por, po iu betohna që s’po gënjej. Une e konsideroj vetën super të realizum në jetë por jo edhe në karrierë.

Çka do të thotë kjo? Çka osht’ karriera? Dhetë vjet kom ndjetë me Ibrahim Rugovën dhe për këtë punë edhe sot i nënshtrohem vlerësimeve të publikut edhe ballafaqohna edhe ndi përgjegjësi për çdo gja që qato dhetë vjet une jom vet, edhe jom kullë. Edhe kom merita edhe sot në qytet nuk kom t’hecun prej respektit që ma bojnë njerëzit për atë punë. Për shkak të korrektsisë. Ajo është një. E dyta, personalisht domethanë kom punu në telekom, po ja që në atë kohë në telekom m’shkoj Kouchner e erdh ky Steiner. Dhe ai e realizoi nifare moto, “Zero tolerancë korrupsionit”. Dhe ai kur zbriti në aeroport në mes të shumë njerëzve ai e kish edhe ni argat t’tina për qat’ zero tolerancë. Dhe ai ish Adnan Merovci, drejtor i postave.

Dhe unë fillova me i ndiq hajnat në postë dhe u mirrsha me ata që vjedhshin t’mirën publike. Dhe këtu kanë qenë të involvum edhe t’hujtë dhe vendortë dhe njerztë e mi dhe shoktë e mi dhe njerztë që kom punu për ta. S’kanë mujtë me marrë me mend, “Ti ke me Rugovën e s’nejte e ke punu, e tash po shkon

dikund e po don me çu luftë”. “Po, une po luftoj për antikorrupsion”. Ju s’e dini po une po iu tregoj që dy muj pa m’dalë kontrata më kanë suspendu. Pse kom folë në publik dhe e kom kritiku ministrin e atëhershëm, që s’ka qenë ministri po ekuivalent Zef Morinën.

Ni njeri, ni djalë që... ni shokë e mik e jaran. Pse? Me drejtorin gjeneral dhe me t’hujtë bojke mallverime. Edhe mandej t’hujtë se t’hujtë jonë vetë, “Pse po folë ti në publik”. Qikjo u kanë. M’kanë thirrë në *disciplinary hearing*, iu kom thanë, “Për me ardhë në dëgjim disiplinor? Duhet me ditë pse edhe me u pregadit”. Këtë letër iu kom çu, t’nesërmen u ardhë vendimi në tavolinë. Okej, unë kom bo ankesë, i kom paditë në gjygj për dy sene. Kanë kalu tani m’kanë thirrë m’kanë thanë, “Hajde kthehu edhe ni muj ditë” i kom thanë, “Jo se ju s’ma vazhdoni ma kontratën. Po trajtoman suspending”. Niherë duhet suspending me u trajtu tani *the outcome of this*, me kqyrë çka po bohet. “Ju as konkurs nuk guxon me shpallë. Se po e shpallni konkursin e ni vendi të suspendum që s’pe trajtoni. E ju s’keni fakte dhe argumente, kurgjo”.

Une i kom thanë tri fjalë në gazetë, i kom luftu fenomenet e kqija, ju po thuni, “Pse ke folë në publik?” Çka osht’ kjo? *What is this?* Cili osht’ argumenti i... se sot e kom, qaty e kom atë letër suspending. Okej, mos me e zgjatë vjen kontrata e shpallin konkursin. Kuptohet që une nuk jom kandidat. I qes në gjygj shkalltë e para fitoj, të dytat një fitoj, njo s’fitoj. Se dy padi i pata bo edhe qashtu okej edhe aty përfundoj ajo punë.

Rasisht e shoh ni konkurs OSBE-ja për ni kryeshef ekzekutiv, e shisha kryeshef kisha qef drejtor me u bo se si jo anglisht, shqiptartë kanë qef drejtor me i thonë. Edhe konkurova. Njohuritë e mia për zgjedhje kanë qenë sa tash për Jupiterin. E Jupiterin di bile çka osht’ pak. E thojsha, hajt po konkuroj veç. Por, jom pregadit shumë në intervistë dhe pak përvoja e ka bo që kur kom shku atje jom vlerësu dhe fakti që kanë vendosë t’hujtë. Bile, bile kom pasë konkuru veç me e pa a më mbajnë në mend t’hujtë, a e kanë memorien patologjike? Qe ky që s’ka nejtë urtë në postë, e s’ka ngu, e mos te pranojmë ashtu. Se këto ku te çojsh, ky s’po rrika rahat. Jo, m’kanë pranë edhe ata kanë qenë amerikantë që kanë vendosë.

Pa modesti apet, në 2004-tën jonë vlerësu zgjedhjet ma të mira në regjion. Sepse për herë të parë zgjedhjet në aspektin operativ iu lanë vendorëve. Tash unë... dhe unë kom qenë këshilltar i Pascal Fieschi në KQZ. Se KQZ-ja ka qenë hibride po kryesus me drejtë t’vetën ka qenë dhe unë si vendor, jo partiak kom qenë niveli ma i naltë. Ka kryeshef edhe tash, po roli i tij edhe ndikimi i tij osht’ shumë ma i vogël. Për qata mandej diqysh m’u rrit nami e kur i kanë thonë Rugovës... merreni me mend qat’ kohë, a muni me marr me mend që kom dalë me ni intervistë, rri shtremt e fol drejtë me moderator Adem Mikullovcin dhe kom folë diçka.

Pjesa e Nëntë

Adnan Merovci: Këtë që pasna fol në postë dhe jom suspendu, u mendojshin në KQZ me thanë, “Ky osht’...ky duhet me kanë neutral e ka fol te Adem Mikullovc kundër LDK-së edhe Ibrahim Rugovës”. *Mama mia, it’s too much* kom thanë, “Kjo osht’ e patolerushme”. Marcy Reese ka qenë udhëheqëse e zyrës amerikane edhe m’ka thirrë m’ka thanë, “Ti për qët’ punë jep dorëheqje edhe dhjetë vjet në Amerikë s’mun shkon”.

Sot e kom shkrimin në Kohë Ditore në fotografi në drekë që m’pat’ thirrë. Sepse OSBE-ja u çu n’kamë kanë thanë, “Ky osht’ njeriu kyç për zgjedhje, pa këto s’mahen zgjedhjet” se patëm trajnu e patëm motivu njerëz... *I’m so sorry*, nëse e kom marr ni veprim të ri une *rüfahrt* [Ger: mbrapa] nuk kom pasë, *the best one* [Eng - më i miri] jo i dyti, i pari gjithë edhe i kom arritë. Pra, për qata ndjehna i realizum, por rahat s’më kanë lanë dhe moslënia rahat... a munesh me marrë me mend kanë nënshkru nënkryetari i LDK-së me dhanë dorëheqje prej KQZ-së se se osht’ kundër LDK-së, *my God what is this?* [Eng - Zot i imi, çka është kjo punë?]

Edhe u çu krejt OSBE-ja... edhe zyra amerikane me m’pengu. Une i thojsha, “Nuk kom problem une, por nuk mbahen zgjedhjet kur ni parti politike nuk e don njeriun që i udhëheq zgjedhjet”. Në botëkuptim ata u çmendshin me qat’ qasje time, thojshin, “Po ti nëse e ki qit’ qasje *you are the right one* [Eng- atëherë ti je i duhuri]” “Po, veç në princip kom të drejtë une”. Se nëse dikush s’po të beson... merreni me mend thojshin, “Bon dallavere ky në zgjedhje”, s’osht’ me randsi. Tash gjithëhere osht’ ni arsye...

Kaltrina Krasniqi: Ni pyetje. Pse u ndërtu ky animozitet i LDK-së kundër juve?

Adnan Merovci: Pse, gjithëherë t’thashë osht’ ni arsye. Me vite, me vite m’u osht’ dashtë pse, me vite, e kom gjetë po po e thom shumë thjeshtë... Gjyste Vulaj e ka nifar’ kange Xhelozia, xhelozia (qeshë). Veç xhelozia, asgja tjetër, *we are jealous people* [Eng - na jemi njerëz xheloz]. Domethanë, me Rugovën ka punu krejt zotnillaku i tij pa modesti për me e kry këtë mision pa ambelsinë, njeri që din goxha shumë, a thu mos flet ky najherë? Hajde pak t’ja ungjim krytë që edhe me fol, i ultë, *understand?*

I am so sorry... kom vazhdu ma tutje, i kom majt zgjedhjet s’kom dhanë dorëheqje, zgjedhjet ma t’mira Kofi Anani na i ka lavdu zgjedhjet dhe ka thanë, “Zgjedhjet ma t’mira në Ballkan”. Peterseni ma ka çu ni mirënjohje për zgjedhje... mas kësaj u kry aty. Zgjedhjet, kur je në proces në ato rrethana ni mandat shkon, mandej nuk konkurova për ma tutje. Edhe mandej kom nejt pak poshtë e naltë, kom punu në do ndërmarrje private kom lypë vetën me u realizu andej këndeje, s’jom angazhu partiakisht askund.

Deri në fund në ni, në ni... kom provu me e lypë votën e popullit në ni garë për zgjedhje në vitin 2007, t’u u bashkangjitë masi që ka ndrru jetë Rugova kom thanë, s’kish ardhë në shprehje une i ri e me lypë vota e Rugova gjallë. Po në vitin 2007 me kolegën time të studimeve, shoqën e studimeve Edita Tahirin. Ajo e pat’ bo ni tërhjekje prej LDK-së bile e kom qortu shumë, sepse ajo u mendojke me e bo nifarë krahasimi me mu, i pata thonë, “Une... nuk osht’ as tërhjekja aq çlirim. Une e kom tërhjek angazhimin

tem, ti je në parti dhe me u shkëputë prej ni partie t'madhe osht' rrezik i madh". "Jo, Adnan, une po du vet, e kom..." dhe e ka pasë kauzën e mirë se dojke ni diversitet, e ni...

Dhe m'ka thirrë e jom shku për hatër t'saj i kom ndihmu. Jemi hi edhe kemi dalë në gara. Problemi ka qenë që në gara dul pragu dhe në prag si parti s'ka mujtë. Dhe une t'u i njoftë zgjedhjet i kom thanë, "Duhesh edhe aleati i parë osht' LDK-ja edhe shko provo", po LDK-ja... s'ka dashtë Fatmir Sejdiu me ndi për këtë punë, s'e kanë pranë në koalicion. Ka qenë me... ka provu mandej në koalicion me Listën Ora, ka qenë atëherë. Ka qenë problemi i vendit t'parë edhe t'dytë, Vetoni i pari, kjo dojke e dyta, Ylberi thojke, "Jo, une i dyti" edhe ajo ra.

Me Pacollin ka dështu, metëm a po hijmë në zgjedhje a jo? I thashë, "Une kurrë në zgjedhje s'kom dashtë me hi, une për ty jom ardhë". Në moment të fundit kjo u hy në pullaz të PDK-së si koalicion. Po e keqja u kanë që ajo si ankronim u kanë veç PDK, kjo u kanë parti e vogël, kjo u kanë parti e vogël s'kanë mujt me u faktorizu që me shku koalicioni PDK-Alternativa Demokratike, a qysh e ka pasë partia e saj dhe si PDK. Tash krejt e kanë ditë që... po shpesh herë edhe kanë luftue që kjo hini me PDK.

Ajo koha e dëshmoi që po, se mandej ajo hini aleancave e krejt por edhe emri jem ka qenë për deputet, që ju s'po e dini, i kom marrë 7 mijë e 200 vota, janë goxha vota. Adnan Merovci me lypë votë për ata që s'din që duhet me votu PDK-në, it's *too much*. Kom marr ma shumë se anëtarët e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, e s'po i përmendi emrat se s'o me randsi. Po pse p'e përmendi kta, sepse kjo tash na qenka ni parti e dalun nga... pra, nuk osht' që kom bo najfarë fushate ku ta di unë. Njerëzit e kanë ditë, por pragu i madh. Tash në disa zgjedhje do vota janë kanë pasë pshtill poshtë e naltë e sene.

E kom ofru pragun edhe me dorëheqje e kisha po unë jom tërhjekë mandej edhe... domethanë, kjo osht' ni fakt që njihet por edhe me qat' numër. Kjo flet për kualitet domethanë, jo kualitet s'po thom personal timin po kualitet, le të themi, të peshës së votës që me 7 mijë e 200 vetë se kom mrrri kuoten me hi në parlament, se ajo osht'... sistemi zgjedhor që e përcakton. Tash une ato i di mirë qysh shkojnë, por po du me thanë që për shembull ka deputet edhe me shumë ma pak vota që... dhe vjen '98-ta shpallet konkursi në Postë Telekom...

Kaltrina Krasniqi: 2008?

Adnan Merovci: 2008-ta m'fal. Dhe nostalgjia jem për telekom dhe për qat' pozitë të drejtorit jom dalë i suspendum me u kthy me ni çantë. Aty kish qenë rehabilitim i madh edhe personal dhe publik dhe kom konkuru te t'hujtë, t'hujtë janë pytë se '98-ta [mendon 2008] hala s'u krijue pavarësia, po flas për fillim, dhe intervistat i kanë bo t'hujtë. Kemi ardhë dy kandidat, une edhe profesori i Besës, Edmond Hajrizi ni shok i imi i ngushtë. Ata e përkrahshin vendorët edhe ndërkombëtarë, mu vendorët edhe kemi ardhë *cic-mic* {onomatope}.

T'hujtë thanë, “Bone ligjin e ju për ndërmarrje publike, e keni hazër, shtetin e shpallët, në këtë periudhë derisa të aprovonë këtë ligj. Qita dy kandidat, cilido bon”. Qeshtu ka mbetë. Si u aprovu ligji meniherë ma dhanë mu mandatin dhe fillova. Presidenti i kohës Fatmir Sejdiu ka qenë njeriu që s’osht’ nda i knaqun me zgjedhjen time dhe ka bo presion në Ambasadë Amerikane. Ambasada Amerikane përmes qarqeve të ndryshme... kjo osht’ njo prej arsynave që kom papapërshtatje, pa *welcome*, pa mikëpritje. Janë tutë që une i hi postës tash edhe i njeku hajnat apet.

Kanë pasë ata hajnat e vet nëpër postë, por kanë gabu se unë tash po shkoj me menaxhu jo me luftu, s’kanë ditë. Kom kërkim mirëkuptim e s’ka hecë, mandej kanë qenë edhe disa projekte në postë që m’kanë bo domethanë mos me pasë kurajo. Dhe kur e kom pa që LDK-ja në bord të PTK-së po e stopon kandidatin për me ardhë në mledhje... se kryeshefi ekzekutiv i postës, unë i zgjedhun me kontratë tri vjet, pesë mijë euro rrogën, në mledhje të referimit të bordit kandidati i LDK-së nuk po vjen. Edhe tash i njejtë i ndodhun sikur për zgjedhje, presion domethanë. Dhe nuk po vjen, sepse presidenti i madh Fatmir Sejdiu, t’cilin e kom mbajt në ‘96-ten n’krahë kur ka bo ndeshje dhe kom bashkëpunu dhe komuniku me to dhe duhet t’ketë edhe obligime personale se osht’ normale, ka qenë kundër dhe të deleguarën e vet asokohe në bord të PTK-së e ka stopu me shku nëpër mledhje. Dhe ajo osht’ bojkot.

T’u ma njoftë temperamentin, se mu mjafton me m’kqyrë mrrolt edhe une s’rri ma me ty, se osht’ puna që i mrrolt jom vet une edhe në moment unë kur jom tërhjekë prej Ibrahim Rugovës nuk ka situatë tjetër që... ma provokative, ma të omël se ai. Kur te shoh vetën që *it’s enough*, dhe kur e kom dhanë dorëheqjen në bord, mas gjithë asaj pune t’bome, kryetari i bordit u shtangu, s’ka mujt me marr me mend se s’e ka ditë, dhe nuk e ka pranë dorëheqjen ka thanë, “Jo, jo, jo nuk muj”. Megjithatë, mandej në konsulta, mas ni jave kur u majt mledhja e kanë aprovu se e kanë pa që ajo osht’ ni vendim i jem.

Por, tek atëherë bordi e ka kuptu, se unë ju thojsha, “Nuk ka disponim këtu për mu, edhe nuk ecë kështu kompania, edhe nuk du unë zhegrave me u... ju lemni mu n’teren të menaxhimit edhe qaty ku duhet. Si t’më shihni mu po t’përkrahë, s’po t’përkrahë, me menu unë andrra poshtë e naltë, *no*.” Dhe edhe kjo fati unë u dorëhoqa mas dy mujve, bile dy rroga s’mi dhanë t’plota, ni rrogë e gjysë ma kanë dhanë. M’ka përcjellë tani ni turbulencë edhe financiare edhe ku ta di unë, se familja e madhe hajde de, e shpija edhe ni banesë e kallabllak, pata hy ni kredi e çka po di unë, po kto janë personale. Por sido që të jetë, në vetsh për mu edhe për karrierën edhe për krejt kto, janë ato turbulencat.

Derisa ni punëtore KPM-së vjen edhe m’thotë, “Adnan kem nevojë për ni kryetar. Kryetarin e zgjedh parlamenti po ti je njeriu që... i duhun për atë punë”. Ajo ka qenë ni ish kolege e jemja në KQZ dhe për herë të parë të parë këtë send po e thom, ajo ka qenë shkasi që veç ma ka qitë ndërmend se edhe KPM-ja për mu ka qenë kuptim abstrakt. Megjithatë, jom shku. Kur kom shku, kom konkuru, jom nominu ni ditë para intervistës. Ni ditë para intervistës m’ka thirrë kryetari i komisionit që ka me na intervistë, m’ka thanë, “Adnan a e din që nesër ki intervistë?” I kom thanë, “Po”. “Pse s’po m’thret?” Deputeti bon me u thirrë, bon deputetin me e thirrë me i thanë, “Ndihi mom edhe përkrahëm”, se ai osht’ i zgjidhun me votë, kur ka pasë nevojë ty t’ka thirrë thirrë edhe ti thuj ndihmom, me meritë e

krejt. Thotë, “Pse s’po lajmërohesh?” {rrudhë krahët} “Pashë zotin, a e ke lexu Ligjin e KPM-së?” Tha, “Nesër ki provim, lexo s’paku qato. Qysh s’ke thirrë? Qysh?”

Une nuk e kom ditë që zgjedhja bohet me lobime, që duhet me... jo bre, Adnan Merovci jom, vij në intervistë, qaty në intervistë ndash t’qes n’gjumë, ndash t’shti me kajtë. Kur t’vi në intervista, nëse s’vi dije që s’jom pregadit. A erdha në intervistë, ma në zor kanë qenë komisionet prej meje se une vet. Tash, e kom këtë dhunti sido që të jetë. Kom shku në komision, në komision vëzhgus kanë qenë të Komisionit European. Kur u kry me t’gjithë kandidatët u dalë kryetarja e Komisionit European për nevoja fiziologjike, përfaqësuesja e Komisionit European i ka shku mas edhe i ka thanë... thotë, “Veç ni pyetje e kom...” thotë, “para se me fillu ju me i bo ato që i keni...” thotë, “Kush o i pari?” thotë, “Merovci” thotë, “Ditën e mirë!” E lëshon mbledhjen edhe *she is fine* [Gjithcka ka qenë në rregull me të].

I ka interesu se tash domethanë i ka pa gjithë të intervistumit, unë i kom pëlqy ma s’shumti edhe osht’ frigu mos me m’u bo e padrejtë, ajo vëzhgusja qat’ detyrë e ka. Jom zhgjedhë, jom hy në garë s’kom lobu hiç. Në parlament po dufke me lobu, për dy poena s’jom zgjedhë. U anuloi konkursi, u rishpall edhe niherë hina apet i pari. Tash, fola me do apet e ma bojshin, “Ju ka mbetë hatri, pse Adnani ty t’ka thirrë, e ty jo?” Deputetët po dufke tonë me i thirrë. I thirra do pak ma shumë edhe më zgjedhën, kalova, katër vjet kryetar i KPM-së. Anëtar po aty në... prej shtatëve mandej, mandej isha kandidat edhe u zgjedha kryetar. Katër vjet kom nejt në KPM, në KPM. KPM-ja është në rregullator. Ka qenë lami e re.

Tash, me përvoja t’mëdha njeriu edhe përshtatet, se mediat për mu nuk kanë qenë kuptim abstrakt e i panjoftun me krejt përvojat që i kom pasë, por rregullimi i mediave po. Une e kuptoj çka është frekuenca, e kuptoj çka është rregullorja e ligji se kom punu në KQZ edhe kemi hartu rregullore, akte normative edhe pse *backgroundin* [prapavinë] e kom master në elektroteknikë jeta m’ka çu në kto sene. E di çka është rregullimi, e di çka është vendimi, akti normativ e tjerë, e tjerë, e tjerë. Dhe mendoj që e kom luft ni rol... sepse KPM-ja ka qenë e paqëndrueshme, sepse gjithëherë i ka mungu ni kryetar. S’ka pasë forum, ka pasë zhurma t’mdhaja, procesi i digjitalizimit i ka iritu industrinë.

Unë mendoj që e kom bo ni qetësi, e kom qetësu institucionin. Nuk ka pasë afera e fjalë, janë nalë ato zhurmat në publik. Kom qenë shumë komunikativ me media, me industrinë. Gjithëherë ju kom thanë, “Na jem për juve, jo anasjelltas”. Por, ky është në institucion i pavarur kushtetues që mirret me këto. Mendoj që aty e kom lanë ni mesazh t’mirë për katër vjet. Dhe në kohën kur po flasim, unë jom ligjerues në ndërkohë në Kolegjin UBT, ku kryesisht i kam landët e mediave dhe mirren me rregullim dhe menaxhim. Domethanë, landët që kanë t’bëjnë me rregullim të mediave dhe...

Une nuk jom ni ekspert i gazetarisë, le të themi, dhe momentalisht po luftoj për ni titull të doktoraturës në lami për gradë sepse më duhet. Edhe pse pak vonë e në pleqni, s’e kom për karrierë se s’më duhet. Unë veç po realizohna nuk kom mo... kariera jem... une nuk ndërtoj karrierë mo. Kurgjo. E ndjej vetën

të aftë me punu ende, në menaxhim kryesisht kom qef edhe në mbikqyrje bon. Do m'i kanë përmend diplomacitë e m'kanë thanë... po unë ambasador goxha i mirë isha kanë, por ambasador s'munesh me u bo vet, të bojnë. Për me t'bo duhet pak me e pasë nifarë lobimi. Kom pasë komunikime, kontakte me Ministrinë e Jashtme edhe me qarqet vendimmarrëse, jom nifarë pritje po jo shumë i nxehtë. Bohet bohet, s'bohet shnosh.

Kaltrina Krasniqi: E kom ni... 20 vjet jemi larg prej qasaj partie që faktikisht e keni majt në kambë...

Adnan Merovci: Jo, nuk thom kështu. Unë s'e kom mbajtë partinë në kambë, unë kom qenë afër partisë të qatij njeriut që ka qenë kryetar, u kanë kryetar edhe i partisë.

Kaltrina Krasniqi: Ka ndodhë aty, n'mes kanë ndodhë dy ngjarje shumë të randësishme. Njo osht' rizgjedhja e Ibrahim Rugovës dhe e dyta është vdekja e tij. Po më intereson qysh kanë... qysh i keni kalu qato dy momente? Sidomos këta të dytën, vdekjen e Ibrahim Rugovës.

Adnan Merovci: Tash rizgjedhja e Rugovës ose konfirmimi, sepse projekti i tij ka qenë, "Liri, Pavarësi, Demokraci!" Porosia jem prej Rambujesë ka qenë me u tërhjekë, sepse Rambujeja s'ka sjellë pavarësi. Dhe ky t'u qenë "Babai i Pavarësisë", që une e kom konsideru dhe këtë prej momentit që është mbajtë konferenca e Rambujesë dhe e kom pa që është njeri që i ka punu edhe i ka besu idesë për pavarësi nga Dayton-i e knej kom thanë, "Rri simbol i pavarësisë dhe tërhiq prej çdo aktiviteti". Ka thanë, "Adnan, liri, pavarësi, popull, demokraci. Duhet në demokraci". Tash qajo pavarësi është... shkojshim te pavarësia se u dije që u punojke, plani i Ahtisarit e tjera, e tjera.

Dhe fundi fundit, institucionet dhe kryetari i Kosovës, por jo Kosova e pavarur. Dhe duhet me i ndihmue demokracisë dhe për këtë aryse ai u kyç. Përndryshe, une... s'po di, nuk e kom përkrahë që ky me hi në gara për vota në ni treg çfare ka qenë tek ne, jo pse iu kom frikësue fitorës t'tij, por i kom thanë, "Rekruto ni njeri, kundër dikujt se është treg tjetër. Dikush don, dikush s'don. Ai të shanë, ai grusht, ky grusht. Ti s'je njeri i tillë".

Megjithatë, ai osht' n'thojza, "sakrifiku" për me i kontribu demokracisë dhe këtu ai ka pasë të drejtë. Populli e ka thanë dhe kjo është nifarë barometri që tregon nivelin e popullit, jo të Rugovës shumë. Sepse, definitivisht ni popull i dalun prej ni lufte, domosdoshmërisht historia nuk mbanë në mend fitore të ni grupi tjetër, le të themi, që cilësohet që s'e ka përkrahë. Por këtu flitet për, këtu flitet për vetëdije, sidomos kolektive. Dhe unë mendoj që këtu ka fitue Kosova dhe shqiptaria, këtu s'ka t'bojnë partitë në sensin çfare po e thom.

Mandej çashtja e shëndetit të tina... okej, ajo osht' si me thanë, si me thanë ni rrjedhë e jetës që deri në atë moment quhet rrjedhë e jetës, mandej quhet rrjedhë e ndrrim jetës. Une personalisht... janë dy momente, njo osht' personalisht ndihna pak keq sepse unë jom kanë shumë i përkushtum ndaj tij dhe kjo s'do të thotë që tjetër mas meje s'kanë qenë të përkushtum se qata njerëz unë i kom caktu, i kom

lanë aty, në çashtjen e veprimtarisë edhe aktivitetit që e kom bo une. Jo që une kisha mujt me bo diçka tjetër, ose... fundi fundit une besoj në Zotin dhe mendoj që ato punë janë pak edhe çashtje që lidhen me besim te Zoti.

Por, çka që hajt me mashtru vetën me thanë që paska shkak e shkas. Qysh e kom kuptu ai ka qenë m'doket i ka parapri ni qëndrimi në bregdet, ni zonë të Italisë të ftohtë ku osht' ftohë si duket, ka marrë ni ftohje të thellë dhe kjo ka qenë si ngacmim, po thom si shkas. Po edhe kjo e thom veç kështu si përfundim. Por e thom për katarsis shpirtnor, sepse ndihna keq pak që... s'di pse thom, që t'kisha qenë une s'e kisha lanë qatje me shku edhe thu se ia kisha zgat nja dy sahat jetën edhe ish bo nami. Jo, por megjithatë edhe unë jom njeri dhe ndjehem pak keq për këtë send, por në anën tjetër unë mendoj që Rugova e ka kry punën e vet, misionin e vet.

Nuk... mu nuk më pëlqejnë fort fjaltë kur thojnë, "T'ish konë Rugova, me pasë konë... A ka nevojë Kosova tash për to? T'ish konë Rugova, a ishin leju qito?" Nuk i përkrahi qito sene. Une thom që Rugova e ka kry misionin e vet dhe ne me Rugovën duhemi me u marr veç me zbërthim të figurës, të idesë të tij, me e njoftë dhe me pru konkluzione. Që ky njeri i cili del edhe vjen prej ni vendi ku Janjevën e ka 30-40 kilometra larg, e cila në kohën kur ka qenë kalldërm krejt Parisi ka qenë në puqillë. Dhe Janjeva është vendi ku ka histori Pjetër Bogdani që ka studiu. Dhe ni njeri që ni shtet, nëse asnjë tjetër, ni shtet që quhet Francë me opinione t'stilit të nivelit intelektual që kanë ndiku që Chirac të intervenojë, se vetëm elitat e opinioneve veprojnë në Francë, se Franca funksionon ashtu.

Dhe ky njeri po ndrron jetë, normalisht që është ni njeri që edhe në histori edhe si qenie njerëzore... për qata edhe osht' pak... jo osht' po në fakt vet figura e tij edhe refleksioni i tij prej njeriut me tipare të profetit që osht' manifestu veç në reflektim... une s'jom i zoti me thanë që Rugova osht' profet, se për me thanë une duhet me kanë ma i zoti pak se që jom. Këtë s'muj e thom. Por, që ka pasë rrezatim profetik, po se po. Dhe këtu ka pak edhe emocion, ka pak edhe mitizim. Por, krejt kjo e përshkrun figurën e Rugovës i cili ka kriju vlera, ka bo vlera. Dhe me përfundu rreth figurës t'tina, unë kom thanë disa herë, është e vrazhdë pak me e thanë por kanihere senet për me i çu deri në skejt duhet me i thanë thjeshtë. Ni atentator që kish taku Rugovën para ekzekutimit të urdhnit të tij ni minut kish hjekë dorë prej atij veprimi, kushdo që kish qenë në rruzullin tokësor.

Kjo flet që ky njeri e ka pasë nifarë rrezatimi, se njerëzit tash flasin e thojnë e... kryesisht dy sene që i përmendin, "E jo bombardimet, e jo e ke kundërshtu luftën, e jo s'ke qenë në Prekaz, e jo ke thonë UÇK-ja dorë e zgjatun e Serbisë". Unë kurrë këto sene s'i kom ndi prej gojës të tij, as prej rezonit të tij. Ky ka qenë i politikës edhe qysh e kom thanë ma herët, politika dhe strategjia e tij me Amerikë ka qenë ni luftë e vogël. Lufta e vogël ka qenë me përkrahjen e Ibrahim Rugovës në mënyrë publike që njerëzit mas 20 vjete fillojnë tash me menu kah pak. Dhe duke qenë kështu kuptohet që ka pak edhe nostalgji edhe sentiment këtu që themi Rugova vyn, e i ka vyjtë Kosovës. Por në aspektin tjetër Rugova e ka kry misionin e vet, *he's fine*. Ai është ni njeri që i ka vnu vule për ni kohë shumë të shkurtë, shumë se shkurtë është po mos të harrojmë që po flasim për shekullin e XXI. Skenderbeu 20 e sa vjet ka majt...

Kaltrina Krasniqi: Praktikisht ke t'u e përmbyllë... poenta juj është se Rugova... nuk ishit dashtë me mendu çka kish bo Rugova sot, për shkak se misioni i tij osht' finalizu sipas juve. Mirëpo unë e kom ni pyetje qitu, ju keni pasë raport intim me të në sensin që ka qenë dikush me të cilin në kohna jashtëzakonisht shumë të randa i keni nejt shumë afër. Mandej ka ardhë ai momenti ku ju jeni sqaru që keni pasë nevojë me pasë jetën e juj ma në fund ose ma mirë me thanë me u rikthy jeta juj në durë t'juja. Mirëpo, mandej keni vazhdu edhe jeta juj ka ndodhë çka ka ndodhë edhe jeta e Ibrahim Rugovës. Po më intereson a e keni ndërpre plotësisht komunikimin apo ka ekzistuar prapë ai komunikim edhe po më intereson intimisht qysh jeni ndje në ditën kur ai ka vdekë...

Adnan Merovci: Po...

Kaltrina Krasniqi: Se ka qenë ni shkundje, jo veç për juve që keni punu me to gjatë qasaj kohe, por edhe për krejt neve.

Adnan Merovci: Në fakt, në periudha kur une jom tërhjekë prej aktivitetit tim dhe kur them jom tërhjekë është tipik tërhjekje. Domethanë, nuk po du me ma iu kthy por s'di pse po ndjej ndonjëherë nevojë me rijustificu disa gjana. Se fjala jom tërhjekë jep me kuptu që osht' ni vendim i yti dhe vendimi për me u tërhjekë ka qenë vendim i jemi i plotë, i pathanun po i ndodhun për shkak që e kom vrejt që qajo është fundi jem në aktivitet me to. As nuk jemi nda keq, as s'ka pasë konflikt, as s'ka pasë ni arsye që une tash muj e thom s'muj e thom.

Dhjetë arsye janë, po njo nuk osht'. Dhe kur janë dhjetë, gjithherë osht' qiky rrezoni që po e thom. Dhe unë mendoj që e kom gjetë, se edhe vet kom pasë problem njerëzve me iu justifiku. Për besë shumë sinqerisht po e thom, kur më ka ra në mend që njerëzve duhet me iu thonë, "O burra nuk e kom ni arsye se s'kom, o të isha friku e po frikohna une". Une e thom po frikohna se frika është njerëzore edhe po e thom ni send njerëzor. Jom konë trim e s'kom mendu në tutë, dikur une s'di çka pse me u frigu.

Se a din njerëzit... jo... kërcënim. Kurrë në histori teme prej kërkujt s'kom pasë se edhe kërcënimi është që mund t'len pasoja njerëzore, vështirë pranohet. Po valla mas nja 20 vjetve e kisha thanë ose fundi fundit janë bre njerëzit. Qe del njeri... facebook-un e ki, ai ka dhe mund të thotë çka don, por le t'del dikush edhe në format t'cilat në mënyra të komunikimit le të thotë po rren se e kemi kërcënu na, jo na i kemi thanën që... edhe... pra, ka qenë ni vendim i jemi autonom qysh ka qenë vendimi për t'u kyç. Jeta e tij ka vazhdu, unë nuk kom qenë... unë e kom përcjellë politikën. Politikën e përcjelli çdo sekond. Por, une e kom pa edhe e kom ditë që ai osht' në peshën e vet specifike në rrethana tjera.

Rugova kurrë s'e ka rritë as s'e ka ulë vetën. Gjithëherë ka nejt në peshë specifike që e ka pasë, por edhe iu ka përshtat. Në kohën kur ai ka qenë president, unë kom qenë në aktivitete tjera dhe une si natyrë nuk e kom t'sillna tash qasajde. Sepse jom ni njeri që kom punu qat' kohë dhe çdo gozhdë që

osht' vnu aty dhe çdo bari që osht' mjellë... nëse s'jom autor, jom udhëheqës i qasaj. U kry ai mision, u kry ajo punë une s'kom çka sillna asajde ai domethanë osht'...

Mandej, une menihere jom gju në zgjedhje edhe zgjedhjet më kanë marrë ni kohë, se shumë kemi punu, kemi pasë shumë trajnime ku ta di unë. Mandej, edhe vet procesi zgjedhor të bon pak... pak të edukon që është qashtu që mos me majt edhe kontakte se s'ka lidhje kjo me atë send me atë punë. Bile, bile kur ka ardhë puna te zgjedhjet, Rugova ka thanë, "Ma mirë Adnani se ai osht' i zoti..." edhe për në postë bile ka pasë thanë, "Ma mirë se s'na kputë telefonin", se gjithë ia kputshin telefonin për pagesë. Ai pagujke, qatij që pagujke atij ia kputshin.

Edhe tash ndrrim jeta e tij ose kur ai veç ka ra në shtratin e ndrrim jetës, se dihen disa sene, kuptohet... unë e kom kuptue si, si ose e kom ndje si... okej si ni proces se e thashë mund t'bohna nifarë teoriku n'krejt ktëë, në kuptim edhe të ni ndjesie të spontanitetit e nonchalancës, jo. E kom ndje që po mbesim pa një njeri edhe pa një vlerë shumë të madhe, që veç ni gërrham e tij, veç ni fjalë e tij, veç ni frymë e tij i kish vyjtë Kosovës në kuptimin, le të themi, edhe moralo-rehabilitues. Por, në fakt unë e kom konsideru që ai e ka kry misionin e vet.

Tani shumë gjana lidhen rreth procedurës, ceremonisë, vorrimit e ku ta di une. Edhe njerëzit m'kanë pytë, m'kanë thanë, "Pse s'të kem pa në vendin ku osht' vorros?" Ose me thanë, "Pse s'e ke pasë ni konop ti kur e ke gjithë atë kontribut?" Ju e dini që janë konë pasë avancu senet e osht' pasë kriju protokoli i shtetit edhe ato janë kanë sene të parapame mirë shtetërisht. Mu kërkush s'më ka parapengue. Por une i kom kry ritet e mia të ngushëllimit, shkumjes edhe në kuvend po edhe në vorrim, por nuk jom kanë në plan të parë a e kupton? Dhe këtë e kom pasë edhe në publik këto farë senesh. Kështu që, unë i konsideroj ato... e kom kry misionin tem, une e kom ditë ku e kom pasë vendin tem në këtë send.

Une tash nuk marr turr pse ai ka ndrru jetë edhe me shku, fundi fundit tash ajo është pak çashtje protokollare, çashtje familjare i ni bashkëpunëtori që është shumë i rëndësishëm që ka qenë edhe e njeh publiku edhe goxha i veçantë... nashta edhe t'isha kanë tip tjetër une isha kanë aty, por domethanë m'u ka dokë si... se kom pasë këso pytje edhe bile bile goxha si me grep edhe goxha me hatërmбетje njerëzit t'u mendue thu ti se une kom nifarë, nifarë arsye, çka po di, kur vjen njeri deri te... se kanë shkue edhe për njeri të madh fliten këto gjana. Gjithçka osht' pastërt.

Une kom kontakte me familje, une e vizitoj familjen vazhdimisht, kom respekt t'madh për ta. Senin ma së shumti që pritoj osht' që kur të shkoj në familje, pesë minutat e parë janë gjithëhere të vështirë se zoja e shpisë nuk ndahet prej vajit kur t'më sheh, se saherë shkoj thotë, "Ku osht' Ibrahim? Ku e le Ibrahimin?" Domethanë, osht' ni komunikim edhe mas save që ka vdekë, sepse figurën tem kur te sheh ajo e sheh kryetarin. Sepse figuren tem kur te sheh ajo e sheh kryetarin se e mbanë në mend. Dhe ajo shpesh herë ka thanë se s'po du tash me i citu fjalhtë, po thotë, "Ma i afërt ke qenë ti edhe ma intim ke qenë ti, se une në shumë situata".

Ajo ka qenë ni periudhë dhjetë vjeçare që nuk... për kohën edhe për shekullin XX edhe XXI nuk osht' periudhë e shkurtë. Ni dekadë osht' shumë në krahasim me përpara. Koha si si term fizik osht' i njejtë si atëherë si tash po Ajnshtajni e shpjegon këtë me teorinë e relativitetit, dallon ni sahat me ra shi edhe ni sahat me nxe dielli kudo që të jetë, e le mo dhjetë vjet përpara. Kështu që, e konsideroj vetën goxha të pasun me këtë karrierë që historia m'ka dhanë rast që siç e thashë që dy milion shqiptarë kanë qenë të gatshëm me qenë në rolin tim. Disa thojnë, "Bravo që ke ndejtë e ka qenë rrezik". Disa thojnë, "Ke pasë fat". Disa thojnë, "A je i vetëdijshëm..." disa...

Por, ajo që du me përmbyllë osht' çashtja, ndihna mirë edhe për ni arsye, le të themi, të faktit historik që mbetet pas njëqind vjete. Nëse flitet që ni argat i Rugovës ka qenë me master, dhjetë vjet përvojë pune, s'ka qenë keq me pare dhe i mirë në familje dhe në themel nuk flitet ma për atë njeri, por flitet për Ibrahim Rugovën. Siç mund të themi tash që, po e zojmë, Hasan Prishtina paska pasë ni shok ose ni njeri që e ka vozitë, e paska qenë mirë financiarisht ai, paska qenë me shkollë goxha të naltë e me punë goxha të madhe po e paska vozitë Hasan Prishtinën. Nuk flasim ma për atë shoferin, por për Hasanin. Pra, Hasani paska qenë i vlerësuar. Le të jetë kjo edhe ni shenjë që një njeri i tillë paska vendosë me kanë argat i tij në situata pa mekanizma.

Sigurtë, unë t'i kisha pasë mekanizmat ndryshe ish kanë. Ia kom fshi këpuctë, ia kom vozitë kerrin, ia kom hekurosë kmishën, i kom qitë me i la floktë, e kom përcjellë, ia kom ndreqë shallën, kur m'ka vetë i kom folë diçka, i kom thanë qiknej s'bon po qiknej, i kom thanë, "Urdhno qitu ulu!" S'e kom urdhnu, po ia kom tregu vendin. Kom qenë i vetmi njeri që kam mujtë me ia ndrru vendin kur u ulë, se u kanë i randë shumë, i vështirë u kanë Rugova me punu me to. Ka pasë karizmë, aurën e ka pasë t'randë. Ai ka qenë shumë njeri i thjeshtë, por t'ka preokupu, u kanë e vështirë me to me... e unë herë me humor kaniherë... mandej edhe une vet jom njeri pa karizmë edhe tash t'u mos pasë karizmë... njeri pak ma specifik, pak ma, në thojza "i ashpër" pak ma... e tash me ni njeri të tillë goxha problem. Por, une e di që ai ma ka njoftë punën time edhe t'u ma njoftë punën time, une e kom marr edhe nifarë hallalli prej tij, nifarë... dhe ndihna plot.

Sot në atë aspekt, pa keqardhje më kujtohen disa momente, por kur më kujtohen momentet që iu thashë disa, vendimi jem për me ndejtë, kthimi jem prej Shkupit edhe lufta jem për mos me nda me familje, goxha m'shërbejnë nifarë freskie në ndërgjegje edhe në këtë katarsis shpirtëror.

Kaltrina Krasniqi: Shumë faleminderit zotri Merovci.

Adnan Merovci: Faleminderit juve.

Kaltrina Krasniqi: Ka qenë shumë kënaqësi.